

ISSN 2220 - 461X

Viti i IX-të i Botimit, Nr.1, Qershor 2018



OPTIME

Tiranë 2018

KRYEREDAKTOR

Prof.Dr. Anesti Kondili, Akademik

ZV.KRYEDAKTOR

Prof.Asoc. Dr. Fatmir Tartale

REDAKSIA

Dr. Erda Qorri	Kordinatore
Dr. Eglantina Dervishi	Kordinatore
Prof Asoc.Dr. Manuela Meça	Antare
Prof Asoc.Dr. Remzi Sulo	Antar
Prof Asoc.Dr. Aida Dama	Antare
Dr. Genta Rexha	Antare

BORDI DREJTUES

Prof.Dr. Vera Ostreni	Prof. Livio Gallottini (Romë)
Prof.Dr. Pavli Kongo	Prof. Giovani Gravina Manes (l'Aquila)
Prof.Asoc.Dr. Bedri Kola	Prof. Gilberto Sammartino (Napoli)
Prof.Dr. Gjovalin Shkurtaç Akademik Asoc.	Prof.Asoc. Giorgio Croatto (Padova)
Prof.Dr. Hamit Boriçi	Prof. Maria Grazia Cifone (L'Aquila)
Prof.Asoc.Dr. Argita Malltezi	Prof. Giuseppe Marzo (L'Aquila)
Dr. Ismail Tafani	Prof. Roberto Gatto (L'Aquila)
Dr. Elona Kongo	Prof. Massimo Galli (Romë)
Dr. Dorina Shengjergji	Prof.As. Vincenzo Calderone (Piza)
Dr. Elisabeta Kafia	Dr. Stefano Fogli (Piza)
Dr. Ndrëim Mehmeti	Prof. Enrico Camillera (Palermo)
Dr. Doriana Pano	Prof. Aldo Schiavello (Palermo)
	Prof. Dr. Alexander Bucur (Bukuresht)

REDAKORE LETRARE

Prof.Asoc.Dr. Anila Kananaj

ARTI GRAFIK

MSc. Ilirjan Mullaj

ISSN: 2220-461X

© 2017, Albanian University. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Botime Shkencore të "Albanian University"

Adresa: Bulevardi Zogu I. tel. +355 4 2271601 e-mail: kerkimi_shkencor@albanianuniversity.edu.al



Shtëpia Botuese Albanian University Press. Adresa: Bulevardi "Zogu i Parë", Tiranë, Albania
Mobile: +355 (0) 696075580
e-mail: albaniauniversitypress@gmail.com, www.albanianuniversity.edu.al,

PËRMBAJTJA

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

KONTURI FACIAL I REGJENERUAR ME LIPOFFILING: PROTOKOLLI I NJË SISTEMI TË MBYLLUR

FACIAL CONTOUR RECOVERY BY LIPOFILLING: A CLOSED LOOP SYSTEM PROTOCOL

Claudio Taglia, Claudio Matteini, Claudio Rinna, Maurizio Perugini,

Paolo Di Curzio, Erda Qorri, Mario Goisis _____ 7

AFTËSIA ADAPTUESE E PERIODONTIT, SHPREHUR NË RELACIONE NUMERIKE TË GJERËSISË RADIOGRAFIKE MESATARE

ADAPTIVE ABILITY OF PERIODONTAL LIGAMENT, EXPRESSED IN NUMERICAL RELATIONSHIPS OF MEAN RADIOGRAPHIC WIDTH

Ilma Robo, Saimir Heta, Edlira Sadiku, Luan Mavriqi _____ 17

PARANDALIMI I NEKROZËS SË MANDIBULËS DHE/OSE MAKSIKËS GJATË TERAPISË ME BIFOSFONATE NË PACIENTËT ME OSTEOPOROZË

PREVENTION OF JAW NECROSIS DURING BIPHOSPHONATE THERAPY IN PATIENTS WITH OSTEOPOROSIS

Joana Hankollari _____ 24

EFEKTET E ZGJERUESIT TË SHPEJTË MAKSIKAL NË PACIENTËT NË RRITJE

EFFECTS OF RAPID MAXILLARY EXPANDER IN GROWING PATIENTS

Sidrit Beqiraj _____ 31

ANALIZA KIMIKE ME KROMATOGRAFI TË GAZTË PËR VAJIN ESENCIAL TË ROSMARINUS OFFICINALIS NGA ZONA E TEPELENËS

GAS CHROMATOGRAPHY CHEMICAL ANALYZES OF ROSMARINUS OFFICINALIS ESSENTIAL OIL FROM TEPELENA AREA

Aurel Nuro, Jonida Salihila, Dorina Shëngjergji, Aida Dama, Aurora Napuçe,

Erjon Troja, Dhimitër Peci _____ 39

ANALIZAT KIMIKE TË PËRBËRJES ALKOOLIKE DHE PËRMBAJTJES TË POLIFENOLEVE NË VERËRAT E TREGUT SHQIPTAR

CHEMICAL ANALYSIS OF ALCOHOLIC COMPOSITION AND POLYPHENOLIC CONTENT ON WINE SAMPLES OF ALBANIAN MARKET

Ardit Shehi, Aurel Nuro, Bledar Murtaç, Dorina Shëngjergji, Aurora Napuçe _____ 47

KARAKTERIZIMI KIMIK I VAJIT ESENCIAL TË BIMËS SË BORZILOKUT (OCIMUM BASILIKUM) NGA ZONA TË NDRYSHME TË SHQIPËRISË

CHEMICAL CHARACTERIZATION OF BASILIKUM ESSENTIAL OIL FROM DIFFERENT AREAS OF ALBANIA

Aurel Nuro, Jonida Salihila, Dorina Shëngjergji, Aida Dama, Aurora Napuçe,

Erjon Troja, Vilma Toska _____ 56

RAPORTIM MBI EFEKTIVITETIN IN VITRO TË DERIVATIT TË ACIDIT DIHIDROANTRACEN DISULFONIK NDAJ ENTEROBACTER CLOACAE

IN VITRO ANTIBACTERIAL ACTIVITY OF DIHYDROANTHRACENE DISULFONIC ACID DERIVATIVE AGAINST ENTEROBACTER CLOACAE

Florjana Rustemi, Ledjan Malaj, Gëzim Boçari, Dritan Mnela _____ 65

ANALIZAT KIMIKE TË PËRBËRJES ALKOOLIKE DHE PËRMBAJTJES TË POLIFENOLEVE NË MOSTRAT E BIRRËS NGA TREGU SHQIPTAR

CHEMICAL ANALYSIS OF ALCOHOLIC COMPOSITION AND POLYPHENOLIC CONTENT ON BEER SAMPLES OF ALBANIAN MARKET

Ardit Shehi, Aurel Nuro, Bledar Murtaç, Dorina Shëngjergji, Aurora Napuçe, Aida Dervishi _____ 71

FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE

- PIKËPAMJET HISTORIKE, BASHKËKOHORE DHE PSIKOLOGJIKE MBI STILET E LIDERSHIPIT TË MËSUESIT TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE**
HISTORICAL, CONTEMPORARY AND PSYCHOLOGICAL VIEWPOINTS OF THE LEADERSHIP OF THE TEACHER IN EDUCATIONAL INSTITUTIONS
Elisabeta Kafia, Silva Ibrahim, Fatmir Tartale _____ 81
- NDËSHKIMI FIZIK DHE NDIKIMI I TIJ NË SHFAQJEN E SJELLJEVE AGRESIVE TE FËMIJËT**
THE PHYSICAL PUNISHMENT AND ITS INFLUENCE IN THE EMERGING OF CHILDREN'S AGGRESSIVE BEHAVIORS
Eglantina Dervishi, Silva Ibrahim, Valbona Habili/ Sauku _____ 89
- MBROJTJA SPECIALE PËR TË MITURIT DHE GRATË SHATZËNË NË PUNË**
SPECIAL PROTECTION FOR MINORS AND PREGNANT WOMEN IN WORK ENVIRONMENT
Enea Sheqi _____ 96
- TESTET PROJEKTIVE GRAFIKE DHE ZVILLIMI I KAPACITETIT GRAFIK**
THE TECHNICAL PROJECTIVE DRAWINGS AND THE DEVELOPMENT GRAPHIC CAPACITY
Mariglana Gjoni _____ 105
- PERCEPTIMET E PEDAGOGËVE TË UNIVERSITETIT TË KORÇËS LIDHUR ME SHPËRBLIMET NË MOTIVIM**
LECTURES' PERCEPTIONS OF KORÇA UNIVERSITY REGARDING REWARDS IN MOTIVATION
Eralda Zhilla, Spiridhona Bello, Klea Kuburi _____ 114

FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA DHE EKONOMIKE

- PROBLEMATIKA E TRAJTIMIT TË AKTIVEVE BIOLOGJIKE NË SHQIPËRI**
CHALLENGES ON BIOLOGICAL ASSETS ACCOUNTING PRACTISES IN ALBANIA
Albana Jupe, Remzi Sulo, Ervis Bejko _____ 123
- ROLI I KOMUNIKIMIT NË E-LEARNING: KATËRKËNDËSHI DIDAKTIK**
THE ROLE OF COMMUNICATION IN E-LEARNING: DIDACTIC QUADRILATERAL
Lekë Pepkolaj, Genta Rexha _____ 130
- MIGRIMI DHE VARFËRIA NË VENDET E EVROPËS QËNDRORE DHE LINDORE: NJË ZBATIM I MODELIT TË GRAVITETIT (2007-2016)**
MIGRATION AND POVERTY IN CEE COUNTRIES: A GRAVITY MODEL APPROACH (2007 – 2016)
Emi Malaj, Visar Malaj _____ 139
- ANALIZË MBI PROBLEMATIKAT E TIK NË ARSIM**
ANALYSIS OF ICT ISSUES IN EDUCATION
Besjana Tosuni _____ 148
- UDHËZIME PËR AUTORËT** _____ 157



SHKENCAT MJEKËSORE

SEKSIONI 1



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

FACIAL CONTOUR RECOVERY BY LIPOFILLING: A CLOSED LOOP SYSTEM PROTOCOL

Claudio Taglia*, Claudio Matteini*, Claudio Rinna*, Maurizio Perugini*, Paolo Di Curzio*, ERDA QORRI ** Mario Goisis*

*Belcolle Hospital Viterbo Department of Maxillo Facial Surgery

**Albanian University, Department of Dentistry

Corresponding author: info@claudiomatteini.it

Abstract

Since Coleman¹ first introduced the use of free flat graft to improve aesthetic contour in the face this technique is widely adopted.

The authors reports their experience with a closed loop system technique.

The main advantages of such technique are represented by no post treatment infections rate, less invasivity due to smaller needle used both for the graft and the fill and moreover no centrifugation of the grafting is required.

Goisis' technique results less invasive with no hematomas, minor algic symptoms, overall a better patients' compliance.

Keywords: *graft, aesthetic, closed loop system technique.*

KONTURI FACIAL I REGJENERUAR ME LIPOFFILING: PROTOKOLLI I NJË SISTEMI TË MBYLLUR

Përmbledhje

Coleman¹ ishte i pari që futi përdorimin e graftit të sheshtë të lirë për të rritur estetikën e konturit facial, që atëherë kjo teknikë gjeti një përhapje të shpejtë.

Autorë të ndryshëm ndajnë përvojën e tyre me teknikën sipas sistemit të mbyllur.

Avantazhi kryesor i një teknike të tillë është mungesa e infeksionit pas trajtimit, invaziviteti i ulët falë ageve më të vogla të përdorura si për graftin dhe fillerin dhe mbi të gjitha nuk nevojitet centrifugimi i graftit. Teknika e Goisis është edhe më pak invazive me mungesën e hematomes, simptoma dhimbje me të vogla, por mbi të gjitha pajtueshmëri më të mirë me pacientin.

Fjalë çelës: *graft, estetikë, teknikë e mbyllur.*

Introduction

Since Coleman¹ first introduced the use of free flat graft to improve aesthetic contour in the face this technique is widely adopted in practical clinic for merely aesthetic purposes or as an help in reconstructive surgery.^{2,3,4}

This technique is appreciated both by specialists and patients due to the fact it is a minimally invasive procedure and can be easily performed under local anaesthesia and provides immediate results at a low cost, with a rapid clinical recovery and an improved patient's compliance.

The main problem with this procedure is represented by its unpredictability due to the variable degree of resorption ranging from 45% to 80% ^{5,6}.

The wide world application of such procedure has increased the variability of the procedures, one of these proposed by M. Goisis since 2016 and provides the use of a closed loop system.

Material and methods


In our practice we have adopted the Goisis' protocol in the treatment of 12 female patients affected by aging with zygomatic volume loss, with an age from 36 to 72 years (average 47,5), between January and March 2017.

The harvesting of fat graft is provided by 10cc syringe with multi perforated blunt tip cannula with a diameter of 2 mm rounded. The 6 holes have a diameter 0,6 mm with a spiral disposition that allows the aspiration with rotatory movements and not only piston movements.

The microfat is injected with a 22 gauge 7 cm long blunt cannula.


The Goisis' protocol has 9 steps to be performed:

Step 1: Arranging the contents




- Open and dispose the content of the box onto the sterile field: the manifold is connected to:
A, B and C: direct connection with 60 cc syringes
D: filter and tube connected with a 60 cc syringe
E: tube connected with a stopcock and a 10 cc syringe

Step 2: Preparation



syringes A and D are filled by local anaesthesia syringe B is filled by saline solution


Step 3: Anaesthesia



The local anaesthetic is transferred directly from Syringes A and D to the syringe E. Because the system is completely closed, the risks of infection are reduced.

In particular, when the stopcock is in position “a”, by pulling the plunger, the syringe is filled by anaesthetic solution. By moving the stopcock in position “b” the anaesthetic solution is rapidly injected. In this way, all the infiltration of anaesthesia takes 5 minutes of operating time.


Step 4: Fat harvesting



For fat harvesting, the plunger of syringe E is retracted.


The negative pressure is maintained and the syringe is progressively filled by fat. The stopcock is in position “b”.

Step 5: Transferring of fat into the system




When the syringe is completely filled, move the stopcock in position “a”. The fat mixed with blood and anaesthesia is pushed and transferred directly from the syringe E to the syringe A.

Step 6: Filtration




The stopcock of Syringe E is moved in position “b”. Then, push down on the plunger of syringe A. Because of the filter, most of the blood cells and anaesthesia are automatically directed to the syringe D (red arrow). At the opposite, the fat cells are moved to the syringe C (yellow arrow). All is automatic and there is no need to move stopcocks or valves.

Step 7: Washing




Push the plunger of syringe B. This will automatically draw saline solution into the syringe C. Wait 60 seconds, then push down on the plunger to move out the content of the lower part of the syringe C. In fact, because of separation by gravity, in the lower part of syringe are concentrated blood, water and local anaesthesia. A check valve automatically directs these elements to syringe A and to filter. Wait for 60 seconds the separation between fat and water, and repeat the procedure. The colour of fat which is in syringe C move from orange to yellow.

Step 8: Second filtration



Remove the content of syringe A. Then push down on the plunger of syringe C. The residual water is squeezed out to the filter. At the opposite, the fat cells are moved to the syringe A. All is automatic and there is no need to move stopcocks or valves.

Step 9: Injecting the fat

Move the stopcock of the syringe 6 from position “b” to position “a”. Then, the fat is automatically transferred from syringe.

Results

Any complication was detected in our sample of patients, the average recovery (edema) period was 7 days.

No hematomas were detected.

Minor pain symptoms at the pressure were registered in the donor site with an average last of 8 days.

The results achieved were absolutely satisfying.





Discussion and conclusion

Fat grafting is extensively used in plastic and reconstructive surgery, the use of fat filler is the golden standard for many authors⁶⁻⁷.

The success of fat grafting in the clinical practice is motivated by the desire of establishing an ideal approach, which may guarantee optimal and rapid outcomes with low complications rate according and high patient's compliance¹.

In our experience the use of the protocol previously described is a quick, easy and safe technique with good results.

In our experience this protocol represents a valid alternative to the more usually adopted protocols. Due to the fact that introduces a closed loop system, reduces the infections risk.

The main advantage of this protocol, however, is the smaller diameter of the needles used both for the lipo-aspiration and for the grafting.

The graft in the Coleman's technique is provided by needle with a diameter of 3 mm and the graft has larger particulate adipose cells that need to be centrifuged, in the Goisis' technique the graft aspiration is performed by cannula with a diameter of 2 mm, no centrifugation is of the grafting required.

For the filling in the Coleman's techniques is provided 1,2 mm in the Goisis' one cannula is with smaller diameter 22 gauge.

The Goisis' technique results less invasive with no hematomas, less algic symptoms, overall a better patients' compliance, and it safer for any contamination risk.

References

1. Coleman SR Facial recontouring with lipostructure. Clin Plast Surg 1997;24:347.
2. Gir P, Brown SA, Oni G, et al. Fat grafting: evidence-based review on autologous fat harvesting, processing, reinjection, and storage. Plast Reconstr Surg. 2012; 130:249–258.
3. Del Vecchio D, Rohrich RJ. A classification of clinical fat grafting: different problems, different solutions. Plast Reconstr Surg. 2012;130:511–522.
4. Strong AL, Cederna PS, Rubin JP, et al. The current state of fat grafting: a review of harvesting, processing, and injection techniques. Plast Reconstr Surg. 2015;136:897–912.
5. Krastev TK, Beugels J, Hommes J, Piatkowski A, Mathijssen I, van der Hulst R. Efficacy and Safety of Autologous **Fat Transfer in Facial Reconstructive Surgery: A Systematic Review and Meta-Analysis**. Facial Plast Surg. 2018 Mar 29. doi: 10.1001/jamafacial.2018.0102. [Epub ahead of print]
6. Ibrahiem SMS, Farouk F, Salem IL Facial rejuvenation: Serial fat graft transfer. Alexandria Journal of medicine (2016) 52:371-376.
7. Pereira LH, Nicaretta B, IllouzYC. Clinical application of autologous fat transplantat. In Illouz YZ, Sterodimas A, ed. Adipose stem cells and regenerative medicine. 7th ed. Berlin Heidelberg: Springer-Verlag 2011 p.57-65.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

AFTËSIA ADAPTUESE E PERIODONTIT, SHPREHUR NË RELACIONE NUMERIKE TË GJERËSISË RADIOGRAFIKE MESATARE

Ilma Robo,* Saimir Heta,** Edlira Sadiku,*** Luan Mavriqi*

*Departamenti i Stomatologjisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Tiranë, Shqipëri

**Shërbimi i Kirurgjisë Pediatrike, QSUT, Tiranë, Shqipëri

***Klinikë private dentare, Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: ilmarobo@yahoo.com

Përmbledhje

Hyrje: Forcat që aplikohen mbi periodont janë nxitëse për të reduktuar ose për të shtuar gjerësinë e ligamentit periodontal. Modelimi në këto forca mund të varet ndjeshëm nga ndërhyrja ose jo **në kohë e stomatologut me anë të procedurave dentare.**

Materiale dhe metoda: Studimi u bazua në matjet e gjerësisë së ligamentit periodontal: 3 matje për sipërfaqe meziale dhe 3 për sipërfaqe distale. Mostra që iu nënshtrua vlerësimit ishte 102 dhëmbë, 34 për çdo grup dhëmbësh. Në total u kryen 612 matje.

Rezultatet: Gjerësia e ligamentit periodontal varionte në vlerat brenda limiteve 0.06 – 0.3 mm. Vlerat u regjistruan në gjetjet e mesatareve për zonat e caktuara të dhëmbëve të përzgjedhur. Në tabela u organizuan të dhënat e grumbulluara për dhëmbët e ndarë si dhëmbë me funksion, me funksion të lehtë dhe pa funksion, në pjesën koronale të dhëmbit, në qendër të rrënjës së dhëmbit dhe në apeks. Dhëmbët u klasifikuan si incisivë, kaninë, premolarë dhe molarë.

Konkluzione: Forcat që janë brenda limitit të kapacitetit durues, adaptues të ligamentit periodontal shkaktojnë zgjerim të ndjeshëm të ligamentit periodontal, në të kundërt ndodh atrofia jofunksionale që shoqërohet me zvogëlim të numrit dhe të trashësisë së trabekulave kockore, me reduktim të densitetit të fibrave periodontale.

Fjalë çelës: *ligament periodontal, aftësi adaptuese, gjerësi mesatare, relacione numerike.*

ADAPTIVE ABILITY OF PERIODONTAL LIGAMENT, EXPRESSED IN NUMERICAL RELATIONSHIPS OF MEAN RADIOGRAPHIC WIDTH

Abstract

Introduction: The forces that are applied to periodontal ligament incentive to reduce or increase the width of the periodontal ligament. Modelling these forces can significantly depend on the intervention or not, in time, the dentist through dental procedures.

Materials and methods: The study was based on measurements of the width of the periodontal ligament, medial surface measurements 3 and 3 to the distal surface. Samples that underwent the assessment were 102 teeth, 34 for each set of teeth. In total, 612 measurements were carried out.

Results: Width of periodontal ligament ranged in values within the limits 0.06-0.35mm. They were registered in the values of averages findings of certain areas of the teeth to the selected membership. Tables were organized in the data collected for separate teeth as the teeth with normal function, function easily and without function in the coronal tooth in the centre of the tooth root and apex. Teeth were classified as incisors, canine, premolar and molar.

Conclusions: The forces that are within the limits of the capacity resistant, adaptive to ligament periodontal cause significant expansion of ligament periodontal, on the opposite occurs atrophy dysfunctional that is accompanied by a decrease in the number and thickness of trabecula of bone, with reduced density fibres periodontal.

Keywords: *periodontal ligament, adaptive ability, average width, numerical relationships.*

Hyrje

Dhëmbi është nën efektin e vazhdueshëm të forcave aksiale dhe jo aksiale, ciklike ose jo ciklike, në varësi të pozicionimit të dhëmbit në arkadë, të statusit periodontal të vetë dhëmbit, që në përfundim rezulton në statusin biomekanik të vetë dhëmbit.⁽¹⁾

Forca që ushtrohet në dhëmb ka drejtimin, madhësinë, kohëzgjatjen; elemente këto që e bëjnë aktiv ligamentin periodontal për të përballuar forca të ndryshme, pa dëmtime të strukturave të forta. Ligamenti periodontal me ngjeshjen në zona të ndryshme gjatë gjatësisë së rrënjës, reflekton drejtimin e forcës së aplikuar. Kohëzgjatja e forcës tregohet me ndryshime të riparueshme ose jo të ligamentit periodontal. Madhësia e forcës të lë kuptosh nëse ligamenti periodontal e përballon po këtë forcë, vetëm me ngjeshje dhe zgjerim në zona të caktuara, apo forca është aq e madhe sa strukturave të forta i lejon kontaktin me njëra-tjetrën; kontakt ky që mund të përkthehet edhe me ngjitje, bashkim, të këtyre strukturave. Për aq kohë sa forca që aplikohet tek dhëmbi është në kufijtë e forcave biologjike të aplikueshme, te dhëmbi nuk shkakton dëmtime të riparueshme.

Kohëzgjatja e aplikimit të forcave varet nga procesi i bluarjes së ushqimit, kapërdirjes, kontakteve vesore mes dhëmbëve. Kontakti okluzal gjatë procesit të bluarjes së ushqimit, është më pak se 1 sekondë dhe forca që ushtrohet në apeksin e dhëmbit, midis furkacionit, kur forcat janë aksiale, zgjasin 3 – 5 sekonda.⁽²⁾ Të mendojmë që këto forca janë vetëm aksiale, po sa forca jo aksiale mund të veprojnë tek dhëmbi, për ta detyruar atë në një mënyrë ose tjetrën të dalë nga balanca, ekuilibri i balancuar që ofron komplet aparati i mastikacionit, me mandibulën e lëvizshme dhe maksilën stabël, me muskujt bilateral që veprojnë tek mandibula si një kockë e vetme e lëvizshme e kokës, dhe me elementin thelbësor, ndërtimin e mandibulës. Mandibula përbëhet nga elemente kockore horizontale dhe elemente kockore vertikale, që kryejnë si një trup i vetëm minimalisht lëvizjen e lisharsit, fiksuar me kapsulën artikulare të ATM-së.

Përballë kësaj pamjeje është periodonti, që funksionon në bazë të teorisë së tensionimit dhe visko-elasticitetit. Strukturat dhëmbëmbajtëse janë të rezorbueshme, të riparueshme, të rimodelueshme – të dëmtueshme.⁽³⁾

Metodologjia

Ligamenti periodontal në varësi të aftësisë përshtatëse kundrejt funksionit të shtuar ose jo të dhëmbit, reagon me rritje ose reduktim të gjerësisë. Ky ndryshim në trashësi i ligamentit periodontal shprehet në trashje të fibrave ekzistuese, ose rritje në diametër dhe numër të fibrave Sharpey. Për këtë arsye u kryen matjet në të qindtat e mm-rit të gjerësisë së ligamentit periodontal tek dhëmbët me funksion të shprehur, me funksion të lehtë dhe pa funksion, tek hapësira periodontale në hyrje të alvolës, në mes të alveolës dhe në fund të alveolës; si në sipërfaqet meziale dhe në sipërfaqet distale të dhëmbëve të përzgjedhur në pacientë, dokumentuar në radiografitë e sakta periapikale. Pacientët nuk duhet të vuajnë nga sëmundje sistemike që ndikojnë drejtpërdrejtë në shtimin ose reduktimin e gjerësisë së ligamentit periodontal.

Nën termin funksion, në studim u vendos ky kriter:

- funksion i shprehur: dhëmbi ka kontakt okluzal dhe pikë kontakti me të dy dhëmbët fqinjë.
- funksion i lehtë: dhëmbi ka kontakt okluzal dhe mungojnë njëra, ose të dyja pikat e kontaktit.
- pa funksion: dhëmbi nuk ka kontakt okluzal.

Matjet u kryen në radiografitë e sakta periapikale sipas kriterëve të saktësisë për përdorim e vlerësim në periodontologji. U kryen 3 matje për sipërfaqe meziale dhe 3 për sipërfaqe distale. Mostra që iu nënshtrua vlerësimit ishte 102 dhëmbë, 34 për çdo grup dhëmbësh. Në total u kryen 612 matje.

Rezultate

Rezultatet e grumbulluara nga matjet janë pasqyruar në tabela, respektivisht sipas ndarjes për dhëmbët me funksion, me funksion të lehtë dhe dhëmbët pa funksion.

Për dhëmbët me funksion të dhënat janë pasqyruar në tabelën 1 dhe në tabelën 2.

Tabela 1. Në këtë tabelë pasqyrohen vlerat mesatare të gjerësisë së ligamentit periodontal, shprehur në mm, për sipërfaqet meziale dhe sipërfaqet distale.

Dhëmbë me funksion	Inciziv	Kanin	Premolar	Molar
Kurorë	0.24	0.4	0.375	0.4
Qendër	0.24	0.35	0.34	0.35
Apeks	0.24	0.35	0.3	0.34
Mesatare	0.24	0.37	0.34	0.36

Tabela 2. Përmbledhja e vlerave mesatare për dhëmbët me funksion, shpërndarë sipas sipërfaqes meziale dhe asaj distale, për zonën koronale, në qendër dhe apikale.

Dhëmbë me funksion	Sip. Meziale	Sip. Distale
Kurorë	0.32	0.31
Qendër	0.3	0.29
Apeks	0.28	0.29
Mesatare	0.3	0.296

Në tabelat 1 dhe 2 janë pasqyruar të dhënat për gjerësinë mesatare të ligamentit periodontal, matur në tri zonat e paracaktuara, por në varësi të llojit të dhëmbit të përfshirë në studim. Kuptohet që në varësi të pozicionimit të dhëmbit në harkadë luhatet edhe vlera mesatare e forcës së mastikacionit, të aplikuar në dhëmb.

Tabela 3 dhe tabela 4 pasqyrojnë të dhënat për dhëmbët me funksion të reduktuar.

Tabela 3. Në këtë tabelë pasqyrohen vlerat mesatare të gjerësisë së ligamentit periodontal, shprehur në mm, për sipërfaqet meziale dhe sipërfaqet distale, tek dhëmbët me funksion të lehtë.

Dhëmbë me funksion të lehtë	Inciziv	Kanin	Premolar	Molar
Kurorë	0.1	0.2	0.18	0.1
Qendër	0.06	0.15	0.13	0.1
Apeks	0.06	0.2	0.11	0.1
Mesatare	0.073	0.18	0.14	0.1

Tabela 4. Përmbledhja e vlerave mesatare për dhëmbët me funksion, shpërndarë sipas sipërfaqes meziale dhe asaj distale, për zonën koronale, në qendër dhe apikale.

Dhëmbë me funksion të lehtë	Sip. Meziale	Sip. Distale
Kurorë	0.16	0.11
Qendër	0.12	0.11
Apeks	0.11	0.11
Mesatare	0.13	0.11

Në krahasim me tabelat 1 dhe 2, tek tabelat 3 dhe 4 dallohen që të dhënat e mbledhura për dhëmbë me funksion të lehtë janë në vlera numerike më të reduktuara. Këto vlera janë kudo më të reduktuara, edhe në varësi të llojit të dhëmbit, edhe në vlera mesatare.

Tek tabela 5 dhe tabela 6 janë grupuar të dhënat për dhëmbët pa funksion.

Tabela 5. Në këtë tabelë pasqyrohen vlerat mesatare të gjerësisë së ligamentit periodontal, shprehur në mm, për sipërfaqet meziale dhe sipërfaqet distale.

Dhëmbë pa funksion	Inciziv	Kanin	Premolar	Molar
Kurorë	0.08	0.2	0.1	0.08
Qendër	0.06	0.1	0.1	0.06
Apeks	0.06	0.1	0.1	0.06
Mesatare	0.06	0.13	0.1	0.06

Tabela 6. Përmbledhja e vlerave mesatare për dhëmbët me funksion, shpërndarë sipas sipërfaqes meziale dhe asaj distale, për zonën koronale, në qendër dhe apikale.

Dhëmbë pa funksion	Sip. Meziale	Sip. Distale
Kurorë	0.09	0.09
Qendër	0.08	0.09
Apeks	0.08	0.09
Mesatare	0.08	0.09

Reduktimi në gjerësi i ligamentit periodontal është shprehimisht i dukshëm te dhëmbët që nuk kanë antagonist dhe nuk kanë pikë kontakti. Funksionin amortizues në zhytjen dhe daljen e dhëmbit nga alveola, periodonti e kryen edhe në këto raste.

Për të përballur të dhënat e grupuara dhe për të krahasuar këto të dhëna për grup-dhëmbët e përfshirë në studim, shërben tabela nr. 7.

Tabela 7. Përmbledhje e të dhënave të gjerësisë së ligamentit periodontal, në varësi të llojit të dhëmbit dhe funksionit të tij.

	Dhëmbë me funksion	Dhëmbë me funksion të lehtë	Dhëmbë pa funksion
Incizivët	0.24	0.073	0.06
Kaninët	0.37	0.18	0.13
Premolarët	0.34	0.14	0.1
Molarët	0.36	0.1	0.06
Mesatare	0.33	0.12	0.09

Më poshtë, në figurën 1 pasqyrohen disa prej rasteve klinike të marra në studim. Rastet klinike janë pasqyruar me anë të radiografive.

Figura 1. Radiografite e disa prej dhëmbëve të përfshirë në studim, për grupin e parë – dhëmbë me funksion. Respektivisht është përfshirë në studim te grafia e parë dhëmbi nr. 22, 23; te grafia e dytë dhëmbi nr. 14 dhe te grafia e tretë dhëmbi 11.



Figura 2. Radiografite e disa prej dhëmbëve të përfshirë në studim, për grupin e dytë – dhëmbë me funksion të lehtë. Respektivisht është përfshirë në studim te grafia e parë dhëmbi nr. 15; te grafia e dytë dhëmbi nr. 24 dhe te grafia e tretë dhëmbi 14.





Figura 3. Radiografite e disa prej dhëmbëve të përfshirë në studim, për grupin e tretë – dhëmbë pa funksion. Respektivisht është përfshirë në studim te grafia e parë dhëmbi nr. 16; te grafia e dytë dhëmbi nr. 24.



Diskutime

Reduktimi i ngarkesës funksionale ka tendencë në reduktim të gjerësisë së ligamentit periodontal. Gjerësia e ligamentit tenton të reduktohet me moshën. Humbja e funksionit normal shkon me ndryshime atrofike të tilla si ngushtimi i hapësirës periodontale, disorientimi i fibrave kolagenike dhe vazokonstriksioni.^(4, 5) Në gjerësinë e ligamentit periodontal ndikojnë shumë edhe sëmundjet sistemike. Zgjerimi i ligament periodontal dallohet tek pacientët me sklerozë sistemike që nuk kanë pllakë ose kalkulus.⁽⁶⁾ Në hiperparatiroidizëm humbet lamina dura dhe zgjerohet ligamenti periodontal.⁽⁷⁾ Prandaj për të eliminuar këto ndikime në grupdhëmbët e përzgjedhur, pacientët e përzgjedhur, nuk vuajnë nga sëmundje sistemike me shprehje të efektit të tyre në gjerësinë e ligamentit periodontal.

Nga rezultatet e mbledhura u vu re reduktimi i ndjeshëm i ligamentit periodontal në lidhje me funksionin e dhëmbit. Nga analizimi i të dhënave të grupuara tek tabela 1, 3 dhe 5, vihet re që trashësia më e madhe e ligamentit, pavarësisht funksionit, është te kaninët, pasuar nga molarët. Mesatarja e trashësisë së ligamentit periodontal te dhëmbët me funksion është 0.33 mm, te dhëmbët me funksion të lehtë është 0.13 mm dhe tek dhëmbët pa funksion është 0.09 mm-ra. Kjo e dhënë tregon faktin që aplikimi i forcave mbi periodont e përballon atë me reagim indor, për të përballuar këto forca pa dëmtime. Ky reagim indor është i shprehur me trashje të ligamentit periodontal.

Nga të dhënat e tabelave 2, 4 dhe 6, dallon diferencë e ndjeshme midis trashësisë së ligamentit periodontal në sipërfaqet meziale dhe sipërfaqet distale. Tek dhëmbët me funksion, ky dallim është më i lehtë, ndërsa për dhëmbët me funksion të lehtë dhe pa funksion diferenca është disi më e ndjeshme. Gjerësia e ligamentit periodontal varionte në vlerat brenda limiteve 0.06 – 0.35 mm. Vlerat u regjistruan në gjetjet e mesatareve për zonat e caktuara të dhëmbëve të përzgjedhur.

Bazuar në rezultatet e një studimi marrë nga literatura, efektet e reduktimit të funksionit për një kohëzgjatje të lartë mund të prekë morfologjinë, aftësitë mekanike dhe variacionet minerale të vetë ligamentit periodontal. Këto ndryshime shpjegojnë funksionin biomekanik dhe adaptimet e lidhjes dhëmb-kockë. Ekzistojnë modulime me origjinë nga funksioni okluzal te ligamentit periodontal. Janë këto modulime që duhen patur parasysh sidomos në trajtimet ortodontike dhe prostodontike.⁽⁷⁾

Dallimet në reagimet te sipërfaqet meziale dhe te sipërfaqet distale janë të mbështetura edhe në literaturë.⁽⁸⁾

Lëvizjet e dhëmbit nën efektin e forcave të mastikacionit kryhen në drejtim mezio-distal, vestibulo-oral, kundrejt aksit të rrotullimit të dhëmbit. Lëvizjet meziodistale janë më të redutuara për shkak të pikës së kontaktit, dhe kuptohet që në mungesë të saj lëvizjet janë më të ndjeshme në këtë

drejtim. Në drejtimin vestibulo-oral, lëvizshmëria e dhëmbit është shprehëse e veprimit të forcës shtytëse të gjuhës dhe forcës me drejtim për brenda të muskujve të mimikës. Ligamenti periodontal është më i ngushtë në regjionin e aksit të rrotullimit të dhëmbit.⁽⁹⁾ Për dhëmbët me funksion dhe me funksion të lehtë, kjo qendër rrotullimi është në qendër të gjatësisë së rrënjës së dhëmbit, me tendencë drejt apeksit të rrënjës. Aksi i rrotullimit të dhëmbëve me funksion, afrohet rreth mesit të dhëmbit. Aksi i rrotullimit për dhëmbët me funksion të reduktuar dhe pa funksion, i afrohet apeksit të rrënjës së dhëmbit.

Nga të dhënat e tabelës 7 vihet re reduktimi i ndjeshëm i trashësisë së ligamentit periodontal sidomos te kaninët dhe te molarët, me rënien e ndjeshme të funksionit mbi sipërfaqet okluzale të dhëmbëve.

Përfundime

Forcat që janë brenda limit të kapacitetit durues, adaptues të ligamentit periodontal shkaktojnë zgjerim të ndjeshëm të ligamentit periodontal, në të kundërt ndodh atrofia jofunksionale që shoqërohet me zvogëlim të numrit dhe të trashësisë së trabekulave kockore, me reduktim të densitetit të fibrave periodontale.

Referenca

- 1- Kenneth M. Hargreaves, DDS, PhD, FICD, FACHD and Louis H. Berman, DDS, FACHD "Cohen's Pathways of the Pulp Expert Consult, 11th Edition", Mosby 2014 ISBN: 978-0-323-09635-5.
- 2- William R. Proffit, DDS, PhD, Henry W. Fields, Jr., DDS, MS, MSD and David M. Sarver, DMD, MS; Contemporary Orthodontics, 5th Edition; Mosby 2013, ISBN: 978-0-323-08317-1.
- 3- Michael G. Newman, DDS, Henry Takei, DDS, MS, Perry R. Klokkevold, DDS, MS and Fermin A. Carranza, Dr. ODONT Carranza's Clinical Periodontology, 12th Edition Saunders 2015, ISBN: 978-0-323-18824-1.
- 4- Amemiya A, Abe S An Electron Microscopic Study On The Effects Of Extraction Of Opposed Teeth On The Periodontal Ligament In Rats. Jpn J Oral Biol 1980; 22:72-83.
- 5- Kaneko S, Ohashi K, Soma K, Yanagishita M Occlusal Hypofunction Causes Changes Of Proteoglycan Content In The Rat Periodontal Ligament. J Periodontal Res. 2001;36(1):9-17.
- 6- Rout PG, Hamburger J, Potts AJ Orofacial Radiological Manifestations Of Systemic Sclerosis. Dentomaxillofac Radiol. 1996; 25(4):193-196.
- 7- Niver EL¹, Leong N, Greene J, Curtis D, Ryder MI, Ho SP Reduced functional loads alter the physical characteristics of the bone-periodontal ligament-cementum complex; J Periodontal Res. 2011 Dec;46(6):730-41. doi: 10.1111/j.1600-0765.2011.01396.x. Epub 2011 Aug 17.
- 8- Ji-Hyun Lee, 1 Jeremy D. Lin,1 Justine I. Fong,1 Mark I. Ryder,2 and Sunita P. Ho1; "The Adaptive Nature of the Bone-Periodontal Ligament-Cementum Complex in a Ligature-Induced Periodontitis Rat Model"; BioMed Research International; Volume 2013 (2013), Article ID 876316, 17 pages; <http://dx.doi.org/10.1155/2013/876316>.
- 9- Steven W. McCormack, Ulrich Witzel, Peter J. Watson, Michael J. Fagan, Flora Gröning; "The Biomechanical Function of Periodontal Ligament Fibres in Orthodontic Tooth Movement"; <http://dx.doi.org/10.1371/journal.pone.0102387>; Published: July 18, 2014.



Viti i IX-të i Botimit, Nr. 1,
Qershor 2018

PARANDALIMI I NEKROZËS SË MANDIBULËS DHE/ OSE MAKSILËS GJATË TERAPISË ME BIFOSFONATE NË PACIENTËT ME OSTEOPOROZË

Joana Hankollari

Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University, Tiranë

Adresë kontakti: joanahankollari@gmail.com

Përmbledhje

Hyrje: Bifosfonatet përdoren gjerësisht në fushën e reumatologjisë si linjë e parë në trajtimin e osteoporozës. Përdorimi i gjerë i tyre ka përballur mjekë dhe pacientë me një nga efektet anësore më të komplikuar siç është nekroza mandibulare dhe/ose maksilare. Njohja e faktorëve të riskut që rrisin probabilitetin e shfaqjes së këtij efekti është hapi i parë në parandalimin e tij. Është i domosdoshëm trajtimi i osteoporozës me bifosfonate, por nga ana tjetër ekzistojnë mënyra parandalimi të nekrozës në fjalë. (2,5,8,10)

Qëllimi: Qëllimi i këtij studimi është evidentimi i mënyrave parandaluese të nekrozës së mandibulës dhe/ose maksilës gjatë trajtimit me bifosfonate të pacientëve me osteoporozë.

Metodologjia: Ky studim është një recensë e bazuar në hulumtimin e studimeve dhe literaturës botërore në lidhje me mënyrat e parandalimit të nekrozës së mandibulës dhe maksilës gjatë terapisë me bifosfonate në pacientët me osteoporozë.

Rezultatet: Së pari parandalimi i këtij efekti anësor të bifosfonateve kërkon evidentimin e faktorëve predispozues, informimin e pacientëve për të ruajtur higjienën orale dhe për të njohur që në fazat fillestare klinikën e kësaj nekroze sado atipike qoftë, marrjen e anamnezës nga ana e mjekut stomatolog përpara kryerjes së një ndërhyrjeje dentare, përdorimin e një terapie të ndryshme nga bifosfonatet në trajtimin e osteoporozës ose ndërprerja e përkohshme e tyre. (8,9,11)

Përfundime: Pavarësisht riskut për të zhvilluar nekrozën mandibulare dhe/ose maksilare gjatë përdorimit të bifosfonateve në osteoporozë, ekzistojnë mënyra parandalimi që kërkojnë bashkëpunimin e mjekut reumatolog, pacientit dhe mjekut stomatolog.

Fjalë çelës: *bifosfonatet, osteoporoza, nekroza mandibulare dhe/ose maksilare.*

PREVENTION OF JAW NECROSIS DURING BIPHOSPHONATE THERAPY IN PATIENTS WITH OSTEOPOROSIS

Abstract

Introduction: Bisphosphonates are widely used in the field of rheumatology as the first line treatment in osteoporosis. Their extensive use has confronted physicians and patients with

one of the most complicated side effects such as jaw necrosis. Knowing the risk factors that increase the probability of the occurrence of this effect is the first step in its prevention. It is imperative to treat osteoporosis with bisphosphonates, but on the other hand there are ways of preventing the necrosis in question. (2,5,8,10)

Purpose: The purpose of this study is to identify the preventive ways of jaw necrosis during the treatment with bisphosphonates of patients with osteoporosis.

Methodology: This study is a review of different studies and literatures about the prevention of jaw necrosis during bisphosphonate therapy in osteoporotic patients.

Results: Firstly, the prevention of this side effect of bisphosphonates requires evidence of predisposing factors, patient information to maintain oral hygiene and to recognize the jaw necrosis in the early stages even if the clinical manifestation can be atypical, taking the anamnesis from the dentist physician before performing a dental intervention, using a different therapy from bisphosphonates in the treatment of osteoporosis or their temporary interruption.(8,9,11)

Conclusions: Despite the risk of developing mandibular and / or maxillary necrosis during the use of bisphosphonates in osteoporosis, there are prevention methods that require the co-operation of the rheumatologist, the patient and the dentist.

Keywords: *bisphosphonates, osteoporosis, mandibular and/or maxillary necrosis.*

Hyrje

Fjala osteoporozë do të thotë kockë porotike. Është një çrregullim i metabolizmit kockor që karakterizohet nga ulja e densitetit kockor. Në osteoporozë kocka humb një sasi të konsiderueshme të matriksit organik dhe përbërësve mineralë, kryesisht të kalciumit. Raporti midis matriksit organik dhe përbërësve mineralë ruhet. Në këtë mënyrë kocka humbet fortësinë e saj dhe mund të frakturohet lehtësisht në trauma minimale (1,2). Metabolizmi kockor ekuilibrohet nga veprimi i osteoblasteve dhe osteoklasteve. Osteoblastet janë qelizat të cilat sintetizojnë matriksin kockor, pra modelojnë osteoidin dhe ky i fundit më pas mineralizohet. Osteoklastet janë qeliza, të cilat e rezorbojnë kockën (3). Densiteti i masës kockore vjen duke u rritur që nga lindja, duke arritur pikun e tij në dekadën e tretë të jetës. Zhvillimin më të shpejtë e ka prej pubertetit deri në moshën 30 vjeçare. Pas arritjes së pikut të tij, densiteti kockor ulet gradualisht deri në dekadën e shtatë të jetës. Pas dekadës së shtatë ka një humbje të shpejtë. Te femrat, në periudhën e post menopauzës humbet shumë shpejt densiteti i masës kockore, ndërsa meshkujt uljen më të shpejtë të densitetit të tyre kockor e kanë pas dekadës së shtatë të jetës. Në shfaqjen e osteoporozës ndikojnë faktorë gjenetikë, nutricionalë, medikamentoz, patologji të ndryshme, stili i jetesës, menopauza te femrat dhe vetë procesi i plakjes (4,6). Të gjithë këta faktorë shkaktojnë predominimin e rezorbimit kockor përkundrajt formimit të tij.

Aktualisht krahas këshillave të lidhura me stilin e jetesës dhe dietën e pacientit, në osteoporozë përshkruhen dhe medikamente kuruese. Së pari duhet kuruar patologjia bazë në rastet e osteoporozës sekondare dhe më pas si linjë e parë e trajtimit rekomandohen bifosfonatet. Këto të fundit janë analogë të pirofosfateve, të cilat absorbohen nga hidroksiapatitet e kockës dhe veprojnë duke frenuar rezorbimin e saj (3,5,6,11,12). Bifosfonatet mund të rekomandohen në formë tablete ose injeksioni.

Disa nga efektet e padëshiruara të tyre janë: ezofagiti, ulcera ezofageale, erozione ezofageale, shqetësime dhe dhimbje abdominale, diarre ose konstipacion, dhimbje muskuloskeletike, cefale. Më rrallë hasim ekzantema, eritema, ulje të përkohshme të nivelit të kalciumit dhe fosfateve në serum, nauze, të vjella, ulcera peptike, urtikarie, angioedema. Për këto arsye përpara fillimit të terapisë me bifosfonate duhen korrigjuar çrregullimet e metabolizmit të kalciumit, vitaminës D dhe duhen përjashtuar shkaqet e tjera të osteoporozës. Mjekimi me bifosfonate kundërpërcaktohet në rastet e çrregullimeve të ezofagut, hipokalcemi, çrregullime të funksionit të veshkave, pamundësi për të qëndruar në këmbë ose ulur në pozicion të drejtë për 30 minuta gjatë marrjes së tabletave me bifosfonate, shtatzëni, laktacion. Qëndrimi në këmbë ose ulur në pozicion të drejtë për 30 minuta gjatë marrjes së tabletave me bifosfonate parandalon çrregullimet ezofageale (5,11,12).

Një nga efektet anësore më të rënda, por të rralla të bifosfonateve është dhe osteonekroza e mandibulës dhe maksilës. Për herë të parë u përshkrua rreth vitit 2003. Që nga ky vit po i kushtohet rëndësi si nga mjeku stomatolog dhe nga reumatologu parandalimit të saj. Një zonë kockore e regjionit maksilofacial, e cila është e ekspozuar dhe nuk shërohet për 8 javë në një pacient që trajtohet me bifosfonate mund të konsiderohet si osteonekrozë nga bifosfonatet (2,7). Megjithatë ekzistojnë rekomandime të cilat synojnë parandalimin e këtij efekti anësor. Ky parandalim realizohet përmes bashkëpunimit reumatolog-pacient-stomatolog. Në momentin e vendosjes së diagnozës së osteoporozës dhe fillimit të terapisë me bifosfonate, pacientit i rekomandohet një vizitë te mjeku stomatolog. Ky i fundit vlerëson risqet për të patur osteonekrozë të mandibulës dhe maksilës, e këshillon pacientin për higjienën orale dhe mjekun si metodë parandalimi përpara fillimit të terapisë patologjike orale të pacientit.

Metodologjia

Ky studim është një rishikim i literaturës botërore dhe disa studimeve rreth riskut të zhvillimit të osteonekrozës së maksilës dhe mandibulës në pacientët osteoporotikë që trajtohen me bifosfonate. Qëllimi është evidentimi i strategjive parandaluese të këtij efekti anësor të rrallë, por të rëndë. Këto strategji duhet të jenë pjesë e praktikës së punës së mjekut reumatolog dhe stomatolog, që gjendet përballë një patienti me osteoporozë. Ky studim jo vetëm informon, por bën thirrje për një bashkëpunim të mirë midis reumatologut – pacientit – stomatologut.

Rezultatet

Alternativat e trajtimit të osteoporozës

Ekzistojnë disa alternativa për të trajtuar osteoporozën. Tabela më poshtë tregon listën e medikamenteve që përdoren në osteoporozë dhe cilat fraktura osteoporotike parandalohen prej tyre. (2, 6, 8,11,12)

Tabela 1: Lista e medikamenteve që trajtojnë osteoporozën dhe efikasiteti i tyre në parandalimin e frakturave osteoporotike.

Medikamentet	Osteoporoza vertebrale	Osteoporoza jo vertebrale	Osteoporoza e artikulacioneve kokso-femorale
Terapia zëvendësuese hormonale	✓	✓	✓
Raloksifen	✓	PR	PR
Etidronat	✓	PR	PR
Alendronat	✓	✓	✓
Risendronat	✓	✓	✓
Ibandronat	✓	✓	✓
Zolendronat	✓	PR	PR
Kalcitonin	✓	PR	PR
Stroncium	✓	✓	✓
Parathormoni	✓	✓	✓
Testosteron	✓	PR	PT
Kalcium + vitamin D	✓	✓	✓
Vitamin D	✓	✓	✓
	PR	PT	PT
	PR	✓	✓
	PR	PR	PR

PR= pa rezultat; PT= të patestuara

Terapia zëvendësuese hormonale është përdorur kryesisht në gratë, që janë të prekura nga osteoporoza post menopauzës. Megjithatë efektet anësore të terapisë hormonale i tejkalojnë përfitimet. Gratë që përdorin terapinë zëvendësuese hormonale kanë një risk më të lartë për sëmundje koronare, tromboemboli venoze, kancer gjiri etj. Për këtë arsye nuk rekomandohet për trajtimin afatgjatë të osteoporozës. Raloksifeni është një modulator selektiv i receptorëve të estrogenit. Ai ka efekt estrogen agonist në kocka dhe efekt estrogen antagonist në endometër dhe glandulat mamare. Pra nuk rrit riskun për kancer gjiri dhe kancer endometri, por ama nuk këshillohet te gratë me risk të lartë për tromboemboli, si dhe trajton vetëm osteoporozën vertebrale.

Bifosfonatet janë antagonistë analogë të pirofosfateve. Duke vepruar në osteoklaste ato frenojnë rezorbimin kockor. Në to bëjnë pjesë: etidronat, alendronat, risendronat, ibandronat, zolendronat. Megjithatë vetëm alendronati, risendronati, zolendronati veprojnë në të gjitha llojet e osteoporozave. Efektet anësore të tyre janë paraqitur te hyrja e artikullit, por përfitimet e tyre i tejkalojnë risqet e efekteve anësore të mundshme. Ndaj aktualisht janë terapia e zgjedhur për trajtimin e osteoporozës. Kalcitonina është një hormon polipeptidik që frenon rezorbimin e kockës. Ajo vepron në osteoporozën vertebrale. Injeksionet e përsëritura, kostoja e lartë e trajtimit,

kufizimi i efektshmërisë vetëm në parandalimin e frakturave vertebrale bën që mos të jetë trajtimi i zgjedhur në osteoporozë. (2, 6, 8,10)

Stronciumi është efektiv në parandalimin e të gjitha llojeve të osteoporozës, por ka një risk të rritur për të shkaktuar tromboemboli venoze te pacienti, hipersensibilitet të lartë dhe nuk lejon marrjen e rezultateve të sakta të densitometrisë kockore për monitorimin e osteoporozës. Parathormoni rekombinant human është i disponueshëm në dy formulime: teriparatide dhe preotact. Në muajt e parë të fillimit të terapisë duhet monitoruar kalciumi. Teriparatidi është i licencuar të përdoret në burra dhe gratë post menopauzë, ndërsa preotact vetëm në femra. Efektet anësore të tyre janë hiperkalçemia, nauze, diskomfort në vendin e injektimit. Testosteroni i përdorur në meshkuj nuk ka treguar efikasitet, ndaj të vetmet preparate që mund të përdoren në ta janë alendronati, risendronati, teriparatidi. Po ashtu kalciumi dhe vitamina D janë terapi ndihmuese, por të vetme pa bifosfonatet nuk mund të parandalojnë riskun e frakturave në osteoporozë. (2, 6, 8,10)

Pra linjë e parë e trajtimit në osteoporozë mbeten bifosfonatet dhe më pas teriparatidi. Risku i zhvillimit të osteonekrozës së mandibulës dhe maksilës në pacientët që trajtohen me bifosfonate varion 0.028-4.3%. Ndërsa risku i zhvillimit të frakturave në pacientët osteoporotikë të patrajtuar është rreth 33.3% te femrat dhe 20% te meshkujt. Vetë fraktura mbart risqe të komplikacioneve të tjera më të rënda. Ndaj nëse bëjmë një vlerësim midis riskut të përdorimit të bifosfonateve dhe përfitimeve ndaj tyre, predominojnë këto të fundit. Pra trajtimi me bifosfonate është i pashmangshëm për pacientët me osteoporozë. Ngelet vetëm të diskutojmë mënyrat e parandalimit të osteonekrozës maksilare dhe mandibulare. (2,5,6, 8,10)

Parandalimi i osteonekrozës së maksilës dhe mandibulës

Diagnoza e osteoporozës vendoset përmes densitometrisë e cila mat densitetin kockor. Në varësi të rezultateve të marra, pra T-score vendosim diagnozën si më poshtë:

Tabela 2: Diagnoza e osteoporozës sipas Fondacionit Ndërkombëtar të Osteoporozës dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë. (2)

Statusi	Densiteti i masës kockore
Normal	T-score ≥ -1
Osteopeni	$-2.5 < \text{T-score} < -1$
Osteoporozë	T-score ≤ -2.5
Osteoporozë e rëndë	T-score ≤ -2.5 dhe prezenca e së paku një frakture osteoporotike

Pas vendosjes së diagnozës konsiderohet fillimi i bifosfonateve si linjë e parë e trajtimit të osteoporozës. Si mjeku reumatolog dhe mjeku stomatolog përcakton riskun që ka pacienti për të patur osteonekrozë të maksilës dhe mandibulës. Pastaj përcaktohet risku i përbashkët dhe strategjia që do të ndiqet për të parandaluar këtë komplikacion. Pacienti mund të jetë duke e nisur terapinë për herë të parë ose ka kohë që e vazhdon.

Tabela 3. Vlerësimi i riskut për osteonekrozë nga ana e reumatologut dhe stomatologut në pacientët që do të nisin terapinë me bifosfonate ose janë duke e vazhduar atë. (8,9)

Vlerësimi i reumatologut	Vlerësimi i stomatologut
Pacientë me risk të ulët për osteonekrozë Pacientët që do të nisin terapinë me alendronat, ose zolendronat. Pacientë me risk të lartë për osteonekrozë ✓ Pacientë që kanë përdorur bifosfonate për një kohë të gjatë pa periudha shkëputjeje ✓ Pacientë të cilët kanë marrë doza të larta bifosfonatesh për shkak të një patologjie malinje si mieloma multiple apo metastaza. ✓ Pacientë me moshë më të madhe se 70 vjet. ✓ Pacientë me imunosupresion ✓ Përdorimi sistematik i dozave të larta të kortikosteroidëve	Pacientë me risk të ulët për osteonekrozë Ekstraksion dentar rutinë me anestezi lokale, deri në tre dhëmbë njëri pas tjetrit ose katër dhëmbë në regjione të ndryshme. Pacientë me risk të lartë për osteonekrozë ✓ Kirurgji orale e shtrirë ose ekstraksion i pesë ose më shumë dhëmbëve apo një kuadranti dentar. ✓ Kirurgji me risk për të dëmtuar maksilën ose mandibulën.

Risku për të zhvilluar osteonekrozë të mandibulës ose maksilës vlerësohet si minimal kur dhe reumatologu dhe stomatologu përcaktojnë një risk të ulët. Konsiderohet mesatar kur njëri nga specialistët vlerëson një risk të lartë dhe tjetri të ulët. Konsiderohet i lartë kur të dy specialistët vlerësojnë një risk të lartë për osteonekrozë. (8,9)

Në rastin e një risku të ulët pacientit i këshillohet vetëm një higjienë e mirë orale dhe sa herë të vizitohet te mjeku stomatolog ta vendosë këtë të fundit në dijeni për terapinë që është duke marrë. Në rastin e një risku të mesëm duhet marrë në konsideratë profilaksia me antibiotikë përpara dhe pas çdo procedure dentare nëse e gjykon mjeku stomatolog. Në rastin e riskut të lartë për osteonekrozë është e detyrueshme profilaksia me antibiotikë para dhe pas një procedure dentare si dhe kontroll i vazhdueshëm te mjeku stomatolog. Rekomandohet regjimi preoperator dhe postoperator me klindamicinë, shpëlarja e gojës me klorheksidinë. Në rastet alergjike ndaj klindamicinës mund të përdoret regjimi me amoksisilinë dhe metronidazol së bashku me shpëlarësin lokal klorheksidinë. Në rastin e alergjisë dhe ndaj amoksisilinës mund të jepet roksitromicinë me metronidazol dhe klorheksidina lokale. Gjithsesi përpara se pacientit t'i fillohet terapia me bifosfonate duhet të

këshillohet të ruajë higjienën orale dhe të trajtojë dhëmbët me probleme apo të kryejë ekstraksione të mundshme. Më pas mund t'i fillohet terapia me bifosfonate me risk më të ulët për të zhvilluar osteonekrozë mandibulare ose maksilare. (7,9)

Përfundime

Linja e parë e trajtimit të osteoporozës mbeten bifosfonatet dhe më pas teriparatidi. Risku i zhvillimit të osteonekrozës së mandibulës dhe maksilës në pacientët që trajtohen me bifosfonate varion 0.028-4.3%. Ndërsa risku i zhvillimit të frakturave në pacientët osteoporotikë të patrajtuar është rreth 33.3% te femrat dhe 20% te meshkujt. Vetë fraktura mbart risqe të komplikacioneve të tjera më të rënda. Ndaj nëse bëjmë një vlerësim midis riskut të përdorimit të bifosfonateve dhe përfitimeve ndaj tyre, predominojnë këto të fundit. Si mjeku reumatolog dhe mjeku stomatolog përcakton riskun që ka pacienti për të patur osteonekrozë të maksilës dhe mandibulës. Pastaj përcaktohet risku i përbashkët dhe strategjia që do të ndiqet për të parandaluar këtë komplikacion. Pacienti mund të jetë duke e nisur terpinë për herë të parë ose ka kohë që e vazhdon.

Në rastin e një risku të ulët pacientit i këshillohet vetëm një higjienë e mirë orale dhe sa herë të vizitohet te mjeku stomatolog ta vendosë këtë të fundit në dijeni për terpinë që është duke marrë. Në rastin e një risku të mesëm duhet marrë në konsideratë profilaksia me antibiotikë përpara dhe pas çdo procedure dentare nëse e gjykon stomatologu. Në rastin e riskut të lartë për osteonekrozë është e detyrueshme profilaksia me antibiotikë para dhe pas një procedure dentare si dhe kontroll i vazhdueshëm te mjeku stomatolog. Gjithsesi, përpara se pacientit t'i fillohet terapia me bifosfonate duhet të këshillohet të ruajë higjienën orale dhe të trajtojë dhëmbët me probleme apo të kryejë ekstraksione të mundshme. Më pas mund t'i fillohet terapia me bifosfonate me risk më të ulët për të zhvilluar osteonekrozë mandibulare ose maksilare. Pra bashkëpunimi reumatolog – pacient – stomatolog është shumë i rëndësishëm për të parandaluar këtë komplikacion.

Referenca

1. Jacqueline L. Longe, The Gale encyclopaedia of medicine, third edition, volume 4, 2006, 2714-2718.
2. Philip Seo, Alan Hakim, Gavin Clunie, Inam Haq, Oxford American Handbook of Rheumatology, second edition, 2013, 444-453.
3. Argjend Tafaj, Reumatologjia, Albpaper, 2004, 321-332.
4. G. Birdwood, Understanding osteoporosis and its treatment, The Parthenon Publishing Group Ltd, 1996, 17-36.
5. Skënder Durrësi, Formular Terapeutik, Mediaprint, 2010, 320-322.
6. John H. Klippel, Primer on the rheumatic diseases, thirteenth edition, Arthritis foundation, 2008, 576-598
7. Lars Rassmussen, Jahan Abtahi, Bisphosphonate associated osteonecrosis of the jaw: an update on pathophysiology, risk factors and treatment, International Journal of Dentistry, volume 2014, 1-9
8. M. Doherty, Therapeutic Strategies in Rheumatology, Atlas Medical Publishing Ltd 2010, 179-194.
9. NSW, Department of Health Guidelines, Prevention of osteonecrosis of the jaw in patients on bisphosphonate therapies, Centre for oral health strategy, 2012, 1-31.
10. Compston, J, Cooper, A, Cooper, C et al. UK clinical guideline for the prevention and treatment of osteoporosis. Arch Osteoporosis. 2017; 12: 43.
11. Adler, RA, El-Hajj Fuleihan, G, Bauer, DC et al. Managing osteoporosis in patients on long-term bisphosphonate treatment: report of a Task Force of the American Society for Bone and Mineral Research. J Bone Miner Res. 2016; 31: 16-35.
12. Laius, O.; Pisarev, H.; Maasalu, K.; Kõks, S.; Märton, A. Adherence to osteoporosis medicines in Estonia, A comprehensive 15-year retrospective prescriptions database study. Arch. Osteoporosis. 2017, 12, 19.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

EFEKTET E ZGJERUESIT TË SHPEJTË MAKSILAR NË PACIENTËT NË RRIJJE

Sidrit Beqiraj

Departamenti i Stomatologjisë, Albanian Univeristy, Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: sidirbeqiraj@gmail.com

Përmbledhje

Problemet (diskrepancat) transversale maksilare zakonisht kërkojnë zgjerimin e palatumit duke kombinuar efektet ortopedike dhe ortodontike të lëvizjes së dhëmbëve. Sot ekzistojnë katër mënyra trajtimi: zgjerimi i shpejtë maksilar (RME), zgjerimi i ngadalhtë maksilar (SME), zgjerimi maksilar i asistuar nga mikroimplantet (MARME), zgjerimi maksilar i asistuar kirurgjikal (SARME). Ky artikull ka për qëllim të rishikojë efektet e zgjeruesit të shpejtë maksilar në pacientët në rritje.

Fjalë çelës: *zgjerim maksilar, zgjerim i shpejtë maksilar, zgjerim i ngadalshëm maksilar, zgjerimi maksilar i asistuar me mikroimplante, zgjerim maksilar i asistuar kirurgjikal.*

EFFECTS OF RAPID MAXILLARY EXPANDER IN GROWING PATIENTS

Abstract

Maxillary transverse discrepancy usually requires expansion of the palate by a combination of orthopaedic and orthodontic tooth movements. Four expansion treatment modalities are used today: rapid maxillary expansion (RME), slow maxillary expansion (SME), micro implant assisted maxillary expansion (MARME) and surgically assisted maxillary expansion (SARME). This article aims to review the effects of rapid maxillary expansion in growing patients.

Keywords: *maxillary expansion, rapid maxillary expansion, slow maxillary expansion, micro implant assisted maxillary expansion, surgically assisted maxillary expansion.*


Hyrje

Problemi i moszhvillimit transversal të maksilës është problemi më i shpeshtë okluzal në ditët e sotme. 50-60% e pacientëve ortodontik kanë indikacione për zgjerim maksilar. Deficiti transversal maksilar shoqëron shumë malokluzione, si: cross-bite superior, open bite anterior, malokluzion i Klasës II, malokluzion i Klasës III, protruzione dhe grumbullime dentare. Zgjerimi maksilar ka më shumë se 150 vite që përdoret për korrigjimin e deficitit transversal. Për herë të parë e përdori Emerson C. Angell, e publikuar në 1860 në San Francisco Medical Press (1). Sot ekzistojnë 4

modalitete kryesore të trajtimit: zgjerimi i shpejtë i maksilës (RME), zgjerimi i ngadaltë i maksilës (SME), zgjerim i ndihmuar nga mikro-implantet (MARME) dhe zgjerimi i maksilës me rrugë kirurgjikale (SARME), dy të fundit të përdorur kryesisht në pacientët adultë. Meqë secila nga këto mënyra trajtimi ka avantazhet dhe dizavantazhet e veta, ka akoma pikëpamje të ndryshme për përdorimin e tyre. Zgjedhja nga ortodontët bëhet duke u bazuar në përvojën e tyre, moshën e pacientit dhe tipin e malokluzionit (2,3). Rritja normale palatinale (rreth 90% e saj) përfundon rreth moshës 6 vjeç (4) dhe osifikimi i suturës medio-palatinale e bën shumë të vështirë hapjen e saj pas pubertetit (5,6,7,8,9). Përdorimi i forcave të duhura bën të mundur hapjen e saj në varësi të moshës së pacientit. Qëllimi i këtij artikulli synon një rishikim të efekteve të zgjeruesit të shpejtë maksilar te pacientët në rritje, si edhe të dhënave më të fundit të literaturës në lidhje me këto efekte.

Zgjerimi i shpejtë i maksilës

Zgjeruesi i shpejtë i maksilës (RME) u popularizua nga Andrew J. Haas në fillim të viteve '60 dhe sot është trajtimi më i përdorur në deficitet transversal maksilarë (Fig.1). Objektivi kryesor është korrigjimi i deficitit maksilar, por efektet e tij vërehen edhe në 10 kocka të tjera të fytyrës dhe kokës, siç janë: kocka palatinale, mandibula, vomeri, kocka etmoidale, zigomatike, frontale, sfenoidale, nazale, lakrimale, temporale dhe ajo oksipitale. Nevoja për këtë procedurë bazohet kryesisht në përcaktimin e raporteve transversale të dy harkateve dentare. Indikohet kur kemi mbi 4 mm diskrepancë të këtyre raporteve. Përkrahësit e kësaj mënyre trajtimi besojnë se zgjeruesi i shpejtë minimizon lëvizjen e dhëmbëve (tipping) dhe maksimalizon lëvizjen skeletike. Forcat e mëdha dhe të shpejta të aplikuara mbi dhëmbët posteriorë, bëjnë që dhëmbët të mos kenë kohë të mjaftueshme që të spostohen dhe forcat transferohen tek suturat. Kur këto forca të prodhuara nga zgjeruesi e tejkalojnë limitin e duhur për lëvizjen dentare ortodontike dhe rezistencën që shfaq sutura, atëherë sutura hapet ndërkohë që dhëmbët lëvizin minimalisht në lidhje me kockën e tyre mbështetëse. Zgjeruesi i shpejtë komprimon ligamentin periodontal, përkul proceset alveolare, inklinon dhëmbët ankorues dhe gradualisht hap suturat maksilare.



Efektet e RME në kompleksin maksilar dhe mandibular.

Efektet skeletike në maksilë: Kur shihet nga ana okluzale, në imazhet bidimensionale, vërehet se hapja *transversale* e suturës medio-palatinale është jo paralele dhe trekëndore (formë V-je), maksimalisht në regjionin e incizivëve dhe vjen duke u zvogëluar në drejtim posterior të palatumit,

në një raport afërsisht 2.5-3:1. Në pjesën anteriore të suturës vërehet një hapje mesatarisht 3-4 mm, afërsisht sa 45% e madhësisë së hapjes së vidës zgjeruese, ndërsa në nivel posterior vetëm 1.2-2 mm, rreth 20% e hapjes së vidës (10). Gjerësia maksilare e matur në imazhet cefalometrike A-P (distanca J-J), *direkt pas zgjerimit*, rritet me 3,5 mm nëse zgjerimi realizohet përpara adoleshencës, dhe rreth 2.8 mm nëse realizohet pas adoleshencës. Edhe proceset pterigoidale spostohen lateralisht 1.12 mm. Kjo sepse proceset pterigoide të kockës sfenoide të pozicionuar në mënyrë bilaterale nuk kanë suturë që të spostohen, por mund të bëhen vetëm më divergjente. Hapja mund të jetë paralele, vetëm nëse bëhet shkëputja e proceseve pterigomaksilare me rrugë kirurgjikale (11). Edhe kur shihet në planin frontal kjo suturë hapet nga sipër-poshtë, po ashtu në mënyrë jo paralele dhe trekëndore. Baza lokalizohet në pjesën palatinale dhe maja në drejtim të suturës fronto-maksilare, në mesin e dy orbitave. Studimet tregojnë që në zonën okluzale (interprosthion) vlera e hapjes gjatë *fazës aktive* është rreth 4.8 mm, ndërsa distanca internazale rreth 2.2 mm (43% e vlerës okuzale dhe 1/3 e madhësisë së hapjes së vidës). Po ashtu *Chung dhe Font* (12), arrijnë në të njëjta përfundime: rritja më e madhe është në nivel dentar (intermolar dhe interpremolar) maksilar mesatarisht 7-8 mm, e ndjekur nga distanca interjugulare maksilare (J-J) + 2-3 mm, ajo internazale mesatarisht 2 mm dhe ajo interorbitale (Mo-Mo) +0.25 mm. Kjo mënyrë dhe sasi e hapjes së suturës është e verifikuar edhe me imazhe tridimensionale me CT dhe CBCT (13,14,15,16). Përsa i përket të *dhënave afatgjatë* (5-7 vite pas zgjerimit), maksila (distanca J-J) mbetet 3 mm më e gjerë sesa pacientët e patrajtuar, nëse zgjerimi është realizuar përpara adoleshencës (faza C1-C3 e CVM), ndërsa nuk mbetet asnjë efekt skeletik në maksilë, por vetëm ai dentar nëse zgjerimi është kryer pas adoleshencës (faza C4-C5) (17). Edhe gjerësia latero-nazale ngelet mesatarisht 2.3 mm dhe 1.5 mm më e madhe sesa në pacientët e patrajtuar, nëse zgjerimi është realizuar përpara ose pas adoleshencës respektivisht. Përsa i takon efekteve *sagitale* dhe *vertikale* të zgjerimit të shpejtë në maksilë literatura jep të dhëna kontradiktore. Sipas disa studimeve (9,12,18), vërehet një spostim përpara prej 1-2 mm të pikës A, një rritje e këndit SNA, plani bispinal spostohet përpara dhe poshtë. Ndërsa autorë të tjerë (19,20) nuk vërejnë avancim përpara të planit palatinal. Të tjerë (12) vërejnë një zbritje poshtë por në mënyrë paralele të planit palatinal, ndërsa *da Silva Filho et al* (21) raportojnë një ulje më të madhe poshtë të spinës nazale posteriore sesa ajo anteriore.

Proceset alveolare maksilare: Meqë kocka është reziliente, vërehet një përkulje (bending) laterale e proceseve alveolare, të cilët rikthehen pjesërisht (rebound) pas disa ditëve, duke kontribuar në rreth 6-13% të zgjerimit total (Fig. 2), duke u rritur në drejtim posterior, nga kaninët tek molarët (përkatesisht nga 0.2 – 0.8 mm).

Dhëmbët anteriorë maksilarë: Një nga ndryshimet më spektakolare dhe më evidente për pacientët gjatë përdorimit të RME është hapja e diastemës ndërmjet incizivëve central superiorë. Gjatë fazës aktive të trajtimit, incizivët central largohen përafërsisht sa gjysma e distancës së hapjes së vidës zgjeruese, pra mesatarisht rreth 4 – 6mm, megjithëse ka raste kur arrihen edhe diastema deri në 11-13mm, kjo në varësi të madhësisë së aktivizimit të vidës gjatë ditës, numrit të ditëve të aktivizimit, moshës së pacientit, pranisë të ndonjë diasteme fillestare. Megjithatë madhësia e diastemës ndërmjet incizivëve central nuk duhet të përdoret si një tregues për madhësinë e hapjes së suturës mediopalatinale. Kjo diastemë rimbyllet në mënyrë spontane pas fazës aktive të trajtimit (brenda 1 muaji), për shkak të elasticitetit të fibrave transeptale, por kjo nuk do të thotë që trajtimi ka dështuar. Studimet tregojnë që fillimisht raporti skeletik/dentare i zgjerimit është 3-4/1, por pas 3-4 muajsh arrin afërsisht në 1/1 si pasojë e recidivës skeletike dhe shtimit të lëvizjes dentare (22).




Fig. 2. Molari i parë sipër pas trajtimit me RME

Dhëmbët posteriorë maksilarë: Inklinohen në drejtim bukal dhe tentojnë të ekstrudojnë. Tipping bukal vjen e rritet nga kaninët (2mm), tek premolarët (2.3-2-8mm) deri tek molarët (3.3 mm). Mund të thuhet pra, që zgjerimi total që fitohet nga zgjerimi i shpejtë i maksilës ka përbërësin skeletik (ortopedik), atë alveolar (bending) si edhe atë dentar (ortodontik). Të dhënat e literaturës të bazuara në imazhet tridimensionale të CBCT-së (16) tregojnë se: 1) në zonën e premolarëve të parë, ekspansioni skeletik (hapja e suturës) përbën 55% të zgjerimit total, bending alveolar 6% dhe tipping (inklinimi) dentar 39% të zgjerimit total. 2) në zonën e premolarit të dytë, hapja e suturës përbën 45%, përkulja alveolare 9%, ndërsa inklinimi dentar 46% të zgjerimit total. 3) në zonën e molarit të parë, hapja e suturës përbën 38%, alveolar bending 13% dhe tipping dentar 49% të ekspansionit total. Pra, siç treguam edhe më sipër, efekti skeletik përbën më pak se 50% të ekspansionit total pas 3-4 muajsh dhe nga përpara-prapa ky përbërës zvogëlohet, ndërsa ai dentar rritet.

Përsa i përket efektit të zgjerimit maksilar në *përmasat e harkatave dentare superiore*, matjet e realizuara në modelet e allçisë tregojnë se, direkt *pas fazës aktive* të zgjerimit gjerësia intermolare rritet mesatarisht nga 5-8 mm, afërsisht 90% e madhësisë së hapjes së vidës zgjeruese (10) dhe ngelet stabil edhe pas 5-7 vitesh nga realizimi i zgjerimit të shpejtë maksilar. (2). Gjerësia interkanine rritet mesatarisht me 4 mm dhe në *terma afatgjatë* (pas 5-7 vitesh) ngelen 2.5 mm, pas recidivës. Perimetri i harkatës superiore rritet me 6-6.5 mm *pas zgjerimit* dhe ngelet po kaq edhe në *terma afatgjatë* edhe pse humbet 3.5 mm nga recidiva (23), duke e krahasuar me pacientët e patrajtuar me okluzion normal, në të cilët perimetri zvogëlohet me 3 mm. Sipas *Adkins et al.* (24) mund të *parashikohet* një rritje e perimetrit të harkatës superiore me një madhësi sa 70% e rritjes së gjerësisë në zonën e premolarëve të parë superior. Kjo rritje e perimetrit sjell edhe një rritje të mundësisë me 50-75% të erupcionit spontan të kaninëve/incizivëve superiorë të impaktuar respektivisht, duke e krahasuar me pacientët e patrajtuar (25,26).

Efektet në strukturat dento-paradontale: Ka një shqetësim të vazhdueshëm për pasojat e mundshme mbi strukturat paradontale të dhëmbëve ankorues që mund të shfaqen gjatë zgjerimit të shpejtë të maksilës. Studimet e fundit me imazhe tridimensionale gjatë dhe pas zgjerimit japin të dhëna shumë më të sakta sesa studimet e mëparshme të bazuara mbi imazhet dimensionale. Të dhënat e literaturës tregojnë se nëse zgjerimi realizohet *para adoleshencës* (6 – 11 vjeç), vërehet një rezorbimi kockor vestibular te molarët e parë direkt pas fazës aktive të ekspansionit, mesatarisht 0.2 – 0.4 mm, por plotësisht e rikuperueshme gjatë një periudhe ritencioni 6 muajore. Gjithsesi gjatë gjithë periudhës nuk vërehen as fenomene të fenestracionit, as dehishenca dhe as humbje të atakut gingivar (27,14). Nëse zgjerimi realizohet *pas adoleshencës*, në denticionin permanent, (mosha 12 – 14 vjeç) të

dhënat e literaturës (15,28,29) tregojnë se zvogëlimi i trashësisë kockore vestibulare është më i madh, mesatarisht 0.6-0.9 deri në 1.2 mm, pas një periudhe ritencioni 3-6 mujore pas largimit të zgjeruesit. Vërehet edhe shfaqja e dehishencave kockore në dhëmbët ankorues, sidomos kur trashësi e kockës bucale është e hollë, më shumë në premolarët e parë (kur janë dhëmbë ankorues), mesatarisht 5-7 mm (Fig. 3) dhe më pak tek rrënja mezio-vestibulare molarëve të parë me një rezorbim të kreshtës alveolare mesatarisht rreth 3 – 4 mm. Megjithatë nuk shfaqen recesione gingivare për shkak të periudhës së shkurtër të studimit (vetëm 3-6 muaj) dhe me kalimin e kohës kocka mund të rigjenerohet. Faktori kryesor në shfaqjen e recesioneve është biotipi gingivar. Por në terma afatgjatë (8-10 vite pas ekspansionit), studime të tjera tregojnë se 20% e pacientëve të trajtuar me RME paraqesin recesione gingivare (30). Prandaj këshillohet monitorimi i gingivës aderente dhe teknikës së larjes së dhëmbëve, si faktorë precipitues të recesioneve gingivare, në pacientë ku është realizuar RME më përpara.



Fig. 3. Fenestracion i premolarit të parë sipër, pas trajtimit me RME (pamje nga CBCT e pacientit)

Efektet në mandibul: Ka një tendencë për një spostim poshtë dhe prapa të mandibulës, por klinikisht jo domethënës. Ndërkohë vërehen rritje të rëndësishme të përmasave të harkatës dentare inferiore. Të dhënat e literaturës tregojnë se direkt pas fazës aktive të zgjerimit të maksilës, distanca intermolare inferiore rritet mesatarisht me 1-2 mm e shoqëruar me një rritje të torque-ut të molarëve inferior me + 9° (31), rritje e cila ruhet edhe në terma afatgjatë. Perimetri i harkatës inferiore rritet mesatarisht me 4 mm gjatë fazës aktive dhe humbet 2,5 mm gjatë recidivës. Por nëse e krahasojmë në terma afatgjatë (5-7 vite pas zgjerimit maksilar), me pacientët e patrajtur të cilët humbasin 3 mm në perimetrin e harkatës inferiore (2), rritja neto e perimetrit në pacientët e trajtuar ngelet mesatarisht 4.5 mm. Pas zgjerimit të shpejtë maksilar, në 50% të pacientëve vihet re një përmirësim spontan i konsiderueshëm i malokluzionit të Klasës II, si nga përbërësi dentar, ku raporti i molarëve përmirësohet më shumë se 2.0-2,5 mm, ashtu edhe ai skeletik, me një zvogëlim të vlerës së Wits me 1.2 mm (32). Kjo ndodh kryesisht tek pacientët me gjatësi mandibulare të vogël (Co-Gn) dhe pozicionim më anterior të fosës glenoide (33). Pra nga pikëpamja klinike, duke bërë krahasimin me pacientët e patrajtuar me okluzion normal (grupi i kontrollit), zgjerimi i shpejtë i maksilës korrigjon 2/3 e deficitit fillestar të gjerësisë intermolare në të dy harkatat dentare. Ndërsa madhësia e korrigjimit nga zgjerimi, është 80% për perimetrin e harkatës maksilare dhe 100% për atë mandibulare.

Efektet në rrugët dhe funksionin e frymëmarrjes

Disa studime tregojnë se pas trajtimit me RME, vërehet një zvogëlim i rezistencës së rrugëve ajrore nazale dhe një përmirësim subjektiv i frymëmarrjes nazale. Ndryshimet në rrugët e frymëmarrjes

pas trajtimit me RME janë studiuar me disa metodologji të ndryshme siç janë: cefalometritë 2D dhe 3D, CBCT e rrugëve të frymëmarrjes, rinomanometria e kompjuterizuar, rinometria akustike, polisomnografia (PSG), floumetria e pikut të inspiracionit nazal (PNIF). Megjithatë të dhëna janë akoma kontradiktore. Haas në 1965 (3) raportoi rritje të gjerësisë nazale 2-4.5 mm pas trajtimit me RME. Studimet e fundit me CBCT në pacientë para adoleshencës të (13,14,16,34) gjetën mesatarisht 1.5-2 mm ekspansion të gjerësisë së kavititetit nazal pas trajtimit me RME. Tecco et al. (35) në pacientët me moshë mesatare 8 vjeç, gjetën rritje të përmasave të rrugëve nazofaringeale me 5.2 mm pas trajtimit me RME, në krahasim me 1.2 mm në grupin e kontrollit. Këto ndryshime ndodhin 6 muaj pas trajtimit me RME dhe ngelen stabël edhe për 12 muaj pas ekzaminimit. Por duhet të thuhet se modifikimet morfologjike të rrugëve ajrore nuk sjellin domosdoshmërisht performancë më të mirë respiratore (d.m.th. funksionale) ose e anasjella. Ndryshimet e rrugëve ajrore lidhen edhe me variabla të tjerë më kompleks dhe me modelin e frymëmarrjes së pacientit. Shpeshherë shkaku i bllokimeve të rrugëve ajrore mund të mos lidhet me problemet anatomike skeletike dhe zgjerimi skeletik i kaviteti nazal nuk sjell domosdoshmërisht përmirësim të rrugëve ajrore. Prandaj studimet që përfshijnë vetëm aspektet anatomike të trajtimit me RME duhet të jenë të kufizuara në konkluzione. Ndërkohë që ka edhe studime të tjera që nuk gjejnë ndryshime të kavitetit nazal pas trajtimit me RME (36,37,38,39,40,41). De Felipe et al. (42) me anë të analizave 3D dhe rinometrisë akustike gjetën një zvogëlim me 35% të rezistencës së rrugëve ajrore nazale, menjëherë pas trajtimit me RME dhe rritje të sipërfaqes tërthore minimale të kaviteti nazal deri me 45%. Këto vlera ngelen stabël edhe pas 5 vitesh pas trajtimit me RME dhe janë pothuajse në të njëjta në pacientët me frymëmarrje normale nazale. Iwasaki et al., duke përdorur CBCT dhe analizat kompjuterike të dinamikës së fuidëve, gjeti një zvogëlim të presionit dhe shpejtësisë së ventilimit nazal pas trajtimit me RME të pacientëve 9-vjeçar, duke treguar një përmirësim të frymëmarrje nazale. Fastuca et al. (43,44) gjetën një përmirësim të indeksit të Apne-Hipopne (AHI) deri në një vlerë 4.2/orë. Studime të mëtejshme korrekte nevojiten për të treguar efektet afatgjata të RME në përmasat e rrugëve ajrore dhe në funksionet respiratore.

Referenca

1. Timms D.J. The Dawn of Rapid Maxillary Expansion. The Angle Orthodontist 1999;69:3:247-50.
2. McNamara Jr JA. Maxillary transverse deficiency. Am J Orthod Dentofacial Orthop. 2000;117:567-70.
3. Ficarelli JP. A brief review of maxillary expansion. J Pedod 1978;3:1:29-35.
4. Moyers RE, van der Linden, FPGM and Riolo ML. Standards of human occlusal development, Monograph 5, craniofacial growth series, Center for Human Growth and Development, University of Michigan. Ann Arbor 1976.
5. Persson M, Thilander B. Palatal suture closure in man from 15 to 35 years of age. Am J Orthod 1977;72:42-52.
6. Handelman CS. Nonsurgical rapid maxillary alveolar expansion in adults: A clinical evaluation, Angle Orthod 1997;67:291-305.
7. Isaacson RJ, Ingram AH. Forces produced by rapid maxillary expansion, II. Forces present during treatment. Angle Orthod.1964;34:261-70.
8. Starnebach JK, Cleall JF. Effects of splitting the midpalata suture on the surrounding structures. Am J Orthod 1963;50:923.
9. Haas AJ. The treatment of maxillary deficiency by opening the midpalatal suture. Angle Orthod 1965;35:200-17.
10. Ballanti F, Lione R, Viarani S, Fanucci E, Cozza P. Post-retention effects of rapid maxillary expansion on nasal cavity and on periodontal structures. Oral Implantol

- (Rome). 2008 Oct-Dec; 1(3-4): 95–103.
11. Davidovitch M, Efstathiou S, Sarne O, Vardimon AD. Skeletal and dental response to rapid maxillary expansion with 2- versus 4-band appliances. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* **2005 Apr;127(4):483-92.**
 12. Chung CH, Font B. Skeletal and dental changes in the sagittal, vertical and transverse dimensions after rapid palatal expansion. *Am J Orthod Dentofac Orthop.* 2004;126:569–75.
 13. Podesser B, Williams S, Crismanim AG, Bantleon HP. Evaluation of the effects of rapid maxillary expansion in growing children using computer tomography scanning: a pilot study. *Eur J Orthod.* 2007;29:37–44.
 14. Ballanti F, Lione R, Baccetti T, Franchi L, Cozza P. Treatment and posttreatment skeletal effects of rapid maxillary expansion investigated with low-dose computed tomography in growing subjects. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 2010;138:311-7.
 15. Garib DG, Henriques JFC, Janson G, Roberto de Freitas M, Fernandes AY. Periodontal effects of rapid maxillary expansion with tooth-tissue-borne and tooth-borne expanders: A computed tomography evaluation. *Am J Orthod Dentofacial Orthop* 2006;129:749-58.
 16. Garrett BJ, Caruso JM, Rungcharassaeng K, Farrage JR, Kim JS, Taylor GD. Skeletal effects to the maxilla after rapid maxillary expansion assessed with cone-beam computed tomography. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 2008;134:8.e1–11.
 17. Baccetti T, Franchi L, Cameron CG, McNamara JA Jr., Treatment Timing for Rapid Maxillary Expansion. *Angle Orthodontist* 2001;71:343-50.
 18. Sandikçioğlu M1, Hazar S. Skeletal and dental changes after maxillary expansion in the mixed dentition. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 1997 Mar;111(3):321-7.
 19. Cozza P, Giancotti A, Petrosino A. Rapid palatal expansion in mixed dentition using a modified expander: a cephalometric investigation. *J Orthod.* 2001 Jun;28(2):129-34.
 20. Velázquez P, Benito E, Bravo LA. Rapid maxillary expansion. A study of the long-term effects. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 1996 Apr;109(4):361-7.
 21. da Silva Filho OG, Boas MCV, Capelozzo L. Rapid maxillary expansion in the primary and mixed dentitions: a cephalometric evaluation. *American Journal of Orthodontics and Dentofacial Orthopedics* 1991; 100 : 171 – 181.
 22. Proffit WR, Sarver DM. Diagnosis: gathering and organizing the appropriate information. In: Proffit WR, White RP, Sarver D M (eds). *Contemporary treatment of dentofacial deformity.* 2003 pp. 164 –170.
 23. O'Grady PW, McNamara JA Jr, Franchi L, Baccetti T. Long-Term Stability of Rapid Maxillary Expansion Concurrent with Schwarz Appliance Therapy in the Mixed Dentition. *Am J Orthod Dentofacial Orthop* 2006;130:202-213.
 24. Adkins MD, Nanda RS, Currier GF. Arch perimeter changes on rapid palatal expansion. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 1990 ;97(3):194-9.
 25. Pavoni C, Franchi L, Laganà G, Cozza P. Radiographic assessment of maxillary incisor position after rapid maxillary expansion in children with clinical signs of eruption disorder. *Journal of Orofacial Orthopedics* 2013, 74(6):468-479.
 26. Baccetti T, Mucedero M, Leonardi M, Cozza P. Interceptive treatment of palatal impaction of maxillary canines with rapid maxillary expansion: a randomized clinical trial. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 2009 Nov;136(5):657-61.
 27. Garib DG, Calil LR, Leal CR, Janson G. Is there a consensus for CBCT use in Orthodontics? *Dental Press J Orthod.* 2014 SeptOct;19(5):136-49.
 28. Baysal A, Uysal T, Veli I, Ozer T, Karadede I, Hekimoglu S. Evaluation of alveolar bone loss following rapid maxillary expansion using cone-beam computed tomography. *Korean J Orthod.* 2013 Apr;43(2):83-95.
 29. Rungcharassaeng K, Caruso JM, Kan

- JY, Kim J, Taylor G. Factors affecting buccal bone changes of maxillary posterior teeth after rapid maxillary expansion. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 2007 Oct;132(4):428.e1-8.
30. Vanarsdall RL. Periodontal/orthodontic interrelationships. In: Graber TM, Vanarsdall RL (eds) *Orthodontics, current principles and techniques*, 1994. 2nd edn. Mosby, St Louis, pp.712-749.
 31. Ugolini A, Toldo T, Ghislanzoni L, Mapelli A, Giorgetti R, Sforza Ch. Rapid palatal expansion effects on mandibular transverse dimensions in unilateral posterior crossbite patients: a three-dimensional digital imaging study. *Prog Orthod.* 2016; 17: 1.
 32. Guest SS, McNamara JA Jr, Franchi L, Baccetti T. Spontaneous Improvement of Class II following Maxillary Expansion. *Am J Orthod Dentofacial Orthop* 2010;138:582-591.
 33. Caprioglio A, Bergamini Ch, Franchi L, Vercellini N, Zecca PA, Nucera R, Fastuca R. Prediction of Class II Improvement After Rapid Maxillary Expansion in Early Mixed Dentition. *Prog Orthod* 18 (1), 9. 2017 Apr 03.
 34. Palaisa J, Ngan P, Martin C, Razmus T. Use of conventional tomography to evaluate changes in the nasal cavity with rapid palatal expansion. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 2007;132:458–66.
 35. Tecco S, Festa F, Tete S, Longhi V, D'Attilio M. Changes in head posture after rapid maxillary expansion in mouth-breathing girls: a controlled study. *Angle Orthod.* 2005;75:171–6.
 36. Compadretti GC, Tasca I, Bonetti GA. Nasal airway measurements in children treated by rapid maxillary expansion. *Am J Rhinology.* 2006;20:385–93.
 37. Enoki C, Valera FC, Lessa FC, Elias AM, Matsumoto MA, Anselmo-Lima WT. Effect of rapid maxillary expansion on the dimension of the nasal cavity and on nasal air resistance. *Int J Pediatr Otorhinolaryngol.* 2006;70:1225–30.
 38. Monini S, Malagola C, Villa MP. Rapid maxillary expansion for the treatment of nasal obstruction in children younger than 12 years. *Arch Otolaryng Head Neck Surg.* 2009;135:22–7.
 39. Smith T, Ghoneima A, Stewart K, Liu S, Eckert G, Halum S, et al. Threedimensional computed tomography analysis of airway volume changes after rapid maxillary expansion. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 2012;141:618–26.
 40. Ribeiro Cunha AN, de Paiva JB, Rino-Neto J, Illipronti-Filho E, Mongelli FS. Upper airway expansion after rapid maxillary expansion evaluated with cone beam computed tomography. *Angle Orthod.* 2012;82:458–63.
 41. Hakan E, Palomo JM. Three-dimensional evaluation of upper airway following rapid maxillary expansion. A CBCT study. *Angle Orthod.* 2014;84:265–73
 42. de Felipe NLO, Bhushan N, Da Silveira AC, Viana G, Smith B. Long-term effects of orthodontic therapy on the maxillary dental arch and nasal cavity. *Am J Orthod Dentofacial Orthop.* 2009;136:490.e1–e8.
 43. Fastuca R, Zecca PA, Caprioglio A. Role of mandibular displacement and airway size in improving breathing after rapid maxillary expansion. *Prog Orthod.* 2014;15:40.
 44. Fastuca R, Perinetti G, Zecca PA, Nucera R, Caprioglio A. Airway compartments volume and oxygen saturation changes after rapid maxillary expansion. A longitudinal correlation study. *Angle Orthod.* 2015 Feb 9.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

ANALIZA KIMIKE ME KROMATOGRAFI TË GAZTË PËR VAJIN ESENCIAL TË *ROSMARINUS OFFICINALIS* NGA ZONA E TEPELENËS

Aurel Nuro*, Jonida Salihila*, Dorina Shëngjergji**, Aida Dama**, Aurora Napuçe**,
Erjon Troja***, Dhimitër Peci****

*Departamenti i Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës

**Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University

***Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranës

****Qendra Kombëtare e Florës dhe Faunës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës

Adresë kontakti: nuroaurel@yahoo.co.uk

Përmbledhje

Objektivat: Në këtë studim janë sjellë të dhënat e analizës kimike me kromatografi të gaztë për vajin esencial të bimës të llojit *Rosmarinus Officinalis* nga zona të Tepelenës. *Rosmarinus Officinalis* është një bimë e familjes të Lamiacea. Ka përhapje mjaft të gjerë në vendin tonë dhe thuajse në të gjithë Mesdheun. Ka përdorime të gjera të hershme sidomos në kulinari dhe mjekësinë popullore (1; 2; 3).

Metodat: Bimët e *Rosmarinus Officinalis* janë marrë nga zona të Tepelenës. Bimët janë marrë në tetor 2017. Bimët e thara në ajër janë prerë në pjesë të vogla (1-2 cm). Ato ishin subjekt i hidrodistilimit për 4 orë në aparatin Clevengar, të rekomanduar nga Farmakopeia Europiane, për të përftuar vajin esencial të *Rosmarinus Officinalis*. Përbërja kimike e vajit esencial u analizua duke përdorur teknikën GC/FID. Vajrat esenciale të secilës mostër *Rosmarinus Officinalis* u injektuan në aparatin Varian 450 GC me detektor me jonizim në flakë. Kolona kapilare VF-1ms (30m x 0.33 mm x 0.25 um) u përdor për ndarjen e komponentëve kimike të vajit esencial (4; 5).

Përfundimet: Komponimet kryesore që u gjetën më me shumicë si në bimët e njoma dhe tek bimët e thata të *Rosmarinus Officinalis* ishin: alfa-Pinene, Cineol, Kamfur, alfa-Terpineol dhe Verbenon. Profili dhe nivelet e komponimeve për mostrat e *Rosmarinus Officinalis* nga zona Tepelena ishin të njëjta me studime të tjera të raportuara nga zona Mesdheut dhe e Gadishullit Ballkanik. Përqindja e komponimeve kryesore për bimën e njomë ishte më e madhe se në bimën e thatë. Kontributin kryesor tek vaji esencial i rozmarinës është për monoterpenoidet e oksigjenuar (6; 7; 8).

Fjalë çelës: *Rosmarinus Officinalis*, Vaj esencial, alfa-Pinene, Cineol, Kamfur, alfa-Terpineol, Verbenon, GC/FID.

GAS CHROMATOGRAPHY CHEMICAL ANALYZES OF *ROSMARINUS OFFICINALIS* ESSENTIAL OIL FROM TEPELENA AREA

Abstract

Objective: In this study was present data on gas chromatography chemical analysis of essential oil for *Rosmarinus Officinalis* plant populations from Tepelena area. *Rosmarinus Officinalis* is a plant of Lamiaceae family. It is grow in all Albania and throughout the Mediterranean area. *Rosmarinus Officinalis* has earlier uses especially in culinary and traditional medicine (1; 2; 3).

Methods: *Rosmarinus Officinalis* plants from Tepelena area were taken in October 2017. The air dried plant samples were cut in small pieces (1-2 cm). They were subjected of hydrodistillation for 4 hours using Clevenger type apparatus, recommended to European Pharmacopoeia, to obtain *Rosmarinus Officinalis* essential oil. The chemical composition of the essential oils was analyzed using GC/FID technique. The oil of each *Rosmarinus Officinalis* sample was injected in a Varian 450 GC equipped with flame ionization detector. VF-1ms capillary column (30 m x 0.33 mm x 0.25 μ m) were used for separation of its compounds (4, 5).

Conclusion: Main compounds found in both, fresh and dry plant of *Rosmarinus Officinalis* were: alpha-Pinene, Cineol, Camphour, alpha-Terpineol and Verbenon. Profile and found levels for essential oil of *Rosmarinus Officinalis* from Tepelena area were similar to other studies from Mediterranean and Balkan area. Main compounds percent for fresh plant was higher than dry plant. Oxygenated monoterpenoides were the main group of essential oil for rosemary (6; 7; 8).

Keywords: *Rosmarinus Officinalis*, Esencial oil, alpha-Pinene, Cineol, Camphour, alpha-Terpineol, Verbenon, GC/FID.

Hyrje

Rosmarinus Officinalis është një specie nga familja Laminacea. Kjo bimë që njihet zakonisht si rozmarina, është shumëvjeçare me aromë. Është spontane thuajse në të gjithë zonat e vendit tonë dhe në të gjithë rajonin e Mesdheut. Ajo mund të përballojë thatësinë, duke mbijetuar një mungesë të zgjatur të ujit. Degët e rozmarinës zakonisht janë të drejta, mund të arrijnë 1.5 m. Ato edhe mund të zvarriten. Gjethet janë me gjelbërim të përhershëm, 2-4 cm të gjatë dhe 2-5 mm të gjera, të gjelbra sipër dhe të bardha poshtë, me push të dendur e të shkurtër. Bimët nxjerrin lule në pranverë dhe verë, por mund të jenë në lulëzim të vazhdueshëm në klimë të ngrohtë. Rozmarina gjithashtu ka një tendencë të lulëzojë jashtë sezonit të saj të lulëzuar normal, në fillim të dhjetorit, dhe në mesin e shkurtit. Rozmarina përdoret si një bimë dekorative në kopshte ku mendohet të ketë efekte dhe në kontrollin e insekteve. Gjethet përdoren për të përmirësuar shijen e ushqimeve të ndryshme. Ato kanë një shije të lehtë të hidhur me një aromë karakteristike që plotëson aromën e ushqime të gatuar (1, 2, 3, 4).

Rozmarina është e njohur për shekuj me radhë si një bimë me veti shëruese dhe erëz me aromë karakteristike në kulinari. Ajo është një nga bimët më të vjetra të njohura për njeriun. Ka shije dhe aromë të pazakontë. Çaji nga rozmarina mund të përdoret për të përmirësuar shëndetin e gjithë

trupit, duke përfshirë edhe shëndetin e trurit, zemrës dhe mëlçisë. Rozmarina përmban një numër të madhe të fitokimikateve, duke përfshirë acidin rosmarinik, kamfurin, acidin kafeik, acidin ursolik, acidin betulinik, acidin karnosik dhe karnosol. Në mjekësinë tradicionale, ekstraktet dhe vaji esencial i nxjerrë nga lulet dhe gjethet përdoren për të trajtuar një shumëllojshmëri të çrregullimeve. Vaji esencial i rozmarinës përmban 10-20% kamfur megjithëse përbërja kimike mund të ndryshojë shumë në zona të ndryshme (3, 5, 6, 7).

Përbërësit e vajrave esencialë janë zakonisht komponime me pikë vlimi nga 120-150°C dhe shumica e tyre janë shumë pak të tretshëm në ujë. Këto veti bëjnë që vajrat esencialë të përftoheshin nga bimët ku ndodhen, kryesisht nëpërmjet procesit të distilimit me avull uji. Kjo është metoda më e përdorur për nxjerrjen e vajrave esencialë, por komponimet polare dhe relativisht hidrofile të esencave nuk përftoheshin plotësisht nga bima dhe komponimet me natyrë kimike të paqëndrueshme si aldehidet, esteret etj. mund të pësojnë modifikime nën veprimin e temperaturës, avullit të ujit dhe oksigjenit gjatë procesit të distilimit. Përcaktimi i strukturës kimike dhe sasi të përqindje të përbërësve të secilës esencë, realizohet me anën e analizave gazkromatografike dhe spektrometrisë të masës (4, 6, 7, 8).

Metodologjia

Marrja e mostrave të *Rosmarinus Officinalis*

Mostrat e *Rosmarinus Officinalis* janë marrë nga popullata të kultivuara në ambiente të kopshteve të shtëpive në zonën e Tepelenës. Degë me gjethë të *Rosmarinus Officinalis* u mbledhën në tetor 2017. Një pjesë e mostrave të marra ishte objekt i drejtpërdrejtë i analizave të mëtejshme ndërsa pjesa tjetër u thanë në hije që të mos humbasin karakteristikat morfologjike e më pas u analizuan. Materiali bimor i njomë apo i thatë u copëtua në pjesë të vogla për analizën e mëtejshme.

Mjete dhe reaktivë

n-Hekzani dhe Tolueni të pastërtisë të lartë për përdorime gazkromatografike u sigurua nga Merck (Darmstadt, Germany). Përzierja e n-alkaneve nga n-oktani (C8) deri në eikosanet (C20) u përdorën për llogaritjen e indekseve të Kovats (KI).

Izolimi i vajrave esencialë për *Rosmarinus Officinalis*

Materiali bimor i *Rosmarinus Officinalis* (100 g bimë e njomë ose e thatë e *Rosmarinus Officinalis* ishin subjekt i hidro-distilimit për 4 orë pa ndërprerje me aparaturën e llojit Klevenger (rekomanduar nga Pharmacophea Europea, 2014) për izolimin e vajit esencial. Vaji esencial u grumbullua në 2 ml Toluen si solvent ekstraktimi. Ekstraktit ju largua uji duke shtuar 1 gr sulfat natriumi anhidër. Ai u ruajt në vialë të errët në +4°C. Vaji esencial i *Rosmarinus Officinalis* u hollua (1/10) në Toluen (v/v) që ishte dhe subjekt i analizës GC/FID (8; 9).

Aparatura dhe analiza gazkromatografike

Analiza gaz kromatografike e vajit esencial të *Rosmarinus Officinalis* u realizua në aparatën Varian 450 GC, të pajisur me injektor PTV dhe detektor me jonizim në flakë (FID). Temperatura e injektorit dhe e detektorit u vendosën respektivisht në 280°C dhe 300°C. 2 ul e vajit esencial të *Rosmarinus Officinalis* i holluar në toluen u injektuar në mënyrë split (1:50). Azoti u përdorur si gaz mbartës (1 ml/min) dhe si 'make-up gas' (25 ml/min). Hidrogjeni dhe ajri ishin gazet e flakës në detektor respektivisht me 30 ml/min dhe 300 ml/min. Kolona kapilare VF-1ms (30 m x 0,33 mm x 0,25 µm) u përdor për të izoluar komponimet vajit esencial. Temperatura e furrës

ishte programuar si vijon: nga 40°C (u mbajt për 2 minuta në 50°C) në 150°C me 4°C/min, më tej në 280°C me 10°C/min, në 280°C u mbajt për 2 minuta. Identifikimi i komponimeve është bazuar në krahasimin e kohëve të daljes (RT) me indeksat e Kovats-it, të cilat së bashku me të dhënat e literaturës u përdorën për identifikimin e komponimeve kryesore. Të dhënat sasiore të komponimeve të analizuar janë dhënë në % kundrejt totalit të sipërfaqeve të pikeve (6; 7; 8).

Rezultatet

Vaji esencial i mostrave njoma dhe të thata të *Rosmarinus Officinalis* nga Tepelena janë analizuar duke përdorur teknikën me GC/FID. Mesataret e rezultateve për mostrat e njoma dhe të thata të bimëve të rozmarinës të marra për analizë u prezantuan si krahasim i tyre në këtë studim për të vërejtur dallimet dhe ngjashmëritë midis tyre. Nga GC/FID për bimën e njomë dhe të thatë të rozmarinës ishin nga 90-110. Të dhënat paraqesin 23 komponimet kryesore që janë gjetur për të gjithë vajra esenciale të *Rosmarinus Officinalis*. Të dhënat janë në përqindje kundrejt totalit të pikeve (me përjashtim të pikut të toluenit që u përdor si tretës). Piket me sipërfaqe më të ulët se 0,05% nuk u konsideruan në këtë studim. Tabela 1 tregon përqindjet e komponimeve të detektuar nga analiza e mostrave të vajrave esenciale të *Rosmarinus Officinalis*. Përqindja e komponimeve kryesore për bimën e njomë ishte 95.3% ndërsa të njëjtët komponime në bimën e thatë ishte 93.1%. Për të gjitha mostrat komponimet kryesore ishin alfa-Pinene (21.7% e njomë, 18.8% e thatë), Cineol (21.7% e njomë dhe 19.6% e thatë), Kamfur (9.3% e njomë, 14.1% e thatë), alfa-Terpineol (12.4% e njomë, 6.7% e thatë) dhe Verbenon (4.21% e njomë, 10.3% e thatë). Komponimet e tjera u gjetën të kenë mesatare më të ulët se 1%. Kontributin kryesor tek vaji esencial i rozmarinës është për monoterpenoidet e oksigjenuar (46.6% e njomë, 45.4% e thatë). Monoterpenet (36.0 e njomë, 27.6% e thatë) kryesisht monoterpenet biciklike (30.6% e njomë dhe 23.6% e thatë) janë të dytët që kontribuojnë në totalin e komponimeve kryesore të esencës. Monoterpenoidet aromatike vijnë më tej me 10.4% tek bima e njomë dhe 17.2% te bima e thatë. Seskuiterpenet kanë kontributin më të vogël tek esenca me 2.4% te bima e njomë dhe 2.9% te bima e thatë.

Tabela 1. Përqindjet e komponimeve kryesore për vajin esencial të *Rosmarinus Officinalis* të njomë dhe të thatë marrë në Tepelenë, tetor 2017

	Bimë e njomë	Bimë e thatë
alfa-Pinene	23.72	18.81
Kamfen	4.61	3.22
beta-Pinene	1.56	1.08
Miricen	2.72	1.34
alfa-Felandren	1.43	1.25
alfa-Terpinen	0.41	0.49
Sabinen	0.71	0.46
para-Cimen	1.19	1.38
Limonen	2.93	3.39
Cineole	21.67	19.56
gama-Terpinen	0.33	0.36
Terpinolen	0.47	0.59

Linaleol	2.16	3.17
Kamfur	9.27	14.05
Borneol	0.56	0.73
alfa-Terpineol	12.42	6.71
Terpinen-4-ol	0.53	1.16
Estragol	0.73	1.06
Verbenon	4.21	10.28
Acetat Bornili	0.55	0.62
Acetat Terpinili	0.73	0.43
beta-Kariofilen	1.98	2.54
Humulen	0.42	0.38
Totali	95.31	93.06
Monoterpene aciklike	2.72	1.34
Monoterpene monociklike	2.64	2.69
Monoterpene biciklike	30.6	23.57
Total monoterpene	35.96	27.6
Monoterpenoide të oksigjenuar	46.61	45.38
Monoterpenoide aromatike	10.34	17.16
Seskuiterpene	2.4	2.92

Diskutime

Profili i 23 komponentëve kryesore të analizuar për mostrat e njoma dhe të thata të *Rosmarinus Officinalis* nga Tepelena është paraqitur në Figurën 2. Ka një profil të ngjashëm për mostrat e rozmarinës pavarësisht nëse ajo është e njomë apo është e thatë. Kjo është e lidhur me përbërjen kimike të pandryshueshme me kalimin e kohës të esencës të kësaj bime. Përveç ngjashmërisë të dukshme ka dhe diferenca midis këtyre bimëve. Pamjen e profilit të tyre mund ta ndajmë në dy pjesë. Në pjesën e 10 komponimeve që dalin të parët nga kolona (me pika vlimi më të ulëta) në bimën e njomë ka përqindje më të larta krahasuar me bimën e thatë. E dallueshme është diferencat për alfa-Pinene dhe Cineol që janë dhe komponimet kryesore tek bima e rozmarinës. Për komponimet e tjerë të cilët kanë pika vlimi më të mëdha është e kundërta (Përrjashtim bën alfa-Terpinol). Përqindja e komponimeve si Linaleol, Verbenon, beta-Kariofilen është më e lartë tek bima e thatë. Kjo do të thotë se dhe procesi i tharjes ka ndikim në profilin e esencave, në këtë rast të *Rosmarinus Officinalis* të analizuar nga e njëjta zonë e Shqipërisë. Mund të shtojmë se komponimet volatile me tharjen e bimës mund të largohen më tepër se komponimet më pak volatile duke sjellë dhe këtë tendence tek vajrat esenciale për bimën e njomë e të thatë. Duke vërejtur klasat e ndryshme të komponimeve terpenoike tek esencat e *Rosmarinus Officinalis* (Figura 2) mund të themi se:

- Monoterpenet aliciklike (Miricen) gjenden më pak se 3% tek rozmarina, ato janë më me shumicë në bimën e njomë;
- Monoterpenet monociklike (Felandren, alfa-Terpinen, gama-Terpinen, Terpinolen) gjithashtu gjenden në nivele më të ulëta se 3%. Ato gjenden thuajse në sasi të njëjtë si tek bima e njomë dhe tek bima e thatë.
- Monoterpenet biciklike (alfa-Pinen, Kamfen, beta-Pinen dhe Sabinen) gjenden nga

23.4% tek bima e thatë deri në 30.7% tek bima e njomë. Është e dukshme diferenca midis bimës së njomë, ku ato gjenden më me shumicë krahasuar me bimën e thatë. Kjo shpjegohet me volatilitetin e tyre më të lartë. Kjo diferencë pasqyrohet gjithashtu dhe për totalin e monoterpeneve të cilat shkojnë nga 27.1% tek bima e thatë deri në 36.1% te bima e njomë. Monoterpenet kontribuojnë të dytat në esencën e rozmarinës.

- Monoterpenoidet e oksigjenuara kanë ndikimin kryesor tek esenca e rozmarinës me rreth 45% kundrejt totalit të komponimeve. Cineoli, Linaleoli, Kamfuri, Borneoli, Acetat Bornili, alfa-Terpineol, Terpilen-4-ol dhe Acetat Terpinili janë dhe komponimet kryesore të monoterpenoideve me oksigjen. Përqindjet e tyre nuk ndikohen nga procesi i tharjes të bimës të rozmarinës.
- Monoterpenoidet aromatike (p-Cimen, Limonen, Estragol dhe Verbenon) u gjetën në përqindje më të ulët tek bima e njomë me 10.4% krahasuar me përqindjen e tyre te bima e thatë ku ishin 17.2%. Procesi i tharjes mund të ketë ndikim në shtimin e këtyre komponimeve por nuk përjashtohet që zvogëlimi i sasive të substancave volatile favorizon rritjen e përqindjes për komponimet e tjera.
- Seskuiterpenet që përfaqësohen nga Humulen dhe beta-Kariofilen gjithashtu kanë një rritje të vogël të përqindjes nga 2.4% tek bima e njomë në 2.9% tek bima e thatë. Procesi i tharjes dhe zvogëlimi i përqindjeve për komponimet volatile janë dy faktorët kryesorë.




Figura 1. Përqindjet e komponimeve kryesore në vajin esencial të *Rosmarinus Officinalis*




Figura 2. Shpërndarja e komponimeve terpenoike në vajin esencial të rozmarinës

Përfundime

Përbërja kimike e vajit esencial të mostrave të *Rosmarinus Officinalis* nga Tepelena (tetor 2017) janë analizuar duke përdorur teknikën me GC/FID. Të dhënat paraqesin 23 komponimet kryesore që janë gjetur për vajrat esenciale të bimëve të njoma dhe të thata të *Rosmarinus Officinalis*. Komponimet kryesore që u gjetën më me shumicë si në bimët e njoma dhe tek bimët e thata ishin: alfa-Pinene, Cineol, Kamfur, alfa-Terpineol dhe Verbenon. Profili dhe nivelet e komponimeve për mostrat e *Rosmarinus Officinalis* nga zona e Tepelenës ishin të njëjta me studime të tjera të raportuara nga zona e Mesdheut dhe e Gadishullit Ballkanik (3; 4). Përqindja e komponimeve kryesore për bimën e njomë ishte më e madhe se në bimën e thatë. Kontributin kryesor tek vaji esencial i rozmarinës është për monoterpenoidet e oksigjenuar ku nivelet kryesore i takojnë Cineolit, Kamfurit dhe alfa-Terpinolen. Monoterpenoidet aromatike vijojnë të tretat. Sesquiterpenet kanë kontributin më të vogël tek esencat e rozmarinës si në bimën e njomë dhe të thatë. Përbërja kimike e esencave që nxirren nga bima e njomë dhe e thatë janë të pandryshueshme pas procesit të tharjes. Përveç ngjashmërisë të dukshme ka dhe diferenca midis këtyre bimëve. Pamjen e profilit të tyre mund ta ndajmë në dy pjesë. Në pjesën e 10 komponimeve që dalin të parët nga kolona (me pika vlimi më të ulëta) në bimën e njomë ka përqindje më të larta krahasuar me bimën e thatë. E dallueshme është diferenca për alfa-Pinene dhe Cineol që janë dhe komponimet kryesore tek bima e rozmarinës. Për komponimet e tjerë të cilët kanë pika vlimi më të mëdha, është e kundërta (Përrjashtim bën alfa-Terpinol). Përqindja e komponimeve si Linaleol, Verbenon, beta-Kariofilen është më e lartë tek bima e thatë. Kjo do të thotë se dhe procesi i tharjes ka ndikim në profilin e esencave, në këtë rast të *Rosmarinus Officinalis* të analizuar nga e njëjta zonë e Shqipërisë. Mund të shtojmë se komponimet volatile me tharjen e bimës mund të largohen më tepër se komponimet më pak volatile duke sjellë dhe këtë tendencë tek vajrat esenciale për bimën e njomë e të thatë. Prosesi i tharjes mund të ketë ndikim në shtimin e këtyre komponimeve por nuk përjashtohet që zvogëlimi i sasive të substancave volatile favorizon rritjen e përqindjes për komponimet e tjera.

Referenca

1. Wolfgang Kathe, Susanne Honnef & Andreas Heym. "Medicinal and Aromatic Plants in Albania, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia and Romania". A study of the collection of and trade in medicinal and aromatic plants (MAPs), relevant legislation and the potential of MAP use for financing nature conservation and protected areas" WWF Deutschland / TRAFFIC Europe-Germany (2003), 123-125.
2. Uran Asllani "Esencat e bimëve aromatike shqiptare", (2004), 23-24. Tiranë.
3. Tutin T. "Flora Europaea", Volume 2. (1968).123-125. ISBN 0-521-06662-X
4. Bozin B., Mimica-Dukic N., Simin N., Anac-kov G., "Characterization of the volatile composition of essential oils of some Lamiaceae spices and the antimicrobial and antioxidant activities of the entire oils", J. Agric. Food Chem.,54, (2006) 1822-1828.
5. Adams RP., "Identification of essential oil components by gas chromatography/mass spectroscopy", Allured Publishing Corporation, (1995) Carol Stream: Illinois, USA.
6. Daferera D.J., Ziogas B.N., Polissiou M.G., "GC-MS analysis of essential oils from some Greek aromatic plants and their fungitoxicity on *Penicillium digitatum*", Journal of Agricultural Food Chemistry, 48, (2000) 2576-2581.
7. David F., Scanlan F., Sandra P., Szelewski M., "Analysis of essential oil compounds using retention time locked methods and retention time databases, Application, Agilent Technologies", (2010), 5988-6530EN.
8. Angelov G., Penchev P., Condoret J.S., Optimization of operational conditions of ethanol extraction of rosmarinic acid from Lemon Balm (*Melissa officinalis* L.). Sci. Pap., 2007; 35 (5): 71-76.
9. Azad N., Rasoolijazi H., Joghataie M.T., Soleimani S., Neuroprotective effects of carnosic acid in an experimental model of Alzheimer's disease in rats. Cell J., 2011; 13 (1): 39-44.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

ANALIZAT KIMIKE TË PËRBËRJES ALKOOLIKE DHE PËRMBAJTJES TË POLIFENOLEVE NË VERËRAT E TREGUT SHQIPTAR

Ardit Shehi*, Aurel Nuro**, Bledar Murtaç**, Dorina Shëngjergji*, Aurora Napuçe*

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University

**Departamenti i Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës

Adresë kontakti: ardit_shehi@yahoo.com

Përmbledhje

Objektivat: Në këtë studim janë sjellë të dhëna nga analiza kimike e përbërjes alkoolike të disa nga verërat që gjenden në tregun shqiptar. Për mostrat e verës janë realizuar dhe analiza për përmbajtjen polifenolike të tyre. Vera është një nga pijet më të lashta të vendit tonë dhe në të gjithë Mesdheun (1; 2; 3).

Metodat: Mostrat e verës janë grumbulluar në periudhën dhjetor 2017 deri janar 2018. Mostrat e verës u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme në tregun e qytetit të Tiranës. Analiza e alkoolëve në mostrat e verës u realizua në aparatin GC/FID. Mostrat e verës në fillim u degazuan në banjë me ultratinguj për 30 minuta në temperaturën 30°C dhe më pas ato u injektuan drejtpërdrejt në injektorin split/splitless të aparatit GC/FID. Kolona kapilare VF-1ms u përdor për ndarjen e alkoolëve nga mostrat e verës. Përmbajtja e polifenoleve u realizua me anë të spektrofotometrisë UV-VIS. Matjet u realizuan për secilën nga mostrat e degazuara të verës në gjatësinë e valës 600 nm e rekomanduar për matjet e polifenoleve në pije alkoolike (4; 5).

Përfundime: Për të gjitha mostrat e verës alkooli kryesor ishte etanoli. Në mostrat e verës të prodhuar në mënyrë tradicionale vihet re prezencë më e lartë e alkoolëve me tri dhe katër karbone. Këto alkoolë ndikojnë dhe në buketin e këtyre verërave të cilat janë lehtësisht të dallueshme nga prodhimet industriale, ku nivelet e tyre janë më të ulëta. Përmbajtjen më të madhe të polifenoleve gjithashtu e kanë verat të cilat prodhohen në mënyrë tradicionale (6; 7; 8).

Fjalë çelës: *Mostra vere, përbërja alkoolike, përmbajtja polifenolike, GC/FID, spektrometria UV-VIS.*

CHEMICAL ANALYSIS OF ALCOHOLIC COMPOSITION AND POLYPHENOLIC CONTENT ON WINE SAMPLES OF ALBANIAN MARKET

Abstract

Objective: In this study presents data about chemical analysis of alcoholic composition for some of wines that can be found in Albanian market. Also, polyphenolic content was realized for wine samples. Wine is one of the oldest drinks in our country and across the Mediterranean area (1; 2; 3).

Methods: Wine samples were taken for the period December 2017 - January 2018. Wine samples were selected in random mode in Tirana markets. Analyzes of alcoholic composition in wine samples were realized in GC/FID method. Prior to analyses wine samples were degassed in ultrasound bath for 30 minutes in 30°C degree. Direct injection was realized for wine samples in split/splitless injector of GC/FID equip. VF-1ms capillary column (30 m x 0.33 mm x 0.25 µm) were used for separation of alcohols in wine samples. Polyphenolic contents were realized using UV-VIS spectrophotometry. Analyzes of degassed wine samples were realized in 600 nm, recommended for determination of polyphenols in wine (4, 5).

Conclusion: For all wine samples the main alcohol was ethanol. Traditionally produced wine samples show higher presence of three- and four-carbon alcohols. These alcohols also affect the bouquet of these wines which are easily distinguishable from industrial products where their levels are lower. The higher content of the polyphenols also have the wines that are produced in the traditional way (6; 7; 8).

Keywords: *Wine samples, alcoholic composition, polyphenolic content, GC/FID, UV-VIS spectrometry.*

Hyrje

Vera është një pije alkoolike që prodhohet nga fermentimi i rrushit. Pije të ngjashme me verën mund të bëhen edhe nga fruta të tjera. Vetë fjala verë ka kuptimin *verë rrushi*. Vera është interesante për disa arsye: përdorimi i saj në ceremonitë fetare të shumë kulturave; rëndësia historike e tregut të verës në lashtësi. Ndryshe nga produkte të tjera, vera reflekton tek ai që e shijon varietetin e terrenit, klimës dhe konditave në të cilat rrushi është rritur, duke e bërë verën të ketë një shumëllojshmëri shijesh. Duke shtuar këtu edhe përmirësimin e verës, me kalimin e kohës varieteti i shijes së verës është gati i pafundmë. Shumë fabrika moderne vere mundohen ta fshehin këtë varietet duke prodhuar verë me të njëjtën shije çdo vit. Vera është pa asnjë dyshim pjesë përbërëse e kulturës të të ushqyerit në Mesdhe, duke e nënkuptuar këtë të fundit si një tërësi zakonesh, dokesh, pronësi të ndërgjegjes dhe të mënyrës së sjelljes. Nuk është vetëm një plotësuese e dietës, por simbol kompleksesh për të cilat mjeku ka për detyrë të “individualizojë” kufijtë e konsumimit të saj dhe eventualisht t’i kufizojë ato derisa të arrijë edhe në vënien e vetos për të pasur jehona dhe implikime komplekse për të interesuarin, edhe pse përtej kuptimit energjetik apo potencialit toksik në lidhje me mëlcinë. Për një mjek italian apo francez është e vështirë të imagjinojë se një prodhim kaq tipik i gastronomisë tradicionale, tepër i legjitimuar nga një zakon dhe mënyrë të ushqyeri mijëra vjeçare dhe sot e mbrojtur me fanatizëm nga një mekanizëm i rafinuar konsumist, mund të

bëjë keq përveç rasteve kur ka persona që nga padituria ose të shtyrë nga vesi abuzojnë me verën. Në vendet me vreshtari të zhvilluar zakoni i të pirit verë është përqendruar pothuajse tërësisht gjatë vakteve, dhe si rrjedhojë është më pak e rrezikshme, edhe pse mund të konsumohet në sasi të mëdha, në krahasim me konsumimin në të shkuarën në sasi të mëdha në pijetore ose në lidhje me mënyrën e konsumimit në të kaluarën të pijeve superalkoolike. Është e qartë që dëmet e shkaktuara nga alkooli janë më të vogla kur stomaku është në punë për përpunimin e ushqimeve dhe i njëjti potencial metabolik i mëlçisë duket të ketë një dëm më të vogël të shkaktuar nga oksidimi alkoolik gjatë periudhës së tretjes. Nëse pranojmë pra ndikimin e një tërësie arsyesh shoqërore, psikologjike, dietetike, epidemiologjike, ku mund të bëjë pjesë edhe vera, pa shkaktuar dëme, madje në të kundërtën duke sjellë efekte të dobishme, në mënyrën e të ushqyerit të njeriut, momenti kyç i gjithë çështjes qëndron në identifikimin e parametrave të sigurisë, pra në personalizimin e dozave të pranura (1; 2; 3).

Testet kimike në poçet e lashta tregojnë se vera prodhohej rreth 7000 vjet përpara në Iranin e sotëm, afër qytetit të Urmias. Ky zbulim është veçanërisht i rëndësishëm për arsyen se ajo zonë nuk mbillte rrush dhe prodhimi kryesor i tyre ishte gruri, ndërsa pija e preferuar e kohës ishte birra, që tregon se vera përdorej rrallë si asortiment i veçantë. Vera luante rol të rëndësishëm në jetën ceremoniale të Egjiptit. Edhe pse rrushi i egër nuk rritej kurrë atje, një industri e madhe verë-prodhuese ishte zhvilluar në deltën e Nilit (2; 3; 4).

Tashmë është provuar se konsumi i rregullt i 1 ose 2 gotave verë në dite (1 gotë është e barabartë me 125 ml verë me 13% alkool) ul vdekshmërinë, sepse ul 10% – 40% mundësinë e sëmundjeve të zëmrës për njerëzit mbi moshën 35 vjeç. Sidoqoftë, në sasi më të mëdha të konsumuara ky efekt balancohet me mundësinë e rritjes së sëmundjeve të lidhura me konsumin e alkoolit si për shembull kancer i gojës, probleme të frymëmarrjes dhe eventualisht cirrozë të mëlçisë. Efektet më pozitive vihen re me konsumin e verës së kuqe. Përbërjet e njohura si polifenole që gjenden në sasi të mëdha tek vera e kuqe janë vërejtur të jenë jashtëzakonisht të mira për shëndetin. Një nga polifenolet më interesante është resveratroli, të cilit i atribuohen mjaft nga efektet pozitive. Sidoqoftë, studime të tjera kane treguar se benefite të ngjashme fitohen edhe nga pirja e birrës. Është e paqartë nëse përbërja benefike është etanoli apo përbërje të tjera. Megjithatë mënyra e prodhimit të verës nga rrushi mundëson dhe prani të komponimeve të ndryshme. Sulfitet janë përbërje që gjenden në verë në formën e konservuesve. Ato mund të shkaktojnë alergji të rënda te konsumuesit. Prania e sulfiteve në verë mendohet se shkakton gjendjen e keqe që provokohet të nesërmen e pirjes së verës (3; 5; 6; 8; 10).

Metodologjia

Marrja e mostrave të verës

Mostrat e verës janë grumbulluar në periudhën dhjetor 2017 deri janar 2018. Mostrat e verës u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme në tregun e qytetit të Tiranës. Origjina e tyre ishte artizanale nga vendi jonë dhe industriale nga vendi jonë dhe vende të tjera. Mostrat e përzgjedhura u morën që të ishin sa më përfaqësuese të tregut të verës në vendin tonë.

Analiza gazkromatografike e alkooleve në mostrat e verës

Analiza e alkooleve në mostrat e verës u realizua në aparat GC/FID. Mostrat e verës në fillim u degazuan në banjë me ultratinguj për 30 minuta në temperaturën 30°C dhe më pas ato u injektuan drejtpërdrejt në injektorin split/splitless të aparatit GC/FID. Temperatura e injektorit dhe e detektorit u vendosën respektivisht në 280°C dhe 300°C. 2 ul e mostrës të degazuar të verës u injektuar në

mënyrë split (1:50). Azoti u përdorur si gaz mbartës (1 ml/min) dhe si 'make-up gas' (25 ml/min). Hidrogjeni dhe ajri ishin gazet e flakës në detektor respektivisht me 30 ml/min dhe 300 ml/min. Kolona kapilare VF-1ms (30 mx 0,33 mm x 0,25 mu) u përdor për të izoluar komponimet vajit esencial. Temperatura e furrës ishte programuar si vijon: nga 40°C (u mbajt për 2 minuta në 40°C) në 150°C me 4°C/min, më tej në 280°C me 10°C/min, në 280°C u mbajt për 2 minuta. Identifikimi i komponimeve është bazuar në metodën me standard të jashtëm ku u përgatitën pesë përzierje të alkoolëve C1-C5 në një tretësirë ujë/etanol (50/50) në vëllim. Kjo tretësirë shërbeu dhe për hollimet e tretësirës stok me përqendrim 100 mg/l (2; 4; 5).

Analiza UV-VIS e polifenoleve në mostrat e verës

Fillimisht mostrat e verës degazohen duke e përzierë një sasi të saj në një elenmajer ose duke përdorur banjë me ultratinguj. Qartësohet mostra me anë të centrifugimit dhe lihet për disa minuta në 20 gradë C. Merret 10 ml verë dhe 8 ml reagent Celulozë karboksimetil CMC/EDTA 10 g/litër, 3 ml citrat hekuri 5,6 g/litër Fe^{3+} dhe 0.5 ml hidroksid amoni 35% në një balon 25 ml. Përzihet përmbajtja për disa minuta. Hollohet kampioni, nëse përmbajtja në polifenole është më e madhe se 400 mg/litër është e nevojshme hollimi i mëtejshëm i kampionit. Pas 10 min matet absorbanca në një kuvetë 10 mm duke përdorur një spektrofotometër në 600 nm. Sigurohemi që tretësira që do të matet është i qartë. Përmbajtja e polifenoleve llogaritet duke përdorur formulën: $P = A \times 820 \times F$ ku P - Përmbajtja në polifenole, A - Absorbanca në 600 nm dhe F - Faktori i hollimit (4; 5; 7; 9)

Rezultatet

Të dhënat e alkoolëve për mostrat e verës të marra në këtë studim me anë të teknikës gaz kromatografike janë paraqitur në tabelën 1 dhe grafikët 1, 2, 3 dhe 4. Të dhënat për alkoolët janë të shprehura në përqindje. Përqindjet e alkoolëve dhe përbërësve të tjerë të pijeve alkoolike të analizuar janë të shprehura në mënyrë relative kundrejt totalit të tyre përfshirë dhe etanolin. Alkoolët e analizuar me GC/FID ishin: metanol, etanol, propanol, propenol, t-butanol, izobutanol, butanol-2, butanol-1, pentanol-2 dhe alkool n-amilik. Rezultatet për polifenolet e analizuar me teknikën UV-VIS janë dhënë në grafikun 5. Polifenolet janë dhënë si total i këtyre komponimeve që gjenden tek verës e marra në analizë.

Tabela 1. Përqindjet e alkoolëve tek mostrat e verës të analizuar me GC/FID

	Metanol	Etanol	Propanol	Propenol	t-Butanol	izo-Butanol	Butanol-2	Butanol-1	Pentanol-2	Alkool n-Amilik
Barmash/Erseke	0.000	97.283	0.062	1.892	0.084	0.205	0.297	0.005	0.127	0.045
Berat/Shehi	0.000	99.365	0.084	0.037	0.075	0.270	0.027	0.090	0.016	0.000
Pogradec	0.000	99.532	0.026	0.048	0.270	0.029	0.077	0.018	0.000	0.000
Gaida/Italiane	0.000	98.968	0.187	0.071	0.119	0.415	0.072	0.119	0.033	0.015
Fushë-Prezë	0.000	97.473	1.529	0.058	0.088	0.007	0.006	0.005	0.300	0.084
Italiane	0.000	98.035	0.000	0.000	0.138	0.000	0.030	0.336	0.675	0.096

Korçë	0.000	99.043	0.000	0.000	0.110	0.000	0.059	0.102	0.108	0.176
Leskoviku Pino Nero	0.000	99.115	0.068	0.162	0.083	0.128	0.181	0.087	0.026	0.143
Leskoviku Merlot	0.000	98.868	0.060	0.312	0.082	0.184	0.047	0.300	0.113	0.033
Librazhd Merlot	0.000	98.947	0.000	0.000	0.118	0.000	0.079	0.079	0.049	0.093
Librazhd (Celek)	0.000	98.694	0.000	0.000	0.164	0.000	0.066	0.276	0.109	0.064
Lundër	0.000	98.405	0.110	0.066	0.254	0.070	0.446	0.007	0.012	0.438
Vranac	0.000	99.539	0.077	0.356	0.028	0.000	0.000	0.000	0.000	0.000

Diskutime

Totali i alkooleve: metanol, etanol, propanol, propenol, t-butanol, izobutanol, butanol-2, butanol-1, pentanol-2 dhe alkool n-amilik ishte nga 99.31% për verën e kuqe italiane deri në 100% për mostrat e verës Pogradec (artizanale) dhe Vranac (industriale) dhënë në Tabela 1. Etanoli është përbërësi kryesor i mostrave të verës të marra në analizë (Figura 1). Etanoli është përbërësi kryesor i gjetur për të gjitha mostrat e verës të analizuar me përqindje 97.24% (verë e kuqe artizanale Barmash, Ersekë) deri 99.54% (verë industriale Vranac). Metanoli paraqet interes për njohjen e tij për shkak të toksicitetit në organizmin e njeriut. Ai nuk u detektua në asnjë nga mostrat e verës të marrë në analizë. Vetë procesi i prodhimit të verës në temperatura jo shumë të larta dhe procesi më i shkurtër i fermentimit që nevojitet për prodhimin e verës e favorizojnë një prani të ulët të metanolit në mostrat e verës.




Figura 1. Totali i përqindjeve të alkooleve tek mostrat e verës të analizuar me GC/FID

Alkoolet e larta paraqesin mjaft interes për shkak të buketit që ato sjellin tek vera. Prania e tyre në sasi të lartë nuk preferohet sepse metabolizmi i ngadaltë i tyre shkakton probleme shëndetësore tek organizmi i njeriut. Përqindjet e alkooleve të lartë (C3-C5) që janë marrë në analizë janë dhënë

në Figurën 2. Niveli më i lartë i tyre ishte për verën e prodhuar në mënyrë artizanale me origjinë nga Barmash, Ersekë me 2,67%. Mesatarja për të gjitha mostrat e verës si shumë e alkooleve C3-C5 ishte më e ulët se 1%. Këto nivele gjithashtu janë të lidhura me procesin e prodhimit të verës në kohë më të shkurtër fermentimi dhe në temperaturë jo shumë të lartë. Këto faktorë favorizojnë prani të ulët të alkooleve të larta në mostrat e verës. Prania e tyre gjithashtu ka interes për të dhënë karakteristikat e verave të prodhuara nga zona të ndryshme.




Figura 2. Përqindjet e alkooleve C3-C5 tek mostrat e verës të analizuar me GC/FID

Vihet re se në përgjithësi mostrat e verës të prodhuara në mënyrë artizanale kanë nivele më të larta të alkooleve të larta se mostrat e verës të prodhuara në mënyrë industriale. Proceset e filtrimit që përdoren në industri ndikojnë në uljen e përqendrimit të këtyre alkooleve. Shpërndarja e alkooleve C3-C5 është dhënë në Figurën 3. Ka një shpërndarje të njëjtë për të gjitha mostrat e verës të marrë në analizë për sa i takon alkooleve me katër dhe pesë atome karbon. Kjo është e pritshme për shkak të të njëjtës mënyrë të prodhimit të verës. Përgjatshim bëjnë mostrat e verës Barmash, Ersekë me përqendrim të lartë të propenolit dhe Fushë-Prezë me përqendrim të lartë të propanolit. Të dyja këto vera janë të prodhuara në mënyrë artizanale. Kjo duhet të jetë e lidhur me llojin e rrushit, fermentimin, proceset e staxhionimit dhe filtrimit të mostrave të verës, apo dhe me proceset e ruajtjes të verës në vendet e tregimit të tyre.




Figura 3. Shpërndarja e alkooleve C3-C5 te mostrat e verës të analizuar me GC/FID

Profil i alkooleve C3-C5 jepet në Figurën 4. Profili i tyre ishte Propenol > Propanol > Pentanol-2 > t-Butanol > Butanol-1 > Butanol-2 > izobutanol > Alkool n-amilik. Ky profil ishte i ngjashëm me raportime të alkooleve në studime të tjera nga vendet e rajonit dhe Mesdheut (5; 6).




Figura 4. Profili i alkooleve C3-C5 tek mostrat e verës të analizuar me GC/FID

Në Figurën 5 jepen përqendrimet e polifenoleve në mg/l në mostrat e verës të marrë në analizë. Këto të dhëna janë marrë me teknikën UV-VIS. Përqendrimi i polifenoleve ishte nga 387 mg/l për verën italiane të prodhuar në mënyrë industriale deri në 1295 mg/l për verën merlot, Leskovik të prodhuar në mënyrë artizanale. Në përgjithësi nivelet më të larta të polifenoleve ishin për mostrat e verës të kuqe të prodhuara në mënyrë artizanale. Këto vera sugjerojmë të jenë dhe më të përdorshme nga ana e popullatës për shkak të niveleve të larta polifenoleve që ato kanë. Polifenolet, sidomos rezervatoli në mjaft studime shihet si një komponim që ka efekte mjaft të mira si antioksidant dhe parandalues i mjaft sëmundjeve përfshirë ato kardivaskulare dhe tumorale (6; 7).




Figura 5. Polifenolet tek mostrat e verës të analizuar me teknikën UV-VIS

Përfundime

Përcaktimi i alkooleve në mostrat e verës nga tregu shqiptar u realizua me anë të teknikës gaz kromatografike me detektor me jonizim në flakë. Alkoolet e analizuar me GC/FID ishin: metanol, etanol, propanol, propenol, t-butanol, izobutanol, butanol-2, butanol-1, pentanol-2 dhe alkool n-amilik. Përcaktimi i polifenoleve totale u realizua me teknikën UV-VIS. Ato u vlerësuan si total i komponimeve polifenolike të cilat gjenden në mostrat e verës. Etanoli është përbërësi kryesor i mostrave të verës të marra në analizë. Metanoli nuk u detektua në asnjë nga mostrat e verës. Procesi i prodhimit të verës në temperatura jo shumë të larta dhe procesi më i shkurtër i fermentimit që nevojitet për prodhimin e verës e favorizojnë një prani të ulët të metanolit në mostrat e verës. Përqindjet e alkooleve të lartë (C3-C5) ishin në nivel më të lartë për mostrat e verës që prodhohen në vendin tonë. Këto nivele gjithashtu janë të lidhura me procesin e prodhimit të verës në kohë më të shkurtër fermentimi dhe në temperaturë jo shumë të lartë. Këto faktorë favorizojnë prani të ulët të alkooleve të larta në mostrat e verës. Prania e tyre gjithashtu ka interes për të dhënë karakteristikat e verave të prodhuara nga zona të ndryshme. Vihet re se në përgjithësi mostrat e verës të prodhuara në mënyrë artizanale kanë nivele më të larta të alkooleve të larta se mostrat e verës të prodhuara në mënyrë industriale. Ka një shpërndarje të njëjtë për të gjitha birra përsa i takon alkooleve me katër dhe pesë atome karbon. Kjo është e pritshme për shkak të të njëjtës mënyrë të prodhimit të verës. Nivelet dhe shpërndarja e alkooleve është e lidhur me llojin e rrushit, fermentimin, proceset e staxhionimit dhe filtrimit të mostrave të verës apo dhe me proceset e ruajtjes të verës në vendet e tregtimit të tyre. Profili i alkooleve ishte: Propenol > Propanol > Pentanol-2 > t-Butanol > Butanol-1 > Butanol-2 > izobutanol > Alkool n-amilik. Ky profil ishte i ngjashëm me raportime të alkooleve në studime të tjera nga vendet e rajonit dhe Mesdheut (5; 6). Edhe përqendrimi i polifenoleve ishte më i lartë për mostrat e verës të prodhuar në mënyrë artizanale. Këto vera sugjerohet të përdoren më tepër nga ana e popullatës për shkak të niveleve të larta polifenoleve që ato kanë (6; 7).

Referenca

1. Estruch R., Lamuela-Raventos R.M. Alcohol, wine and cardiovascular disease, two sides of the same coin. *Intern. Emerg. Med.* 2010;5:277–279.
2. Vinson J.A., Mandarano M., Hirst M., Trevithick J.R., Bose P. Phenol antioxidant quantity and quality in foods: beers and the effect of two types of beer on an animal model of atherosclerosis. *J. Agric. Food Chem.* 2003;51:5528–5533.
3. Gorinstein S., Caspi A., Libman I., Leontowicz H., Leontowicz M., Tashma Z., Katrich E., Jastrzebski Z., Trakhtenberg S. Bioactivity of beer and its influence on human metabolism. *Int. J. Food Sci. Nutr.* 2007;58:94–107.
4. Covas M.I. The Mediterranean Diet and the Contribution and Role of Alcohol. In: Preedy V.R., Watson R.R., editors. *Comprehensive Handbook of Alcohol Related Pathology*. Vol. 1. Elsevier Academic Press; San Diego, CA, USA: 2004. pp. 135–146. Chapter 12.
5. 46. Estruch R., Sacanella E., Mota F., Chiva-Blanch G., Antunez E., Casals E., Deulofeu R., Rotilio D., Andres-Lacueva C., Lamuela-Raventos R.M., et al. Moderate consumption of red wine, but not gin, decreases erythrocyte superoxide dismutase activity: A randomised cross-over trial. *Nutr. Metab. Cardiovasc. Dis.* 2011;21:46–53.
6. Brien S.E., Ronksley P.E., Turner B.J., Mukamal K.J., Ghali W.A. Effect of alcohol consumption on biological markers associated with risk of coronary heart disease: Systematic Review and meta-analysis of interventional studies. *BMJ.* 2011;342.
7. Ronksley P.E., Brien S.E., Turner B.J., Mukamal K.J., Ghali W.A. Association of alcohol consumption with selected cardiovascular disease outcomes: A systematic review and meta-analysis. *BMJ.* 2011;342:d671.
8. Costa de Camargo, Adriano; Bismara Regitano-d'Arce, Marisa Aparecida; Camarão Telles Biasoto, Aline; Shahidi, Fereidoon (2014). "Low Molecular Weight Phenolics of Grape Juice and Winemaking Byproducts: Antioxidant Activities and Inhibition of Oxidation of Human Low-Density Lipoprotein Cholesterol and DNA Strand Breakage". *Journal of Agricultural and Food Chemistry*. **62**: 12159–12171.
9. Aizpurua-Olaizola, Oier; Ormazabal, Markel; Vallejo, Asier; Olivares, Maitane; Navarro, Patricia; Etxebarria, Nestor; Usobiaga, Aresatz (2015). "Optimization of Supercritical Fluid Consecutive Extractions of Fatty Acids and Polyphenols from Vitis Vinifera Grape Wastes". *Journal of Food Science*. **80** (1): E101–E107.
10. Pollnitz, Alan P; Pardon, Kevin H; Sefton, Mark A (2016). "Quantitative analysis of 4-ethylphenol and 4-ethylguaiacol in red wine". *Journal of Chromatography A*. **874**(1): 101–9.



Viti i IX-të i Botimit, Nr. 1,
Qershor 2018

KARAKTERIZIMI KIMIK I VAJIT ESENCIAL TË BIMËS SË *BORZILOKUT (OCIMUM BASILIKUM)* NGA ZONA TË NDRYSHME TË SHQIPËRISË

Aurel Nuro*, Jonida Salihila*, Dorina Shëngjergji**, Aida Dama**, Aurora Napuçe**,
Erjon Troja***, Vilma Toska***

*Departamenti i Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës

**Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University

***Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranës

Adresë kontakti: nuroaurel@yahoo.co.uk

Përmbledhje

Objektivat: Studimi sjell të dhëna nga analiza kimike e vajit esencial të bimës të llojit *Ocimum Basilicum* nga zona të ndryshme të Shqipërisë. *Ocimum Basilicum* është një bimë njëvjeçare e familjes të Lamiaceae. Njihet që në lashtësi, grekët e lashtë e kanë quajtur “bima e mbretit” për aromën e saj karakteristike. Përdoret shpesh për zbukurime dhe për qëllime mjekësore. Është bimë e florës tonë spontane dhe rritet thuajse në të gjithë Mesdheun (1; 2; 3).

Metodat: Bimët e *Ocimum Basilicum* nga zona të ndryshme të Shqipërisë janë marrë në qershor 2017. Bimët e thara në ajër, janë prerë në pjesë të vogla (1-2 cm). Ato ishin subjekt i hidrodistilimit për 3 orë në aparatin Klevengar, të rekomanduar nga Farmakopeia Europiane, për të përftuar vajin esencial të *Ocimum Basilicum*. Përbërja kimike e vajit esencial u analizua duke përdorur teknikën GC/FID. Vajrat esenciale të secilës mostër *Ocimum Basilicum* u injektuan në apartatin Varian 450 GC. Kolona kapilare VF-1ms (30 m x 0.33 mm x 0.25 µm) u përdor për ndarjen e komponentëve kimike të vajit esencial (4; 5).

Përfundimet: Monoterpenoidet e oksigjenuara u gjetën në nivele më të larta. Përqindjet më të larta i takojnë Linalolit, Cineolit dhe estereve të Nerilit, Linalilit dhe Terpinilit. Linaloli u ishte nga 37-52% në mostrat e analizuar. Monoterpenet aromatike ishin grupi i dytë kontribuues. Nivel më të lartë të tyre kishte Metilkavikoli. Monoterpenet zënë rreth 10% të totalit të të gjithë komponimeve kryesore. Seskuiterpenet u gjetën më pak se 1%. Profili i gjetur ishte i njëjtë me raportimet e punimeve të ngjashme nga rajoni i Mesdheut (6; 7; 8).

Fjalë çelës: *Ocimum Basilicum*, Vaj esencial, Linalol, Metilkavikol, Cineol, GC/FID.

CHEMICAL CHARACTERIZATION OF *BASILIKUM ESSENTIAL* OIL FROM DIFFERENT AREAS OF ALBANIA

Abstract

Objective: This study presents data about chemical analysis of essential oil for *Ocimum Basilicum* plant populations from different areas of Albania. *Ocimum Basilicum* is one-year plant of Lamiaceae. It is known in ancient times, ancient Greeks have called “king’s plant” for its characteristic aroma. It’s often used for ornamental and medicinal purposes. It is plant of our spontaneous flora and grown almost throughout the all Mediterranean area (1; 2; 3).

Methods: *Ocimum Basilicum* plants from different areas of Albania were taken in June 2017. The air dried plant samples were cut in small pieces (1-2 cm). They were subjected of hydrodistillation on Clevenger type apparatus for 3 hours, recommended to European Pharmacopoeia, to obtain *Ocimum Basilicum* essential oil. The chemical composition of the essential oils was analyzed using GC/FID technique. The oil of each *Ocimum Basilicum* sample was injected in a Varian 450 GC. VF-1ms capillary column (30 m x 0.33 mm x 0.25 um) were used for separation of compounds, parts of essential oil (4, 5).

Conclusion: Oxygenated monoterpenoides were found in higher level. The higher percent were for Linalool, Cineol and Neryl, Linolool, Terpinyl esters. Linalool was found 37-52% for all analyzed samples. Aromatic monoterpenoides were second contributors. The higher level of them was for Methylcavicol. Monoterpenes were around 10% of all compounds. Sesquiterpenes were found lower than 1%. Found profile was similar to other studies from Mediterranean area (6; 7; 8).

Keywords: *Ocimum Basilicum*, *Esencial oil*, *Linalool*, *Methylcavicol*, *Cineol*, *GC/FID*.

Hyrje

Ocimum basilicum, e njohur si bima e borzilokut është një bimë që bën pjesë në familjen Lamiaceae. Borziloku është një bimë barishtore njëvjeçare që kultivohet kryesisht si bimë aromatike. Për aromën e tij karakteristike dhe të mprehtë, borziloku përdoret gjerësisht në kuzhinën mesdhetare dhe të Azisë Juglindore. Kjo erëz e njomë, e njohur ndryshe si erëza e shenjtë, është përdorur shekuj më parë si një bimë mjekësore. Ndër vite njerëzit kanë kultivuar mbi 60 lloje të borzilokut. Ilirët e lashtë e përdornin borzilokun për të thurur kurora duke qenë se kjo bimë asokohe konsiderohej simbol i paqes, harmonisë dhe lumturisë. Është një prej bimëve më të shëndetshme e pasur në vlera ushqyese që e shndërrojnë atë në një ilaç të vërtetë (1,3,5,6).

Vitamina K që gjendet me shumicë tek gjethet e borzilokut është e domosdoshme për koagulimin e gjakut. Krahas kësaj, Vitamina A, betakaroteni, dhe antioksidantët e që borziloku ka, mbrojnë trupin nga radikalet e lira, përgjegjëse për plakjen e organizmit. Parandalon rritjen e kolesterolit në gjak, arteriosklerozën, atakun e zemrës si dhe ul mundësinë e goditjeve në tru. Të tjera vitamina dhe minerale që mund të gjenden tek bima e borzilokut janë: Vitamina C, magnezi, mangani, kalciumi, hekuri, dhe kaliumi. Ky antibiotik i fuqishëm natyral ofron përfitime të pafundme shëndetësore. Të gjitha vitaminat dhe mineralet pastrojnë arteriet nga LDL, kolesterolin “i keq”. Përmbajtja anti-mikrobiale parandalon mjaft sëmundje. Lëngu nga gjethet përdoret kundër ftohjeve dhe inflamacionit të timpanit të veshit ndërsa çaji i borzilokut është pije freskuese dhe shëruese. Uji me gjethet e kësaj bime zbut lëkurën. Është efektiv në traktin urinar, vepron si qetësues, largon pagjumësinë dhe ankthin, stimulon oreksin, ndërsa nënat e reja duhet të pinë çaj borziloku sepse

përmirëson prodhimin e qumështit. Borziloku mund të kurojë dhimbjet artikulare dhe reumatike në saj të vetive anti- inflamatore. Kjo pasi borziloku përmban elemente që lehtësojnë dhimbjet, por nuk i zhduk ato. Prania e eugenolit në fletët e borzilokut luan një rol të rëndësishëm në mukozën gastrike dhe favorizon tretjen. Me kalimin e viteve borziloku është cilësuar si një aleat për të kuruar sëmundjet respiratore si i ftohti dhe dhimbjet e fytyrës. Mund të përdoren si gjethet e borzilokut edhe vajrat esenciale për të përgatitur çajra. Borziloku është shumë i dobishëm për të kuruar ankthin dhe stresin (1,2,3,4,5).

Lloje të ndryshme të bimës të borzilokut kultivohen në kopshte dhe ballkone. Llojet më të përhapura janë *Ocimum basilicum minimum* dhe *Ocimum basilicum classic*. Në varësi të llojit dhe zonës ku rriten bimët e borzilokut është dhe përmbajtja kimike e vajit esencial që ato përmbajnë. Në përgjithësi vihet re se bimët e borzilokut që rriten në Europë përmbajnë përqendrim të lartë të Linalolit dhe Metilkaivol. Përbërës të tjerë janë: Cineol-1,8, Eugenol dhe Miricen.

Metodologjia

Marrja e mostrave të *Ocimum Basilicum*

Mostrat e *Ocimum Basilicum* janë marrë në zona të ndryshme të Shqipërisë. Bimët e *Ocimum Basilicum* u mbledhën në qershor, 2017. Stacionet e zgjedhur në këtë studim ishin: Kavajë, Tiranë, Elbasan, Pogradec, Durrës dhe Lezhë. Në secilin stacion janë zgjedhur pjesët ajrore (gjethet dhe kërcelli) të *Ocimum Basilicum*. Bimët e secilit stacion u thanë në hije që të mos humbasin karakteristikat morfologjike. Materiali bimor pas tharjes u copëtua në pjesë të vogla për analizën e mëtejshme.

Izolimi i vajrave esencialë për *Ocimum Basilicum*

Materiali bimor i *Ocimum Basilicum* (50 g bimë e *Ocimum Basilicum*) ishin subjekt i hidro-distilimit për 3 orë pa ndërprerje me aparaturën e llojit Klevenger (rekomanduar nga Pharmacophea Europea, 2014) për izolimin e vajit esencial. Vaji esencial u grumbullua në 2 ml Toluen si solvent ekstraktimi. Ekstraktit ju largua uji duke shtuar 1 gr sulfat natriumi anhidër. Ai u ruajt në vialë të errët në +4°C. Vaji esencial i *Ocimum Basilicum* u hollua (1/10) në Toluen (v/v) që ishte dhe subjekt i analizës GC/FID (8; 9).

Aparatura dhe analiza gazkromatografike

Analiza gaz kromatografike e vajit esencial të *Ocimum Basilicum* realizua në aparat Varian 450 GC, të pajisur me injektor PTV dhe detektor me jonizim në flakë (FID). Temperatura e injektorit dhe e detektorit u vendosën përkatësisht në 280°C dhe 300°C. 2 ul të vajit esencial të *Ocimum Basilicum* të holluar në toluen u injektuar në mënyrë split (1:50). Azoti u përdorur si gaz mbartës (1 ml/min) dhe si 'make-up gas' (25 ml/min). Hidrogjeni dhe ajri ishin gazet e flakës në detektor respektivisht me 30 ml/min dhe 300 ml/min. Kolona kapilare VF-1ms (30 mx 0,33 mm x 0,25 mu) u përdor për të izoluar komponimet vajit esencial. Temperatura e furrës ishte programuar si vijon: nga 40°C (u mbajt për 2 minuta në 40°C) në 150°C me 4°C/min, më tej në 280°C me 10°C/min, në 280°C u mbajt për 2 minuta. Identifikimi i komponimeve është bazuar në krahasimin e kohëve të daljes (RT) me indeksat e Kovats-it të cilat së bashku me të dhënat e literaturës u përdorën për identifikimin e komponimeve kryesore. Të dhënat sasiore të komponimeve të analizuar janë dhënë në % kundrejt totalit të sipërfaqeve të pikeve (6; 7; 8).




Figura 1. Kromatogramë e marrë me GC/FID për vajin esencial të *Ocimum Basilicum*, Lezhë, qershor 2017

Rezultatet

Vaji esencial i mostrave të *Ocimum Basilicum* nga zona të ndryshme të Shqipërisë u analizua duke përdorur teknikën e kromatografisë të gaztë me kolonë kapilare dhe detektor me jonizim në flakë (GC/FID). Mesataret e rezultateve për mostra nga të njëjtat zona, u prezantuan në këtë studim. Të dhënat paraqesin 22 komponimet kryesore që janë gjetur për të gjithë vajra esenciale të *Ocimum Basilicum* të studiuar nga metoda kromatografike përdorur. Të dhënat janë në përqindje kundrejt totalit të pikeve përveç pikut të toluenit që u përdor si tretës. Piket me sipërfaqe më të ulët se 0,01% nuk ishin të pranishëm në këtë studim. Në të gjitha mostrat e analizuar u detektuan 60-70 komponime. Përqindjet e komponimeve kryesore ishin nga 92.3% në mostrat e Elbasanit deri në 98.0 në mostrat e Kavajës. Tabela 1 tregon vlerat mesatare për përqindjet e komponimeve kryesore të detektuar në vajrat esenciale të *Ocimum Basilicum* nga disa zona të vendit tonë, qershor 2017. Për të gjitha mostrat e *Ocimum Basilicum* komponimi kryesor ishte Linaloli me përqindje nga 37.4 (Pogradec) deri në 52.6% (Kavajë). Metilkavikoli ishte komponimi i dytë nga 6.2% (Kavajë) deri në 9.5% (Durrës). Cineol, cis-Ocimen, Timol, Acetat nerili, Acetat terpinili Citroneol/Pulegon dhe Acetat linalili ishin komponimet që kishin nivele më të mëdha se 1%. Komponimet e tjera u gjetën me mesatare më të ulët se 1%. Diferencat e vërejtura janë të lidhura kryesisht me zonat në të cilat janë marrë mostrat dhe periudhën e marrjes të mostrave. Pjekuria e mostrave nuk është e njëjtë edhe pse marrja e tyre është bërë në të njëjtën periudhë, gjë që reflektohet dhe në ndryshimet midis përbërjes kimike të vajrave esenciale. Monoterpenet (alifatike, monociklike dhe biciklike) variojnë nga 2.9% deri në 11.4%. Monoterpenoidet e oksigjenuara ishin grupi që gjendet më me shumicë në esencën e borzilokut. Nivelet e tyre ishin nga 66.6% në mostrën Durrës deri në 77.5% në mostrën e Tiranës. Monoterpenoidet aromatike ishte grupi i dytë më i rëndësishëm me nivele nga 14.4% në mostrat e Tiranës dhe Elbasanit deri në 19.3 në mostrat e Durrësit dhe Pogradecit. Seskuiterpenet ishin grupi më i vogël me nivele nga 0.3% në mostrën Lezhë deri më 1.3% në mostrën Elbasan.

Tabela 1. Përqindjet e komponimeve të detektuar për vajin esencial të *Ocimum Basilicum*

Mostra / Komponimi	Kavajë	Tiranë	Elbasan	Durrës	Pogradec	Lezhë
Alfa-pinen	0.19	0.39	0.33	0.12	0.23	0.23
Kamfen	0.30	0.13	0.35	0.53	0.23	0.31
Beta-pinen	0.69	0.25	1.20	0.73	0.98	0.62
Miricen	0.68	0.42	0.63	0.77	0.42	0.54
Limonen	0.21	0.41	0.17	0.33	0.19	0.23
Cineol	3.12	5.71	6.32	5.23	8.32	3.43
Cis-Ocimen	3.56	0.54	5.32	2.24	3.13	4.12
Trans-Ocimen	2.94	0.45	3.12	1.12	1.32	2.43
gamma-Terpinen	0.24	0.31	0.29	0.74	0.52	0.44
Linalol	52.64	51.65	47.53	44.45	37.41	48.04
Acetat linalili	3.21	2.44	3.12	3.02	5.13	4.11
Kamfur	0.62	0.73	0.52	0.39	0.27	0.55
Metilkavikol	6.19	7.77	8.32	9.53	8.32	7.23
Borneol	1.19	1.25	2.23	1.91	2.34	3.53
alfa-Terpineol	1.15	0.81	1.36	0.53	1.17	1.04
Acetat terpinili	4.68	3.73	2.56	2.63	3.45	2.24
Acetat nerili	4.23	6.88	5.39	4.82	7.32	2.98
Citroneol / Pulegon	2.23	2.56	1.23	2.94	3.32	3.73
Timol	5.33	1.78	1.21	5.25	6.32	6.32
Karvakrol	2.17	3.65	2.64	3.03	2.16	2.73
Eugenol	1.76	1.28	2.19	1.43	2.48	1.33
beta-Kariofilen	0.65	0.71	1.32	0.52	1.45	0.32
Totali	97.98	93.85	97.35	92.26	96.48	96.50
Monoterpene	8.81	2.90	11.41	6.58	7.02	8.92
Monoterpenoide me oksigjen	73.96	77.51	71.54	66.64	69.92	71.66
Monoterpenoide aromatike	15.47	14.48	14.36	19.24	19.28	17.61
Seskuitepene	0.65	0.71	1.32	0.52	1.45	0.32

Diskutime

Shpërndarja e komponentëve të analizuar për mostrat *Ocimum Basilicum* nga zona të ndryshme të Shqipërisë është paraqitur në Figurën 1. Kishte shpërndarje të njëjtë për të gjitha mostrat e analizuar. Kjo për shkak të së njëjtës specie të *Ocimum Basilicum* të analizuar nga zonë të ndryshme të Shqipërisë. Pozicioni gjeografik (veçanërisht lartësia), gjeologjia e tokave, periudha e marrjes së mostrave, cikli i bimëve janë faktorë të rëndësishëm për dallimet që gjenden midis mostrave

të analizuar të *Ocimum Basilicum*. Profili i komponentëve të analizuar për mostrat e *Ocimum Basilicum* është paraqitur në Figurën 5. Profili i tyre ishte: Linalool > Metilkavikol > Acetat nerili > Timol > Cineol > Acetat linalili. Përqindja mesatare e Linalolit ishte 47%, për Metilkavikolin ishte 7.9%, për Cineolin dhe Acetatin e nerilit ishte 5.3% dhe Timol 4%. Totali i monoterpeneve aliciklike, monociklike dhe biciklike përfaqësohej nga gama-Terpinen, trans-Ocimen, cis-Ocimen, Limonen, Miricen, beta-Pinen, Kamfen dhe alfa-Pinen (Figura 4). Niveli më i lartë i tyre ishte për mostrat e marra në zonën e Elbasanit. Për të gjitha mostrat cis dhe trans-Ocimen ishin kontribuuesit kryesorë. Në Figurën 5 jepen përqindjet e monoterpenoideve të oksigjenuar të cilët ishin komponimet që u gjetën më me shumicë në të gjitha mostrat e analizuar. Linaleoli u gjet më me shumicë për të gjitha mostrat. Cineoli ishte kontribuuesi i dytë në disa mostra. Bie në sy fakti se me rritjen e përqindjes të Linaleolit ulet përqindja e Cineolit dhe e kundërta. Kjo duhet të jetë e lidhur kryesisht me periudhën e pjekurisë të bimës të analizuar. Kontribuues të rëndësishëm janë dhe esteret e Acetatit të Nerilit, Acetatit të Terpinilit dhe të Acetatit të Linalilit. Në Figurën 6 janë dhënë përqindjet e monoterpeneve aromatike. Këto ishin të dytat në kontributin e përgjithshëm. Metilkavikoli gjithashtu ishte komponimi i dytë që u gjet më me shumicë në të gjitha mostrat. Ai u gjet në përqindje thujse të njëjtë për të gjitha mostrat. Po kështu dhe përqindjet e Eugenolit, Karvakrolit dhe Timolit ishin thujse të njëjta. Përqindjet e Timolit ishin të ndryshme për mostrat e Tiranës dhe Elbasanit, krahasuar me ato të zonave të tjera. Seskuiterpenet përfaqësohen vetëm nga përqindjet e beta-Kariofillenit. Vetëm në mostrën e Lezhës niveli i tyre ishte më i lartë se 1%. Profili dhe nivelet e komponimeve për mostrat e *Ocimum Basilicum* nga zona zona të ndryshme të Shqipërisë ishin të njëjta me studime të tjera të raportuara nga zona Mesdheut dhe e Gadishullit Ballkanik (3; 4; 5; 6; 7).




Figura 2. Shpërndarja e komponimeve për vajin esencial të *Ocimum Basilicum*




Figura 3. Profili i komponimeve të detektuar për vajin esencial të *Ocimum Basilicum*




Figura 4. Përqindjet e monoterpeneve në vajin esencial të *Ocimum Basilicum*




Figura 5. Përqindjet e monoterpenoideve të oksigjenuar në vajin esencial të *Ocimum Basilicum*




Figura 6. Përqindjet e monoterpenoideve aromatike në vajin esencial të *Ocimum Basilicum*

Përfundime

Përbërja kimike e vajit esencial të mostrave të *Ocimum Basilicum* nga zona të ndryshme të Shqipërisë është analizuar me teknikën me GC/FID. Të dhënat paraqesin 22 komponimet kryesore të *Ocimum Basilicum*. Të dhënat janë dhënë në përqindje. Përqindjet e komponimeve kryesore përbënin nga 92-98%. Për të gjitha mostrat komponeni kryesor ishte Linaloli që varionte nga 37-52%. Metilkavikoli ishte komponimi i dytë, e më pas vijnë Cineol, cis-Ocimen, Timol, Acetat nerili, Acetat terpinili Citroneol/Pulegon dhe Acetat linalili. Shpërndarja e komponentëve të analizuar për mostrat *Ocimum Basilicum* nga zona të ndryshme të Shqipërisë ishte e njëjtë për të gjitha mostrat. Kjo për shkak të studimit të së njëjtës specie *Ocimum Basilicum*. Pozicioni gjeografik (veçanërisht lartësia), gjeologjia e tokave, periudha e marrjes së mostrave, cikli i bimëve gjithashtu janë faktorë të rëndësishëm për dallimet që gjenden midis mostrave të analizuar të *Ocimum Basilicum*. Monoterpenet (alifatike, monociklike dhe biciklike) variojnë nga 2.9% deri në 11.4%. Monoterpenoidet e oksigjenuara ishin grupi që gjendet më me shumicë në esencën e borzilokut. Nivelet e tyre ishin nga 66.6% deri në 77.5%. Monoterpenoidet aromatike ishte grupi i dytë më i rëndësishëm me nivele nga 14.4% deri në 19.3. Seskuiterpenet ishin grupi më i vogël me nivele nga 0.3% deri më 1.3%. Profili dhe nivelet e komponimeve për mostrat e *Ocimum Basilicum* nga zona të ndryshme të Shqipërisë ishin të njëjta me studime të tjera të raportuara nga zona Mesdheut dhe e Gadishullit Ballkanik (3; 4; 5; 6; 7).

Referenca

1. Uran Asllani “Esencat e bimëve aromatike e mjekësore të trevave Shqiptare: 124-134, Tiranë 2004.
2. Wolfgang Kathe, Susanne Honnef & Andreas Heym. “Medicinal and Aromatic Plants in Albania, Bosnia-Herzegovina, Bulgaria, Croatia and Romania”. A study of the collection of and trade in medicinal and aromatic plants (MAPs), relevant legislation and the potential of MAP use for financing nature conservation and protected areas” WWF Deutschland / TRAFFIC Europe-Germany. 2003
3. David Burnie. “Wild Flowers of the Mediterranean”. (1995) ISBN 0-7513-2761-1
4. Tutin T. “Flora Europaea”, Volume 2. . (1968) 34-45. ISBN 0-521-06662-X
5. Bozin B., Mimica-Dukic N., Simin N., Anac-kov G., “Characterization of the volatile composition of essential oils of some Lamiaceae spices and the antimicrobial and antioxidant activities of the entire oils”, J. Agric. Food Chem.,54, (2006) 1822-1828.
6. Adams RP., “Identification of essential oil components by gas chromatography/mass spectroscopy”, Allured Publishing Corporation, Carol Stream: Illinois, USA. (1995)
7. Daferera D.J., Ziogas B.N., Polissiou M.G., “GC-MS analysis of essential oils from some greek aromatic plants and their fungitoxicity on *Penicillium digitatum*”, Journal of Agricultural Food Chemistry, 48, (2000) 2576-2581.
8. David F., Scanlan F., Sandra P., Szelewski M., “Analysis of essential oil compounds using retention time locked methods and retention time databases, Application, Agilent Technologies”, 5988-6530EN. (2010)
9. Filip Varga, Klaudija Carović-Stanko, Mihailo Ristić, Martina Grdiša, Zlatko Liber and Zlatko Šatović, Morphological and biochemical intraspecific characterization of *Ocimum basilicum* L., *Industrial Crops and Products*, 109, (611), (2017).



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

RAPORTIM MBI EFEKTIVITETIN IN VITRO TË DERIVATIT TË ACIDIT DIHIDROANTRACEN DISULFONIK NDAJ ENTEROBACTER CLOACAE

Florjana Rustemi*, Ledjan Malaj, Gëzim Boçari***, Dritan Mnela******

* Departmenti i Farmacisë, Albanian University, Tiranë

**Departmenti i Farmacisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

***Departamenti Lëndëve Biomjekësore dhe Eksperimentale, Katedra e Farmakologjisë, Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

****-Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë

Adresë kontakti: florjanarustemi@gmail.com

Përmbledhje

Ky studim paraqet efektivitetin antibakterial *in vitro* të preparatit të derivatit të acidit dihidroantracen disulfonik (patenta DE102004003030A1) në një rast të diagnostikuar me Fasciit Nekrotizant, i cili ka rezultuar rezistent ndaj shumë antibiotikëve. Fasciiti Nekrotizant njihet kudo në botë si infeksion vdekjeprurës, por në studimin tonë *in vitro* paraqitet efektiviteti antibakterial i derivatit të acidit dihidroantracen disulfonik. Vlerësimi u krye me metodën e hollimit në bujon (Makrohollimi) në Laboratorin Mikrobiologjik të QSU “Nënë Tereza” Tiranë. Metoda konsiston në zvogëlimin në mënyrë progresive të sasisë së antimikrobikut në epruveta me bujon Mueller Hinton. Për studimin tonë u morën 12 epruveta, në epruvetën e parë morëm tretësirën 20% të preparatit që u testua kurse në epruvetat e tjera u zvogëlua përqendrimi i preparatit dhe sasia u plotësua me bujon Mueller Hinton. Pas hollimit 12 epruvetat u inkubuan dhe pas 24 orësh, u kultivuan në pjata petri në terren MacConkey për 24 orë. Nga studimi ynë rezultoi se efektiviteti antibakterial *in vitro* i derivatit të acidit dihidroantracen disulfonik është ekuivalent me efektin *in vitro* të Imipenem (MIC≤0.25), Meropenem (MIC≤0.25), Amikacin (MIC 8), Colistin (MIC≤0.5) në shtamin e izoluar *Enterobacter Cloacae*. Nevojiten studime dhe rezultate të tjera në mënyrë që të kemi një spektër të plotë të aktivitetit antibakterial të derivatit të acidit dihidroantracen disulfonik.

Fjalë çelës: *in vitro*, efektivitet antibakterial, derivat i acidit dihidroantracen disulfonik.

IN VITRO ANTIBACTERIAL ACTIVITY OF DIHYDROANTHRACENE DISULFONIC ACID DERIVATIVE AGAINST ENTEROBACTER CLOACAE

Abstract

This paper is a report of the *in vitro* antibacterial activity of the dihydroanthracene disulfonic acid derivative preparation (patent DE102004003030A1) against a case diagnosed with Necrotizing Fasciitis that resulted resistant to many antibiotics. Necrotizing Fasciitis is known for his high lethality, but our *in vitro* study demonstrated the antibacterial effectiveness of dihydroanthracene

disulfonic acid derivative. We decided to use the method of dilution in broth (Macrodilution) in the Microbiological Laboratory of the UHC “Mother Theresa” Tirana. The method consists in progressively decreasing the amount of the antimicrobial preparation in the test tubes with Mueller Hinton. In our case, we collected 12 test tubes. In the first test tube we poured a 20% solution of dihydroanthracene disulfonic acid derivative, which activity we wanted to test and in all the other test tubes we progressively decreased the amount of our preparation and added Mueller Hinton. After the dilution we incubated the 12 test tubes for 24 hours and we cultivated the above in plates with MacConkey broth for 24 hours. *In vitro* antibacterial effect of dihydroanthracene disulfonic acid derivative is equivalent with the *in vitro* effect of Imipenem (MIC $\leq$ 0.25), Meropenem (MIC $\leq$ 0.25), Amikacin (MIC 8), Colistin (MIC $\leq$ 0.5) in the isolated strain of *Enterobacter Cloacae*. Further studies are needed to evaluate the full pharmacological activity of dihydroanthracene disulfonic acid derivative.

Keywords: *in vitro*, antibacterial activity, dihydroanthracene disulfonic acid derivative.

Hyrje

U vlerësua efektiviteti antibakterial *in vitro* i preparatit të ri të derivatit të acidit dihidroantracen disulfonik. Derivati i acidit dihidroantracen disulfonik, (patenta DE102004003030 A1, klasifikimi: IPCA61K31 / 185, aplikim datë 01.09.2005, publikim Nr: DE102004003030 A1), është preparat antibakterial dhe antiviral me spektër të gjerë veprimi.

Sinteza kimike realizohet, duke futur të bashkëveprojnë në reaksione kimike 10 lëndë me pastërti prosintezë. Është e domosdoshme disiplina teknike sipas metodikës duke filluar nga radhitja e hedhjes në reaktorin e reaksionit kimik, koha e përzierjes, pauza pas hedhjes së reagjentit të radhës, ruajtja e temperaturave optimale gjatë reaksionit sipas reagjentëve që hidhen në reaktorin e reaksionit. Reaksioni kimik vazhdon për 36 orë dhe kërkon një kujdes të veçantë pasi çdo devijim teknologjik prish mbarëvajtjen e reaksionit kimik ndërmjet reagjentëve. Sinteza e preparatit kërkon përdorim të shpejtë të mjetit ftohës të reaktorit për të shmangur ngritjen përtej normës së lejuar të temperaturës. Përmbajtja përfundimtare e reaksionit është një masë kristallore e trashë, e cila vendoset në tava tharëse me një shtresë 07 mm – 08 mm me ventilim ajri me temperaturë 45°C – 50°C. Pas tharjes, lënda e përfutur bluhet si pluhur i imët. Në përfundim preparati i përfutur duhet të ketë lagështi 1 deri në 2% dhe pH në tretësirë 7,4 – 7,6. Një cikël prodhimi llogaritet të zgjasë minimalisht 36 orë pune.

Produkti përfundimtar në formë kristali, ka ngjyrë kafe të errët, me aromë shpuese karakteristike, të ngjashme me esteret, ka shije të fortë me nuancë **të ngjashme me atë të jodit dhe rozmarinës**, tretet mirë në ujë (deri 40%), në glicerinë, në vaj dhe në tretës të tjerë dhe është i qëndrueshëm ndaj temperaturës.

Nuk janë vërejtur efekte toksike në kafshët eksperimentale. Dozat më të larta shkaktajnë diateza hemorragjike, konvulsione, vdekje. Në lepujt e vegjël, doza 1g/kg e injektuar intravenoz tri herë në një **interval 1.5 orë nuk ka shkaktuar çrregullim të dukshëm klinik dhe në ekzaminimet fizpatologjike të organeve nuk u vunë re ndryshime patologjike në organe**. Preparati ruhet në temperaturën e zakonshme të ambientit, larg dritës, **në enë të mbyllura për tu mbrojtur nga lagështia**.

Metodologjia

Efektiviteti antibakterial i preparatit të ri u vlerësua *in vitro*. Studimi u realizua me shtamet rezistente të izoluar në një rast të diagnostikuar me Fasciit nekrotizant ^(3,4,5) në Laboratorin Mikrobiologjik të

QSU “Nënë Tereza” Tiranë.

Vlerësimi u krye me metodën e hollimit në bujon (Makrohollimi) ⁽²⁾.

Metoda konsiston në zvogëlimin në mënyrë progresive të sasisë së antimikrobikut në epruveta me bujon Mueller Hinton, siç tregohet në Tabelën 1. Në rastin tonë u morën 12 epruveta (100 x 13 mm) ku tek epruveta e parë u hodhën 2 ml tretësirë 20% të preparatit që testojmë kurse në epruvetat e tjera, u zvogëlua në mënyrë progresive përqendrimi i preparatit dhe tek epruveta e fundit u hodhën 2 ml bujon Mueller Hinton.

Me pipetë sterile u mor 1 ml preparat eksperimental nga epruveta e parë dhe u hodh tek epruveta e dytë, nga epruveta e dytë u mor 1 ml dhe u hodh tek epruveta e tretë. Kjo procedurë u përsërit deri tek epruveta e 10^{te}, nga e cila 1 ml derdhet jashtë. Kështu kemi kryer hollimin e preparatit, duke përgjysmuar përqendrimin e tij në çdo kalim, respektivisht në epruvetën e parë kemi përqendrimin maksimal (X) kurse në epruvetën e dytë X/2 e kështu me radhë si në Tabelën 1. Epruveta e 11^{te} ka vetëm 1 ml bujon kurse epruveta 12^{te} ka 2 ml bujon. Çdo kalim bëhet me pipetë të re sterile.

Tabela 1. Përgatitja e epruvetave me **përqendrime** të ndryshme të preparatit

Epruveta Nr	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
Hollimi preparatit	1/1	1/2	1/4	1/8	1/16	1/32	1/64	1/128	1/256	1/512	0 Bujon 1 ml	0 Bujon 2 ml
Përqendrimi	20	10	5	2.5	1.25	0.625	0.312	0.156	0.078	0.039	Kontroll	Kontroll
Preparatit	%	%	%	%	%	%	%	%	%	%	pozitiv	negativ

Në një epruvetë me 5 ml NaCl u hodhën 3-5 koloni bakteriesh *Enterobacter Cloacae*, duke përfutur një pezulli me densitet 0.5 McFarland, që ka $1-2 \times 10^8$ CFU/mL.


Pezullia e përfutur u hollua në raporte 1:150 me bujon Mueller Hinton duke përfutur një pezulli me densitet bakterial 1×10^6 CFU/mL.

Nga pezullia e përfutur u mor nga 1 ml kulturë bujonike dhe u hodh në secilën epruvetë përveç 2 epruvetave të fundit, siç tregohet edhe në Tabelën 2 dhe Pamjen 1.


Në këtë rast bëhet hollimi $\frac{1}{2}$ duke holluar përsëri preparatin eksperimental dhe duke holluar kulturën bujonike dhe në këtë rast përftohet densitet bakteror 5×10^5 Cfu/mL.

Tabela 2. Përqindja e preparatit në secilën epruvetë

Epruveta Nr	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
C preparatit	1/2	1/4	1/8	1/16	1/32	1/64	1/128	1/256	1/512	1/1024	0	0
Cfu/mL	5×10^5	5×10^5	5×10^5	5×10^5	5×10^5	5×10^5	5×10^5	5×10^5	5×10^5	5×10^5	5×10^5	0

Pamja 1. Paraqitja e epruvetave të përgatitura para inkubimit

Bëjmë inkubimin në 37°C për 18-24 orë.

Pamja 2: Paraqitja e epruvetave të përgatitura pas inkubimit.

Pas inkubimit të secilës epruvetë në 37°C për 24 orë (Pamja 2), u kultivuan në pjata petri me terren MacConcey, u inkubuan në 37°C për 24 orë dhe u krye leximi për secilin rast siç tregohet në Tabelën 3.

Në rastin tonë kemi rritje në të gjitha pjatat përveç pjatës që i korrespondon epruvetës së parë me përqendrimin e preparatit eksperimental X/2 dhe në epruvetën e fundit që ka vetëm bujon.

Tabela 3. Rezultatet e përfthuara pas inkubimit

Epruveta Nr	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12
C preparatit	1/2	1/4	1/8	1/16	1/32	1/64	1/128	1/256	1/512	1/1024	0	0
Rritja në pjata	-	+	+	+	+	+	+	+	+	+	+	-
Rezistenca	S	R	R	R	R	R	R	R	R	R		

Shtami i izoluar nga Fasciiti nekrotizant⁵ ishte *Enterobacter Cloacae*, i cili në antibiogramën e realizuar me VITEK 2 (Tabela Nr. 4) rezultojnë ⁽¹⁾:

Tabela 4. Rezultatet e antibiogramës

Antimikrobiale	MIC	Interpretim	Antimikrobiale	MIC	Interpretim
Ampicillin/Sulbactam	-		Amikacin	8	S
Piperacillin/Tazobactam	-		Gentamicin	≥ 16	R
Cefoxitin	≥ 64	R	Ciprofloxacin	≥ 4	R
Ceftazidim	16	R	Levofloxacin	4	I
Ceftriaxone	≥ 64	R	Tigecycline	4	I
Cefepime	≥ 64	R	Fosfomicin	≥ 256	R
Aztreonam	≥ 64	R	Colistin	≤ 0.5	S
Imipenem	≤ 0.25	S	Trimetoprim/ sulfamethoxazole	40	S
Meropenem	≤ 0.25	S			

Preparati derivat i acidit dihidroantracen disulfonik në tretesirë 10% *in vitro* ka një efekt antimikrobiale.

Ky efekt antimikrobiale i preparatit eksperimental është i barazvlefshëm me efektin *in vitro* të Imipenem (MIC ≤ 0.25), Meropenem (MIC ≤ 0.25), Amikacin (MIC 8), Colistin (MIC ≤ 0.5), Trimetoprim/sulfamethoxazole (MIC 40) në shtaminë e izoluar *Enterobacter Cloacae*.


Figura 1. Shtami i izoluar i *Enterobacter Cloacae* në MacConkey (kolonitë ngjyrë rozë)**Figura 2. Rritja në MacConkey për epruvetat 1, 2, 3, 4**

Figura 3. Rritja në MacConkey për epruvetat 5, 6, 7, 8**Figura 4. Rritja në MacConkey për epruvetat 9, 10, 11, 12**

Përfundime

Efektiviteti antibakterial *in vitro* i derivatit të acidit dihidroantracen disulfonik është ekuivalent me efektin *in vitro* të Imipenem (MIC≤0.25), Meropenem (MIC≤0.25), Amikacin (MIC 8), Colistin (MIC≤0.5), Trimetoprim/sulfamethoxazole (MIC 40) në shtamin e izoluar *Enterobacter Cloacae*. Nevojiten studime dhe rezultate të tjera në mënyrë që të kemi një spektër të plotë të aktivitetit antibakterial të derivatit të acidit dihidroantracen disulfonik.

Referenca

1. Franklin R. Cockerill, III, Matthew A. Wikler, Jeff Alder et al. Clinical And Laboratory Standards Institute (CLSI); Methods for Dilution Antimicrobial Susceptibility Tests for Bacteria That Grow Aerobically; Approved Standard—Ninth Edition; M07-A9; Vol. 32; No. 2; January 2012; 16-40.
2. Jean B. Patel, Franklin R. Cockerill III, Patricia A. Bradford et al. Clinical And Laboratory Standards Institute (CLSI); Performance Standards for Antimicrobial Susceptibility Testing; Twenty-Fifth Informational Supplement; M100-S25; Vol. 35; No. 3; January 2015; 158-178.
3. Swain RA, Hatcher JC, Azadian BS, et al. A five-year review of necrotising fasciitis in a tertiary referral unit. Annals of The Royal College of Surgeons of England Vol. 95(1):57-60, January 2013.
4. Jacqueline A. Roemmele, Donna Batdorff. Surviving the Flesh-Eating Bacteria Understanding, Preventing, Treating, and Living with the Aftermath of Necrotizing Fasciitis; Second Edition; July 2015; 84-108.
5. Vayvada H, Demirdover C, Menderes A, Karaca C. Necrotizing fasciitis: diagnosis, treatment and review of the literature. Turkish Journal of Trauma & Emergency Surgery (*Ulus Travma Acil Cerrahi Derg.*) November 2012; 18(6):507-13.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

ANALIZAT KIMIKE TË PËRBËRJES ALKOOLIKE DHE PËRMBAJTJES TË POLIFENOLEVE TE MOSTRAT E BIRRËS NGA TREGU SHQIPTAR

Ardit Shehi*, Aurel Nuro, Bledar Murtaj**, Dorina Shëngjergji*, Aurora Napuçe*,
Aida Dervishi*****

*Departamenti i Farmacisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University

**Departamenti i Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës

***Departamenti i Bioteknologjisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës

Adresë kontakti: ardit_shehi@yahoo.com

Përmbledhje

Objektivat: Në këtë studim janë sjellë të dhëna nga analiza kimike e përbërjes alkoolike të disa nga birrat që gjenden në tregun shqiptar. Për të gjitha mostrat e birrës janë realizuar dhe analiza për përmbajtjen polifenolike të tyre. Birra është një pije me përmbajtje të ulët alkoolike që konsumohet në sasi të madhe në tregun shqiptar (1; 2; 3).

Metodat: Mostrat e birrës janë grumbulluar në dhjetor 2017. Mostrat e birrës u përzgjodhën në mënyrë të rastësishme në tregun e qytetit të Tiranës. Analiza e alkooleve në mostrat e birrës u realizua në aparatin GC/FID. 30 ml nga mostrat e birrës në fillim u degazuan në banjë me ultratinguj për 30 minuta në temperaturën 30°C dhe më pas ato u injektuan drejtpërdrejt në injektorin split/splitless të aparatit GC/FID. Kolona kapilare VF-1ms u përdor për ndarjen e alkooleve nga mostrat e birrës. Përmbajtja e polifenoleve u realizua me anë të spektrofotometrisë UV-VIS. Matjet u realizuan për secilën nga mostrat e degazuara të birrës në gjatësinë e valës 600nm e rekomanduar për matjet e polifenoleve në pije alkoolike (4; 5).

Përfundimet: Për të gjitha mostrat e birrës alkooli kryesor ishte etanoli. Në mostrat e birrës të prodhuara në vendin tonë vihet re prezenca e alkooleve me tri atome karbon. Këto alkoole ndikojnë në buketin e këtyre birrërave. Përmbajtjen më të madhe të polifenoleve e k.ishin gjithashtu birrat të cilat prodhohen në vendin tonë (6; 7; 8).

Fjalë çelës: *Mostra birre, përbërja alkoolike, përmbajtja polifenolike, GC/FID, spektrometria UV-VIS.*

CHEMICAL ANALYSIS OF ALCOHOLIC COMPOSITION AND POLYPHENOLIC CONTENT ON BEER SAMPLES OF ALBANIAN MARKET

Abstract

Objective: In this study presents data about chemical analysis of alcoholic composition for some of beers that can be found in Albanian market. Also, polyphenolic content was realized for beer samples. Beer beverage has lower alcoholic percentages. It consumed in large amounts in Albanian markets (1; 2; 3).

Methods: Beer samples were taken in December 2017. Beer samples were selected in random mode in Tirana markets. Analyzes of alcoholic composition in beer samples were realized in GC/FID method. Prior to analyses 30 ml beer samples were degassed in ultrasound bath for 30 minutes in 30°C degree. Direct injection was realized for beer samples in split/splitless injector of GC/FID equip. VF-1ms capillary column (30 m x 0.33 mm x 0.25 µm) were used for separation of alcohols in beer samples. Polyphenolic contents were realized using UV-VIS spectrophotometry. Analyzes of degassed beer samples were realized in 600 nm, recommended for determination of polyphenols in beer (4, 5).

Conclusion: For all beer samples the main alcohol was ethanol. Beer samples produced in Albania show higher presence of three carbon alcohols. These alcohols also affect the bouquet of these beers which. The higher content of the polyphenols also have the beers that are produced in our country (6; 7; 8).

Keywords: *Beer samples, alcoholic composition, polyphenolic content, GC/FID, UV-VIS spectrometry.*

Hyrje

Birra është pija alkoolike më e vjetër dhe më e njohur në botë. Nuk dihet me saktësi se kur u zbulua birra. Në një muze të Londrës deri më 1926 ruhehin dy pllaka të lashta, që fillimisht konsideroheshin se ishin shkruar 9 000 vjet më parë. Sot provat më të lashta për ekzistencën e birrës mendohet të jenë rreth më se 6 000 vjet dhe përshkruhen nga sumerët. Prodhohet nga fermentimi i lëndëve me bazë amidonin, zakonisht përdoret elbi. Në Egjiptin e Lashtë, prodhimi i birrës ishte shumë i përhapur dhe parapëlqej si pije. Gërmimet arkeologjike që janë bërë atje kanë zbuluar recetën më të vjetër të prodhimit të birrës. Më pas teknologjia e prodhimit të birrës u fut edhe në Evropë. Disa historianë romakë në fillim të erës sonë përmendin keltët, gjermanët dhe fise të tjera që e pëlqenin birrën. Në Evropë gjatë mesjetës, birra filloi të prodhohej nëpër manastire. Murgjit evropianë e përmirësuan teknologjinë e prodhimit duke përdorur kulprën e butë që birra të mos prishej. Industrializimi në shekullin e 19-të bëri të mundur mekanizimin e prodhimit të birrës, dhe ky ishte një moment i shënuar në historinë e kësaj pijeje kaq të famshme. Kimisti dhe mikrobiologu francez Lui Paster zbuloi se majaja që shkaktonte fermentimin e birrës përbëhej nga organizma të gjalla. Ky zbulim bëri të mundur që të kontrollohej më mirë transformimi i sheqerit në alkool. Botanisti danez Emil Kristian Hansen u bë një nga personazhet kryesore në historinë e prodhimit të birrës. Gjatë gjithë jetës ai bëri kërkime dhe i ndau llojet e majave në kategori të ndryshme. Ndërmjet të tjerave, kërkimi i tij kishte të bënte edhe me kultivimin e një majaje birre të pastër. Teknologjia e prodhimit të birrës ka ndryshuar shumë gjatë shekujve. Madje edhe sot ajo ndryshon nga njëra punishte ose fabrikë birre në tjetrën. Por në përgjithësi të gjitha llojet e birrave përmbajnë katër përbërës kryesorë: elb, kulpër të butë, ujë dhe maja. I gjithë procesi i prodhimit mund të ndahet në katër faza: maltimi, përgatitja e mushtit të maltit, fermentimi dhe staxhionimi (1; 2; 3).

Sheqernat që gjenden në mushtin e birrës me ndihmën e enzimave të majasë shndërrohen në alkool etilik dhe gaz karbonik. Gjatë fermentimit formohen dhe shumë nënprodukte të tjera që i japin birrës shijen karakteristike. Alkoolët e rendeve të larta, formohen nga metabolizimi nga ana e majasë e lëndëve proteinike. Gjatë shumëzimit dhe jetës të tyre qelizat e majasë përdorin aminoacidet që ndodhen në musht. Kur sasia e aminoacideve në musht është e vogël, këto i sintetizon vetë majaja. Në këto raste majaja përdor grupet aminike që ndodhen në musht duke formuar ndërkohë alkoolë

të rendeve të larta në birrë. Përbërja e lëndëve proteinike që ndodhen në musht, ka rëndësi për formimin e tyre. Prania e alkooleve të rendeve të larta në birrë i jep asaj shije të keqe, të hidhur dhe “të egër”. Ato i japin birrës një shije mjalti dhe aromë trëndafili (2; 3; 4).

Sipas disa studimeve birra mund të ulë rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare nga 20% – 40%. Konsumi i moderuar i birrës ul riskun për sëmundje të zemrës. Kjo falë fibrave të pranishme tek birra që ndihmojnë në reduktimin e kolesterolit në gjak, reduktohen shanset e mpiksjes së gjakut apo bllokimit të arterieve, dy shkaqet kryesore të atakut të zemrës dhe isheminë (bllokimin e enëve të gjakut në tru). Tek birra gjenden gjithashtu polifenole, antioksidantë të fuqishëm për shëndetin e zemrës. Birra njihet gjithashtu si një pije që ul riskun për krijimin e gurëve në veshka. Sasia e lartë e ujit (rreth 93%) tek birra ndihmon në ruajtjen e veshkave dhe mundëson që ato të punojnë si duhet duke nxjerrë toksinat jashtë organizmit. Gjithashtu, efekti diuretik tek birra nuk do të shkaktojë dehidratim, një nga shkaqet kryesore për formimin e gurëve në veshka. Birra redukton riskun e zhvillimit të problemeve me kujtesën në moshën e tretë me deri në 23%. Gjithashtu, konsumi i moderuar i birrës ul riskun për prekje nga sëmundja e Alzheimer-it dhe dementia-s, pasi birra nxit rritjen e qelizave të reja të trurit. Birra gjithashtu lejon trurin të ketë një fokus më të lartë, duke përmirësuar kujtesën, forcën e arsyes dhe përqendrimin. Birra përmban nivel të lartë silici, një përbërës që ndihmon në shëndetin e kockave. Megjithatë, birra në sasi të lartë rrit riskun për frakturë në kocka. Birra përmban xanthohumol, një antioksidant i fuqishëm, që lufton kancerin. Birra bllokoi reaksionin kimik që mund të çojë në zhvillimin e kancerit të prostatës tek meshkujt. Gjithashtu, mund të ulë rrezikun e shfaqjes së kancerit të gjirit te femrat. Shumë studime kanë treguar se konsumi në masë të moderuar i birrës mund të reduktojë rrezikun e shfaqjes së diabetit. Birra hidraton lëkurën nga brenda. Në fakt, pirja e birrës pas punës hidraton trupin më mirë se uji. Është zbuluar gjithashtu se egjiptianët e lashtë laheshin me birrë për të hidratuar lëkurën kur ishin në shkretëtirë. Gjithashtu, niveli i lartë i ujit tek birra ndihmon në nxjerrjen e toksinave jashtë trupit dhe lëkurës, duke i dhënë fytyrës suaj një shkëlqim natyral (3; 5; 6).

Metodologjia

Marrja e mostrave të birrës

Mostrat birrave janë grumbulluar në periudhën Dhjetor 2017. Mostrat e birrës u përzgjedhën në mënyrë të rastësishme në tregun e qytetit të Tiranës. U morën jo vetëm lloje të ndryshme birre por edhe paketime të ndryshme të tyre për të njëjtin lloj. Kjo u bë që mostrat e birrës të jenë sa më përfaqësuese (2; 3).

Analiza gazkromatografike e alkooleve në mostrat e birrës

Analiza e alkooleve në mostrat e birrës u realizua në aparat GC/FID. Mostrat e birrës në fillim u degazuan në banjë me ultratinguj për 30 minuta në temperaturën 30°C dhe më pas ato u injektuan drejtpërdrejt në injektorin split/splitless të aparatit GC/FID. Temperatura e injektorit dhe e detektorit u vendosën respektivisht në 280°C dhe 300°C. 2 ul e mostrës të degazuar të verës u injektuar në mënyrë split (1:50). Azoti u përdorur si gaz mbartës (1 ml/min) dhe si ‘make-up gas’ (25 ml/min). Hidrogjeni dhe ajri ishin gazet e flakës në detektor respektivisht me 30 ml/min dhe 300 ml/min. Kolona kapilare VF-1ms (30 m x 0,33 mm x 0,25 µm) u përdor për të izoluar komponimet vajit esencial. Temperatura e furrës ishte programuar si vijon: nga 40°C (u mbajt për 2 minuta në 40°C) në 150°C me 4°C/min, më tej në 280°C me 10°C/min, në 280°C u mbajt për 2 minuta. Identifikimi i komponimeve është bazuar në metodën me standard të jashtëm ku u përgatitën pesë përzierje të alkooleve C1-C5 në një tretësirë ujë/etanol (50/50) në vëllim. Kjo tretësirë shërbeu dhe për hollimet e tretësirës stok me përqendrim 100 mg/l (5; 6; 7).

Analiza UV-VIS e polifenoleve në mostrat e birrës

Fillimisht birra degazohet duke e përzierë një sasi të saj në një elenmajer ose duke përdorur banjë me ultratinguj. Qartësohet birra me anë të centrifugimit dhe lihet për disa minuta në 20 gradë C. Merret 10 ml birrë dhe 8 ml reagent Celulozë karboksimetil CMC/EDTA 10 g/litër, 3 ml citrat hekuri 5,6 g/liter Fe^{3+} dhe 0.5 ml hidroksid amoni 35% në një balon 25 ml. Përzihet përmbajtja për disa minuta. Hollohet kampioni, nëse përmbajtja në polifenole është më e madhe se 400 mg/litër është e nevojshme hollimi i mëtejshëm i kampionit. Pas 10 min matet absorbanca në një kuvetë 10 mm duke përdorur një spektrofotometër në 600 nm. Sigurohemi që tretësira që do të matet është i qartë. Përmbajtja e polifenoleve llogaritet duke përdorur formulën: $P = A \times 820 \times F$ ku P - Përmbajtja në polifenole, A - Absorbanca në 600 nm dhe F - Faktori i hollimit (6; 7)

Rezultatet

Të dhënat e alkooleve të marra me anë të teknikës gaz kromatografike janë paraqitur në tabelën 1 dhe grafikët 1,2,3 dhe 4. Të dhënat për alkoolet janë të shprehura në përqindje. Përqindjet e alkooleve dhe përbërësve të tjerë të pijeve alkoolike të analizuara janë të shprehura në mënyrë relative kundrejt totalit të tyre përfshirë dhe etanolin. Alkoolet e analizuar me GC/FID ishin: metanol, etanol, propanol, propenol, t-butanol, izobuatnol, butanol-2, butanol-1, pentanol-2 dhe alkool n-amilik. Rezultatet për polifenolet e analizuar me teknikën UV-VIS janë dhënë në grafikun 5. Polifenolet janë dhënë si total i këtyre komponimeve që gjenden tek birrat e marra në analizë.

Tabela 1. Përqindjet e alkooleve tek birrat e analizuara me GC/FID

Alkooli/Birra	Tirana	Stela	Kaon	Korca	Elbar	Peja	Heinek-en	Lowenbrau	Amstel
Metanol	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Etanol	99.85	98.84	99.49	99.52	89.76	99.91	99.64	99.60	99.67
Propanol	0.04	0.37	0.00	0.00	9.63	0.09	0.00	0.00	0.00
Propenol	0.00	0.00	0.00	0.00	0.07	0.00	0.00	0.00	0.00
t-Butanol	0.00	0.05	0.01	0.01	0.02	0.00	0.01	0.01	0.02
izo-Butanol	0.07	0.09	0.01	0.01	0.00	0.00	0.00	0.01	0.00
Butanol-2	0.00	0.00	0.05	0.04	0.00	0.00	0.03	0.04	0.04
Butanol-1	0.04	0.00	0.00	0.00	0.28	0.00	0.00	0.00	0.00
Pentanol-2	0.00	0.04	0.02	0.00	0.04	0.00	0.03	0.04	0.03
Alkool n-Amilik	0.00	0.00	0.26	0.08	0.00	0.00	0.05	0.04	0.05
	100.00	99.39	99.84	99.65	99.80	100.00	99.76	99.74	99.80




Figura 1. Totali i përqindjeve të alkooleve tek birrat e analizuar me GC/FID




Figura 2. Përqindjet e alkooleve C3-C5 te birrat e analizuar me GC/FID




Figura 3. Shpërndarja e alkooleve C3-C5 të birrat e analizuar me GC/FID




Figura 4. Profili i alkooleve C3-C5 të birrat e analizuar me GC/FID




Figura 5. Polifenolet te birrat e analizuara me teknikën UV-VIS

Diskutime

Totali i alkooleve: methanol, etanol, propanol, propenol, t-butanol, izobuatnol, butanol-2, butanol-1, pentanol-2 dhe alkool n-amilik ishte nga 99.39% për birrën Stela deri në 100% për birrat Tirana dhe Peja (Tabela 1). Etanoli është përbërësi kryesor i birrave të marra në analizë (Figura 1). Etanoli është përbërësi kryesor i gjetur për të gjitha birrat e analizuara nga 89,76% (Elbar) deri 99.91 (Peja). Metanoli paraqet interes për njohjen e tij për shkak të toksicitetit në organizmin e njeriut. Ai nuk u dedektua në asnjë nga mostrat e birrës të marrë në analizë. Alkoolet e larta paraqesin interes për shkak të buketit që ato sjellin tek birra. Prania e tyre në sasi të lartë nuk preferohet sepse metabolizmi i ngadaltë i tyre shkakton probleme shëndetësore tek organizmi i njeriut. Përqindjet e alkooleve të lartë (C3-C5) që janë marrë në analizë janë dhënë në Figurën 2. Niveli më i lartë i tyre ishte për birrën Elbar me 9.87%. Për të gjitha birrat e tjera shuma e alkooleve C3-C5 ishte më e ulët se 0.5%. Shpërndarja e alkooleve C3-C5 është dhënë në Figurën 3. Ka një shpërndarje të njëjtë për të gjitha birrat për sa i takon alkooleve me katër dhe pesë atome karbon. Kjo është e pritshme për shkak të të njëjtës mënyrë të prodhimit të birrës. Përjashtim bëjnë birrat Elbar dhe Stela të cilat kanë përqendrime të larta të propanolit. Kjo duhet të jetë e lidhur me cilësinë e lëndëve të para, proceset e staxhionimit dhe filtrimit të birrave në fabrikë apo dhe proceset e ruajtjes të birrave në vendet e tregimit të tyre. Profili i alkooleve C3-C5 jepet në Figurën 4. Profili i tyre ishte Propanol > Alkool n-amilik > Butanol-1 > Butanol-2 > izobutanol. Ky profil ishte i ngjashëm me raportime në studime të tjera. Në Figurën 5 jepen përqendrimet e polifenoleve në mg/l në mostrat e birrës të marrë në analizë. Këto të dhëna janë marrë me teknikën UV-VIS. Përqendrimi i polifenoleve ishte nga 102 mg/l për birrën Stela deri në 237 mg/l për birrën Kaon. Në përgjithësi nivelet më të larta të polifenoleve ishin për mostrat e birrës të prodhuar në vendin tonë. Këto vera s'gjerojmë të jenë dhe më të përdorshme nga ana e popullatës për shkak të niveleve të larta polifenoleve që ato kanë.

Përfundime

Përcaktimi i alkoolëve u realizua me anë të teknikës gaz kromatografike me dedektor me jonizim në flakë. Alkoolët e analizuar me GC/FID ishin: metanol, etanol, propanol, propenol, t-butanol, izobutanol, butanol-2, butanol-1, pentanol-2 dhe alkool n-amilik. Përcaktimi i polifenoleve totale u realizua me teknikën UV-VIS. Etanoli është përbërësi kryesor i birrave të marra në analizë. Metanoli nuk u detektua në asnjë nga mostrat e birrës të marrë në analizë. Përqindjet e alkoolëve të lartë (C3-C5) ishin në nivel më të lartë për birrat që prodhohen në vendin tonë. Këto alkoolë ndikojnë në buketin e këtyre birrërave. Ka një shpërndarje të njëjtë për të gjitha birrat për sa i takon alkoolëve me katër dhe pesë atome karbon. Kjo është e pritshme për shkak të të njëjtës mënyrë të prodhimit të birrës. Nivelet dhe shpërndarja e alkoolëve duhet të jetë e lidhur me cilësinë e lëndëve të para, proceset e staxhionimit dhe filtrimit të birrave në fabrikë apo dhe proceset e ruajtjes të birrave në vendet e tregtimit të tyre. Profili i alkoolëve ishte: Etanol > Propanol > Alkool n-amilik > Butanol-1 > Butanol-2 > izobutanol. Ky profil ishte i ngjashëm me raportime në studime të tjera (3; 6; 7). Nivelet më të larta të polifenoleve ishin për mostrat e birrës të prodhuar në vendin tonë. Këto vera sugjerojmë të jenë dhe më të përdorshme nga ana e popullatës për shkak të niveleve të larta polifenoleve që ato kanë.

Referenca

1. Estruch R., Lamuela-Raventos R.M. Alcohol, wine and cardiovascular disease, two sides of the same coin. *Intern. Emerg. Med.* 2010;5:277–279.
2. Vinson J.A., Mandarano M., Hirst M., Trevithick J.R., Bose P. Phenol antioxidant quantity and quality in foods: beers and the effect of two types of beer on an animal model of atherosclerosis. *J. Agric. Food Chem.* 2003;51:5528–5533.
3. 22. Gorinstein S., Caspi A., Libman I., Leontowicz H., Leontowicz M., Tashma Z., Katrich E., Jastrzebski Z., Trakhtenberg S. Bioactivity of beer and its influence on human metabolism. *Int. J. Food Sci. Nutr.* 2007;58:94–107.
4. Covas M.I. The Mediterranean Diet and the Contribution and Role of Alcohol. In: Preedy V.R., Watson R.R., editors. *Comprehensive Handbook of Alcohol Related Pathology*. Vol. 1. Elsevier Academic Press; San Diego, CA, USA: 2004. pp. 135–146. Chapter 12.
5. 46. Estruch R., Sacanella E., Mota F., Chiva-Blanch G., Antunez E., Casals E., Deulofeu R., Rotilio D., Andres-Lacueva C., Lamuela-Raventos R.M., et al. Moderate consumption of red wine, but not gin, decreases erythrocyte superoxide dismutase activity: A randomised cross-over trial. *Nutr. Metab. Cardiovasc. Dis.* 2011;21:46–53.
6. Brien S.E., Ronksley P.E., Turner B.J., Mukamal K.J., Ghali W.A. Effect of alcohol consumption on biological markers associated with risk of coronary heart disease: Systematic Review and meta-analysis of interventional studies. *BMJ.* 2011;342:d636.
7. Ronksley P.E., Brien S.E., Turner B.J., Mukamal K.J., Ghali W.A. Association of alcohol consumption with selected cardiovascular disease outcomes: A systematic review and meta-analysis. *BMJ.* 2011;342:d671.



SHKENCAT SHOQËRORE

SEKSIONI 2



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

PIKËPAMJET HISTORIKE, BASHKËKOHORE DHE PSIKOLOGJIKE MBI STILET E LIDERSHIPIT TË MËSUESIT TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Elisabeta Kafia*; Silva Ibrahimimi **; Fatmir Tartale***

* Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, " Albanian University", Tiranë, Shqipëri

** Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

***Departamenti i Drejtësisë, " Albanian University", Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: elisabetakafija@gmail. com

Përmbledhje

Sot, në shek XXI, një numër gjithmonë e më i madh fëmijësh e të rinjsh po përballen me çrregullime, problematika e sfida në të nxënë, të natyrës psiko-emocionale, të sjelljes sociale etj. Sot po rritet jo vetëm numri i nxënësve me vështirësi, por edhe ashpërsia dhe kompleksiteti i vetë vështirësive.

Për të përballuar me sukses këto vështirësi, ka lindur nevoja imediate për ripërcaktimin e rolit të mësuesit si lider në shkollë qoftë në aspektin e mësimdhënies, qoftë në trajtën e reformimit të roleve dhe shërbimeve që ofron çdo ditë të nxënësit, prindërit dhe komuniteti i gjerë.

Në fokusin e këtij artikulli qëndron parashtrimi i një panorame sa më të gjerë dhe mbështetëse për liderin mësues dhe aftësimin e tij psikologjik e social karshi ndryshimeve cilësore dhe kërkesave gjithnjë e më në rritje të edukimit me bazë aftësimin si parakusht domethënës i integritetit në BE.

Fjalë çelës: *leadership edukimi, mësues, aftësim, integritet.*

HISTORICAL, CONTEMPORARY AND PSYCHOLOGICAL VIEWPOINTS OF THE LEADERSHIP OF THE TEACHER IN EDUCATIONAL INSTITUTIONS

Abstract

Nowadays, in the 21st century, an increasing number of children and youth are facing disorders, problems and challenges of the nature of learning, psycho-emotional, social behaviour, and further on. Today, not only is the number of students with difficulties but also the severity and complexity of the difficulties themselves.

To successfully cope with these difficulties, immediate needs have arisen to redefine the role of the teacher as a leader in the school both in terms of teaching and in the form of reforming the roles and services that day-to-day access to students, parents and the wider community.

The focus of this article is to present a broader and supportive view of the Teacher Leadership and its psychological and social training towards qualitative changes and ever-increasing demand for Education-based training as a significant pre-requisite for EU integration.

Keywords: *education leader, teacher, training, integration.*

Hyrje

Koncepti i lidërshipt ka marrë një vëmendje të gjerë në studimet e psikologjisë organizacionale fillimisht, e më pas në atë të profilizimit klinik e atij psikopatologjik, që në mesin e dytë të viteve nëntëqind.

Në etimologjinë e fjalës së sotme angleze "lead" janë rrënjët e kallëzuesit të vjetër "læden" që përkon me fjalën holandeze "leiden" dhe atë gjermane "leiten" si pjesë etimologjike e familjes anglo-saksone. Kjo përkatësi e re "to lead" do të thoshte "... për të shkuar me...", ndërsa përdorimi i parë i termit "leadership" (1), me kuptimin "...të qenit në vendin e parë" nuk njihet para lindjes së Krishtit. Karakteristikë themelore kësaj së lidërshipt është udhëheqja e individëve brenda konteksteve sociale të organizuara, mobilizimi i të gjitha palëve të përfshira brenda një dimensionit të marrëdhënies ndërmjet subjekteve të cilët ndërveprojnë së bashku me qëllim arritjen e rezultateve të kërkuara. Studimi psikodinamik i procesit të lidërshipt dhe aspektet dinamike të personalitetit të liderit janë më rëndësi për analizën dhe interpretimin e këtij studimi. Përvojat e fëmijërisë dhe modelet e rritjes së fëmijëve ndikojnë në mënyrën e maturimit dhe të zhvillimit të individit. Në modelin e tij psikanalitik (2) është argumentuar mbi rëndësinë e metodës së mësimdhënies në shkollë dhe universitet, si një nga përfitimet më të mëdha që mund të japë psikanaliza në jetën e përditshme. Metoda e mësimdhënies dhe mësimnxënies, për Frojdit, duhet të jetë didaktike përmes leksioneve, diskutimeve dhe përvojës.

Më vonë, në shkrimin "Katër leksione mbi psikanalizën për mësuesit dhe prindërit" (3) përshkruhet sesi marrëdhënia që krijohet mes mësuesit, fëmijës dhe analistit është si proces delikat i arsimimit. Roli i psikologjisë është t'i japë fëmijëve "një ndihmë" qoftë në shpalosjen e mundësive të paeksploruara, qoftë në përjetimin e plotë dhe të vërtetë të simptomës.

Koncepti psikanalitik mbi edukimin i përngjan "një betejë të pafundme" ku egoja sillet në botë përmes mekanizmave të saj mbrojtëse (perceptim, vëzhgim, projektion, halucinacion dhe testim i realitetit përtej ndikimeve dhe trysnive të jashtme). Mësuesit liderë mund të përfshihen në ëndërrime dhe fantazi bashkë me një gamë të gjerë mbështjellëse të mekanizmave mbrojtëse.

Teoritë e hershme mbi lidërshiptin, organizatat dhe institucionet ishin të orientuara nga detyrat. Qëllimi ishte nxitja e eficiencës pavarësisht ndikimeve të faktorit njerëzor. Përkundër kësaj qasjeje, studiuesit (4) parashtuan modelin humanist të lidërshipt, ku marrëdhëniet njerëzore dhe motivimi mbi punën mbartin një rol kryesor. Studimet e mëvonshme e përshkruajnë lidërshiptin si një kontinuum ku ndërthuren disa tendenca të sjelljes të liderit. Dimensionit i tendencës sjellore i propozuar nga këta autorë mbart një numër pohimesh të Q edhe në studimin tonë.

Stilet e lidërshipt mund të paracaktohen sipas dy makro objektivave që duhen ndjekur (5):

1. koherenca e rezultateve dhe përqendrimi në përgjegjësi (tipar më karakteristik i liderit autokratik ose paternal që urdhëron ose bind);

2. marrëdhëniet ndërpersonale dhe përqendrimi në burimin-Njeri (tipar më karakteristik i liderit demokratik ose këshillues që përfshin dhe bashkëpunon me vartësit e tij);

Qasja situacionale (6) argumenton se ekziston një bashkëlidhje mes të dy objektivave që tejashtëzohet në një shumësi stilesh lidërshipti:

- autoritari-agresivi,
- asertivi kërkuesi/i vëmendshmi,
- motivacionali,
- administrativ,
- politiku.

Përmes këtij modeli kërkohet të përcaktohet një stil ndaj orientimit, detyrës dhe situatës ku

zhvillohet ky stil. Thënë përndryshe, kemi të bëjmë me një qasje ku vihet në dukje marrëdhënia objektuale e liderit mësues dhe drejtues.

Lideri funksional shkollor duhet të përmbushë disa përgjegjësi:

- të organizojë dhe planifikojë (sipas përparësive dhe të emergjencave të rastit);
- delegojë;
- të njohë meritat dhe vlerat në mënyrë të sinqertë dhe këmbëngulëse;
- të verifikojë dhe vlerësojë;
- të riprojektojë në përmirësim të vazhdueshëm (veprime në kohë dhe të përshtatshme);
- të dijë se çfarë kërkon, të gjejë forma për të arritur çka do përmes maksimalizimit të burimeve dhe me synim nxitjen e efciencës dhe produktivitetit, të krijojë klimën e përshtatshme për të motivuar produktivitetin e individëve;
- si një lider i suksesshëm duhet të zotërojë njohuritë normative, juridike dhe të ekspertimit, kuptimshmëri dhe solidaritet, aftësi të sintezës analitike, aftësi për të zgjidhur problemet dhe marrë vendime asertive dhe konstruktive, si dhe të jetë fleksibël.

Lidershipi në shkollë duhet t'i përgjigjet nevojave për ndryshim dhe informacionit që dëshiron shoqëria duke përqafuar forma të reja të lidërsipit, veçanërisht të lidërsipit në fushën e mësimdhënies (7). Lidershipi formues shpërndan përgjegjësinë e udhëheqjes ndaj shumë edukuesve individual në një mënyrë anti-hierarkike ose horizontale. Studiuesit (8) argumentojnë se demokratizimi i arsimit ndodh duke ripërcaktuar lidërsipin e mësuesve si një formë e bashkëndarë e lidërsipit për të gjithë mësuesit. *"Liderët mësues mund të transformojnë shkollat në komunitete që përgatisin nxënës dhe student për qytetari dhe punë në një shoqëri komplekse, teknologjike dhe demokratike."* (9) Ekziston një marrëdhënie e fortë mes rezultateve shumë të larta të nxënësve dhe lidërsipit të përdorur në komunitetin e shkollës përfshirë edhe fuqizimin e mësuesve. Mësuesit si liderë mund të vazhdojnë të kërkojnë që institucionet shkollore t'i largohen sistemeve të strukturuara dhe t'i bashkohen formave të përmirësuara organizacionale (10). Le të kujtojmë në këtë pikë përpjekjet e vazhdueshme të vendosjes së një rregullatori të brendshëm e të jashtëm të trajtesës së shkollës si "shërbim komunitar" në Shqipëri. Kjo formulë e re për vendin tonë, por me baza të forta të besueshmërisë në vendet perëndimore, krijon natyrisht më shumë hapësira për rregullimin e sjelljes organizacionale dhe hapësirës së lidërsipit për mësuesit. Në një studim të ngjashëm mbi përmbushjen e reformës arsimore në Shtetet e Bashkuara (11) dalluan një karakteristikë të rëndësishme që lidhej me lidërsipin e bashkëndarë. Në këtë formë të lidërsipit mësuesit, sipas autorëve, duhet të jenë pjesëmarrës aktivë që të mund të kontribuojnë në progresin e shkollës (12). Disa nga dimensionet më të rëndësishme të lidërsipit në edukim mund të përmbledhen në tabelën e mëposhme (13):

Skemë përmbledhëse e dimensioneve më të rëndësishme të lidërsipit efektiv edukativ

<i>Vetënjohja</i>
Kognicioni i gjendjes së brendshme të vetes dhe burimeve ndërpersonale.
<i>Kognicioni emocional</i> : Njohja e emocioneve dhe efekteve të vetes.
<i>Vlerësimi i përshtatshëm i vetes</i> : Njohja e pikave të forta dhe të dobëta të vetes.
<i>Vetëbesimi</i> : Siguri në vlerësimin e vetes dhe aftësive të të tjerëve.

Aftësitë sociale
<i>Aftësia për të paraqitur reagime të dëshirueshme të tjerët.</i>
<i>Ndikimi:</i> Përdorimi i teknikave efektive të bindjes.
<i>Komunikimi:</i> Dërgimi i mesazheve të qarta dhe bindëse.
<i>Lidershipi:</i> Frymëzimi dhe drejtimi i grupeve dhe individëve.
<i>Katalizimi i ndryshimit:</i> Fillimi i drejtimit të ndryshimeve.
<i>Zgjidhja e konflikteve:</i> Aftësia për të negociuar dhe zgjidhur konfliktet.
<i>Bashkëpunimi dhe bashkëveprimi:</i> Të punosh me të tjerët për arritjen e qëllimi të përbashkët.
<i>Aftësitë e grupit:</i> Aftësia për të krijuar sinergji grupi në arritjen e qëllimeve kolektive.

Stilet e lidershit shkollor dhe roli psikosocial i mësuesit lider

Stilet e lidershit lidhen me personalitetin, angazhimin dhe strukturat e komunikimit të liderit në udhëheqjen e të tjerëve për të arritur qëllimet e vendosura të organizatës ose personale. Hulumtimet më të rëndësishme mbi stilet e lidershit kanë qenë të lidhura me perceptimet vetë-raportuese të sjelljes së liderit mbi vendimmarrjen, marrëdhëniet ndërpersonale, planifikimin, lidershipin mbikëqyrës dhe menaxhimin eficient. Ndër instrumentet më të përdorura në literaturë për të vlerësuar stilin e lidershit janë: Pyetësi i Përshkrimit të Klimës Organizacionale (OCDQ), Pyetësi i Përshkrimit të Sjelljes në Lidership (LBDQ) dhe Inventari i Shëndetit Organizacional (OHI). Të gjithë këto instrumente shërbejnë për të mbledhur të dhëna mbi perceptimet e stafit dhe anëtarëve mbi stilin e lidershit të drejtuesve të shkollës dhe mësuesve në dinamikën e organizimit në shkollë.

Literatura, nga ana tjetër, na ofron një sasi të limituar të studimeve empirike për të kuptuar më qartë pse disa stile të lidershit në disa situata janë më dominues sesa të tjerë.

Ndër kategoritë kryesore të lidershit në literaturën e tashme janë: *liderishi karazmatik, liderishi i të drejtës sociale, liderishi mbi rolet gjinore dhe racën, liderishi moral dhe shpirtëror*. Katër stilet e lidershit që rrjedhin nga këto kategori janë: autoritari, pjesëmarrësi, transaksionali ose transformuesi.

Lideri autoritar përdor taktika shtrënguese për të ndjekur forcërisht rregullat, përdor mënyra makiaveliane për të manipuluar të tjerët dhe jep besimin sipas meritës. Kontrolli dhe zotërimi janë strategjitë kryesore të menaxhimit që përdoren nga liderët autoritarë. Në këtë formë të lidershit vihet në pah rëndësia e objektivitetit në vendin e punës, tentohet mosqenia i përfshirë në problemet e njerëzve dhe të mos shfaqet emocion o dashamirësi ndaj të tjerëve. Teoria e X-të (15) është lajtmotivi i stilit autoritar sipas të cilës njerëzit duhet të detyrohen të punojnë, të mbikëqyren rreptësisht dhe të shpërblehen o të ndëshkohen sipas produktivitetit që sjellin. Në disa situata të caktuara, kur kërkohet një "komandant për të drejtuar anijen", stili i lidershit autoritar është efektiv. Kështu për shembull, nëse drejtuesi i një institucioni të rëndësishëm nuk do të kishte disa karakteristika të autoritarit, me shumë gjasa drejtimi do të krijonte hapësira për neglizhim dhe kaotizëm. Po kështu, është shumë e rëndësishme edhe vetë perceptimi i individit mbi stilin e lidershit që mbart; të dhënat e këtij studimi të shqyrtuara më poshtë vënë në dukje rritjen progresive të perceptimit mbi stilin e lidershit dhe forcimit të karakteristikave të atij stili që janë perceptuar. *Lidershipi pjesëmarrës* i largohet mënyrës së lidershit autoritar duke u përqendruar në anën njerëzore të institucionit (16). Për ta, produktiviteti dhe marrëdhëniet njerëzore ishin ngushtësisht të lidhura

dhe të drejtuara kah strukturave informale dhe sistemeve sociale. Follet arsyetonte se ”*menaxherët duhet të trajtonin punonjësit me dinjitet dhe të ndryshojnë mjedisin e punës nga kontrolli autoritar strikt në një koncept më kolegjal të ekipit*”. Autorët e kësaj rryme shihni organizatat si sisteme sociale ku nevojat sociale të njerëzve janë faktorët më të rëndësishëm në motivimin e efikasitetin më të lartë. Studiuesit (17) kanë argumentuar se vendimmarrja e bashkëndarë dhe pjesëmarrja grupe në organizatat produktive qendësohet te njerëzit dhe nevojat e tyre. Këta autorë ndikuan fuqishëm në krijimin e vendimmarrjes të bashkëndarë në arsimin publik. *Liderët transaksionalë* tentojnë të vënë në balancë strukturat që të plotësojnë nevojat e njerëzve gjatë plotësimit të nevojave të tyre. Kjo formë e liderishipit kërkon integrimin e qëllimeve dhe pritshmërive organizacionale me nevojat e individëve. Si shembull i përfaqësimit të stilit të liderishipit transaksional është modeli i sistemeve sociale (18). Ky model përmban dy dimensione kryesore: idiografike (nevojat e individëve) dhe nomotetike (qëllimet e organizatës) dhe transaksionet mes të dyve. Kështu balancohen dinamikat e nevojave dhe produktiviteti i organizatës me nevojat, personalitetin dhe predispozitat e njerëzve në punë. Psikanaliza transaksionale (19) analizoi fillimisht marrëdhëniet mes grupit dhe liderishipit sipas parimeve të analizës transaksionale, e cila përfshinte këto elemente: shpërblimin e kontigjencës, menaxhimin përmes përjashtimit aktiv dhe menaxhimin përmes përjashtimit pasiv. Këta liderë ndikojnë motivacionin e ndjekësve të tyre duke shkëmbyer shpërblimet për punonjësit për aq kohë sa ata janë eficientë me nevojat menaxheriale. *Liderishipi transformues* quhet stili i liderishipit ku lideri punon së bashku me punonjësit për të identifikuar ndryshimet e nevojshme, të zhvillojnë një pikëpamje udhëheqëse për ndryshimin dhe të vënë në jetë efektet e këtij ndryshimi. Kjo formë e liderishipit nxit motivacionin, moralin dhe performancën në punë përmes një sërë mekanizmash, si kuptimi mbi identitetin vetes dhe mënyra e projektimit të këtij kuptimi në identitetin e grupit, të qenurit një model për ndjekësit, sfidimi i punonjësve që të marrin zotërim mbi punën e tyre dhe kuptimi i pikave të forta dhe të dobëta të punonjësve në mënyrë që lideri të mund të nxisë performancën e tyre.

Liderishipi transformues përbëhet nga *pesë elementë* themelorë:

- *Ndikimi i idealizuar* (atribuimi) - formë e liderishipit karizmatik që bazohet në emocionet e adhurimit, respektit dhe vlerësimit të punonjësve nga lideri.
- *Motivacioni frymëzues* – motivacion për të nxitur një pikëpamje të përbashkët dhe për të stimuluar anëtarët e organizatës që të mbajnë një sjellje që shkon përtej detyrave të parashikuara të organizatës dhe pajisjen e stafit me sjellje të përputhshme me të.
- *Konsiderata e individualizuar* - stimulimi intelektual siguron forma të reja të punës shoqëruar me inovacion dhe krijimtari.

Një argument tjetër mbi liderishipin transformues është dhënë (20), sipas të cilit arsyetoi për herë të parë mbi konceptin e liderishipit pseudotransformues. Termi lidhet me liderët që janë vetë konsumues, shfrytëzues dhe të orientuar drejt pushtetit (21). Liderishipi pseudotransformues është konsideruar si i personalizuar, që fokusohet te interesat e liderit (22). Liderishipi transformues autentik është një lideriship i socializuar, në të cilin liderët lënë në hije interesat e tyre për hir të tjerëve. Studiuesit (23) kanë propozuar një model teorik që shpjegon sesi liderishipi transformues autentik ndikon etikën e ndjekësve dhe grupeve të individëve. Për autorët, liderishipi autentik transformues ndikon pozitivisht identitetin moral dhe emocionet morale që shpien në vendimmarrjen dhe veprimin moral të ndjekësve të tyre. Andaj ky nëngrup i liderishipit është pozitivisht i shoqëruar me klimën etike të grupit, vendimmarrjen dhe veprimin moral. Autenticiteti i liderit konsiderohet po kaq i rëndësishëm sa autenticiteti i qenies dhe *Dasein* i saj. Studimi psikodinamik i procesit të liderishipit dhe aspektet dinamike të personalitetit të liderit janë me rëndësi për analizën dhe interpretimin

e këtij studimi. Përvojat e fëmijërisë dhe modelet e rritjes së fëmijëve ndikojnë në mënyrën e maturimit dhe zhvillimit të individit. Në vitet e hershme fëmijët fillojnë të idealizojnë prindërit dhe vëllezërit më të mëdhenj, ndërsa me rritjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre vetjak, ata identifikojnë figurat e jashtme me role dhe modele të caktuara. Ekziston gjithnjë rreziku i atributit të roleve *lidërshiptale* (udhëheqëse) ndaj modeleve të rolit. Studiuesi amerikan (24) argumenton se qasja psikodinamike e lidërshiptit fillon nga një analizë e thelluar e personalitetit njerëzor që bashkëlidhen më pas me tipet dhe nivelet e lidërshiptit. Këto tipare të formësuara të personalitetit ingranohen ngushtësisht me njëra-tjetrën. Qasja psikodinamike kërkon të eksplorojë motivet e pavetëdijshme të liderit në mjedisin e edukimit dhe partnerëve të tij në këtë marrëdhënie të nxënësve. Studime të tjera (25) vënë në dukje se lidërshipti përfshin përdorimin e pushtetit dhe tiparet e personalitetit të liderit mund të diktojnë mënyrën sesi reagohej ndaj vështirësive, situatave të krizës dhe vendimmarrjes. Në studimin e tyre mbi zhvillimin e identitetit (26), autorët citojnë studime të tjera mbi këtë argument. Ata parashtrojnë një fushë 4-dimensionale të *maturitetit* dhe *vetërregullimit* në identitetin psikodinamik të liderit.

- Difuzioni i identitetit, më pak i maturuari karakterizohet nga një mungesë e drejtimit dhe orientimit ndaj qëllimeve.
- Identiteti i bashkëlidhur është më shumë i maturuar dhe përfshin angazhimin.
- Individidi me identitet moratorium ndërmerr hapa proaktivë dhe synon arritjen e një veteje autonome. Në fundin e hierarkisë qëndron arritja e identitetit, gjendja më e maturuar e shoqëruar me të menduarin, marrëdhëniet ndërpersonale dhe shoqërore të maturuara. Në kuptimin psikodinamik, një lider me identitet të arrirë është individ i ku forcat libidinale dhe antilibidinale neutralizojnë njëra-tjetrën për të mirën e egos.

Mund të flasim kështu për lider autentik, me identitet të arrirë dhe ego mbrojtës si individin mësimdhënës me parametrat më të larta të organizimit të një personaliteti. Qëndrueshmëria e forcave neutralizuese është kështuqësi thelbi i një OP të shëndetshëm dhe orientimi bihevioral pozitiv për liderin mësues. Me qëllimin e vet kryesor, lidërshipti transformues kërkon të përmirësojë performancën e ndjekësve të vet dhe të zhvillojë potencialet e tyre të plota (27). Kjo formë e lidërshiptit mund të përfshijet nga njerëzit që mbartin një sërë vlerash dhe ideale personale dhe mund të motivojnë të tjerët që të veprojnë në forma që mbështesin interesin e të gjithëve dhe jo vetëm të vetes (28). Promovimi i këtij stili të lidërshiptit nxit liderin mësues që të ndikojë në zbërthimin e kuptimit dhe konflikteve intra-psikike dhe në fuqizimin e potencialeve të brendshme të nxënësve si konsumatorë të dijes dhe zhvillimit të ardhëm.

Përfundime

Të dhëna të fundme argumentojnë se mësuesit zgjedhin të qëndrojnë në ato institucione arsimore që u ofrojnë mundësi të bashkëpunimit dhe lidërshiptit të bashkëndarë (29). Kërkuesit (30) kanë arsyetuar se kur mësuesit ndjehen të vlerësuar si pjesëmarrës në një komunitet koheziv dhe fuqizohen si vendimmarrës, ata e tejkalojnë këtë fuqizim të nxënësit dhe studentët e tyre duke u dhënë zë në vendimmarrje. Tanimë është argumentuar (31) se lidërshipti i suksesshëm në shkollë kërkon një shkallë të autonomisë administrative në vendimmarrje për elementët kryesorë të informacionit hyrës në procesin e mësimdhënies. Lidërshipti i mësuesit, pra, luan një rol të rëndësishëm në ndikimin e sjelljes kompiante për qëllim të nxitjes dhe progresionit të strukturave të mësimnxënies dhe edukimit me organizimin efektiv.

Referenca

1. Quaglio, G. P. "Leadership. Nuovi profili del leader per nuovi scenari organizzativi", 2005, Milano : Raffaello Cortino ed. 231-234.
2. Freud S., Introduzione alla psicoanalisi (nuova serie di lezioni), 1932., vol. 11, Boringhieri, Torino 1979, fq. 121-284.
3. Freud, A., Quattro conferenze di psicoanalisi per insegnanti e genitori. vol. 1, Boringhieri, 1930, Torino 1978, fq. 87-131, fq. 101.
4. McGregor, D. The human side of enterprise- Annotaded Edition, Botimi i parë. Mc-Graw Hill Education, 2002, 123-135.
5. Tannenbaum, A. S. Schmidt, W. H, " How to choose a leadership pattern", Harvard Business Review, 1958, 36, fq. 95-105.
6. Mumford MD, Zaccaro S, Harding F, Jacobs T, Fleischman EA. Leadership skills for a changing world: solving complex social problems. Leadership Quarterly, 2000, 11, fq. 11-35.
7. Dimmock, C. dhe Walker, A. . Educational leadership: Culture and diversity. Thousand Oaks, CA: Sage, 2005, 45-49.
8. Gonzales, L. D. Sustaining teacher leadership: Beyond the boundaries of an enabling school culture. Lanham, MD: University Press of America, 2004, 321-345.
9. Lieberman, A. dhe Miller, L. Teachers - transforming their world and their work. New York: Teachers College Press, 1999. 123-124.
10. Akerman, R., dhe McKenzie, S. V. Uncovering Teacher Leadership. Educational Leadership, 2006, 63, 24-99.
11. Glickman, C., Gordon, S. dhe Ross-Gordon, J. . Supervision and Instructional Leadership: A Developmental Approach. Boston, MA: Ally & Bacon, 2001, 232-235.
12. Ash, R. C. dhe Persall, J. M. The principal as chief learning officer: Developing teacher leaders. NASSP Bulletin, 2000, 84, 15-22.
13. Goleman, D. La pratica de Inteligencia Emocional, Botimi Spanjoll, Kairos, 1998, fq. 19
14. McGregor, D. The human side of enterprise- Annotaded Edition, 2006, Mc-Graw Hill Education, 236-238.
15. Le Blanc, L. A., Bruce, C. Laura, Heimberg, G. Richard, . Hope, A. D., Blanco, C., Schneier, R. Franklin, dhe Liebowitz, R. Michael Evaluation of Psychometric Properties of Two Short Forms of the Social Interaction Anxiety Scale and Social Phobia Scale, Assessment Journal Sage Publication, 2014, fq. 312-313.
16. Leithwood, K., Jantzi, D. dhe Steinbach, R. Changing Leadership for Changing Times, Buckingham: Open University Press, 1999, 453-457.
17. Getzel, J. W dhe Guba, E. G. Social Behavior and the Administrative Process. The school review, 1957, Vol. 65 Nr. 4, fq. 423-441.
18. Berne, E The Structure and Dynamics of Organizations and Groups. Philadelphia: Lippincott, 1963, 124.
19. Bass, B. M. . The ethics of transformational leadership. Gjendur në J. Ciulla (Ed.), Ethics: The heart of leadership, 1998, fq. 169-192. Westport, CT: Praeger.
20. Bass, B. M., dhe Avolio, B. J. . The implications of transactional and transformational leadership for individual, team, and organizational development. Research in Organizational Change and Development, 1990, 4, fq. 231-272.
21. Bass, B. M., dhe Steidlmeier, P. Ethics, character, and authentic transformational leadership behavior, Leadership Quarterly, 1999, 10 (2), fq. 181-217.
22. Howell, J. M., dhe Avolio, B. J. The ethics of charismatic leadership: Submission or liberation? Academy of Management Executive, 1992, 6 (2), fq. 43-54.
23. Stech EL. Psychodynamic approach. Gjendur në: Northouse P (ed.), Leadership: Theory and Practice. Thousand Oaks, CA: Sage, 2007, fq. 237-64.
24. Kriegel, U Subjective Consciousness A Self-Representational Theory Oxford University Press, 2009.
25. Cote, E. James dhe Schwartz, J. Seth Comparing psychological and

- sociological approaches to identity: identity status, identity capital, and the individualization process, *Journal of Adolescence*, 2002, 25, fq. 571-586.
26. Avolio, J. B., Walumbwa, O. Fred., Gardner, L. William, Wernsing, S. Tara, Petersson dhe J. Suzanne Authentic Leadership: Development and Validation of a Theory-Based Measure, *Journal of Management*, 2008, 34:1, fq. 89-126; Southern Management Association, SAGE Publications. <http://digitalcommons.unl.edu>
 27. Kurtines, W. M., Berman, S. L., Ittel, A. dhe Williamson, S. Moral development: a co-constructivist perspective. Gjendur në *Moral development: An introduction*, Kurtines, W. M. dhe Gewirtz, J. L (Eds). New York, Wiley, 1995, fq. 337-376.
 28. Harris, A., dhe Muijs, D. . Improving schools through teacher leadership. UK: MPG Books, Bodmin, Cornwall, 2005, 68-69.
 29. Kirkpatrick, S. A., dhe Locke, E. A. Leadership: Do traits matter? *The Executive*, 1991, 5, fq. 48-60.
 30. Kilcher, A. Becoming a change facilitator: The first-year experience of five teacher leaders. Gjendur në C. Livingston (Ed.), *Teachers as leaders evolving roles*, 1992, fq. 91-114. Washington, D. C: NEA Professional Library, National Education Association.
 31. Pont, B., Nusche, D. dhe Moorman, H. Improving School Leadership. Volumi 1: Policy and Practice, Directorate for Education . Education and Training Policy Division (OECD), 2008, 234-237.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

NDËSHKIMI FIZIK DHE NDIKIMI I TIJ NË SHFAQJEN E SJELLJEVE AGRESIVE TE FËMIJËT

Eglantina Dervishi*; Silva Ibrahimii** Valbona Habili/ Sauku*

*Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

** Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme, "Albanian University", Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: egladervishi@gmail.com

Përmbledhje

Fokusi i këtij studimi është eksplorimi i faktorëve që lidhen me ndëshkimin fizik prindëror dhe shfaqjen e agresivitetit të fëmijët në moshën shkollare. Studimi është realizuar në Tiranë dhe Durrës, me fëmijë të tetë shkollave fillore, gjithsej 830 fëmijë të grupmoshës 7 deri 11 vjeç.

Qëllimi ynë është evidentimi i dallimeve midis fëmijëve të ndëshkuar fizikisht dhe fëmijëve të pandëshkuar fizikisht në shfaqjen e agresivitetit në përgjithësi, identifikimin e formave të agresivitetit që shfaqin fëmijët e ndëshkuar fizikisht, identifikimin e dallimeve gjinore në shfaqjen e formave të agresivitetit të fëmijët e ndëshkuar fizikisht. U përdor pyetësori i agresivitetit (Direct and Indirect Aggression Scales (DIAS); Björkqvist, Lagerspetz, Österman, 1992) si dhe u hartuan 4 pyetje që merrnin informacion nga fëmija nëse ishin ndëshkuar apo jo nga prindërit përmes këtyre formave.

Rezultatet e studimit treguan se ekzistojnë dallime në shfaqjen e agresivitetit midis fëmijëve të ndëshkuar fizikisht dhe fëmijëve të pandëshkuar fizikisht, gjithashtu ekziston një tendencë që fëmijët e ndëshkuar fizikisht të shfaqin nivel më të lartë të agresivitetit direkt. Gjithashtu, dolën në pah gjetje edhe përsa u përket dallime gjinore në shfaqjen e formave të agresivitetit tek fëmijët e ndëshkuar fizikisht.

Konkluzionet paracaktojnë rolin e madh që luan faktori ndëshkim fizik në shfaqjen e sjelljeve agresive tek fëmijët. Në këtë kontekst, sigurisht që roli i modeleve prindërore dhe asaj që ata përçojnë tek fëmija, duhet të kihet në konsideratë nga figurat autoritare që janë në kontakt të përditshëm me fëmijën, qofshin këto prindërit apo mësuesit.

Fjalë çelës: *fëmijë, ndëshkim fizik, agresivitet, prindër.*

THE PHYSICAL PUNISHMENT AND ITS INFLUENCE IN THE EMERGING OF CHILDREN'S AGGRESSIVE BEHAVIORS

Abstract

The focus of the present study is the exploration of factors related to physical parental punishment and the display of aggression among school-age children. The study was conducted in Tirana and Durres with children of eight elementary schools, in a total of 830 children of the group-age 7 to 11 years old.

Our *aim* is : To identify the differences between physically punished children and physically non-punished children in the emergence of aggressiveness in general, identification of forms of aggression that exhibit the physically punished children, identification of gender differences in the manifestation of forms of aggression in physically punished children.

We used the Direct and Indirect Aggression Scales (DIAS), Björkqvist, Lagerspetz, Österman, 1992) and four questionnaires were designed to collect information from the child whether the parents were involved in these forms of punishment or not.

The *results* of the study showed that there are differences in the display of aggressiveness among physically punished children and physically non-punished children; there is also a tendency for physically punished children to exhibit a higher level of Direct Aggression. Findings also emerged in terms of gender differences in the appearance of aggressiveness in physically punished children.

Conclusions referred the great role played by the physical punitive factor in the emergence of aggressive behavior in children. In this context, of course, the role of parental patterns and what they transmit to the child should be taken into account by authoritarian figures who are in daily contact with the child whether parents or teachers.

Keywords: *children, physical punishment, aggressiveness, parents.*

Hyrje

Ndëshkimi fizik mbetet një nga problemet më të vështira për t'u menaxhuar nga strukturat dhe profesionistët e shëndetit mendor¹ që kanë në fokus të punës së tyre ndërhyrjet rehabilituese në moshë të hershme. Ndëshkimi fizik ose trupor përkufizohet si përdorimi i forcës me qëllim shkaktimin e dhimbjes², me synim korrigjimin e sjelljes. Midis kërkuesve është pranuar se është shumë e vështirë të bëhet dallimi midis ndëshkimit fizik dhe abuzimit, duke e parë shumë të vështirë ndarjen në një linjë të drejtë të konceptit të ndëshkimit fizik³ dhe abuzimit fizik.

Praktikat prindërore ndëshkuese⁴ dhe jo ndëshkuese ndryshojnë nga njëra tjetra nga mënyrat dhe shpeshësia e ndëshkimeve fizike tek fëmijët e tyre, si dhe në lidhje me arsyen e përdorimit të ndëshkimit me qëllim korrigjimin e sjelljes tek fëmijët apo jo. Prindërimi synon të pajisë fëmijën me moral të shëndoshë, të zhvillojë botën emocionale dhe ta ndihmojë të zhvillojë një koncept për veten që i lejon fëmijës të aftësohet për të marrë përgjegjësitë që i takojnë në një moshë të rritur. Përpjekjet prindërore në edukimin e fëmijës me kufijtë e asaj që është e përshtatshme dhe e papërshtatshme, e mirë dhe e keqe, nxisin instalimin e asaj që është etaloni vlerave, qëndrimeve dhe besimeve personale tek fëmija. Por janë këto elemente që bëhen pjesë e qenësishme e personaliteti që fëmija do të zhvillojë. Disiplina pozitive i ndihmon fëmijët që të kuptojnë se përse disa sjellje janë të papërshtatshme dhe pse disa janë të përshtatshme. Aktualisht përdoren dy teknika kryesore për disiplinimin pozitiv të fëmijëve në moshë më të vogël. E para është metoda “ushtrimi i forcës”, e cila nënkupton ndëshkrimin e fëmijës në çdo rast kur fëmija bën një sjellje të papërshtatshme⁵, ndërsa e dyta është “metoda induktive”, e cila nënkupton vendosjen e limiteve⁶, duke u shpjeguar pasojat logjike, duke arsyetuar dhe shpjeguar.⁷ Praktikat prindërore jo pozitive të cilat bazohen në përdorimin e formës së ndëshkimit fizik, sigurisht që kanë pasojat të rënda në ndërtimin e personalitetit të fëmijës, por edhe në shfaqjen tek fëmija në disa raste të problemeve të shëndetit mendor si rezultat i abuzimit fizik. Një element shumë i rëndësishëm në eksperiencën e rritjes së fëmijës është niveli i ekspozimit të fëmijës⁸ ndaj agresivitetit prindëror. Ky agresivitet

duket se është i vazhdueshëm dhe shpesh ndodh që fëmija e brendëson dhunën e pësuar⁹, duke tentuar që ta shfaqë atë së jashtmi kundrejt bashkëmoshatarëve të tij. Është pranuar gjerësisht se ndëshkimi fizik prindëror do ta udhëheqë fëmijën drejt sjelljeve të mëvonshme agresive¹⁰. Në mbështetje të rezultateve të përfituara nga ky drejtim sa i përket efekteve të ndëshkimeve fizike kundrejt fëmijëve¹¹, Shoqata Amerikane e Psikiatrisë kërkon të merren masa të rrepta edhe kundër ndëshkimeve fizike të fëmijëve në shkollë. Rezulton nga studime mbi fushën një lidhje midis ndëshkimit fizik dhe shfaqjes së sjelljeve agresive nga ana e fëmijës. Kjo tipologji merr dy forma të mundshme: Së pari është lidhja pozitive, lineare. Kjo lidhje është identifikuar nga përfundimet e arritura nëpërmjet studimeve të njëpasnjëshme^{12;13;14; 15;16} të cilat kanë të bëjnë me lidhjen e fortë pozitive që ekziston në mes të ndëshkimit fizik prindëror ndaj fëmijëve dhe niveleve të larta të agresivitetit të identifikuar në marrëdhëniet e mëvonshme të fëmijëve¹⁷, si dhe me sjelljen e tyre antisociale.

Së dyti grupi i dytë i kërkuesve^{18;19;20;21;22} kanë sugjeruar se prania e ndëshkimeve fizike të fëmijët mund të kontribuojë në rritjen e problemeve emocionale të fëmijët në një moshë më të vonë zhvillimore.²³

Metoda

Studimi është i tipit korrelacional eksplorues dhe u fokusua tek fëmijët e grupmoshës 7 – 11 vjeç. U përfshinë fëmijë të klasave të 2, 3, 4 dhe 5 përkatësisht në 4 shkolla të Tiranës dhe 3 shkolla të Durrësit. Kampioni përbëhet nga 830 subjekte, prej tyre 442 djem dhe 438 vajza. Përzgjedhja e fëmijëve është bërë sipas modelit të përzgjedhjes së numrave tek në renditje në regjistrin e notave, duke marrë për bazë vendin e shkollën dhe moshën e fëmijës. Është përdorur instrumenti për matjen e agresiviteti fizik dhe verbal (Direct Indirect Aggression Scales (DIAS), Björkqvist et al., 1992), i përbërë nga 24 pohime që masin nivelin e agresivitetit fizik dhe verbal. Shkalla e DAS është përdorur në cilësinë e vetëraportimit. Është përdorur edhe një pyetësor me katër pohime i hartuar për qëllime të mbledhjes së të dhënave në lidhje identifikimin e fëmijëve të ndëshkuar fizikisht dhe të pandëshkuar nga prindërit. Analiza e të dhënave u realizua përmes metodës SPSS.18. Duke u fokusuar në përlllogaritjen e koeficienti Cronbach's Alpha, që rezultoi në vlerat më të mëdha se 0.9 si për pyetësorin total edhe për nënshkallët. Analiza deskriptive dhe korrelacione u kryen me qëllim vërtetimin e hipotezave tona.

Rezultatet

Nga subjektet e përfshira në studim rreth 53 %e tyre i përkasin grupmoshës 7-9 vjeç dhe 47% i përkasin grupmoshës 10-11 vjeç.

Tabela 1. Paraqitja e të dhënave sipas moshës dhe gjinisë (N=830)

Gjinia * Grupmosha krostabe					
7-9 vjeç			Grupmosha		Totali
10-11 vjeç					
Gjinia	Vajzë	numri	330	108	438
		% Gjinia	60,5%	39,5%	100,0%
	Djalë	Numri	160	282	442
		% Gjinia	46,7%	53,3%	100,0%

Duke iu referuar të dhënave nga analiza deskriptive përse i përket shfaqjes së agresivitetit fizik dhe verbal, fëmijët paraqiten në një nivel të moderuar të tij. Kjo sigurisht që na jep informacion për përdorimin e formave agresive në ndërveprimet sociale midis fëmijëve.

Tabela 2. Niveli i përgjithshëm i agresiviteti tek fëmijët

Statistikat deskriptive					
	N	Minimum	Maksimum	Mesatarja	Devijimi Standard
AGRESIVITETI	830	,31	4,03	1,8784	,75978
Numri total	830				

Duke iu referuar të dhënave në lidhje me nivelin e agresivitetit fizik, duket se ky nivel te subjektet e marra në shqyrtim paraqesin pranimë e një niveli të moderuar të tij (mesatarja = 1.8237), pra fëmijët kanë shfaqje të agresivitetit fizik, ndërsa përse i përket agresivitetit verbal paraqiten në nivele më të larta (mesatarja = 2.354). Rezulton se agresiviteti në total është në një nivel të moderuar, ka disa dallime përse i përket atij fizik dhe verbal te fëmijët e grupmoshës shkollore. Ndërsa përse i përket dallimeve midis agresivitetit direkt (mesatarja = 1,7129) dhe indirekt (mesatarja = 1,2440) ky i fundit paraqitet në nivele më të ulëta. Në përgjithësi, duket se fëmijët shfaqin nivele jo problematike të agresivitetit të tyre. Ata janë të moderuar në shfaqjen e agresiviteti. Gjithsesi, vihen re dallime në tendencat për të përdorur më tepër një lloj agresiviteti se sa një tjetër. Më shpesh fëmijët shfaqin agresivitet të llojit direkt/verbal, në nivele të moderuara paraqitet edhe agresivitet direkt/fizik, dhe mesataren më të ulët prezanton agresivitetin indirekt/fizik.

Tabela 3. Statistikat përshkruese midis fëmijëve të ndëshkuar fizikisht dhe fëmijëve të pandëshkuar fizikisht në shfaqjen e agresivitetit të përgjithshëm

Statistika Përshkruese						
A ju kanë rrahur prindërit tuaj kur keni bërë ndonjë gabim?		N	Minimum	Maksimum	Mean	Std. Deviation
Po	AGRESIVITETI	452	1,17	3,04	1,9888	,44289
	Valid N =830	452				
Jo	AGRESIVITETI	431	,21	1,54	,6223	,27970
	N =830	431				

Në të dhënat e mësipërme del në pah se mesatarja e nivelit të përgjithshëm të agresivitetit të shfaqur nga fëmijët të cilët janë ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre është (mean=1.9888) dhe ajo e fëmijëve që nuk janë ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre është (mean = 0.6223). Këto të dhëna tregojnë se fëmijët e ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre shfaqin nivele të moderuara të agresivitetit ndaj të tjerëve, ndërsa ata që nuk janë ndëshkuar nga prindërit shfaqin nivele të ulëta të agresivitetit. Duke interpretuar edhe vlerat minimale dhe maksimale të agresivitetit të fëmijëve, vihet re se fëmijët që janë ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre shfaqin nivele të ulëta të agresivitetit, të moderuara dhe të larta, pavarësisht se në mesatare niveli i tyre i agresiviteti është i moderuar. Ndërsa tek fëmijët e pandëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre ka fëmijë që shfaqin

nivele shumë të ulëta të agresivitetit dhe disa të tjerë nivele të moderuara, por asnjë prej tyre nuk shfaq nivele të larta të agresivitetit.

Ajo çfarë bie në sy janë dhe forma e agresiviteti që shfaqen më tipikisht nga fëmijët e ndëshkuar fizikisht, që tregojnë se niveli i përgjithshëm i agresivitetit të fëmijët e ndëshkuar fizikisht është i moderuar (mean = 1.9888). Ky nivel i moderuar shfaqet edhe në llojet specifike të agresivitetit, atij direkt (mean = 2.4151) dhe atij indirekt (mean = 1.5626). ($1.33 < \text{mesatarja} < 2.67$). Megjithatë vihet re një tendencë për të shfaqur në nivele më të larta agresivitetin direkt se sa atë indirekt. Ndërkohë tek fëmijët e pandëshkuar fizikisht nga prindërit si agresiviteti i përgjithshëm (mean = 0.6223), ashtu edhe dy format specifike të agresivitetit, ai direkt (mean = 0.5349) dhe indirekt (mean = 0.7097) shfaqen në nivele mjaft të ulëta. (mesatarja –mean- e secilës < 1.33).

Përsa i përket agresivitetit, si vajzat dhe djemtë e ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre shfaqin në përgjithësi nivele të moderuara të agresivitetit. Megjithatë, vihet re një nivel paska më i lartë i agresivitetit të djemtë (mean = 2.0768) sesa tek vajzat (mean = 1.8479). Vajzat e ndëshkuara fizikisht nga prindërit e tyre shfaqin nivele të moderuara si të agresivitetit direkt ashtu edhe të atij indirekt, megjithatë agresiviteti direkt (mean = 2.0750) është më i lartë se sa agresiviteti indirekt (mean = 1.62).

Djemtë e ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre shfaqin nivele të moderuara si të agresivitetit direkt, ashtu edhe të atij indirekt, megjithatë agresiviteti direkt (mean = 2.6267) është më i lartë se sa agresiviteti indirekt (mean = 1.52). Megjithatë kur i referohemi interpretimit të pikëve mesatare mbi nivelin e agresiviteti vlera ($1.33 < \text{man} < 2.68$) tregojnë nivel të moderuar të agresivitetit, vihet re se niveli i agresivitetit direkt (mean = 2.6267) të djemtë që janë ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre, është në kufijtë e sipërme të kësaj fushe (1.34 deri 1.67). Pra djemtë e ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre shfaqin një nivel të moderuar agresiviteti direkt me tendencë për t'u bërë i lartë.

Kur krahasohet niveli i agresivitetit direkt mes vajzave dhe djemve të ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre, vihet re një dallim më i lartë në vlerat mesatare përkatëse sipas gjinisë. Vajzat shfaqin nivele të moderuara të agresivitetit direkt (mean = 2.0750), ndërsa djemtë nivele gati të larta të agresivitetit direkt (mean = 2.6276). Duke u nisur nga ky shkak, u vendos të analizohej më tej ky variabël. Duke iu referuar shkallës matëse të përdorur në këtë studim, rikujtojmë se agresiviteti direkt përbëhet nga dy nënshkallë: agresiviteti fizik dhe agresiviteti verbal. Nga analiza deskriptive e llojeve të agresivitetit direkt fizik dhe verbal sipas gjinisë për fëmijët të cilët janë ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre. Për vajzat e ndëshkuara fizikisht nga prindërit evidentohet një nivel i moderuar i agresivitetit direkt fizik. Ndërsa niveli i agresivitetit direkt verbal është gati i lartë (man=2.67). Për djemtë e ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre evidentohet një nivel i moderuar i agresivitetit direkt fizik. Ndërsa agresiviteti direkt verbal është i lartë. Agresiviteti direkt fizik i shfaqur nga vajzat dhe djemtë të ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre në përgjithësi është i moderuar. Megjithatë djemtë (mean=2.433) shfaqin më tepër agresivitet direkt fizik sesa vajzat (mean = 1.65). Agresiviteti direkt verbal i shfaqur nga vajzat edhe djemtë e ndëshkuar fizikisht është në përgjithësi i lartë. Megjithatë vajzat më tepër shfaqin kryesisht nivel të moderuar të agresivitetit direkt verbal me tendencë për të qenë i lartë (mean = 2.67), ndërsa djemtë shfaqin në përgjithësi nivel të lartë të agresivitetit direkt verbal (mean= 2.9). Diferenca mes djemve dhe vajzave të ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre për sa i përket agresivitetit direkt fizik është: $2.433 - 1.65 = 0.783$. Diferenca mes djemve dhe vajzave të ndëshkuara fizikisht nga prindërit e tyre për sa i përket agresivitetit direkt verbal është $2.9 - 2.67 = 0.23$. Këto të dhëna tregojnë se djemtë janë më të prirur për të shfaqur nivele më të larta të agresivitetit direkt si fizik, ashtu edhe verbal krahasuar me vajzat. Megjithatë, duke parë se diferenca për sa i përket nivelit të agresivitetit direkt

verbal është e vogël, atëherë lind pyetja nëse kjo diferencë është statistikisht e rëndësishme apo thjesht rastësore. Për këtë arsye u vendos të përdorej përsëri testi statistikor jo parametrik (Mann-Whitney test). Përsa i përket diferencave gjinore në nivelin e agresivitetit direkt verbal $\text{Sig} = 0.188 > 0.05$, atëherë mund të themi se nuk ka diferencë përsa i përket shfaqjes së agresivitetit direkt verbal për dy gjinitë. Ndërsa në lidhje me dallimet gjinore në shfaqjen e agresivitetit direkt fizik $\text{Sig} = 0.000 < 0.05$, ka një diferencë të rëndësishme statistikore mes nivele të shfaqjes së agresivitetit direkt fizik mes djemve dhe vajzave që janë ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre. Djemtë e ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre kanë tendencë të shfaqin më tepër agresiviteti direkt fizik sesa vajzat e ndëshkuara fizikisht nga prindërit e tyre.

Përfundime

Referuar rezultateve të studimit mund të arrijmë në përfundimet se fëmijët që morën pjesë në studim shfaqën një nivel të moderuar agresiviteti, ky i orientuar përmes dy formave tipike atij direkt dhe indirekt. Agresiviteti fizik dhe verbal ishte në një nivel mesatar, por ka një tendencë të fëmijëve për t'u orientuar më tepër rreth agresivitetit direkt verbal sesa agresivitetit direkt fizik. Nisur nga variabëli tjetër i rëndësishëm i marrë në shqyrtim, ndëshkimi fizik, del në pah se fëmijët që nuk janë ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre shfaqin një nivel të ulët të agresivitetit, ndërsa ato që janë ndëshkuar fizikisht shfaqin një nivel të moderuar të agresivitetit. Referuar formave më tipike të shfaqjes së repertorit të sjelljeve agresive tek fëmijët e ndëshkuar fizikisht duket se agresiviteti direkt është në nivele më të larta dhe indirekt është në nivele të moderuara. Më shumë se gjysma e fëmijëve pjesëmarrës në këtë studim (62,7%) raportojnë se prindërit e tyre kanë ushtruar ndëshkim fizik ndaj tyre kur kanë bërë ndonjë gabim. Nga studimi del se janë më tepër djemtë ata që ndëshkohen fizikisht nga prindërit e tyre. Kështu nga gjithë vajzat e këtij studimi gjati gjysma (52,6%) e tyre pohuan se ishin ndëshkuar fizikisht nga prindërit e tyre, dhe shumë me tepër se gjysma e djemve (71,1%) raportuan të njëjtën gjë. Ushtruesit kryesorë të ndëshkimit fizik te fëmijët janë nënat (69.2%). Pavarësisht gjinisë së vetë fëmijës, ndëshkimin fizik e ushtron më tepër nëna (65.6%) sesa babai (34.4%). Referuar këtyre përfundimeve, është e rëndësishme të ndërgjegjësohemi në lidhje më mënyrën sesi fëmijët synojnë të projektojnë përvojat e tyre në të gjitha marrëdhëniet sociale e emocionale në të cilat ata përfshihen (Vygotsky, 1978). Niveli i ekspozimit të fëmijës ndaj agresivitetit prindërorë nxit fëmijën të brendësojë atë që përjeton, në raport me të tjerët. Kështu, agresiviteti i shfaqur te fëmijët në moshë shkollore derivon nga niveli i agresivitetit të pësuar nga prindërit, i tillë si agresiviteti direkt.

Referenca

(Endnotes)

- 1 Action for Children and Youth Aotearoa. Children and Youth in Aotearoa 2003: The Second Non-Governmental Organisations' Report from Aotearoa New Zealand to the United Nations Committee on the Rights of the Child, Action for Children and Youth Aotearoa, Wellington (2003), 245-256.
- 2 Keenan, K., & Shaw, D. Developmental and social influences on young girls' early problem behaviors. *Psychological Bulletin*, 121, (1997) 95–113.
- 3 Baumrind, D., R. E. Larzelere and P. A. Cowan. "Ordinary physical punishment: Is it harmful? Comment on Gershoff (2002)" *Psychological Bulletin*, 128(4): (2002) 580–589.
- 4 Baruah, Kausik. A Comparison of Emotional Verbal, Physical Social and Destructive Modes of Aggression among Tribal and Non-Tribal Young Adults of Assam *International Journal of Scientific Research*

- and Management (IJSRM), Volume 5, Issue, 02, (2017) 5129-5138.
- 5 Keenan, K., & Wakschlag, L. S. More than the terrible twos: The nature and severity of behavior problems in clinic-referred preschool children. *Journal of Abnormal Child Psychology*, 28, (2000) 33–46.
 - 6 Keenan, K., & Shaw, D. S. The development of aggression in toddlers: A study of low-income families. *Journal of Abnormal Child Psychology*, 22, . (1994) 53–77.
 - 7 Jones, B. L., Nagin, D. S., & Roeder, K. (2001). A SAS procedure based on mixture models for estimating developmental trajectories. *Sociological Methods and Research*, 29, 374–393.
 - 8 Johnson, J. G., Cohen, P., Smailes, E. M., Kasen, S., & Brook, J. S. Television viewing and aggressive behavior during adolescence and adulthood. *Science*, 295, (2002). 2468–2471.
 - 9 Allen, E. S., Atkins, D. C., Baucom, D. H., Snyder, D. K., Gordon, K. C., & Glass, S. P. Intrapersonal, interpersonal, and contextual factors in engaging in and responding to extramarital involvement. *Clinical Psychology: Science and Practice*, 12, (2005). 101-130.
 - 10 Ang, R., & Goh, D. Cyber bullying among adolescents: The role of affective and cognitive empathy and gender. *Child psychiatry Human Development*, 41, (2010) 387-397.
 - 11 Allen, K. Off the radar and ubiquitous: text messaging and its relationship to 'drama' and cyber bullying in an affluent, academically rigorous us high school. *Journal of Youth Studies*, 15(1). (2011). 99-117.
 - 12 Grogan-Kaylor, A. "The effect of corporal punishment on antisocial behavior in children" *Social Work Research*, 28(3): (2004) 153–164.
 - 13 Holden, G.W. "Perspectives on the effects of corporal punishment: Comment on Gershoff" *Psychological Bulletin*, 128(4): (2002) 590–595.
 - 14 Gershoff, E.T. "Corporal punishment by parents and associated child behaviors and experiences: A meta-analytic and theoretical review" *Psychological Bulletin*, 128(4): (2002a) 539–579.
 - 15 Gershoff, E.T. "Corporal punishment, physical abuse, and the burden of proof:" *Psychological Bulletin*, 128(4): (2002) 602–611.
 - 16 Deater-Deckard, K. and K.A. Dodge. "Externalising behavior problems and discipline revisited: Nonlinear effects and variation by culture, context and gender" *Psychological Inquiry*, 8(3): (1997) 161–175.
 - 17 Horn, I.B., J.G. Joseph and T.L. Cheng "Nonabusive physical punishment and child behaviour among African-American Children" *Journal of the National Medical Association*, 96 (9): (2004) 1162–1168.
 - 18 Ahmed, R., & Haque, M. E. A comparative study in aggression between adolescent boys and girls of tribal and nontribal students in Chitagong Hill Tracts. *Journal of Life and Earth Science*, 2(2), (2007). 79-84.
 - 19 Crick, N. R., Grotpeter, J.K., Bigbee, M.A. Relationally and physically aggressive children's intent attributions and feeling of distress for relational and instrumental peer provocations. *Child Development*, 73. 4. (2002). 1134-1142.
 - 20 Coyle, D.D., L.A. Roggman and L.A. Newland "Stress, maternal depression, and negative mother–infant interactions in relation to infant attachment" *Infant Mental Health Journal*, 23(1–2): (2002) 145–163.
 - 21 Jester, J.M., M. Muzik, R. Berube, S. Narnag, B. Tuttle and J. Jacobson . "How do maternal reasoning and physical punishment contribute to development of verbal competence and behavior problems?" presented at the Society for Research in Child Development Biennial meeting, Albuquerque, New Mexico, (1999) , 203-234.
 - 22 Grusec, J.E. and J.J. Goodnow. "Impact of parental discipline methods on the child's internalization of values: A reconceptualization of current points of view" *Developmental Psychology*, 30(1): (1994) 4–19.
 - 23 NICHD Early Child Care Research Network. Trajectories of physical aggression from toddlerhood to middle childhood. *Monographs of the Society for Research in Child Development*. Serial No. 278, Vol. (2004). 69, 4.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

MBROJTJA SPECIALE PËR TË MITURIT DHE GRATË SHTATZËNË NË PUNË

Enea Sheqi

Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës

Adresë kontakti: enea.sheqi@yahoo.com

Përmbledhje

Objektivi: Objektivi i këtij artikulli është trajtimi në mënyrë të detajuar dhe shpjegimi i mbrojtjes së kategorisë së veçantë të punëmarrësve gjatë marrëdhënies së punës. Kështu kjo trajtesë ofron një panoramë të kuadrit ligjor shqiptar të rregullave që ofrojnë sigurinë dhe shëndetin në punë në kuadrin e një perspektive ndërkombëtare dhe europiane.

Metoda: Metodologjia që është përdorur për të ndërtuar këtë artikull i përshtatet nevojave të studimit. Në këtë mënyrë është analizuar në mënyrë të detajuar legjislacioni shqiptar i punës si dhe praktika gjyqësore shqiptare e ndërthurur me doktrinën juridike.

Rezultatet: Artikulli paraqet gjetje të rëndësishme që tregojnë përparimin e legjislacionit shqiptar me qëllim luftimin e informalitetit në marrëdhënien e punës. Gjithashtu, në të paraqitet situata aktuale e punës së të miturve dhe grave shtatzëna në Shqipëri, duke synuar t'i japë fokusin e duhur rëndësisë së mbrojtjes së kësaj kategorie.

Përfundimet: Në përfundim të trajtimit u vu re se në Shqipëri legjislacioni është i përqasur me Direktivat e Bashkimit Europian dhe Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Nevojitet që të synohet një bashkëpunim më i gjerë institucional për të ofruar një mbrojtje maksimale të të rinjve dhe grave shtatzëna në punë.

Fjalë çelës: *kodi i punës, kategori të veçanta, siguria në punë, parandalim.*

SPECIAL PROTECTION FOR MINORS AND PREGNANT WOMEN IN WORK ENVIRONMENT

Abstract

Objective: The objective of this article is to treat in a detailed way and to explain the protection of a particular category of employees during the employment relations. Thus, this paper provides an overview of the Albanian legal framework that offer safety and health at work, in the framework of an international and European perspective.

Method: The methodology used to build this article fits the needs of the study. In this way, the Albanian labour legislation and the Albanian judicial practice combined with the juridical doctrine have been thoroughly analyzed.

Results: The article represents an important finding that shows the progress of Albanian

legislation in order to combat informality in labour relations. Also, the current situation of minors and pregnant women in Albania is presented, aiming to give proper focus to the importance of protecting this category.

Conclusions: At the end, it was noted that in Albania the legislation is in line with the European Union Directives and the Conventions of the International Labour Organization. Wider institutional cooperation is needed to provide maximum protection for young people and pregnant women at work.

Keywords: *labor Code, special categories, safety at work, prevention.*

I. Hyrje

Disa kategori të veçanta të punëmarrësve gëzojnë një mbrojtje ligjore speciale, nisur kjo nga vetë fakti se këto kategori përbëjnë një interes më të lartë për t'u mbrojtur, por edhe për shkak të kushteve specifike në të cilën ata ndodhen. Mbrojtja e tyre ligjore është e sanksionuar që në Kushtetutë duke përcaktuar se fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti (1). Këto parime kushtetuese janë të inkorporuara mjaft mirë dhe në Kodin e Punës, ku i kushtohet një kapitull mbrojtjes së të miturve dhe grave (2).

Kodi i Punës e ndan kategorinë e mësipërme në dy pjesë, ku në pjesën e parë i kushtohet një trajtim mbrojtjes së të miturve në punë dhe në pjesën e dytë mbrojtjes së grave në punësim. Duhet të përcaktohet se Kodi i Punës nuk është i vetmi kuadër rregullues i këtij problem, por në sinkron me të janë nxjerrë shumë akte me karakter nënligjor për të siguruar një zbatim të plotë dhe rigoroz të standardeve të përcaktuara në këtë kod. Mbrojtja e të miturve ndodh për arsye të mirëkuptuara, si për shkak të moshës së tyre ata kanë nevojë që të marrin arsimin e nevojshëm bazë, të kryejnë veprimtari argëtuese, si dhe të kenë një zhvillim shëndetësor e moral të plotë. Nga ana tjetër, mbrojtja e grave shtatzëna ndodh për të ruajtur shëndetin e nënës dhe fëmijës, por edhe për shkak të vetë statusit të veçantë biologjik që ka kjo kategori. Ndërkombëtarizimi i marrëdhënieve juridike të punës ndihmoi në vendosjen e standardeve dhe marrjen e masave efektive në këtë drejtim. Kështu, disa akte me karakter ndërkombëtar janë miratuar nga ana e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) me qëllim një mbrojtje më efektive ligjore të kësaj kategorie të punësuarish. Ndalimi i punës së fëmijëve përbën një ndër të parat masa të nxjerra në mbrojtje të punëmarrësve në legjislacionet kombëtare dhe ndërkombëtare. Standardet ndërkombëtare të vendosura nëpërmjet ONP-së përcaktojnë si moshën minimale të punësimit atë 15-vjeçare, por rekomandimet e fundit synojnë të nxisin shtetet që të përcaktojnë moshë minimale atë 16-vjeçare. Nga ana tjetër, për të mbrojtur punonjësit me përgjegjësi familjare, që në këtë rast janë gratë shtatzëna dhe nënat e reja, hapat e para legjislative kanë qenë ndalimi i punësimit natën, mosdiskriminimi për shkak të shtatëzanisë, rikthimi në vendin e mëparshëm të punës, apo dhe marrja e lejes prindërore për fëmijët e lindur apo të birësuar.

Bashkëpunimi i domosdoshëm duhet të ekzistojë në marrëdhëniet ndërmjet pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv, ku në këtë funksion një rol të rëndësishëm kryen dhe Këshilli i Ministrave. Këto akte shërbejnë për të rregulluar në mënyrë më të plotë dhe të qartë mbrojtjen e interesave ligjore të të miturve. Në këtë kuadër, VKM-të (4) luajnë një rol të rëndësishëm, duke specifikuar natyrën e shumë punëve dhe të drejtat e detyrimit e subjeteve të marrëdhënies së punës.

II. Mbrojtja e të miturve në punë

Fëmijët gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti. Kjo mbrojtje është një angazhim i sanksionuar në Kushtetutë në nenin 54 të saj. Kështu, në këtë nen deklarohet se fëmijët janë të mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij normal (5). Fëmijët janë subjektet më të prekura gjatë marrëdhënies së punës dhe për këtë arsye duhet që t'u përcaktohen rregulla të veçanta, të cilat duhet që t'u përshtaten atyre. Arsyet janë të kuptueshme dhe në çdo rast synohet që t'u garantohen një sërë të drejtash.

Mbrojtja e të miturve duhet që të jetë gjithmonë edhe në përputhje me politikat dhe drejtimit e shtetit, në mënyrë që t'i përfshijë sa më shumë ata në shoqëri. Edhe pse *a priori* neni 59 i Kushtetutës nuk është detyrues, pra përcakton vetëm disa nga objektivat sociale të shtetit, ai duhet që të jetë një gur themeli për të synuar drejtësinë sociale. Kështu në këtë nen sanksionohet se objektivi social nuk përbën vetëm zënia me punë e të gjithë personave të aftë për punë, por edhe arsimimin dhe kualifikimin sipas aftësive të fëmijëve dhe të të rinjve (6). Gjithashtu e rëndësishme është edhe përkujdesja ndaj kësaj kategorie të veçantë jo vetëm në insitucionet shtetërore, por dhe në ato private, të cilat kurdoherë duhet që të jenë në përputhje me interesin më të lartë të të miturit (7).

Në Kodin e Punës (8), në një kre të veçantë janë parashikuar dispozita të caktuara për të realizuar një mbrojtje sa më eficiente ndaj kësaj kategorie. Synimi i ligjit *ratio legis* ka qenë që të arrijë një mbrojtje maksimale të të drejtave të njeriut, por dhe të jetë në përputhje me interesin më të lartë të të miturit, pa e dëmtuar atë nga ana shëndetsore apo nga të drejtat për të marrë pjesë në veprimtari shoqërore e për të ndjekur arsimin përkatës.

Për sa u përket të miturve, përcaktohet se mosha minimale për të realizuar një marrëdhënie pune është mosha 16 vjeç. Sipas përcaktimeve të Kodit të Punës, fëmijët quhen të gjithë ata persona që nuk kanë fituar zotësinë e plotë për të vepruar (9). Pra siç shihet qartë, mosha për të fituar zotësinë e plotë për të vepruar nuk përkon me moshën për të fituar zotësinë për të realizuar një marrëdhënie pune. Mosha për të fituar zotësinë e plotë për të vepruar është mosha 18-vjeçare (10), ku subjekti mund të lidhë ndryshojë apo të shuajë marrëdhënie të ndryshme juridike civile. Arsyja e vendosjes së një kriteri të tillë është dhe fakti se në këtë moshë fëmijët arrijnë një pjekuri më të lartë edhe për t'u përjasur me standardet europiane dhe ndërkombëtare (11). Vendimi i Këshillit të Ministrave Për Mbrojtjen e Fëmijëve në Punë bën edhe një përcaktim se kush do të quhet adoloshent, duke i përcaktuar ata si çdo fëmijë nga 16 deri në 18 vjeç, i cili nuk është më subjekti i arsimimit të detyrueshëm me kohë të plotë (12).

Por duhet të përcaktohet gjithashtu edhe fakti se fëmijët që janë ndërmjet moshës 15 – 16 vjeç mund të kryejnë punë të lehta vetëm gjatë pushimeve shkollore dhe kjo nuk është e ndaluar, por pa i dëmtuar atyre shëndetin dhe formimin. Në rastin e një punësimi të tillë duhet që të merret një autorizim i posaçëm nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Punës. Ky parashikim është edhe në përputhje me konventat ndërkombëtare të cilat përcaktojnë se mosha minimale për t'u përfshirë në një marrëdhënie pune është mosha 15 vjeç, duke iu përshtatur kështu edhe zhvillimit të të miturve (13).

Për të treguar se cila do të ishte natyra e një pune të lehtë, e rëndësishme do të ishte dhe përkufizimi i këtij termi. Në nenin 99 të kodit përcaktohet se punë e lehtë do të quhet çdo punë që për shkak të natyrës së pandashme të detyrave dhe kushteve të veçanta në të cilën kryhet ajo, nuk çënon sigurinë, shëndetin e fëmijëve, apo zhvillimin e tyre, si dhe pjesmarrjen e tyre në shkollë, programe profesionale dhe trajnuese të miratuara nga institucionet përgjegjëse dhe zotësinë e fëmijëve për të

përfitur nga ky trajnim.

Nga ana tjetër, do të na duhet të përcaktojmë edhe punët e vështira, por edhe se kush janë subjektet që do të mund të ushtrojnë këto punë. Sipas Kodit të Punës vetëm personat madhorë mund të kryejnë punë të vështira apo që paraqesin rrezik për shëndetin dhe personalitetin e tyre. Pra vetëm personat që kanë fituar zotësinë e plotë për të vepruar.

Gjithashtu, roli i rëndësishëm i pushtetit ekzekutiv paraqitet edhe në këtë pjesë, ku nevojiten aktet nënligjore përkatëse për të përcaktuar se kush do të quhet punë e vështirë apo e rrezikshme, si dhe kushtet e ushtrimit të tyre (14). Kështu, fëmijët mund të punësohen vetëm në punë që nuk janë të vështira, i përshtaten moshës së tyre, dhe kushtet e punës janë të lehta. Punëdhënësi nuk i propozon atyre asnjë punë e cila ka një natyrë që mund të dëmtojë shëndetin e tyre apo zhvillimin e tyre fizik, psikologjik, social, moral apo të komprometojë shkollimin e tyre. Punësimi i fëmijve ndalohe kur:

- a) objektivisht shkon përtej kapacitetit të tyre fizik ose mendor;
- b) përfshin ekspozim ndaj agjentëve të cilët janë toksikë ose kancerogjenë, shkaktojnë dëmtime gjenetike të trashëgueshme apo dëmtime të cilat kanë efekte negative dhe shkaktojnë dëmtime kronike tek shëndeti gjatë gjithë jetës;
- c) përfshin ekspozim ndaj rrezatimeve të dëmshme, përfshirë rrezatimin jonizues dhe jojonizues; ç) përfshin rrezikun e aksidenteve të cilat mund të parashikohen se mund të ndodhin, por të cilat nuk mund të njihen apo të shmangen nga fëmijët, për shkak të vëmendjes së tyre të pamjaftueshme ndaj sigurisë apo mungesës së përvojës në punë apo formimit.
- d) përbën një risk për shëndetin, për shkak të kushteve të motit, si i ftohti apo i nxehti ekstrem si dhe zhurmës e dridhjeve.

Gjithashtu, ndalohen punët të cilat mund t'i sjellin rreziqe të veçanta fëmijve apo që përfshijnë ekspozim të dëmshëm ndaj agjentëve fizikë, biologjikë dhe kimikë në kushtet e sipërpërmendura (15).

Edhe puna e natës është e ndaluar për personat të cilët nuk kanë mbushur moshën madhore sipas përcaktimeve të nenit 101 të Kodit të Punës, por edhe një kategori tjetër e ka të ndaluar ushtrimin e punës të natës që janë të gjithë personat që janë shpallur invalidë dhe përfitojnë nga sigurimet shoqërore. Ndalimi i punës së natës për të miturit është i rëndësishëm, pasi në këtë mënyrë të miturve u shmanget rreziku për të rënë pre e abuzimeve të ndryshme, por edhe të mos dëmtohen nga rreziqe të ndryshme sociale, siç janë vjedhjet, vrasjet, përdhunimet etj.

Gjithashtu, të miturit duhet t'i nënshtrohen edhe një kontrolli mjekësor të plotë për të përcaktuar nëse ata janë të aftë apo jo për punë, duke iu nënshtuar në këtë mënyrë rregullave të veçanta që rregullojnë procedurën e kontrollit mjekësor, ku detyrimet e shpenzimeve mjekësore paguhën nga ana e punëdhënësit (16). Përpara se i mituri të hyjë në marrëdhënien e punës, ai duhet që t'i dorëzojë punëdhënësit një raport mjekoligjor, i cili e deklaron atë të aftë për punë. Ndaj fëmijëve punëmarrësi duhet që të vazhdojë në mënyrë periodike kontrollet mjekësore, si dhe të evidentohen në kartelën mjekësore, e më pas t'i bëhen të ditura edhe përfaqësuesve ligjorë të fëmijve.

Punëdhënësi ka për detyrë që të shohë dhe të evidentojë të gjitha rreziqet e mundshme që mund të shfaqen gjatë punës. Pasi i ka evidentuar këto risqe, ai duhet që të parandalojë çdo dëmtim të mundshëm të fëmijës, duke i siguruar atij mbrojtjen dhe shëndetin në punë. Kështu ai duhet që të ndërmarrë masa për të monitoruar dhe planifikuar mbrojtjen dhe sigurinë në punë. Ai duhet që të informojë fëmijët për të gjitha risqet e mundshme, si dhe duhet që t'u ofrojë atyre trajnim të vazhdueshëm për të mbrojtur shëndetin e tyre. Në rastet kur në punë shfaqen rreziqe të caktuara, ai

duhet që të informojë edhe përfaqësuesit ligjorë të fëmijëve, në mënyrë që mbrojtja për të miturit në punë të jetë e gjithanshme (17).

Koha e punës për të personat të cilët nuk kanë mbushur moshën madhore, pra atë 18 vjeç, nuk mund të jetë më shumë sesa 6 orë në ditë sipas Kodit të Punës (18). Në VKM bëhet edhe një rregullim më specifik duke përcaktuar se koha e punës për adoleshentët është e kufizuar:

- a) Deri 6 orë në ditë dhe 30 orë në javë, për punën e kryer në kuadrin e një sistemi formimi në ndërmarrje, në bazë të një skeme të kombinuar të punës/trajnitimit;
- b) Deri 2 orë në një ditë shkolle dhe 12 orë në javë, për punën e kryer në periudhën jashtë orëve të përcaktuara për ndjekjen e shkollës; Në asnjë rrethanë, koha ditore e punës nuk mund të tejkalojë 7 orë. Ky kufi mund të ngrihet në 8 orë në rastin e fëmijëve që kanë mbushur moshën 16 vjeç;
- c) Deri 6 orë në ditë dhe 30 orë në javë, për punën e kryer gjatë një periudhe prej të paktën një jave, kur shkolla nuk është në proces;
- d) Deri 6 orë në ditë dhe 30 orë në javë, për punën e lehtë të kryer nga fëmijët që nuk janë më subjekte të shkollimit të detyrueshëm me kohë të plotë.

Koha e shpenzuar për formimin nga një fëmijë që punon në kuadrin e një sistemi formimi në ndërmarrje, në bazë të një skeme të kombinuar të punës/trajnitimit, do të llogaritet si kohë pune. Në rastet kur një fëmijë punësohet nga më shumë se një punëdhënësi, ditët e punës dhe koha e punës janë kumulative (19).

Për sa i përket fëmijëve nën 15 vjeç, koha maksimale e punës për një fëmijë që nuk e ndjek arsimin e detyrueshëm nuk duhet të tejkalojë 2 orë në një periudhë prej 24 orësh, dhe 10 orë në një periudhë 7 ditore në total. Ndërsa për fëmijët të cilët janë në ndjekje të arsimit të detyrueshëm, koha maksimale e punës nuk tejkalon:

- a) 2 orë në ditë në një periudhë prej 24 orë, gjatë ditëve të shkollës, ose
- b) 10 orë jashtë orarit të shkollës, në një periudhë 7 ditore, ndërsa koha ditore e punës në një rast të tillë nuk tejkalon 6 orë në total; ose
- c) 6 orë në një periudhë prej 24 orësh apo 30 orë në një periudhë 7 ditore në total e kryer gjatë pushimeve të shkollës.

Në rastin kur koha e punës e kalon 2 orë në një periudhë 24-orëshe, atëherë fëmijës i sigurohet një periudhë pushimi e çlodhjeje e pandërprerë, prej jo më pak se 30 minutash për periudhën përkatëse. Një minimum prej 14 orësh radhazi, periudhë pushimi ndërmjet veprimtarive të punës duhet të zbatohet para se një fëmijë mund të fillojë ndonjë veprimtari të re pune. Në rast se fëmija ushtron veprimtari pune për 5 ditë rresht brenda një periudhe 7-ditore, fëmijës i akordohet një periudhë çlodhjeje prej 2 ditësh rresht (20).

Fëmijët kanë të drejtë për një periudhë minimale prej 14 orësh radhazi pushim, në një periudhë 24-orëshe. Ndërsa adoleshentët çdo periudhë 24-orëshe, kanë të drejtë për një periudhë minimale çlodhjeje prej 12 orësh të pandërprera. Fëmijët dhe adoleshentët kanë të drejtë për të paktën 2 ditë radhazi për çlodhje brenda periudhës 7-ditore. Kur justifikohet nga shkaqe teknike ose organizative, periudha minimale e çlodhjes mund të reduktohet, por në asnjë rrethanë nuk mund të jetë më pak se 36 orë rresht. Zakonisht kjo përfshin ditën e shtunë dhe ditën e dielë. Punëdhënësit janë të detyruar t'u sigurojnë fëmijëve punëmarrës pushime për çlodhje. Për sa u përket punëve që zgjatin mbi 4.5 orë në ditë, duhet që të sigurohet një pushim ditor gjatë punës prej jo më pak se 30 minuta të pandërprera (21). Një herë në vit fëmijët nga mosha 15-16 vjeç kanë të drejtën që të kenë një pushim prej 4 javësh të pandërprera, duke mos përfshirë angazhim në shkollë apo në ndonjë punë tjetër (22).

Në rastet e forcës madhore dhe kur duhet që të kryhet një punë urgjente dhe e përkohshme, ose kur punonjësit e rritur nuk janë në dispozicion dhe sigurohet mbrojtja e siguria e të miturve, mund të lejohet puna e tyre (23).

III. Mbrojtja e grave shtatzëna në punë

Gratë shtatzëna dhe nënat e reja gjithashtu gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti. Neni 54 i Kushtetutës i cili parashikonte një mbrojtje të veçantë të miturve, sanksionon të njëjtin detyrim edhe ndaj grave shtatzëna dhe nënave të reja.

Legjislacioni shqiptar i punës ka tentuar të ofrojë një mbrojtje maksimale ndaj të drejtave të grave shtatzëna dhe nënave të reja në punësim në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato europiane. Ky detyrim *vis-à-vis* ndaj grave shtatzëna apo ndaj nënave të reja kërkon një bashkëpunim ndërmjet institucioneve shtetërore, por edhe ndërmjet vetë punëmarrësve dhe punëdhënësve.

Problemet e hasura në këtë drejtim janë të shumta, duke bërë që shpesh të jenë subjekt i konflikteve gjyqësore të marrëdhënies së punës. Punësimi i grave shtatzëna dhe nënave të reja lidh me vete tërësinë e të drejtave e detyrimeve që lindin gjatë marrëdhënies së punës, por edhe shumë elemente të të drejtave themelore të njeriut.

Trajtimi i barabartë në punësim dhe shmangia e formave të ndryshme të diskriminimit për këtë shkak janë disa nga parimet themelore të cilat nuk mund të mbeten vetëm në teori, por të gjejnë një zbatim të thellë në praktikë.

Legjislacioni i punës në mënyrë të veçantë ka vendosur mbrojtjen në punë të grave shtatzëna dhe nënave të reja (24). Një përcaktim më i qartë se kush do të quhet grua shtatzënë apo nënë e re e bën edhe VKM-ja në nenet e saj (25). Në këtë mënyrë, sipas nenit 104 të Kodit të Punës, ndalohet kryerja e punës për gratë shtatzëna 35 ditë para lindjes dhe 63 ditë pas lindjes. Në rastet kur gruaja shtatzënë ka në barrë më shumë se sa një fëmijë, periudha 35 ditë bëhet 60 ditë. Duhet përcaktuar se ky parashikim ligjor u ndryshua për t'iu përshtatur standardeve ndërkombëtare dhe direktivave të Bashkimit Europian, për shkak se dispozita e mëparshme parashikonte një pushim prej 42 ditësh pas lindjes së fëmijës nga ana e gruas shtatzënë.

Gjithashtu, është e ndaluar edhe që gratë shtatzëna apo ato me fëmijë në gji të punësohen në punë të rrezikshme, apo punë të rënda të cilat dëmtojnë shëndetin e nënës dhe të fëmijës. Siç e kemi përcaktuar më sipër, është Këshilli i Ministrave ai që përcakton se cilat janë punët që mund të lejohen të kryhen nga gratë shtatzëna e cilat janë punë që mund të dëmtojnë shëndetin e tyre e të fëmijës, së bashku me procedurat përkatëse. Në rastet kur gruaja shtatzënë vendos të kthehet në punë pas kalimit të afatit të sipërpërmendur dhe nuk ekzistojnë të njëjtat kushte që ekzistonin para se të largohet dhe vendi i punës nuk konsiderohet më i përshtatshëm, punëdhënësi merr të gjitha masat e nevojshme që të sigurojë përshtatshmërinë e vendit të punës për të shmangur çdo rrezik që mund t'i shkaktohet personit në fjalë. Kur punëdhënësi nuk arrin dot që të përshtasë kushtet e punës, atëherë ai mund të transferojë punëmarrësin në një punë të ngjashme me atë që kryente para transferimit dhe që është e përshtatshme. Në rastet kur edhe vetë transferimi nuk është i mundshëm, punëmarrësja gëzon të gjitha përfitimet sipas legjislacionit të sigurimeve shoqërore për të gjithë periudhën që është e nevojshme për të mbrojtur shëndetin e saj, apo të fëmijës.

Një e drejtë e rëndësishme që i takon grave shtatzëna është dhe e drejta për të gëzuar lejen e lindjes. Të ardhurat që përfitohen në rastet e lejes së lindjes, përcaktohen sipas ligjit të sigurimeve shoqërore. Është vetë gruaja që vendos nëse dëshiron të punojë apo të përfitojë nga sigurimet shoqërore, pas periudhës 63 ditore pas lindjes. Në rastet kur gruaja vendos që me dëshirën e saj të punojë pas periudhës 63 ditore të paslindjes, ajo mund të lidhë edhe një marrëveshje me

punëdhënësin, për të ushqyer fëmijën e saj deri sa të mbushë 1 vjeç. Kështu në këtë rast ajo mund të zgjedhë mes marrjes së një pushimi të paguar prej 2 orësh, brenda kohës normale të punës ose një kophëzgjatje pune të reduktuar me 2 orë, ku do të paguhet me pagën e njëjtë sikur të punonte me kohë normale në punë. Pas mbarimit të lejes së punës punëmarrsja ka të drejtë të kthehet në vendin e punës që kishte para se të merrte lejen ose në një vend të barazvlefshëm me të, si dhe të përfitojë të gjitha përmissimet e kushteve të punës që do të kishte përfituar gjatë mungesës (26).

Një nga mbrojtjet e rëndësishme që legjislatori i ka vendosur grave shtatzëna, është neni 105/a i Kodit të Punës, i cili sanksionon se është i ndaluar çdo test shtatzanie gjatë punësimit nga ana e punëdhënësit. Në rastet kur vendi i punës kërkon të punohet në kushte që mund të ndikojnë negativisht në shtatzani apo që mund të dëmtojnë shëndetin e nënës apo fëmijës, këto teste lejohen. Gruas i lejohet gjithashtu që në marrëveshje me punëdhënësin të marrë leje të paguara për të kryer vizitat mjekësore të domosdoshme për t'u kryer gjatë orarit të punës. Në këtë fokus, një sugjerim i mundshëm do të ishte dhe një trajtim me një pagë më të madhe se disa kategori të tjera punëmarrësish, e cila nuk është aspak diskriminuuese, pasi kjo pagë kompenson humbjet profesionale që lindin për punonjësen në rastet e largimit nga puna (27). Gjithashtu, punëdhënësi nuk mund të ndërpresë kontratën e punë për shkak që lidhen me shtatzëninë, pasi në rastet kur ndodh, është i detyruar të provojë përpara gjykatës faktin e kundërt, duke rënduar mbi të në këtë mënyrë barrën e provës.

Mund të ndodhë që punëmarrësi të birësojë një fëmijë të posalindur. Në këto raste punëmarrësi ka të drejtën e lejes së lindjes të parashikuar në ligj. Lejen e lindjes mund të përfitojë vetëm njëri nga prindërit birësues, pra babai ose mamaja birësuese. Gjatë kësaj kohe personi që ka përfituar lejen e punësimit, nuk mund të detyrohet që të kryejë punë nga ana e punëdhënësit. Pas përfundimit të lejes së birësimit punëmarrësi ka të drejtë të kthehet në vendin e punës që ishte përpara se të merrte lejen ose në një vend të barazvlefshëm me të, si dhe të përfitojë nga të gjitha të drejtat që mund të përfitonte gjatë mungesës së tij (28). Gjithashtu, është e pavlefshme zgjidhja e kontratës së punës gjatë kohës që personi gjendet në kushtet e lejes së birësimit dhe përfiton të ardhura nga sigurimet shoqërore. Në rastet kur punëdhënësi e zgjidh për këtë shkak, atëherë ai mban përgjegjësinë dhe ky pushim është i pavlefshëm (29).

Në nenin 108 është parashikuar se punëdhënësi nuk mund të urdhërojë kryerjen e punës së natës për gratë shtatzëna dhe gratë që kanë lindur fëmijë, deri në moshën 1 vjeç të fëmijës, kur ajo është e dëmshme për shëndetin dhe sigurinë e gruas apo fëmijës, e vërtetuar me anë të raportit mjekësor. Në rastet kur gruaja shtatzënë bëhet e papërshtatshme për të punuar natën, vërtetuar kjo dhe me raportin mjekësor, ajo transferohet në një punë të përshtatshme për të të kryer ditën. Edhe pse e drejta për të punuar natën ka marrë një zhvillim të rëndësishëm, pasi një mohim i të drejtës për të punuar natën është konsideruar si një formë diskriminimi (30), në këtë rast është i justifikuar ky kalim nga puna e ushtruar natën në atë ditën. Në çdo rast, është Këshilli i Ministrave që përcakton kushtet në të cilat kryhen punët e natës për gratë shtatzënë dhe se kush janë ato punë që mund të kryhen.

Legjislacioni i punës parashikon që nuk mund të zgjidhet kontrata e punës kur punëmarrësja është me leje lindje ose pas mbarimit të saj. Megjithatë, në praktikën gjyqësore ndeshen edhe raste të tilla (31). Në një çështje (32) ku e paditura ka qenë në marrëdhënie pune si drejtoreshë spitali, i është komunikuar ndërprerja e marrëdhënies së punës kur ajo ishte shtatzënë. Lidhur me pretendimin e paditëses për t'u paguar për periudhën e paaftësisë së përkohshme në punë, për shkak se në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies të punës paditësja ka qenë në muajin e pestë të shtatzënisë, gjykata vlerëson se është i pambështetur në ligj dhe si i tillë, duhet rrëzuar. Zgjidhja

e kontratës së punës me paditësen është bërë në kohën që paditësja ka qenë efektivisht në punë dhe jo gjatë kohës që ajo ka qenë në periudhë paaftësie për punë. Të drejtën për t'u paguar për periudhën e paaftësisë së përkohshme në punë e gëzojnë personat që janë në marrëdhënie pune dhe jo ata të cilëve kjo marrëdhënie u është ndërprerë (33).

Përfundime

Disa kategori të punëmarrësve gëzojnë një mbrojtje ligjore speciale, nisur kjo nga vetë fakti se këto kategori përbëjnë një interes më të lartë për t'u mbrojtur, por edhe për shkak të kushteve specifike në të cilën ata ndodhen. Duke qenë se kjo kategori është dhe më e rrezikuar në shëndetin dhe sigurinë e saj në punë, shtetet janë munduar që të ofrojnë një mbrojtje ligjore të veçantë, duke përmisuar kuadrin e tyre ligjor.

Fëmijët gëzojnë një mbrojtje të veçantë nga shteti. Gjatë marrëdhënies së punës punëdhënësit kujdesen që t'u ofrojnë atyre të gjitha kushtet e domosdoshme me qëllim që ata të jenë të mbrojtur në punë. Një sërë aktesh legjislative synojnë që të mbrojnë këtë kategori. Nevojitet një bashkëpunim më i thellë ndërmjet organeve ligjzbatuese dhe grupeve të tjera të interesit, siç janë përfaqësuesit e punëdhënësit dhe ata të punëmarrësve në mënyrë që standardet e punës të rriten, por edhe të zbatohen. Vendosja e moshës minimale prej 16 vjeç për të hyrë në marrëdhëniet e punës, ishte një hap i rëndësishëm për të eliminuar punët e fëmijëve, format më të këqija të këtyre punëve, si dhe abuzimet e tjera që mund të ndodhin.

Ne çdo rast puna e fëmijëve duhet që të shoqërohet me një trajnim të vazhdueshëm nga ana e punëdhënësve, por edhe me informim si dhe nuk duhet që të çenojë në asnjë çast shëndetin e tyre fizik apo mendor, moralin dhe edukimin e tyre.

Gratë shtatzëna janë një tjetër kategori e veçantë që gëzojnë mbrojtje nga shteti gjatë marrëdhënies së punës. Legjislacioni shqiptar i punës ka tentuar të ofrojë një mbrojtje maksimale ndaj të drejtave të grave shtatzëna dhe nënave të reja në punësim në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe ato europiane.

Shmangia nga detyrimi për të kryer punë të vështura, ndaj ekspozimeve të agjentëve të ndryshëm, apo mosdetyrimi për të kryer punën natën janë disa nga të drejtat që i takojnë në mënyrë eksplicite kësaj kategorie. Duhet thënë se trajtimi i grave shtatzëna nuk duhet të jetë kurrë në mënyrë të diferencuar nga punonjësit e tjerë dhe çdo shkarkim nga puna nuk do të ketë asnjë efekt ligjor dhe është i pavlefshëm.

Referenca

1. Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2016.
2. Çela K., E drejta e Punës, Tiranë; 2014, f. 353.
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave "Për Mbrojtjen E Fëmijëve Në Punë" Nr. 108, datë 15.2.2017 dhe "Për prezantimin e masave për sigurinë dhe shëndetin në punë të grave shtatzëna dhe të reja" Nr. 634, datë 15.7.2015.
4. Neni 54/3 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2016.
5. Neni 59 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2016.
6. Shtylla A., E Drejta Kushtetuese Ligjore për Punë dhe Mbrojtja Shoqërore e Saj, Në Republikën E Shqipërisë Në Këndvështrimin E të Drejtës Së Bashkimit European, Disertacion; Tiranë 2015, f. 131.
7. Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë, Ligj Nr. 7961, datë 12.7.1995; (Ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, datë 5.12.2015); Tiranë 2015.
8. Neni 98/1 dhe 98/2 i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2015.
9. Neni 6 i Kodit Civil së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2016.

- Shqipërisë, Tiranë 2014.
10. Rekomandimi Nr 146 i Organizatës Ndërkombëtare të Punës sugjeron që vendet të caktojnë si moshë minimale të punësimit moshën 16-vjeçare.
 11. Neni 2/3 i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Mbrojtjen E Fëmijëve Në Punë” Nr. 108, datë 15.2.2017.
 12. Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës “Për Caktimin e Moshës Minimale të Punësimit”, Nr. 138.
 13. Neni 100 i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2015.
 14. Neni 6 i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Mbrojtjen E Fëmijëve Në Punë” Nr. 108, datë 15.2.2017.
 15. Neni 103 i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2015.
 16. Neni 4 i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Mbrojtjen E Fëmijëve Në Punë” Nr. 108, datë 15.2.2017.
 17. Neni 78/2 i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2015.
 18. Neni 7 i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Mbrojtjen E Fëmijëve Në Punë” Nr. 108, datë 15.2.2017.
 19. Neni 8 i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Mbrojtjen E Fëmijëve Në Punë” Nr. 108, datë 15.2.2017.
 20. Neni 10 i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Mbrojtjen E Fëmijëve Në Punë” Nr. 108, datë 15.2.2017.
 21. Neni 11 i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Mbrojtjen E Fëmijëve Në Punë” Nr. 108, datë 15.2.2017.
 22. Neni 12 i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Mbrojtjen E Fëmijëve Në Punë” Nr. 108, datë 15.2.2017.
 23. Çela K., E drejta e Punës, Tiranë; 2014, f. 355.
 24. Neni 1 i Vendimi i Këshillit të Ministrave dhe “Për prezantimin e masave për sigurinë dhe shëndetin në punë të grave shtatzëna dhe të reja” Nr. 634, datë 15.7.2015.
 25. Neni 105 i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2015.
 26. Gjykata Europiane e Drejtësisë; Oumar Dabo dhe të tjerë vs Renault Sh.A., C-218/98.
 27. Neni 106 i i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2015.
 28. Neni 107 i i Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2015.
 29. Gjykata Kushtetuese Federale e Gjermanisë; Vendimi nr. 85; BVerfGE 191 (1992).
 30. Semini A., Konfliktet Gjyqësore të Marrëdhënies së Punës Parë nën Këndvështrimin e Barazisë Gjinore; Tiranë; Shkolla e Magjistraturës; 2014, f. 69.
 31. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, nr. 326, datë 09.02.2009.
 32. Semini A., Konfliktet Gjyqësore të Marrëdhënies së Punës Parë nën Këndvështrimin e Barazisë Gjinore; Tiranë; Shkolla e Magjistraturës; 2014, f. 69.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

TESTET PROJEKTIVE GRAFIKE DHE ZVILLIMI I KAPACITETIT GRAFIK

Mariglana Gjoni*

Universiteti i Urbinos “Carlo Bo”, Itali, Departamenti i Psikologjisë

Adresë kontakti: mmariglana@yahoo.it

Përmbledhje

Objektivi i këtij studimi teorik është të paraqiten teknikat projektive grafike dhe zhvillimi i kapacitetit grafik te individit. Së pari, kjo trajtesë do të parashtrojë një panoramë të shkurtër ilustruese mbi teknikat projektive grafike dhe disa aspekte të dinamikave projektive që duhen pasur parasysh në vëzhgimin dhe në interpretimin e çdo lloj vizatimi të realizuar. Së dyti, do të fokusohemi në shpjegimin dhe eksplorimin e vizatimit në zhvillimin fizik, motorik, kognitiv dhe socio-emotiv në periudhat evolutive. Çdo arritje evolutive dhe çdo aspekt i personalitetit reflektohet hollësisht në produktin grafik. Nëpërmjet fletës së bardhë tregohet marrëdhënia që çdo individ vendos jo vetëm me veten, por edhe me të tjerët, në familjen dhe në shoqërinë në të cilin ndodhet. Metodologjia e përdorur është ajo *cilësore* e zhvilluar në linjën e shqyrtimit të të dhënave të literaturës rreth çështjes në shqyrtim. Përgjatë kësaj trajtese, artikulohej një sërë gjetjesh të rëndësishme të lidhura pikërisht me rëndësinë e vizatimit për njohjen e gjithanshme të personalitetit dhe si zhvillimi i kapacitetit grafik pasqyron zhvillimin global të individit.

Fjalë çelës: *teknika projektive vizatimore, zhvillim, fëmijë.*

THE TECHNICAL PROJECTIVE DRAWINGS AND THE DEVELOPMENT GRAPHIC CAPACITY

ABSTRACT

Objective of this theoretical study is to present the technical projective and the development capacity graphic in the subject. First, this work will present an overview brief illustrate by technique projective graphics and some aspect to dynamics projective that consider to observe and to interpret in every picture realized. Secondly, we will focus in the treatment and explorative drawings in the physique, cognitive, social-emotional in the period evolution. Every evolutionary progress and every aspect of personality by reflect all particularly in the product graphic.

Through the white sheets to tell the relationships that each person establish with himself and the others, in family and in society.

In the present study the methodology is qualitative developed on a review of literature about the question to treatment. During the present work there are articulated a series of

important **findings** related the argument about the important drawings to know whole personality and how the progress capacity graphic reflect the global development person.

Keywords: *technical projective drawings, development, child.*

Hyrje

Vitet e fundit kërkimet në fushën e vizatimeve si teknika projektive të personalitetit dhe në veçanti ato të bëra për moshën zhvillimore kanë shfaqur interes të konsiderueshëm dhe kanë paraqitur rezultate të larta. Këto rezultate e paraqesin vizatimin si një mjet për të studiuar zhvillimin e mendjes në mënyrë komplekse, duke vlerësuar njëkohësisht së bashku funksionin simbolik të përfaqësimit të botës së brendshme e të botës së jashtme dhe rëndësinë e tij si instrument komunikues me ndërvepruesin, të vëmendshëm ndaj mesazhit të tij. Vizatimi është një instrument shprehës i thjeshtë dhe i ndërlikuar në të njëjtën kohë, për të kuptuar personalitetin e vizatuesit në çdo moshë (1). Me anë të tij realizohet projektimi i botës së brendshme të fëmijës, të tërheqjeve dhe të refuzimeve, të dëshirave dhe ndrojtjeve të tij.

Nëpërmjet vizatimit individi organizon elemente të ndryshme duke i dhënë fill një krijimi të larmishëm, që tregon botën e parë me sy, domethënia e të cilit ushqehet në marrëdhëniet ndërpersonale. Këto marrëdhënie janë mjaft të rëndësishme për aspektet kognitive dhe emotive që “ngjyrosin” produktin grafik.

Vizatimet e fëmijëve, ashtu si çdo lloj vizatimi tjetër, mund të analizohen nga pikëpamje të ndryshme, si: zhvillimore, njohëse, tregimtare ose rrëfyese, artistike, projektive etj. Punimi do të ilustrojë disa aspekte projektive kyç në interpretimin e çdo lloj vizatimi dhe si vizatimi reflekton zhvillimin e individit dhe anasjelltas.

Përcaktimi i testeve grafike

Me “teste grafike” kuptojmë metodat projektive të bazuara në aktivitetin grafik. Nëpërmjet këtyre testeve subjekti projekton dhe tregon veten e vet, duke shfaqur edhe aspekte të personalitetit për të cilat nuk është fare i vetëdijshëm dhe u tregon të tjerëve botën ashtu siç e përjeton, realitetin shoqëror në të cilin përfshihet. Quhen ndryshe edhe teste “laps-fletë”, sepse janë teknika të lehta dhe praktike për t’u administruar. Këto teknika përdoren në fushën diagnostifikuese si instrumente efikase për një “shikim” kompleks të personalitetit: gjendjet emotive, krijimin e marrëdhënieve njerëzore, dëshirat, prirjet (të vetëdijshme dhe të pavetëdijshme), si edhe konfliktet më të thella të personit (2).

Testet psikologjike që përqendrohen në analizimin e produkteve grafike janë të ndryshëm, ndër më të famshmit kemi testin e figurës njerëzore, testin e familjes, testin e pemës, testin e Wartegut, testin e Benderit etj. Mënyra e interpretimit të këtyre testeve është e tipit psiko-grafologjik, sepse llogarisin vendosjen, presionin e vijave mbi fletë, vendosjen dhe rendin e pjesëve të vizatuara etj., tregues projektivë këta që vënë në dukje problematikën e pavetëdijshme me natyrë afektive.

Aspekte projektive të vizatimit

Sipas Ana Oliverio Ferraris (3) vija, pavarësisht përmbajtjes, ka një ngarkesë të fortë shprehëse. Ajo zotëron një gjallëri që kontribuon në dinamikën dhe strukturimin e formës. Vija mund të jetë e llojllojshme, si p.sh., e trashë, e hollë, e vazhdueshme, vertikale, spirale, horizontale, e shndritshme, e zbehtë dhe nëpërmjet llojit të saj mund të shprehen gjendje emotive të larmishme,

si p.sh., trishtim, gëzim, dëshpërim, siguri, gjendje mendore dhe tipare të personalitetit. Forca dhe intensiteti i vijës, përveç emocioneve, pasqyron edhe energjinë jetësore dhe mënyrën se si përdoret ajo nga fëmija. Vijat që fillojnë në mënyrë energjike (të forta) dhe përfundojnë të lehta (të dobëta) pasqyrojnë entuziazëm të shkurtër dhe paaftësi për të përfunduar angazhimin e marrë. Po ashtu, duhen pasur parasysh edhe konturet. Kur ato janë shumë të ngurta, shprehin armiqësi dhe represion (shtypje), shpesh neuroza apo një kontroll të tepërt emotivo-kognitiv. Në të kundërt, konturet që rrëshqasin butë dhe në mënyrë të sigurt, përveçse pasqyrojnë vlera estetike, shfaqin edhe një personalitet të matur.

Kur fëmija shkarravit disa herë të njëjtën zonë të fletës, duke fshirë ose duke vendosur në hije pjesët e trupit apo personazhe të caktuara, kjo gjë është tregues ankthi dhe ndrojtjeje ndaj këtyre pjesëve. Ndërsa vijat e lehta janë tregues të një sigurie dhe të një përshtatjeje të mirë. Nëse një fëmijë është i qetë, por percepton se i rrituri e gjykon atë, mund të vizatojë ndryshe nga herët e tjera. Shpesh fëmijët që ndihen nën presion mund të përdorin fillimisht vija gjallëruese, që tregojnë temperamentin e tyre real, por më pas mund t'i vendosin figurat në mënyrë të çrregullt mbi fletë (4). Nëse fëmija është i relaksuar dhe në një gjendje të mirë, priret që të lëvizë në mënyrë të hapur, jo të shtrënguar, vijat e bëra mbi fletë do të jenë më të rrumbullakosura.

Në përgjithësi, fëmijët që vizatojnë elementet e shpërndara mirë në fletë janë persona të qetë. Përdorimi i hapësirës shpreh marrëdhënien e subjektit me mjedisin dhe reagimet e tij. Prirja për të dalë nga anët e fletës është një karakteristikë tipike jo vetëm e fëmijëve të vegjël apo me vonesë mendore, por edhe e fëmijëve që kanë mungesa afektive apo që nuk kanë besim në vetvete. Edhe fëmijët e ndrojtur e tregojnë pasigurinë e tyre duke e bërë vizatimin në një cep të ngushtë ose në anët e fletës. Në përgjithësi fëmijët parapëlqejnë të vizatojnë në pjesën e sipërme dhe jo të poshtme të saj. Pjesa sipër parapëlqehet duke u nisur nga faktorë të lidhur me skemën trupore apo me lëvizjen e dorës, si edhe sepse është simbol i kokës, i qiellit, i vlerave të larta. E larta shpreh çlodhje, lirshmëri, ndërsa e ulëta shtrëngim dhe rëndesë.

Vizatimi në zonën e sipërme të fletës simbolizon hapje, imagjinatë dhe idealizëm, por në disa raste mund të jetë edhe tregues i prirjes paranojake, ndërsa vizatimi në zonën e poshtme është tipik i fëmijëve të mbyllur, të trishtuar dhe melankolikë. Vizatimi i vendosur në të majtë tregon regresion, ndërsa vizatimi i vendosur në të djathtë tregon nevojën e fëmijës për t'u projektuar në të ardhmen. Vizatimi i vendosur sipër në të majtë sjell në mendje mall, të ndierit i bllokuar, i paaftë për t'u individualizuar. Vizatimi i vendosur sipër në qendër është tregues i mirëqenies psikike, i optimizmit dhe i qetësisë. Vizatimi i vendosur sipër në të djathtë është tregues i dëshirës për autonomi, edhe pse shpesh mund të tregojë prirje agresive (5).

Fleta mund të ndahet në nëntë pjesë, ku secilës i përgjigjet një realitet që karakterizon prirjet, qëndrimet ndaj vetes dhe të tjerëve. Zgjedhja për të vizatuar në njërën prej këtyre zonave varet nga karakteristikat psikologjike, mosha, gjendja emotive dhe afektive e fëmijës (6), siç shihet në tabelën e mëposhtme nr. 1.

Tab. 1. Ndarja e fletës

Kujtimet	Fantazia	Ëndrrat
Lidhjet me zanafillën	Egocentrizmi	Projektimi në të ardhmen
Frika	Pasiguria	Dëshira

Zona sipër:
mendimi

Zona në qendër:

Zona poshtë:
mendimi

Hapësira që fëmija përdor për vizatim, sidomos në testin e figurës njerëzore, pasqyron vlerësimin që ka për veten e vet. Përmasat e vogla paraqesin vetëvlerësim të ulët, ndërsa përmasat e mëdha agresivitet dhe gjithëpushtetshmëri. Për më tepër, përmasat e vogla në vizatim paraqesin një fëmijë të ndrojtur, introvert, që ka frikë prej gjykimit të të tjerëve, të trembur ose të bllokuar. Hapësirat e mëdha ia fusin frikën, prandaj subjekti ka nevojë për cepin e fletës për t'u ndier më i mbrojtur. Deri në moshën gjashtë vjeç fëmijët priren të vizatojnë figura të mëdha, pasi akoma nuk zotërojnë një kontroll të plotë motorik. Por nëse vazhdojnë të vizatojnë me këto përmasa, atëherë mund të tregojnë përpjekjen për t'u hequr hapësirë të tjerëve dhe për t'ua dhënë personave më të rëndësishëm, zakonisht vetes dhe nënës.

Personazhi i vizatuar lart, në vija të përgjithshme, është më i idealizuar dhe më i vlerësuar nga fëmija, sepse ndodhet në zonën e mendimit, ndërsa personazhi i vendosur poshtë priret të jetë më i zhvlerësuar prej tij. Ndodh që personazhet të jenë të shpërndarë nëpër fletë dhe një personazh i vetëm të ndodhet i vendosur në tokë, në këtë rast fëmija paraqet nevojën e vet për t'u mbështetur dhe siguruar nga ky person. Në qendër fëmija vizaton personazhin më të rëndësishëm për të dhe kur vizatohet edhe i pari, për fëmijën do të thotë se është modeli me të cilin ai identifikohet. Personazhi i vizatur në të djathtë perceptohet si i pavarur, i aftë të ketë marrëdhënie të mira me të tjerët, sepse është dinamik dhe ekstrovert. Në këtë zonë zakonisht vendoset figura e babait, urë lidhëse me mjedisin e jashtëm. Në të majtë personazhi i vizatuar shihet si pasiv, i lidhur me traditat dhe introvert. Në më të shumtën e rasteve vizatohet nëna, e cila për fëmijën është një enë mbajtëse e ngrohtë dhe e dashur.

Zgjedhja apo jo e një ngjyre ka një domethënie psikologjike për fëmijën. Mungesa e ngjyrës mund të shfaqë boshllëk të lartë afektiv apo prirje antisociale. Një fëmijë që zotëron aftësi të mira përshtatjeje përdor pesë lloje ngjyrash në vizatimet e tij, ndërsa fëmijët introvertë përdorin zakonisht vetëm dy ngjyra.

Në stadin e parë evolutiv, shkarravinat e ngjyrosura mund të paraqesin një fëmijë të qetë dhe të gëzueshëm, ekstrovert, që kanalizon në mënyrë pozitive agresivitetin e tij, ndërsa shkarravinat e pangjyrosura mund të shfaqin një fëmijë të ndjeshëm dhe introvert. Në moshën 5-6 vjeç fëmija përdor ngjyrat për të bërë konturet e figurës, por nëse kjo ndodh disa vite më vonë duhet të bëhet vlerësimi i rritjes kognitive dhe afektive të subjektit. Pas moshës 6 vjeç zakonisht ngjyrat e përzgjedhura nga fëmijët janë më pak të forta ose të ndezura, pasi në zgjedhje ndikon zhvillimi i racionalitetit dhe përvoja shkollë. Në moshën 7-8 vjeç fëmija vizaton i shtyrë nga emocionet dhe është subjektiv në përzgjedhjen e ngjyrave. Në moshën 10 vjeç arrin të kapë marrëdhënien mes ngjyrës dhe objektit dhe pas moshës 11 vjeç priret të përdorë ngjyrat në mënyra sa më realiste, falë fazës së realizmit në të cilin subjekti ndodhet.

Ngjyrat kanë domethëniet e tyre simbolike. E kuqja është ngjyra e forcës, e gjakut, e dëshirës, e veprimit dhe e nismës. Kjo ngjyrë është e pranishme në çdo lloj vizatimi fëmijëror dhe shpesh

përfaqëson përpunimin e impulseve armiqësore. Mund të shprehë agresivitetin e fëmijës ndaj vetes së vet ose agresivitetin e të tjerëve ndaj tij. E verdha është ngjyra e dritës, e haresë, e gjallërisë, e hapjes, e miqësisë dhe e marrëdhënieve sociale, por edhe e zilisë dhe e shpërthimit. Simbolizon një afektivitet të hapur ndaj të afërmit. Akoma më tepër se e kuqja pasqyron agresivitet, çmenduri dhe dalldi. Portokallja është përzjerja e të kuqes me të verdhën. Është ngjyra që parapëlqejnë personat krijues, nxitës dhe të qetë. Mund të shprehë një ekuilibër të paqëndrueshëm dhe dëshirën për të ndërmarrë aventura të çuditshme. Ngjyra blu është ngjyra e intelektit, e arsytimit, e qëndrueshmërisë, e thellësisë, e qetësisë dhe e ndjenjës morale, por edhe e ftohtësisë afektive dhe e kontrollit racional. Është ngjyra e qiellit dhe e detit dhe simbolizon ujërat dhe feminilitetin. Ngjyra vjollcë është ngjyra e sëmundjes dhe e trishtimit, por mund të pasqyrojë edhe ndjeshmëri dhe një kuptim të thellë të tjetrit. Shpesh kjo ngjyrë mund të jetë treguese e një racionaliteti, që brendëson emotivitetin. Ngjyra e zezë simbolizon boshllëk, errësirë, turp, dhe dhimbje, është ngjyra e vdekjes dhe e personave që jetojnë të pashpresë. Është mohimi i dritës. E zeza në vizatimin e fëmijës tregon ankth, frikë, mohim, dhimbje ku ai përjashton mundësinë se diçka e mirë dhe pozitive mund të ndodhë. Ngjyra gri përbëhet nga e bardha dhe e zeza. Është një ngjyrë që fëmija nuk zgjedh pothuajse kurrë, sepse është një ngjyrë e fikur, e papërcaktuar dhe neutrale. Ngjyra e bardhë është shumica e të gjitha ngjyrave. Është vetë drita në të cilën të gjitha ngjyrat zhduken. Simbolizon qetësinë, boshllëkun, arratisjen nga bota. Një fëmijë që parapëlqen ngjyrën e bardhë është një fëmijë i vetmuar, një fëmijë që kërkon mbrojtje dhe që gjendet në opozitë me mjedisin e jashtëm. Gjithashtu mund të jetë edhe një fëmijë i bllokuar në përcaktimin e identitetit të vet (7).

Vizatimi në zhvillimin fizik, motorik, kognitiv dhe socio-emotiv

Zhvillimi i kapaciteteve grafike të fëmijës dhe aftësitë e tij për ta përfaqësuar botën e brendshme dhe të jashtme nëpërmjet vizatimit, është e lidhur me zhvillimin e aparatit motorik dhe të perceptimit pamor. Fëmija fillon të bëjë vizatimet e para kur fillon të zhvillohet nga ana fizike dhe ajo kognitive. Fëmija që në moshën 2-3 vjeç, ka raste edhe përpara, mëson të qëndrojë në këmbë dhe të ecë, të mbajë ekuilibrin e lëvizjeve të këmbëve, të krahëve, të duarve, të syve, falë të cilave arrin të hedhë pikat e para mbi fletë. Zhvillimi i këtyre zotësive në aspektin motorik dhe fizik i mundëson fëmijës të zhvillohet edhe në aspektin perceptivo-kognitiv. Ai arrin t'i njohë objektet e ndryshme që ndodhen përreth tij, t'i prekë ato pa ndihmën e të tjerëve dhe të bëjë përpjekjet e para për t'i paraqitur ato në vizatim (8). Fëmija çdo ditë e më tepër bën zbulime dhe përvoja të shumta e të ndryshme. Këto njohje kontribuojnë në ndërtimin e identitetit të tij psikik dhe në nivelin e vetëvlerësimit, që parashtruan në kapitullin e dytë. Pra, fëmija ndikohet nga mënyra se si ndihet i gjykuar prej të rriturve, duke përfshirë edhe mënyrën se si vlerësohen vizatimet e tij. "Fëmija bën shkarravina rastësore (pika dhe vija). Fëmija kënaqet me këtë gjë (....). Ashtu si ecja këmba-dorës i paraprin ecjes së vërtetë, ose ashtu si gugatjet i paraprijnë të folurit, ashtu edhe shkarravinat i paraprijnë krijimtarisë" (9).

Vizatimi nga mosha një deri në tre vjeç

Qysh prej lindjes, edhe pse vetëm për pak çaste, fëmija i kushton vëmendje atyre lëvizjeve që prekin fushën pamore të tij dhe me sytë e vegjël kërkon të ndjekë atë çfarë i ndodh përreth. Kur është 3-4 muajsh fillon të vëzhgojë në mënyrë sistematike duart, me të cilat manipulon objekte të ndryshme, si p.sh., biberonin, mbulesën e shtratit të vet, lodrën etj. Ky është momenti kur fillojnë përvojat e shumta kognitive dhe afektive të fëmijës. Ai bëhet i aftë të orientohet në hapësirë dhe të dallojë objektet dydimensionale nga ato tridimensionale dhe të bëjë zgjedhjen e tyre duke përdorur strategjitë e veta (10).

Me gishtin e vogël lë gjurmë mbi çdo lloj sipërfaqeje që prek (mbulesa, xham, dysheme) dhe ndërsa manovron me objekte të ndryshme duke i zvarritur apo duke i hedhur mbi sipërfaqe të ndryshme, jo vetëm kupton se po lë gjurmë, por edhe nëse këto objekte janë të përshtatshme për t'i futur në kategorinë e objekteve që mund të lënë shenja sa më të sakta të vetvetes. Pra, produkti i parë vizatimor për fëmijën janë këto shenja ose pika, që nuk janë thjesht pika, por mënyra më e mirë për të shprehur botën e tij të vogël. Pikat shprehin vlera të larta simbolike, pasqyrojnë lidhjen e parë të fëmijës me gjoksin e nënës.

Në pak kohë fëmija kalon nga pikat tek vijat (shkarravinat). Vijat fillimisht janë rastësore, shumë të trasha, aq sa prishin fletën dhe dalin poshtë saj. Por nga mosha dy vjeç e gjysmë, me koordinimin dhe kontrollin e lëvizjeve, fëmija arrin ta lëvizë lapsin pa e shkëputur nga fleta në dy drejtime të caktuara: nga poshtë në të majtë dhe nga lart në të djathtë, pa pasur një drejtim të caktuar. Edhe pse në dukje nuk vihet re ndonjë ndryshim i madh, në fakt secili fëmijë nëpërmjet këtyre vijave të ngatërruara me njëra-tjetrën shpreh veten dhe veçanësinë e vet. Nga mënyra se si fëmija shkarravit mund të dallojmë fëmijën e shëndoshë nga ai i dobët, fëmijën e ngadaltë nga ai i shpejtë, fëmijën pasiv nga ai aktiv etj. Bëhet fjalë në të vërtetë për një reagim psikodiagnostik (11).

Një hap tjetër në fushën e zhvillimit është momenti kur fëmija fillon të ngrejë lapsin nga fleta dhe ta rivendosë në të njëjtën pikë për të vazhduar vizatimin, të krijojë shenja të tjera, si p.sh., kthesat dhe cepat, si edhe të zgjedhë një pikë dhe duke u nisur prej aty të ndjekë një drejtim në formë spiraleje. Këto spirale interpretohen si zgjerim i vetvetes dhe i mjedisit rrethues, shprehje e ritmeve ose e dinamizmave të brendshëm, si edhe shfaqje e pulsioneve orale. Këto vija nuk kanë vetëm për qëllim shkarkimin e tensioneve, por edhe një qëllim përfaqësimi, domethënë shprehin diçka. Për Kellogg-in (12) ato përbëjnë një alfabet grafiko-piktorek. Kjo është një fazë që autorja e përcakton *si stadin e modeleve*, në të cilin fëmija nëpërmjet këtyre shenjave arrin të vendosë bazat për përfaqësimin e figurave më komplekse, si p.sh., persona, ndërtesa etj.

Me fjalë të tjera, këto vija edhe pse të ngatërruara marrin një domethënie të caktuar. Ato përfaqësojnë nënën, babanë, një shtëpi, një qen, një pemë dhe çdo lloj gjëje tjetër. Në këtë moshë fëmija fillon të vizatojë në mënyrë spontane çdo gjë që e godet apo që i bën përshtypje. Me rritjen e koordinimit të funksioneve perceptive dhe motorike fëmija arrin të krijojë forma vizatimore të caktuara dhe jo më kaotike. Pas pikave dhe vijave, rrethi është forma e parë gjeometrike që fëmija vizaton. Rrethi, thjesht një vijë e mbyllur, bëhet shprehja e parë e imazhit mendor dhe e imazhit trupor të ndarë nga hapësira e jashtme. Ai përfaqëson një objekt përmbajtës nëpërmjet të cilit fëmija fillon të mësojë kontrollin e emocioneve dhe të ndjenjave. Në moshën tre vjeç fëmija nëpërmjet mbylljes së rrethit fillon të vizatojë qeniet njerëzore. Duke filluar prej këtij momenti e në vazhdim ai do të jetë i aftë të dallojë format nga përmasat, si edhe të shtojë detaje, si p.sh., sytë, gojën dhe flokët, sa më shumë që rritet.

Vizatimi nga mosha katër deri në shtatë vjeç

Fëmija në moshën 3-4 vjeç arrin një kapacitet pamor akut pothuajse të ngjashëm me të rriturin. Bëhet i aftë të dallojë në mënyrë të përshtatshme ngjyrat dhe të kontrollojë gjithnjë e më mirë lëvizjet e syve dhe të duarve. Gjatë kësaj periudhe fëmijët ende nuk janë të aftë t'i integrojnë dhe t'i përdorin njëkohësisht paraqitjen e formës së objekteve të njohura dhe të pjesëve që e përbëjnë atë dhe vendosjen në fletë të elementeve duke pasur parasysh lidhjet hapësinore, si p.sh., afër, larg, brenda, jashtë. Ata, nëse janë të vëmendshëm ndaj një aspekti të një objekti, nuk arrijnë të kontrollojnë edhe vendosjen e tij në një kontekst të caktuar.

Me përvojën e kopshtit, fëmija pjek gjithnjë e më shumë kompetencat e veta motorike, kognitive,

gjuhësore, po ashtu edhe grafike. Po të shohim me vëmendje vizatimet e kësaj moshe, do të vëmë re se figurat paraqesin skema, që përshkruajnë sende, objekte, mjedise ose protagonistë të ndryshëm, edhe pse format e tyre përgjithësisht nuk janë të koordinuara dhe të pasuruara akoma mirë. Në pikëpamjen grafike fëmija ka arritur fazën e “realizmit qëllimor”, fazë në të cilën vendos dhe shpreh lirisht me zë të lartë domethënien e asaj që do të paraqesë nëpërmjet vizatimit përpara se ta realizojë atë. Për Georges-Henri Luquet, (13) një nga studiuesit e parë të grafizmit fëmijëror, kjo fazë quhet ndryshe edhe faza e “realizmit të munguar”, sepse fëmija mund të shprehë qëllimin për të vizatuar elemente të caktuar, por produkti i vizatimit është me të vërtetë tepër skematik, figurë e paplotësuar dhe e paindividualizuar. Në këtë moshë fëmija, që tashmë është ushtruar në përdorimin e lapsit, deklaron atë që vizaton. Ndodh që fëmija thotë: “Po vizatoj një fëmijë, por në realitet vizaton vetëm një vijë, një rreth apo diçka tjetër”.

Fëmijët më të shkathët arrijnë të bëjnë forma rrethore nga një pikë e caktuar, duke realizuar kështu forma të ndryshme gjeometrike, si p.sh. drejtkëndësja dhe trekëndësja për të paraqitur persona, kafshë, shtëpi, mjedisin rrethues etj. Në rastin konkret, në vizatimin e figurës njerëzore, fëmija katër vjeç vizaton kokën, një rreth me dy pika brenda (sytë), një vijë të shkurtër (gojën) dhe dy vija të zgjatura që dalin nga rrethi (këmbët). Skica e këtij vizatimi quhet “njeriu i vogël kokëmadh”. Për ta bërë këtë vizatim subjekti frymëzohet nga një “model i brendshëm”, domethënë nga një skemë grafike e brendshme, që formohet gjatë vëzhgimit dhe kontaktit me figurat njerëzore. Skicon në fletë ato shqisa, funksionet dhe rëndësinë e të cilave i njeh mjaft mirë, si p.sh., sytë për të parë, gojën për të folur e ushqyer dhe këmbët për të ecur.

Për fëmijën viti i pestë i jetës shënon jo vetëm një pjekuri të mëtijshme nga pikëpamja fizike, emotive dhe kognitive, por edhe një vit kyç për formimin e krejt personalitetit të tij. Elementet e realitetit nuk përjetojnë si të ndara apo të izoluara, por falë zhvillimit të aftësisë për të bërë sintezë përvojat ai i përjeton si një e tërë, në veçanësinë e tyre. “Rreth moshës pesë vjeç skemat grafike në lidhje me një objekt priren të pasurohen dhe të bëhen të larmishme, gjë që tregon zhvillimin e aftësive të analizës (aftësia për të kapur elementet dhe diferencat), ato fillojnë e përdoren jo më të izoluara, por si një skemë e vetme (gjë që dëshmon edhe zhvillimin e aftësisë për të bërë sintezë)” (14). Në vazhdim edhe figura njerëzore merr forma akoma më të qarta dhe diferencimi seksual mes dy vizatimeve bëhet më i theksuar. Kjo është faza e vizatimit që quhet “faza figurative”, sepse fëmija jo vetëm shpreh verbalisht qëllimin e të vizatuarit, siç thamë pak më lart, por ky qëllim shprehet qartë nëpërmjet asaj që ai dëshiron të paraqesë në vizatim, qëllim ky që pasqyron realitetin kognitiv, emocional dhe marrëdhënior të fëmijës. Kur mbush pesë vjeç, njeriu i vogël bëhet gjithnjë e më i dallueshëm, i duken sytë, hunda, goja dhe nga trangu i dalin këmbët dhe krahët.

Vajza diferencohet nga djali duke vizatuar në kokën e saj flokë të gjata dhe një v të përmbysur për të paraqitur fundin. Shpesh vizatohen edhe figura të zhveshura, duke pasqyruar gjenitalet apo karakteret seksuale dytësore (gjoksin). Ky aspekt nuk është patolgjik, por thjesht tregon shqetësim për identitetin e vet seksual. Në moshën gjashtë vjeç zhvillimi përshpejtohet më shumë për vetë faktin se fëmija shkon në shkollë. Figura njerëzore vizatohet në mënyrë më organike dhe paraqitet me më shumë detaje. Del në pah vija mbështetëse dhe prirja për t’i vendosur në të njëjtën vijë objektet e vizatuara (15). Në moshën shtatë vjeç aftësia motorike dhe rritja e madhe kognitive i mundësojnë fëmijës të bëhet një vizatues gjithnjë e më kompetent. Ai arrin të kontrollojë vijat dhe paraqet me më imtësi dhe saktësi marrëdhëniet mes pjesëve të vizatuara, vendos më shumë detaje në vizatimet e tij. Vizatimi i bërë nga një fëmijë në moshën 6-7 vjeç paraqet tashmë një personalitet, që dallohet nga të tjerët për moshën, tiparet e fytyrës, karakteristikat fizike, si p.sh., mustaqet, mjekrën, ngjyrën e flokëve dhe jo vetëm për rrobat që vesh (16).

Vizatimi nga mosha tetë deri në njëmbëdhjetë vjeç

Rreth fundit të vitit të shtatë dhe kalimit në vitin e tetë të jetës, fëmija fillon të përdorë simbole të ndryshme, duke u dhënë atyre një domethënie të veçantë. Në vizatim paraqitet skema e trupit njerëzor dhe e objekteve, si nga ana e përbërjes, ashtu edhe ajo e ngjyrave. Në këtë moshë vizatohet vija bazë, që simbolizon tokën, por shpesh ndodh që të vizatohet edhe vija që përfaqëson qiellin. Gjatë viteve të para të shkollës, edhe pse fëmijët fitojnë aftësi të reja, mund të gabojnë sërish në mënyrën se si i paraqesin vizatimet e tyre.

Sipas Luquet G. H (17) ky fenomen ndodh në fazën e ashtuquajtur të “realizmit kognitiv”, në të cilën fëmija nuk vizaton për t’i riprodhuar gjërat ashtu siç shihen, p.sh., një rrugë në perspektivë, por ndjek një model konceptual të gjërave ashtu siç janë. Për këtë arsye rruga paraqitet me të njëjtën largësi dhe me vija paralele. Fëmija ka një model të brendshëm konceptual jo pamor që e udhëheq në riprodhimin e karakteristikave dalluese të subjektit. Mënyra me të cilën fëmija vizaton mund të përcaktohet si vizatim skematik.

Skema e ndjekur është e ndryshme për fëmijë të ndryshëm, jo vetëm për shkak të karakteristikave personale, por edhe për shkak të pranisë së detajeve. Fëmija mund të ndryshojë përmasat apo format e vizatimit, duke hequr apo shtuar një element të figurës që paraqet një rëndësi të veçantë. P.sh., kur vizaton një person që po merr një dhuratë ai mund ta zgjasë më tepër seç duhet dorën e tij.

Me kalimin e muajve tek fëmija konsolidohet gjithnjë e më tepër kapaciteti grafik. Ai tashmë është i aftë ta ndajë vizatimin e tij në dy nivele, ku secili prej tyre i referohet një dimensionit specifik hapësinor, edhe pse këto nivele nuk janë akoma të integruara mirë ndërmjet tyre. “Fillon të jetë i pranishëm aspekti tridimensional, si p.sh., tavolinat e para nga lart dhe të vizatuara me një drejtkëndësh në të cilin janë të vendosura katër këmbë” (18).

Po ashtu, në këtë stad evolutiv grafik fillon të shprehet marrëdhënia afektive me objektin e vizatuar. Te fëmijët më të ndjeshëm kjo mund të sjellë një deformim shprehës të figurës. Në moshën 10-11 vjeç mund të thuhet se vizatimi bëhet më i plotë, elementet grafike janë të shpërndarë në mënyrë të ekuilibruar në hapësirat e fletës. Është e mundur që stili dekorativ i vizatimit të ndikohet nga reklamat. Në figurën njerëzore, kemi një përpjesëtim të mirë mes krahëve, këmbëve dhe trungut, kemi po ashtu edhe praninë e një hapësire sipër syve (ballin) dhe poshtë gojës (mjekrën).

Vizatimi nga mosha 11 vjeç e sipër

Nga para-adoleshenca deri në fund të adoleshencës plotësohet procesi i pjekurisë kognitive. Subjekti jo vetëm zotëron një repertor më të madh skemash me figura njerëzore, sa mund t’i përdoren njëkohësisht ato, por zotëron edhe procedura më komplekse për të paraqitur marrëdhëniet hapësinore. Kujtesa është më e aftë të ruajë në mendje një objekt të plotë, pjesët e të cilit mund të vizatohen në momente të ndryshme, pa humbur njësinë e figurës.

Gjatë para-adoleshencës kemi një qëndrim të dyfishtë artistik tek subjektet. Kemi adoleshentë që parapëlqejnë paraqitjen artistike të përvojave pamore dhe të përvojave jo pamore. Para-adoleshentët që privilegjojnë përvojat pamore, janë shumë të interesuar ndaj produktit piktoresk dhe më të kujdesshëm ndaj stimujve pamorë, si p.sh., drita, hijet dhe perspektiva hapësinore. Këto ndihen spektatorë të skenës që vizatojnë dhe përqendrohen te krejt figura duke kërkuar të kapin aspekte të ndryshme për të paraqitur një vizatim sa më realist të realitetit. Pikë së pari, perceptojnë tërësinë e një figure, pastaj analizojnë pjesët e veçanta të saj dhe më pas i bashkojnë sërish ato. Para-adoleshentët që privilegjojnë përvojat jo pamore, e perceptojnë vizatimin në funksion të asaj që duan të shprehin nëpërmjet identifikimit me përmbajtjet piktoreske të realizuara.

Në këtë moshë të gjitha vizatimet në përgjithësi dhe figura njerëzore në veçanti paraqesin interesin

e subjektit për ndryshimet morfologjike moshore. Tek vajzat koka e figurës vizatohet më e vogël, theksohet gjoksi, ngushtimi i belit dhe rritet dëshira për detajet e veshjeve, ndërsa tek djemtë vizatimet paraqesin një theksim të organeve gjenitale. Të gjithë ato adoleshentë që refuzojnë të kalojnë në moshën e rritur, si p.sh. anoreksikët nervorë, vizatojnë figura njerëzore të vogla (19). Zhvillimi grafik përfundon me adoleshencën dhe me periudhën e marrjes së vendimeve. Adolehenti i vlerëson aftësitë e veta artistike dhe krijimin e vet piktoresk sipas standardeve të të rriturve.

Përfundime

Teknikat projektive grafike kanë si synim unik dhe thelbësor të tyre, studimin e dinamikave të personalitetit njerëzor. Gjatë realizimit të vizatimit fleta e bardhë është hapësira më e mirë për të projektuar inteligjencën, emocionet dhe afektivitetin. Personaliteti i fëmijës dhe zhvillimi i tij kognitiv dhe emocional shprehet në vija, në përdorimin e hapësirës e në radhën me të cilën vizaton objektet dhe personazhet e ndryshëm, në harrimin e disa pjesëve të vizatimit e në zgjedhjen e ngjyrës, etj.

Ai shihet si një vijë direkte e drejtpërdrejtë e të hyrit në gjendjen psikologjike të fëmijës dhe nëpërmjet tij mund të kuptojmë ecurinë evolutive të fëmijës, ashtu siç del në pah qartë gjatë shtjellimit të këtij argumenti.

Referenca

1. Donsi L. Parrello S. & Priore A, Disegno infantile e interculturalità. Bambini italiani e stranieri in classe. Psicologia e Scuola; 2011; 18; f.18-24.
2. Crotti E & Magni A. Non sono scarabocchi. Come i disegni dei bambini, Torino; Oscar Mondatori; 2012, f. 34-106.
3. Oliviero Ferrari A. Il significato del disegno infantile. Torini; Bollati Boringhieri; 1978, 154-158.
4. Corman L. Il disegno della famiglia, test per i bambini. Torino; Boringhieri; 1970, 234-245.
5. Serraglio A. Gli adulti parlano i bambini disegnano. Manuale per l'interpretazione del disegno infantile. Roma; Armando Editore; 2011, 123-126.
6. Federici P. I Bambini non ve lo diranno mai... ma i disegni si. Milano; Franco Angeli; 1998, 162-163.
7. Antinor M. G & B Puglia. Appunti sull'evoluzione del disegno infantile. Roma; ARIPIT, SAS; 2013, 126- 127.
8. Gallino T G. Il complesso di Laio, i rapporti famigliari nei disegni dei ragazzi. Torino; G. Einaudi; 1978, 124-126.
9. Karaj TH. Psikologjia e zhvillimit të fëmijës. Tiranë; Progres; 2005.
10. Bruner J S. Prime fasi dello sviluppo cognitivo. Roma; Armando; 1971, 124-127.
11. Avasse V. Il disegno del bimbo. Un linguaggio universale per seguire il suo sviluppo intellettuale, Roma; Hever; 2004, 161-164.
12. Cannoni E., I disegni dei bambini, Roma; Carocci; 2003, 34-38.
13. Luquet G.H. Il disegno infantile. Roma; Armando; 1996, 45-47.
14. Ariano G. Il disegno della persona umana, test proiettivo per adulti e bambini. Roma; Borla ; 1999, 257-269.
15. Petter G. Lo psicologo nella scuola. Firenze; Giunti; 2016, 235-236.
16. Castellazzi L.V. Il test del disegno della figura umana. Roma; Las; 2002, 145-147.
17. Luquet G.H. Il disegno infantile. Roma; Armando; 1996, 235-289.
18. Avasse V. Il disegno del bambino. Un linguaggio universale per seguire il suo sviluppo intellettuale. Roma; Hever; 2017, 112-115.
19. Serraglio A. Gli adulti parlano i bambini disegnano. Manuale per l'interpretazione del disegno infantile. Roma; Armando Editore; 2017, 145-146.



Viti i IX-të i Botimit, Nr. 1,
Qershor 2018

PERCEPTIMET E PEDAGOGËVE TË UNIVERSITETIT TË KORÇËS LIDHUR ME SHPËRBLIMET NË MOTIVIM

Eralda Zhilla*, Spiridhona Bello*, Klea Kuburi*

*Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Adresë kontakti: eraldazhilla@gmail.com

Përmbledhje

Punonjësit e motivuar janë baza për një institucion të suksesshëm. Qëllimi i këtij studimi është që të eksplorojë faktorët motivues dhe efektivitetin e programeve të stimujve në motivimin në punë.

Studimi përbëhet nga dy pjesë kryesore: pjesa teorike dhe kërkimi shkencor. Në pjesën e parë ndodhet literatura e studiuar, e cila shqyrton teoritë e motivimit dhe kategoritë e ndryshme të stimujve. Informacioni për formimin teorik u mbledh nëpërmjet librave dhe burimeve në internet. Për studimin empirik, u zgjodh pyetësori për mbledhjen e të dhënave, i cili u administrua personalisht dhe popullata konsistonte te pedagogët e brendshëm të Universitetit të Korçës, nga të cilët u zgjodh kampioni përfaqësues. Rezultatet e studimit treguan se stimujt kanë një potencial motivues shumë të lartë dhe nëpërmjet tyre, punonjësit janë të gatshëm të punojnë më shumë. Tre faktorët më motivues të vlerësuar nga punonjësit ishin mjedisi pozitiv i punës, vlerësimi dhe marrëdhëniet me kolegët. Lidhur me motivimin afatgjatë, faktorët e lidhur me punën, si për shembull zhvillimi i karrierës, përmirësimi i njohurive dhe promovimi u gjetën të ishin motivues. Nga ana tjetër, u gjet se shpërblimet monetare ishin motivues në afatin e shkurtër.

Fjalë çelës: *stimuj, motivimi i punonjësve, universitet, shpërblim.*

LECTURES' PERCEPTIONS OF KORÇA UNIVERSITY REGARDING REWARDS IN MOTIVATION

Abstract

Employees who are motivated are the base of a successful workplace. The aim of this study was to explore the motivational factors and the effectiveness of incentives programs in the motivation at work.

The study is comprised of two components: theoretical and research. In the first part is the theoretical framework, which examines the motivation theories and the different categories of incentives. This information was gathered from books and internet sources. For the empirical study, a questionnaire was used to gather the data, which was administered personally and the research population consisted of the academics in the University of Korça, Albania, from which the sample size was chosen. The results of the study showed

that incentives have a strong motivational potential and through them, employees are willing to work harder. The three most motivating factors valued by employees were the positive working environment, appraisal and good relationship with colleagues. For long-term motivation, job related factors, such as career advancement, improving skills and knowledge and promotion were found to be effective motivators. On the other hand, monetary rewards were motivational on the short-term.

Keywords: *incentives, employee motivation, university, reward.*

Hyrje

Shumica e teoricienëve organizacionalë bien dakord se në mjedisin e sotshëm konkurrues dhe dinamik, punonjësit janë një pjesë integrale e çdo organizatë apo institucioni sepse një pjesë e madhe e detyrave ditore kryhen prej tyre. Suksesi i përgjithshëm i organizatës apo institucionit në arritjen e objektivave strategjikë, varet në performancën e punonjësve. Kështu që është thelbësore që të identifikohen faktorët që e ndikojnë performancën.

Të gjithë organizatat, pavarësisht sektorit, përmasës apo industrisë, kërkojnë punonjës të motivuar për të funksionuar në mënyrë efektive. Burimet njerëzore janë një aset që sigurojnë produktivitet, performancë dhe prosperitet. Punonjësit e motivuar janë më të kënaqur, më të dedikuar dhe punojnë më me entuziazëm. Produkti i një force pune të motivuar përfshin qarkullimin e ulët, besnikërinë dhe harmoninë, faktorë këta që kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin e organizatës. Dukshëm, një nga sfidat me të cilën organizatat përballen sot është të sigurohen që punonjësit e tyre janë të motivuar.

Sa i përket motivimit të punonjësve, programet e stimujve janë gjetur se janë teknika që përdoren shpesh nëpër organizata. Qëllimi i programit është që të shpërblejë performancën produktive, të përforcojë sjelljen pozitive, të rrisë interesimin e punonjësve dhe më e rëndësishmja, t'i motivojë ata. Këto programe stimujsh ofrojnë një rang të gjerë shpërblimesh që mund të jenë monetare ose jo. Çelësi për përmirësimin e motivimit të punonjësve nëpërmjet stimujve është që organizata t'ua komunikojnë programet punonjësve, të shpenzojë kohë për të gjetur se çfarë i motivon ata, si do t'u pëlqente të shpërbleheshin për një performancë të mirë dhe më pas të ndërtojnë dhe zbatojnë një program të përshtatshëm të bazuar në nevojat e punonjësve. Duke ndjekur këtë linjë logjike, qëllimi i studimit është të shqyrtojë faktorët e rëndësishëm motivues dhe efektivitetin e tyre te pedagogët e brendshëm të Universitetit të Korçës.

Rishikimi literaturës

Motivimi përcaktohet si forca e brendshme e një personi që ndikon drejtimin, intensitetin dhe këmbënguljen drejt një sjelljeje të vullnetshme¹. Robbins dhe Coulter² sugjerojnë se motivacioni i referohet proceseve që përbëjnë vullnetin e një individi për të ushtruar nivele të larta përpjekjeje për të arritur qëllimet organizacionale, të kushtëzuara nga aftësia e përpjekjes për të përmbushur nevojat individuale. Në qoftë se menaxherët sot marrin përgjegjësi për t'i çuar punonjësit drejt arritjes së qëllimeve organizacionale, është thelbësore që ata të kuptojnë proceset psikologjike të motivimit.

Elementet kyçe të përcaktimit të mësipërm janë: drejtimi, intensiteti dhe këmbëngulja. Elementi i “drejtimit” i referohet forcës bindëse për të arritur një objektiv specifik. Kjo do të thotë që kur një punonjës i motivuar njih nevojën që të arrijë diçka, të gjithë përpjekjet do të fokusohen në arritjen e qëllimit. Elementi i “intensitetit” përfaqëson magnitudën e përpjekjes drejt qëllimit. Me fjalë të

tjera, një punonjës mund të përpiqet më shumë se një tjetër për të përmbushur qëllimet. Elementi i fundit “këmbëngulja” i referohet kohës që përpjekja kërkon. Një punonjës këmbëngulës nuk do të heqë dorë pa arritur qëllimin. Motivimi mund të përshkruhet si i qëllimshëm kur punonjësit zgjedhin të veprojnë sipas vullnetit të tyre.

Nga ana tjetër, Adams³ beson se përcaktimi i motivimit do të jetë më bindës kur fjala “motivim” të jetë e ndarë nga “lëvizje”. Kur punonjësit i ngarkohet të bëjnë një detyrë që nuk i pëlqen, por që duhet ta bëjnë në mënyrë që të shpërblehet, atëherë ai/ajo është në lëvizje. Por kur punonjësi angazhohet në një detyrë sepse i pëlqen puna, në këtë rast ndodh motivimi.

Një faktor tjetër që ndikon në motivim dhe në performancën është aftësia e punonjësit për të kryer në një mënyrë sa më të suksesshme një punë. “Aftësia” i referohet zotësive dhe kompetencave për të performuar sa më mirë. Zotësitë përfshijnë gatishmërinë mendore dhe aftësinë për bërë të tijat kompetenca të tjera. Organizata mund të ndihmojë punonjësit që të zhvillojnë më tej ekspertizat e tyre nëpërmjet kurseve të ndryshme.

Një stil menaxhimi autoritar nuk është praktik në qoftë se organizata kërkon që punonjësit të kenë iniciativë dhe të qëndrojnë të angazhuar ndaj qëllimeve. Atmosfera e punës duhet t’i lejojë punonjësit të plotësojnë nevojat e larta. Për këtë arsye, menaxherët mund të ndihmojnë në kultivimin e një mjedisi të motivuar së brendshmi duke u dhënë sa më shumë *feedback*, duke iu dhënë detyra punonjësve që kërkojnë përdorimin e aftësive të tij, por edhe duke u dhënë mundësinë për të fituar kompetenca të reja, duke u dhënë autonomi në punën e tyre, duke ua bërë të qartë se punonjësit duhet të mbajnë përgjegjësi për punën e tyre dhe duke ua bërë të qartë ndikimin që puna e tyre ka te kolegët, departamenti dhe te organizata në tërësi⁴.

Nga ana tjetër, motivimi i jashtëm i referohet motivimit i cili vjen nga jashtë, në këmbim të shpërblimeve të jashtme. Ai merr formën e shpërblimeve monetare dhe jo monetare, si për shembull rritje rroge, certifikata, udhëtime, bankete, bileta kinemaje etj. Për shembull, një punonjës mund të punojë dyfish për të përfunduar një projekt para afatit, për të përfituar një shpërblim për punën e tij efikase.

Teksa shpërblimet e jashtme mund të veprojnë si përforcues pozitiv dhe janë një ndikues afatshkurtër shumë i mirë në arritjen e qëllimeve të menjëhershme⁵, ato mund të kenë një ndikim negativ afatgjatë në sjelljen e punonjësve. Rezultate studimesh tregojnë se punonjësit të cilët nuk presin shpërblime të jashtme, kanë një performancë më të mirë se ata që presin shpërblime.⁶ Megjithatë, shpërblimi i jashtëm mund të jetë i dobishëm kur administrohet nën kushtet e duhura, si në rastet e mungesës apo të niveleve të ulëta të motivimit të brendshëm apo kur puna është jo sfiduese dhe monotone.

Stimujt si një mjet motivues

Strategjitë e motivimit në vendin e punës përdoren shpesh nga organizatat për të rritur motivimin dhe produktivitetin, për të ulur shmangien dhe qarkullimin dhe për të mbajtur punonjësit e talentuar dhe të aftësuar. Teknika tipike motivuese, siç janë stimujt, shpërblimet dhe mirënjohjet, përdoren shpesh së bashku për të motivuar punonjësit.

Ndryshimi kryesor midis stimujve dhe shpërblimeve është se stimuli përcaktohet si diçka i cili shkakton një rrugë veprimi të caktuar, ndërsa shpërblimi jepet pas një sjelljeje të dëshirueshme për të rritur shanset që ajo sjellje të përsëritet. Me fjalë të tjera, kur ofrohet një stimul për arritjen e qëllimeve të caktuara, punonjësi ka të ngjarë që të shpenzojë sa më shumë energji dhe përpjekje, dhe stimuli i jepet kur qëllimi u arrit, por e gjitha kjo u shkaktohet nga stimuli. Organizatat përdorin shpërblimet si stimuj për të përforcuar sjellje të dëshirueshme. Mirënjohja, nga ana tjetër, është për

të treguar vlerësim për përpjekjet dhe kontributet pozitive, dhe në të njëjtën kohë për të përforcuar dhe inkurajuar sjellje në të ardhmen. Mirënjohja ndodh vetëm pasi sjellja është kryer dhe mund të ofrohet së bashku me shpërblimin. Në tërësi, edhe stimujt, edhe mirënjohja, janë mekanizma të dobishëm për të shkaktuar qëndrim pozitiv dhe për të motivuar punonjësit. Për qëllimin e këtij studimi, koncepti i stimujve, shpërblimeve dhe mirënjohjes do të studiohen nën kategorinë “stimuj”.

Stimujt monetarë i referohen shpërblimeve monetare që u jepen punonjësve, si për shembull bonuset, sigurimet, paga e dhënë kur largohen etj. Stimujt jo monetarë të prekshëm përfshijnë pagesën indirekte nëpërmjet trofeve, pllakave në mur, udhëtime, pajisje elektronike, si dhe shërbime, si për shembull autobus, festa, privilegje në klube të ndryshme, shërbim interneti etj. Stimujt jo monetarë të paprekshëm përfshijnë shpërblimet sociale dhe të lidhura me punën. Tek ato sociale përfshihen mirësjellja, mirënjohja etj, ndërsa ato lidhur me punën janë përparimi në karrierë, trajnimet dhe autonomia.⁷

Metodologjia

Për të arritur objektivat e studimit u përdor një metodë e përzier. Qasja e përzier përbëhet nga kombinimi i të dhënave cilësore dhe sasiore brenda një studimi.⁸ Avantazhi i përdorimit të kësaj metode është se të dhënat cilësore japin një interpretim të pjesëmarrësve lidhur me çështjen.⁹

Të dhënat u mblodhën duke përdorur një pyetësor të standardizuar. Pyetësi ishte përdorur në një studim të ngjashëm nga Lai në administratën e Singaporit. Të dhënat cilësore u morën nëpërmjet një pyetjeje të hapur, e dizenuar për të gjetur se si respondentët e interpretojnë fjalën “stimul”. Të dhënat sasiore përbëheshin kryesisht nga variabla të përshkruar shkurtimisht, të lidhur me objektivat e studimit. Për të testuar vlefshmërinë e pyetësorit fillestar, u bë pilotimi i tij te 5 pedagogë të rastësishëm. Pyetësi fillestar përmbante 5 seksione, 6 pyetje në seksionin e parë, 1 në të dytin, 1 në të tretin, 14 në të katërtin dhe 1 pyetje në seksionin e pestë me 30 shprehje. Pas pilotimit, u hoqën disa shprehje. Varianti final përmbante 20 pyetje.

U mat besueshmëria e instrumentit me alfa 0.71, në përputhje me shkallën e besueshmërisë edhe në studime të mëparshme në botë.

Popullata përbëhej nga të gjithë pedagogët e brendshëm të Universitetit të Korçës (168 pedagogë). Kampioni u përzgjodh rastësisht nga të gjithë fakultetet. Numri i kampionit ishte 100. Karakteristikat demografike të respondentëve përfshinin gjininë, moshën, niveli i edukimit, kohëzgjatjen në punë, si edhe fakultetit të cilit i përkisnin.

Rezultatet

Pjesëmarrësit në studim sipas gjinisë: Në këtë studim, femrat përbënin numrin më të madh të respondentëve (61 respondentë, përkatësisht 72.62%), ndërsa pjesa tjetër prej 27.38% i përkiste meshkujve. Përfaqësimi i çdo gjinie nuk është shumë i drejtë, pasi idealja do të ishte që numri i tyre të ishte pothuajse i barabartë.

Pjesëmarrësit në studim sipas moshës: Grupi më i madh i respondentëve i përkisnin grupmoshës 36-45 vjeç (33.33%), ndjekur më pas nga grupmosha 25-35 vjeç (30.95%). Grupmosha më e madhe (më shumë se 55 vjeç) përbënte 5.95% ndërsa ajo më e pak se 25 vjeç përbënte vetëm 1.19%. Pjesa tjetër prej 28.57% i përkiste grupmoshës 46-55 vjeç.

Pjesëmarrësit në studim sipas nivelit arsimor: Të dhënat tregojnë se pothuajse gjysma e respondentëve (45.24%) mbajnë gradën shkencore “Doktor”, ndjekur më pas nga 30.95% që mbajnë gradën shkencore “Profesor i Asociuar Doktor”, ndërsa 22.62% mbanin gradën shkencore


“Master”. Vetëm 1.19% mbante gradën “Profesor Doktor” dhe me gradën “Baçelor” nuk kishte asnjë.

Pjesëmarrësit në studim sipas eksperiencës në vite në arsim: Gjysma e respondentëve (50.00%) kishin më shumë se 10 vjet që punonin në atë institucion. Kjo tregon se qarkullimi në atë vend pune është shumë i vogël. Pjesa tjetër e respondentëve kishin 7-9 vite punë atje (22.62%), ndjekur nga 19.05% që kishin 4-6 vite. Grupet më të vogla i përkisnin ndarjes “1-3 vite” me 4.76% dhe “më pak se 1 vit” me 3.57%.

Rezultatet e faktorëve motivues

Pyetja e hapur kërkon të kuptohet se si respondentët e përcaktojnë konceptin e stimujve. U bë si një pyetje e hapur në mënyrë që respondentët të kishin mundësi të shpreheshin hapur. Tre përgjigjet më të shpeshta, sipas frekuencës, ishin motivim (stimulum), shpërblim monetar dhe vlerësim. Fjala “vlerësim” është disi e paqartë sepse nuk është shprehur se çfarë lloji vlerësimi respondentët mendonin, mund të jetë monetar ose jo. Siç mund të shihet, pjesa më e madhe i shikojnë stimujt si diçka motivuese. Përgjigje të tjera përfshinin: paga, drejtësi, mbështetje, faleminderit, shpenzime dhe certifikatë.

Pas pyetjes së hapur, respondentëve iu kërkua të zgjidhnin në qoftë se stimujt janë thelbësorë në motivimin e tyre. Shumica e tyre (92%) mendonin se stimujt ishin të rëndësishëm ose shumë të rëndësishëm. 5% ishin neutral dhe vetëm 3% mendonin se ato nuk ishin të rëndësishme. Stimujt mund të kenë njëfarë potenciali të limituar në motivimin e tyre, por është pothuajse i papërfillshëm.



Grafik nr. 1. Rëndësia e shpërblimeve

Sipas respondentëve, të pasurit të një mjedisi pune pozitiv është faktori më i fortë që i motivon ata. Rreth 82% ishin dakord. Mesatarja e mjedisit pozitiv të punës ishte 4.6, me një devijim standard 0.68.

Më pas, mesataren më të lartë e kishte vlerësimi (4.44, devijimi standard=0.65). Rreth 91% ishin dakord se vlerësimi do i bënte ata që të përmirësoheshin vazhdimisht. Asnjë respondent nuk kishte zgjedhur “aspak dakord” dhe pjesa tjetër ishin neutralë.

Marrëdhënia e mirë me kolegët ishte faktori i tretë më motivues (90% ishin dakord). Mesatarja është 4.43 dhe devijimi standard është 0.75. Vetëm një respondent nuk ishte dakord me këtë faktor, ndërsa 8% ishin shprehur neutralë.

Kanali efektiv i komunikimit ka një mesatare prej 4.35, me një devijim standard 0.78. Përsëri, vetëm një respondent nuk është dakord, 11.9% janë neutrale ndërsa 86.9% janë dakord.

Trajnimet janë faktori i pestë më motivues, shumë afër me kanalin efektiv të komunikimit, me një mesatare 4.3 dhe devijim standard 0.74. Rreth 88% të respondentëve ishin dakord, 10% neutralë dhe vetëm 1 nuk ishte dakord.

Mirënjohja është renditur ndër 5 faktorët më pak motivues. Për këtë shprehi, mesatarja ishte 4.25, me një devijim standard prej 0.77. Nga respondentët, 13.1% ishin neutralë, 2.38% nuk ishin dakord, ndërsa 84% binin dakord.

79% binin dakord që respekti nga të tjerët është faktor motivues; mesatarja=4.12, devijimi standard=0.83. Asnjë respondent nuk kishte zgjedhur “nuk jam dakord”, dhe vetëm 14.29% ishin neutralë.

Më pas, me një distancë prej 0.1 nga respekti, ndodhet përgjegjësia më e madhe, me një mesatare prej 4.11 dhe një devijim standard prej 0.93.

Paratë janë faktori më pak motivues. Mesatarja është 3.95 dhe devijimi standard 0.97. Rreth 10% nuk ishin dakord që paratë i motivojnë për të bërë përpjekje në punën e tyre, 80% ishin dakord, dhe vetëm 9% ishin neutralë.

Rezultatet e efektivitetit të faktorëve motivues

Qëllimi i pyetjes së tretë kërkimore është të ekzaminohet efektiviteti i stimuljeve të ndryshëm. Lista përbëhet nga faktorë që ishin motivues në terma afatshkurtër dhe në terma afatgjatë dhe respondentët duhet të zgjidhnin në qoftë se ato do t'i motivonin në planin afatshkurtër ose afatgjatë. Vihet re se në faktorët afatshkurtër, dy më të lartët lidhen me anën monetare, përkatësisht paga e lartë dhe bonusi monetar, si dhe ndodhet edhe një faktor që konsiderohet social, siç është festa apo evente të ndryshme. Punonjësit mendojnë se shpërblimet monetare janë të rëndësishme, por ama nuk janë thelbësore për punën e tyre.

Në faktorët afatgjatë vëmë re se shumica prej tyre lidhen drejtpërdrejt me punën. Zhvillimi i karrierës ka mesataren më të lartë, ndjekur ngushtësisht nga puna interesante. Faktorë të tjerë përfshijnë promovimin, mirënjohjen nga kolegët dhe superiorët dhe përmirësimi i aftësive dhe njohurive.

Diskutime dhe përfundime

Pyetja e parë kërkimore ishte që të kuptohej se si e konceptonin pedagogët fjalën “stimul”. Përgjigjja më e shpeshtë ishte “motivim”, kështu që mund të themi se gjëja e parë që u vjen ndërmend është që stimujt i bëjnë ata më të motivuar në punën e tyre. Stimujt mund të jenë monetare ose jo. Përgjigjja e dytë më e shpeshtë lidhej me shpërblimin monetar. Kjo tregon se një numër i konsiderueshëm punonjësish përpiqen që të kënaqin nivelin e parë të nevojave, bazuar në teorinë e Maslow, por nisur nga frekuenca më e lartë, ata gjithashtu synojnë që të jenë më të motivuar në

punën e tyre dhe të përpiqen sa më shumë për të arritur shkallët më të larta të nevojave, siç janë nevoja për vlerësim dhe vetë-aktualizim.

Lidhur me përgjigjet për pyetjen e dytë kërkimore, u gjet se tre faktorët të cilët ndikonin më shumë në motivimin e tyre ishin mjedisi pozitiv i punës, vlerësimi dhe marrëdhënia e mirë me kolegët. Faktorët lidhen me motivimin e jashtëm, që do të thotë se ata kanë nevojë që të motivohen së jashtmi për të kryer sa më mirë punën e tyre. Të tre këta faktorë lidhen me tre nevojat e para të hierarkisë së Maslow, nevojat fiziologjike, nevojat për shoqëri dhe vlerësim. Dy prej tyre lidhen me faktorët higjenik të teorisë së Herzberg. Kjo mund të nënkuptojë se ata i japin një rëndësi shumë të madhe kushteve të punës dhe marrëdhënieve me kolegët ose ata mund të mos jenë të kënaqur me këta faktorë, por do të donin që të ishin në nivele sa më të larta.

Faktorët motivues të brendshëm u identifikuan si faktorë motivues afatgjatë si pjesë të pyetjes së tretë kërkimore. Të gjithë motivuesit afatgjatë lidheshin direkt me punën. Kjo gjetje bie në kundërshti me gjetjet e mësipërme, pasi faktorët më motivues në këtë rast kishin të bënin me zhvillimin e karrierës, punën interesante, përmirësimi i njohurive dhe promovimi. Vetëm mirënjohja nga superiorët ose kolegët mund të mbështesë gjetjen se vlerësimi ishte një nga faktorët që rrisnin motivimin e tyre.

Sa i përket faktorëve afatshkurtër, stimujt e listuar lidheshin me pagën dhe bonuset monetare. Kjo tregon se paratë janë të nevojshme vetëm në rrethana të caktuara; në këtë rast ato i motivojnë punonjësit vetëm në planin afatshkurtër.

Referenca

(Endnotes)

- 1 McShane S.L., Von Glinow M.A. Organizational Behavior. New York: McGraw-Hill; 2010, fq. 31 – 33.
- 2 Robbins S.P., Coulter M. Management. Upper Saddle River, NJ; Pearson Prentice Hall; 2015, fq. 67 – 70.
- 3 Adams J. Managing People in Organizations: Contemporary Theory and Practice. London; Palgrave Macmillan; 2017, fq. 46.
- 4 Deci EL; Koestner R; Ryan RM;. A meta-analytic review of experiments examining the effects of extrinsic rewards on intrinsic motivation; 2012 *Psychol Bull*, fq. 627-668.
- 5 Adams J. Managing People in Organizations: Contemporary Theory and Practice. London; Palgrave Macmillan; 2017, fq. 46.
- 6 Gordon J. The extent of personality change: Rank order consistency, mean level change, individual level change, and ipsative stability. Griffith University Undergraduate Student Psychology Journal. 2014, fq. 53 – 60.
- 7 Armstrong M. Armstrong's handbook of human resource management practise. London and Philadelphia; Kogan page; 2016, fq. 23 – 24.
- 8 Rocco T.S., Bliss L.A., Gallagher S., Perez-Prado A. Taking the Next Step: Mixed Methods Research in Organizational Systems; 2013, fq. 40.
- 9 Marshall C., Rossman G.B. Designing Qualitative Research. California; Sage Publications; 2016, fq. 49.



**SHKENCAT
E APLIKUARA
DHE
EKONOMIKE**

SEKSIONI 3



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

PROBLEMATIKA E TRAJTIMIT TË AKTIVEVE BIOLOGJIKE NË SHQIPËRI

Albana JUPE*, Remzi SULO**, Ervis BEJKO*

*Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësorë i Tiranës

**Fakulteti i Ekonomisë, Albanian University

Adresë kontakti: albanajupe@ubt.edu.al

Përmbledhje

Njësitë ekonomike që kanë në fokusin e tyre maksimizimin e fitimit duke zhvilluar një aktivitet bujqësor, janë në qendër të këtij punimi. Nëse në vitin 2016 numërohen të regjistruara rreth 321,358 njësi ekonomike, nga këto 10% merren me aktivitetin e bujqësisë ose rreth 1,287 njësi ekonomike që operojnë si person fizik ose juridik dhe 31,372 fermerë të cilët kanë një aktivitet bujqësor. Për qëllim të raportimit financiar, të gjitha njësitë ekonomike të regjistruara pranë organeve tatimore duhet që për njohjen dhe vlerësimin e aktive biologjike të përdorin standardin kontabël të kontabilitetit të përmirësuar 13. Zbatimi i këtij standardi është i rëndësishëm, duke e bërë të krahasueshëm informacionin kontabël mbi aktivet biologjike të ofruara nga këto shoqëri tregtare që ushtrojnë aktivitet ekonomik në fushën e aktiveve biologjike. Qëllimi kryesor i këtij punimi është të theksojë problemet që hasen në praktikën kontabël të evidencës së aktiveve biologjike. Si metodologji kërkimi do të përdoret analiza krahasuese midis udhëzimeve dhe direktivave që jep SKK 13 ose SNK 41 dhe mënyrës se si zbatohen gjatë raportimit financiar të aktiveve biologjike. Pavarësisht rëndësisë që kanë praktikën e ofruara nga SNK 41, SKK 13, mungesa e kontabilitet bujqësor në programet e mësimdhënies në shkollat e larta pas viteve 1990 ka sjellë mangësi të theksuara dhe sfida që kontabilistët hasin gjatë zbatimit të këtij standardi. Për të nxjerrë përfundimet e këtij punimi, kemi analizuar pasqyrat financiare të njësive ekonomike që trajtojnë aktive biologjike, si dhe opinionet e kontabilistëve që ndërtojnë këto pasqyra. Problematika në vende të tjera është sjellë nëpërmjet rishikimit të literaturës përkatëse. Në fund, ne sjellim disa rekomandime që mund të sjellin përmirësime të praktikave kontabël në bujqësi.

Fjalë çelës: *njësi ekonomike, modeli vlera e drejtë, modeli i kostos, Standardi Kombëtar i Kontabilitetit, Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit.*

CHALLENGES ON BIOLOGICAL ASSETS ACCOUNTING PRACTISES IN ALBANIA

Abstract

Entities with agricultural activity aiming at maximizing the profit are in focus of this paper. In 2016, the number of register entities counted to 321,358, from which 10% are entities with agricultural activity, or around 1,287 entities operate as physical person or legal person, as well 31,372 farmers operate in agricultural sphere. All the entities registered near by the tax authorities should report the financial information and for the evaluation

and recognition of biological assets the national accounting improved 13 has to be applied. Implementation of this standard is essential comparing accounting information on the biological assets offered from the trading entities operating in the economic activity in the field of biological assets.

The main goal of this paper is to emphasize the problems encounter in accounting practice on recognizing the biological assets. As research methodology a comparative analysis between guidance and directives highlighted in national accounting 13 or international accounting standard 41 and way of adaptation and implementation by entities during the financial reporting of biological assets. Despite the importance of accounting practices offered by IAS 41 and NAS 13, the lack of agricultural accounting in teaching programmes after the 1990, has brought significant shortcomings and challenges faced by the accountants in the implementation of this standard.

The financial statements of entities with focus in biological assets have been analyzed as well the opinions of the accountants compiling these statements have been used to draw the conclusions of this paper.


Literature review has brought the challenges and insights on biological assets recognitions and evaluations in other countries. Finally we bring some recommendations in order to improve the accounting practices in agriculture.

Keywords: *entities with biological assets, fair value model, cost model, national accounting standard, international accounting standard.*

1. Hyrje

Në vendin tonë bujqësia vlerësohet si një sektor mjaft i rëndësishëm i ekonomisë sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, Regjistri i Ndërmarrjeve (INSTAT) (1), kjo bazuar në kontributin e saj me rreth 18.9% në Produktin e Përgjithshëm Bruto, ka të punësuar 47.8% të popullsisë dhe punohet vetëm 24.31% e tokës bujqësore. Megjithatë vërehet se ritmet e rritjes së këtij sektori janë më të ulëta se ato të rritjes ekonomike të deklaruar nga qeveria. Është kjo arsyeja që nisur nga zhvillimet e fundit në kontekstin e sfidave të integritetit europian, bujqësia po shihet si një prioritet gjithnjë në zhvillim që synon në prodhimin dhe tregtimin e produkteve të shëndetshme.

Njësitë ekonomike të vogla dhe të mesme në sektorin e bujqësisë kanë një rol të rëndësishëm në uljen e varfërisë dhe në zhvillimin ekonomik të vendit. Në vitin 2016, sipas INSTAT (1), raportohet se 10% e njësive ekonomike veprojnë në fushën e bujqësisë, siç shikohet në grafikun 1. Duhet që këto njësi të zhvillojnë më shumë aktivitetin e tyre bujqësor dhe blegtoral. Sa më shumë të orientohen këto aktivitete drejt tregtimit, aq më shumë do të kenë nevojë për shpërndarje informacioni dhe përdorim të vlerës së drejtë në vlerësimin e aktiveve biologjike.



Grafiku nr. 1. Struktura e njësive ekonomike në Shqipëri, Burimi: INSTAT

Si në çdo degë tjetër të ekonomisë, edhe sektori i bujqësisë raporton rregullisht aktivitetin e tij. Në vitet e fundit ndryshimet e ndodhura në fushën e raportimit kanë prekur edhe këtë sektor. Zhvillimet e brendshme dhe të jashtme nxorën në pah përshtatjen dhe harmonizimin, për të kaluar gradualisht tek implementimi i standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar. Vështirësitë dhe kostot për të implementuar versionin e plotë të tyre bënë që të hartoheshin standardet lokale dhe njësitet ekonomike do të raportonin në mënyrë të diferencuar sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006, si dhe në VKM nr. 742, datë 07.11.2007 “Kriteret e përzgjedhjes së njësive ekonomike që duhet të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit”.

Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, pas krijimit të tij në vitin 2004, hartoi dhe publikoi Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, midis të cilave ishte edhe SKK 13 për aktivet biologjike. Ky standard u hartua i orientuar nga SNK 41. Me qëllimin e mirë për të lehtësuar barrën e raportimit financiar dhe uljen e kostos së kontabilitetit, u caktua që aktivet biologjike të mateshin vetëm sipas modelit të kostos. Në korrik të vitit 2014 pësojnë ndryshime edhe vetë SKK-të, me datë efektive 1 janar 2015. SKK 13 i përmirësuar, për pjesën e aktiveve biologjike, lejon vlerësimin e tyre me modelin e vlerës së drejtë, por pa përjashtuar metodën e skontimit të flukseve. Një ndryshim shumë pozitiv tek SKK e përmirësuar është vlerësimi i prodhimit bujqësor jo më me kosto historike, por me vlerë të drejtë.

Ndryshimi i standardit për aktivet biologjike përfshin edhe pjesën e raportimit. Referuar SKK 2 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare – i përmirësuar*, Shtojca 1 *Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci)* aktivet biologjike afatgjata paraqiten si zë më vete (2). Kurse aktivet biologjike afatshkurtra dalin si nën zë tek pjesa e klasifikimit të inventarëve. Kjo paraqitje ngre pikëpyetje për faktin se si mund të klasifikohen aktivet biologjike afatshkurtra si inventar kur mënyra e tyre e vlerësimit është e ndryshme.

Për qëllim të raportimit financiar, të gjitha njësitet ekonomike të regjistruara pranë organeve

tatimore duhet që për njohjen dhe vlerësimin e aktive biologjike të përdorin standardin kontabël të kontabilitetit të përmirësuar 13 (3). Zbatimi i këtij standardi është i rëndësishëm, duke e bërë të krahasueshëm informacionin kontabël mbi aktivet biologjike të ofruara nga këto shoqëri tregtare që ushtrojnë aktivitet ekonomik në fushën e aktiveve biologjike. Qëllimi kryesor i këtij punimi është të theksojë problemet që hasen në praktikën kontabël të evidencës së aktiveve biologjike.

2. Rishikimi i literaturës

Në punimet e autorëve shqiptarë nuk ka reflektim të ndryshimeve dhe zbatimit të vlerës së drejtë në vlerësimin e aktiveve biologjike të njësitë ekonomike. Sektori i bujqësisë zë një vend të rëndësishëm në të ardhurat kombëtare dhe vitet e fundit vërehet një rritje e njësive ekonomike me aktivitet bujqësor. Këtë mangësi në praktikën kontabël e theksojnë dhe autorë të ndryshëm të huaj, punimet e të cilëve lidhen me zbatimin e IAS 41 në bujqësi. Feleaga (4) thekson ndryshimet që ka sjellë zbatimi i IAS në bujqësi dhe përmirësimet e krahasueshmërisë së pasqyrave financiare të njësive në sektorin bujqësor.

Zhvillimi i kontabilitetit në vendet e Bashkimit Evropian ka pësuar ndryshime të rëndësishme pasi u vunë në zbatim Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Ndryshimet që ekzistonin midis rregullave kontabël të zbatuara në vendet e Bashkimit Evropian pengonin një raportim financiar të besueshëm dhe të krahasueshëm. Direktivat e iniciuara nga Bashkimi Evropian, të tilla si direktiva e Katërt, Shtatë dhe Tetë, luajtën një rol të rëndësishëm në vendosjen e rregullave të reja mbi kontabilitetin. Sipas direktivës së Katërt, të gjitha aktivet, detyrimet dhe rezultati financiar duhet të vlerësohen në kuadër të konceptit të vlerës së drejtë.

Në një përmbledhje të studimeve të bëra në Turqi në lidhje me zbatimin e SNK 41 për njohjen dhe vlerësimin e aktiviteteve biologjike, autori Duman (5) ka theksuar disa nga problemet dhe sfidat që hasen gjatë zbatimit të këtij standardi. Si një gjetje e këtij punimi vlen të theksohet fakti që në Turqi matja e aktiviteteve bujqësore bëhet sipas parimit të kostos kur raportohet pranë organeve tatimore dhe me vlerën e drejtë në rregulloret e SNK 41 (5). Athanasios (6) shqyrtoi ndryshimet midis praktikave kontabël në praktikë dhe informacionit kontabël në sektorin bujqësor në Greqi dhe arriti në përfundimin se fermat janë kryesisht me madhësi të vogël, të drejtuara nga familja, kanë trajnime të kufizuara në kontabilitet dhe financë, nuk kanë evidencë kontabël në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e konstatuara, operojnë vetëm me anë të sistemit monetar, dhe raportojnë vetëm për efekt të tatimeve.

3. Metodologjia e kërkimit

Për të realizuar objektivat e këtij punimi do të analizohen pasqyrat financiare të njësive ekonomike të regjistruara si shoqëri tregtare pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB). Për të analizuar pasqyrat financiare të hartuara nga njësitë ekonomike të cilat veprojnë në sektorin e bujqësisë, është përdorur si kod NIPT i tyre në adresën elektronike të faqes së QKB si në vijim http://www.qkr.gov.al/nrc/Kerko_Per_Subjekt.aspx. Me anë të kësaj adrese elektronike janë shfletuar ekstratet historike të njësive ekonomike me status person juridik dhe më pas janë analizuar pasqyrat e tyre financiare. Gjithsej persona juridik të regjistruar në QKB, të cilët veprojnë në industrinë e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit, janë 240. Midis tyre ka njësi ekonomike të cilat janë klasifikuar gabimisht si të tilla pasi veprojnë në tjetër sektor. Numri i tyre arrin në 35 njësi ekonomike ose 14.6%. Në këtë mënyrë numri i personave juridikë të regjistruar në QKB dhe që veprojnë realisht në sektorin

e bujqësisë, blegtorisë dhe peshkimit është 205 njësi ekonomike. Të gjitha këto njësi kanë zbatuar standardet kombëtare të kontabilitetit për hartimin e pasqyrave të tyre financiare. Këto pasqyra financiare janë analizuar nën këndvështrimin e përdorimit të SKK 13. Analiza e përmbajtjes së këtyre pasqyrave është përdorur për të vënë në pah problemet që hasen gjatë raportimit të aktiveve biologjike në njësitë ekonomike shqiptare.

4. Analiza dhe rezultatet e kërkimit

4.1 Njësitë ekonomike të regjistruara si shoqëri tregtare

Njësi ekonomike të regjistruara me aktivet në sektorin e bujqësisë janë 127. Prej tyre kanë depozituar dhe publikuar pasqyra financiare vetëm 36 njësi ekonomike ose 28.3%. Njësitë ekonomike të tjera ose kanë publikuar pasqyra financiare më të fundit duke filluar nga viti 2014 dhe më herët në 23 raste, ose nuk kanë të publikuar asnjë pasqyrë financiare në 68 raste.

Nga njësitë ekonomike në sektorin e bujqësisë të cilat kanë të publikuara pasqyra financiare për vitin 2015, kanë paraqitur të klasifikuar në zëra më vete aktivet biologjike afatshkurtra dhe aktivet biologjike afatgjata vetëm 4 njësi ekonomike nga 36, ose 11.1%. Prej tyre kanë përdorur si model vlerësimi të aktiveve biologjike modelin e vlerës së drejtë 0 njësi ekonomike. Të gjitha njësitë ekonomike të cilat veprojnë në sektorin e bujqësisë dhe kanë publikuar pasqyra financiare për vitin 2015, nuk e kanë përdorur fare modelin e vlerës së drejtë për vlerësimin e aktiveve të tyre biologjike. Njësi ekonomike të cilat veprojnë në sektorin e blegtorisë janë regjistruar 45. Prej tyre kanë publikuar pasqyra financiare vetëm 24 ose 53.3%, pjesa tjetër, 21 njësi, nuk kanë publikuar pasqyrat financiare.

Nga njësitë të cilat kanë publikuar informacion financiar, vetëm 4 njësi ose 16.7% i kanë paraqitur të klasifikuar në zëra më vete aktivet biologjike afatshkurtra dhe aktivet biologjike afatgjata. Në të gjitha rastet vlerësimi i këtyre aktiveve është bërë me modelin e kostos historike, pa e përdorur në asnjë rast modelin e vlerës së drejtë.

Njësi ekonomike të cilat veprojnë në sektorin e peshkimit, janë regjistruar 33. Prej tyre kanë publikuar pasqyra financiare vetëm 13 ose 39.4%, pjesa tjetër, 20 njësi, nuk kanë publikuar pasqyrat financiare.

Nga njësitë të cilat kanë publikuar informacion financiar, vetëm 1 njësi ose 7.7% i kanë paraqitur të klasifikuar në zëra më vete aktivet biologjike afatshkurtra dhe aktivet biologjike afatgjata. Në të gjitha rastet vlerësimi i këtyre aktiveve është bërë me modelin e kostos historike, pa e përdorur në asnjë rast modelin e vlerës së drejtë edhe në sektorin e peshkimit.

Në mënyrë të përmbledhur të dhënat e mësipërme paraqiten si në tabelën nr 2 në vijim:

Tabela nr. 2. Njësitë ekonomike dhe raportimi financiar.

Sektori	Njësi	PF të publikuara	Klasifikim i zërave	Kosto Historike
Bujqësia	127	36	4	4
Blegtoria	45	24	4	4
Peshkimi	33	13	1	1
Totali	205	73	9	9

Burimi: Llogaritje të autorëve

Nga të gjitha njësitë ekonomike të regjistruara, vetëm 35.6% e tyre i publikojnë pasqyrat financiare, dhe nga këto 12.3% i paraqesin më vete aktivet biologjike në postet përkatëse të pasqyrës së pozicionit financiar. Në asnjë rast aktivet biologjike nuk janë vlerësuar me modelin e vlerës së drejtë. Në të gjitha rastet aktivet biologjike janë vlerësuar sipas modelit të koston.

4.2 Analiza e problematikës së hasur

Siç vihet re në përmbajtjen e pasqyrave financiare të njësive ekonomike me aktivitet bujqësinë, asnjë prej tyre nuk ka përdorur vlerën e drejtë për vlerësimin e vlerës së aktiveve biologjike, por kanë përdorur modelin e koston historike. Në vijim ne kemi kontaktuar me disa ekspertë të cilët auditojnë pasqyrat financiare të njësive ekonomike me aktivitet bujqësor. Në përgjigje të një pyetësi me pyetje të hapura, kemi nxjerrë disa problematika që ata theksuan dhe të cilat do të shërbejnë si rekomandime për ndryshime.

Së pari, këto njësi nuk kanë mundur të përdorin vlerën e drejtë për vlerësimin e aktiveve biologjike sepse nuk ka një treg aktiv nga i cili drejtimi mund të sigurojë një informacion të besueshëm dhe me kosto të ulët. Mungesa e një tregu aktiv sipas standardit kërkon vlerësim të informacionit të tregut dhe një analizë të treguesve në ekonomi, si dhe kushtet e raportimit të periudhave të mëparshme. Nëse ekonomia ka tregues të qëndrueshëm, mund të përdoren çmimet e fundit në vlerësimin e vlerës së drejtë. Të gjitha këto mundësi përshkruhen në lidhje me përcaktimin e vlerës së drejtë, por në praktikë kjo ngelet vetëm në kuadër të opinionëve të drejtuesit dhe nëse do të kërkohej opinion i një audituesi, atëherë do të kishim një kosto të lartë, gjë që nuk i përmbush kriteret e përcaktimit të vlerës së drejtë.

Së dyti, nuk ekzistojnë rregulla dhe udhëzime të mirëfillta në lidhje me veçoritë që paraqesin aktivet biologjike, si dhe një plan llogarish për të bërë një pasqyrim të krahasueshëm midis njësive ekonomike.

Së treti, ka mungesë të udhëzimeve në lidhje me politikat ose procedurat kontabël që duhet të ndjekin këto njësi ekonomike. Çfarë metode duhet të përdoret për amortizimin e aktiveve biologjike afatgjata, në cilat raste ato amortizohen, cilat norma duhet të përdoren, në cilat faza bëhet kalimi si rezultat i ndryshimeve fizike dhe sasiore të kafshëve, çfarë normash duhet të përdoren.

Së katërti, kontabilistët theksuan mungesën e trajnimeve dhe materialeve shpjeguese. Aq më tepër në shënimet shpjeguese të standardit të përmirësuar SKK 13, shembujt e marrë në shqyrtim nuk reflektojnë realitetin e bujqësisë në Shqipëri si shembulli i drurit të kakaos.

Së pesti, legjislacioni fiskal në Shqipëri nuk përputhet me specifikat që kërkon trajtimi kontabël i aktiveve biologjike në standard. Ndryshimet që vijnë si rezultat i matjes me vlerën e drejtë, përmbledhen në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve duke rritur vlerën e rezultatit ose e kundërta.

5. Përfundime

Në këtë punim ne trajtuam problematikën e organizimit kontabël të njësive ekonomike në Shqipëri, dhe veçanërisht vështirësitë që hasen gjatë trajtimit të aktiveve biologjike, si dhe modeli i përdorur në vlerësim. Me qëllim që kontabiliteti të jetë një mjet i rëndësishëm i drejtimit, mendojmë se duhet të bëhen disa ndryshime në standardin kombëtar të kontabilitetit mbi aktivet bujqësore 13. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit duhet të sigurojë manuale në formën e udhëzimeve mbi praktikën kontabël të aktiveve biologjike. Njëkohësisht, trajnime mbi përdorimin e SKK 13 do të shërbenin për një përdorim më të saktë në praktikë të këtij standardi.

Në vijimësi të materialeve të siguruara nga KKK, një listë e llogarive në lidhje me aktivitetet

bujqësore duhet të mbajë parasysh të gjitha veçoritë e këtij sektori.

Një tjetër aspekt i cili duhet të studiohet dhe të rekomandohet nga studiuesit e fushës, është edhe përdorimi i modelit të vlerës së drejtë dhe efektit të këtij përdorimi për efekt të tatimeve. Të gjitha njësitë ekonomike që veprojnë në Shqipëri, nuk kanë mundësinë praktike për të përdorur vlerën e drejtë.

Një tjetër rekomandim do të ishte edhe informacion në lidhje me llogaritjen e kostos. Mënyra dhe teknika të shpërndarjes së shpenzimeve të përgjithshme do t'u jepnin mundësi drejtuesve të kishin gjykime më të sakta në lidhje me kostot në bujqësi dhe blegtori.

6. Referenca

1. Instituti i statistikave, Regjistri i Ndërmarrjeve [Raport vjetor], 2016, fq. 9-10, <http://www.instat.gov.al/al/publikime/>, Tiranë, Albania.
2. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Standardet Kombëtare të Përmirësuara, SKK 02 Paraqitja e Pasqyrave Financiare - i përmirësuar, 2014, fq. 3-4, paragrafi 10 <http://kkk.gov.al>, Tiranë, Albania.
3. Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, Standardet Kombëtare të Përmirësuara SKK 13 Aktivitet Biologjike dhe marrëveshjet konçesionare - i përmirësuar, 2014, fq. 3-5, (paragrafi 12,14,15) <http://kkk.gov.al>
4. Feleaga&Raileanu, V2012. IAS implementation challenges-the case of Romania, World academy of sciences, engineering and technology, 63:415-418.
5. Duman H., Özpeynirci R & Içerli M. Agricultural activities – TAS 41, International journal of academic research in accounting, 2012;2;118-131.
6. Athanasios, V Stergios A & Laskaridou E C, The importance of information through accounting practice in agricultural sector, Journal of social sciences, 2010;2;221-228.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

ROLI I KOMUNIKIMIT NË E-LEARNING: KATËRKËNDËSHI DIDAKTIK

Lekë Pepkolaj*, Genta Rexha*

*Departamenti i Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Albanian University

Adresë kontakti: l.pepkolaj@albanianuniversity.edu.al

Përmbledhje

Mundësitë e ofruara nga e-learning janë dukuri gjithmonë e më të pranishme në kërkimin shkencor lidhur me nxënien në disiplina specifike, duke nxjerrë në pah aspekte të reja në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. Dija varet nga komunikimi dhe është e lidhur ngushtë me proceset e paraqitjes dhe ndërmjetësimit të saj. Në këtë kuadër merr rëndësi të veçantë ndryshimi i rolit të komunikimit në aspektet epistemologjike, pedagogjike dhe didaktike lidhur me e-learning. Ky artikull do të shërbejë si pjesë teorike për koordinimin e sistemeve semiotike me një rëndësi të madhe në edukimin matematik dhe në veçanti, do të përqendrohem në aspektin kognitiv, metakognitiv dhe jokognitiv. Qëllimi i këtij punimi është të nxjerrë në pah fuqitë edukative të platformave të e-learning (ambiente mësimdhënie dhe nxënie) në kontekstin e përparësive dhe kufizimeve që kanë burimet didaktike që gjenden në këto platforma, të përballura me aspekte të edukimit matematik në planin kognitiv e gjithmonë e më shpesh në atë tërheqës dhe emocional.

Fjalë çelës: e – learning dhe matematika, komunikimi, rolet, katërkëndëshi didaktik.

THE ROLE OF COMMUNICATION IN E-LEARNING: DIDACTIC QUADRILATERAL

Abstract

The opportunities offered by e-learning are increasingly present in research related to learning in specific disciplines, highlighting new aspects in teaching-learning process. The knowledge depends on communication and is closely related to the process of its representation and mediation. In this context, the changing role of communication is of importance in the epistemological, pedagogical and didactic aspects related to e-learning. This paper will serve as a theoretical framework for the coordination of semiotic systems of great importance in the mathematical education and we will focus on the cognitive, metacognitive and non-cognitive aspects.

The goal of this paper is to highlight the potential of e-learning platforms (teaching and learning environments) concerning the advantages and limitations of their didactic resources, faced with aspects of mathematical education in the cognitive view and increasingly in the affective and emotional one.

Keywords: e – learning and mathematics, communication, roles, didactic quadrilateral.

1. Hyrje

Mundësitë e ofruara nga *e-learning* janë gjithmonë e më të pranishme në lidhje me kërkimin shkencor në nxënien e disiplinave specifike, duke nxjerr në pah aspekte të reja në procesin e mësimdhënies/nxënies. Matematika ndërton një terren të privilegjuar për të studiuar fuqitë e *e-learning*, si për rolin që luan në të gjitha disiplinat shkencore, si për vështirësitë specifike që krijon në planin *kognitiv* e gjithmonë e më shpesh në atë tërheqës dhe emocional [1]. Nevojat e sotme dërgojnë drejt një kërkimi shkencor për të rakorduar fuqitë e *e-learning* me karakteristikat e veçanta të disiplinave. Ky punim përqendrohet në aspektet *kognitive*, *metakognitive* dhe *jo kognitive* të lidhura ngushtë me aspektet më shqetësuese të matematikës, siç janë ato të komunikimit dhe sistemet semiotike. Në këndvështrimin e *e-learning* do të shfrytëzojmë fuqitë edukative të platformave të saj (ambiente mësimdhënie dhe nxënie) në kontekstin e përparësive dhe limiteve që kanë burimet didaktike në këto platforma, të përballura me aspektet e lartpërmendura të edukimit matematik [2]. Është e rëndësishme të theksohet roli i ndërmjetësimit semiotik në *e-learning*, për të cilin do të konsiderojmë katër pjesë [3]:

- ai që ndërmjetëson - ndërmjetësi (mund të jetë mësuesi, mentori ose kush ka përgatitur lëndën);
- diçka që është ndërmjetësuar - lënda/forca/energja e prodhuar nga ndërmjetësi;
- marrësi i ndërmjetësimit (studenti/nxënësi);
- rrethanat e ndërmjetësimit, mënyrat (mjetet) dhe vendi (platformat e *e-learning*).

2. E-Learning dhe matematika

E-learning ka një ndikim të madh në nivel ndërkombëtar në shumë aspekte të sistemeve të mësimdhënies/nxënies, në të gjitha nivelet e arsimit. Fleksibiliteti i tij lejon të kalohen kufijtë hapësinorë e kohorë të mësimdhënies tradicionale, duke e përshtatur dhe duke e vendosur më pranë nevojave *kognitive* e *jokognitive* të studentëve. Pa dyshim, nuk është se mund të jepet një “recetë universale” për të përdorur në mënyrë optimale *e-learning* në mësimdhënien/nxënien e matematikës. Janë shumë faktorë për t’u konsideruar: perceptimi metodologjik, konteksti, mundësitë e burimeve të lëndës, etj. Mund të ndeshim përparësi për studentin dhe pedagogun, të cilat rrjedhin nga pikëprerja e fuqive të *e-learning* me veçoritë e matematikës. Duhet theksuar edhe vështirësitë që mund të hasen në këto raste, si [4]:

- perceptimi izolues, mungesa ndërvepruese ballë për ballë;
- mungesa e kompetencave teknologjike, në veçanti e *software*-ve të posaçëm.

2.1 Përparësitë për studentin/nxënësin

Shumë kërkues shkencorë kanë nënvizuar që rezultatet e nxënies janë të ndikuara nga faktorë që mund të konsiderohen të paktën në tri nivele të ndryshme:

- niveli *jo kognitiv*: lidhet me bindjet, emocionet dhe qëndrimet dhe të gjitha aspektet tërheqëse. Shumë shpesh këto aspekte drejtojnë subjektin që të vendosë dhe të veprojë;
- niveli *metakognitiv*: si udhëheqin subjektet proceset e tyre;
- niveli *kognitiv*: lidhet me përvetësimin e ideve dhe metodave karakteristike të disiplinës, dhe në veçanti pengesat që i njihen nga kërkimet shkencore dhe nga praktika.

Përparësi për nivelin jokognitiv

Përshtatja me instrumentet teknologjike prodhon emocione (në kuptimin joshës) dhe qëndrime të rëndësishme për nxënien [1]. Për shembull:

- subjektet mund të përdorin instrumentet *online* në orare në të cilat janë më të disponueshëm. Ata kanë mundësinë për të pyetur dhe marrë ndihmë nga pedagogu dhe mentori;
- veprimtaritë që parashikojnë *feedback* automatik mund të jenë më pak stresuese dhe më të këndshme për studentët, në krahasim me veprimtaritë e kryera në praninë e pedagogut, shokëve;
- mundësitë e shumëllojshme të veprimtarive, të ndara sipas vështirësive, tipologjisë së argumenteve [5], lejojnë studentët të fillojnë nga argumentet që ata njohin, duke zvogëluar mundësinë e zhgënjimit dhe duke rritur ndjenjën e *self-efficacy*¹.

Mundësia që një grup studentësh të bashkëpunojë *online* për të përgatitur provimin e një lënde matematike, mund të ndikojë në shumë aspekte, si *kognitive* dhe *jokognitive*, përmes:

- qëndrimeve të subjekteve përballë njohurive matematike, për shembull të kuptuarit në sensin më pak statik dhe dogmatik;
- kuptimit të organizimit konceptual të disiplinës, falë mundësive të projektimit të një teksti duke pasur në dispozicion një seri materialesh, burimesh;
- qëndrimeve të subjekteve përballë gjuhës së matematikës, që mund të bëhet një instrument aktiv për të dhënë produkte që lidhen me nevojat e shtjelluara;
- kompetencave gjuhësore.

Përparësi për nivelin metakognitiv

E-learning mund t'i ofrojë studentëve mundësinë për të shkuar përtej nxënies “konstante”. Mundësitë e provave vetëvlerësuese, hyrja në burime të ndryshme të lëndës dhe veprimtarive që studentët mund të zgjedhin, vendos në provë vetëdijet e tyre metakognitive dhe stimulon aftësinë për të organizuar drejtimin formues [1, 5].

Përparësi për nivelin kognitiv

Platformat informatike lejojnë krijimin dhe grumbullimit e një sasive shumë të madhe veprimtarish, të qëndrueshme që ndryshojnë nga vështirësitë, nëntemat, tipologjitë, edhe në bazë të sistemeve semiotike të zgjedhura. Mundësitë e shumta paraqitëse të platformave lejojnë të punohet duke përdorur një shumicë shenjash (*për shembull*: shënime algjebrike, grafikë, tabela numrash, tekste verbale etj.). Në veçanti, platformat lejojnë realizimin e shënimeve, leksioneve, pyetësorëve, detyrave, shpjeguesëve (fjalorëve) dhe të tjera burime për të cilat sistemet semiotike të ndryshme përdoren edhe në mënyrë të kombinuar për të pasuruar “*ofertën*” dhe duke e kthyer më të përshtatshme për përdoruesin.

Tjetër përparësi është sasia e madhe e materialeve, dërrasa plot me shënime, fletë të shndritshme me skica, formula, argumente, produkte gjatë orës së mësimi të një leksioni të matematikës. Regjistrimi i punës së bërë në klasë gjatë leksioneve dhe diskutimeve mund të jetë i rëndësishëm për nxënien. Shpesh ky material humb në qoftë së mendojmë shpjegimet mbi dërrasat e zeza tradicionale. Puna e bërë në klasë mund të krijohet dhe të ruhet në formë digjitale. Ky arkiv i progresit të klasës në matematikë mund të bëhet një burim për nxënien [1, 6].

2.1 Përparësitë për pedagogun/mësuesin

Përdorimi më i mirë i instrumenteve teknologjike për të mbështetur përmirësimin e nxënies së studentëve, është në vetvete një përparësi edhe për pedagogun. Një tjetër aspekt që duhet konsideruar është përsëritja (gjatë orëve të seminareve në një ose disa klasa) e përgjigjeve nga pedagogu e të njëjtave pyetje, që paraqesin një student apo grup studentësh, të cilët kanë munguar

në orën e mësimit të kaluar. Nëpërmjet platformave *e-learning*, në qoftë se një argument është me interes për gjithë klasën, mund të jetë më e lehtë dhe efikase për t'i dhënë të gjithë studentëve përgjigje për pyetje të përbashkëta [7]. Për sa i përket përpunimit të materialeve didaktike, në dukje rezulton të jetë një rritje e punës për pedagogun, por në të ardhmen ajo ripaguhet, për shembull në mundësinë e ripërdorimit të materialeve të përgatitura. Provat e vetëvlerësimit ose veprimtaritë që parashikojnë një *feedback* automatik për studentët, lehtësojnë punën vlerësuese të pedagogut.

3. Ndërrimi i roleve të komunikimit

Përdorimi i teknologjive të edukimit dhe në veçanti kontaktet me *e-learning* [4] lehtësojnë kalimin nga një paradigmë (model) didaktik i përqendruar tek figura e mësimitdhënësit ekspert drejt një paradigme premtuese, në të cilën studentët kanë një rol aktorësh kryesorë dhe aktivë në proceset e tyre të nxënies. Në këtë perceptim roli i mësimitdhënësit ndryshon: nga një rol i lidhur me transmetimin e njohurive zhvendoset drejt një roli të “lehtësuesit”, i një specialisti që projektin kursin (lëndën), udhëheq dhe mbikëqyr proceset e nxënies së studentëve. Nga ana tjetër, studenti tenton të bëhet më autonom në kërkimin e mjeteve informatike dhe njohëse të lidhura me argumentet e posaçme. Studentët përvetësojnë nga nxënia e tyre, nga zhvillimi personal dhe ata nxënë me ndihmën e mësimitdhënësit, teknologjive dhe studentëve të tjerë. Mund të ndodhë që studentët perceptojnë më shumë “praninë” e pedagogut gjatë një kursi të kryer në platformat *e-learning*, sesa gjatë një kursi tradicional, duke u ndier rregullisht të ndjekur e të kontrolluar gjatë procesit të tyre të nxënies [8].

Shohim ri-përkufizimin e roleve në proceset e mësimitdhënien/nxënies në një platformë *e-learning*. Në përgjithësi, duhet të kemi parasysh ndarjen e roleve që diktohen nga kompetenca të ndryshme që hyjnë në lojë (mes zhvilluesëve, studentëve, mësuesve, mentorëve, ...). Është e rëndësishme të sqarohet ndarja e roleve dhe kompetencat e çdonjërit. Në figurën 1 është dhënë trekëndëshi i didaktikës [9] në të cilin kulmet janë “nxënësi” “mësuesi” dhe “njohuritë”, me të gjitha lidhjet mes tyre, të paraqitura nga “brinjët” e trekëndëshit.




Figura 1. Trekëndëshi i didaktikës




Figura 2. Katërkëndëshi i didaktikës

Ky trekëndësh transformohet në një strukturë më komplekse me kulme “të reja” dhe relacione (lidhje) të ndryshme pas hyrjes së përdorimit të platformave *e-learning* (Figura 2). Kulmet tani janë katër: autori, mentori, nxënësi, njohuritë [10].

3.1 Kulmet e katërkëndëshit didaktik

Autori

Në mësimdhënien tradicionale, mësuesi është në të njëjtën kohë autor, mentor dhe vlerësues i lëndës. Ndërsa në një ambient *e-learning*, është e mundur të fokusohemi në dy figura [6]: autori dhe mentori. Me autor nuk mendojmë një person të vetëm, por një grup në të cilin janë persona më aftësi të ndryshme profesionale, që mund të jenë projektues/administrues edukativ, ekspert vizatimi, ekspert i teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK), ekspert i didaktikës së përgjithshme dhe të disiplinës, ekspert pedagogjik, sociolog, ekspert komunikimi, etj. Midis këtyre figurave është thelbësore ajo e ekspertit të didaktikës së disiplinës, që është përgjegjës i çështjeve që lidhen me pyetjet “çfarë të mësojmë”, “çfarë të bëjmë për të nxënë”, “cilat janë vështirësitë relative të koncepteve të caktuara?”, “cilat metoda didaktike të përdorim?”, “si të bëjmë vlerësimin?”, etj.

Njohuria

Me njohuri (dije) kuptojmë, si në rastin klasik, njohurinë akademike, zyrtare, rezultatin e kërkimit shkencor, pra atë që skicon lëndën e sistemit edukativ dhe paraqet karakteristika specifike strukturore, metodologjike, historike dhe kulturore. Interes të veçantë kanë disa aspekte kryesore që ndikojnë mbi kulmin “njohuritë” për shkak të futjes së TIK dhe në veçanti: *mënyra të reja të paraqitjes, njohuri të reja, ndërthurje disiplinash*.

Mbi të gjitha, instrumentet e TIK lejojnë mënyra të reja të paraqitjes së njohurive të disiplinës. Ka një ndryshim të madh të bësh matematikë me “letër e laps” ose në ambientet TIK, në veçanti duke përdorur platformat e *e-learning*. Këto teknologji mund të japin eksperiencë dhe ndërtim domethëniesh të reja [10]. Domethëniet e “qëndrueshme” u shtohen ato “dinamike”, “ndërvepruese”, tek përpunimet “fizike” shtohen ato “virtuale”, si simulimet dhe animacionet. Dy tipet e përpunimit janë plotësuese dhe zgjidhen në bazë të nevojave. Në matematikë “animacion” nuk i referohet vetëm “objekteve”, por në aspektin më të përgjithshëm edhe proceseve. Zakonisht fjala ‘animacion’ shoqërohet vetëm me lëvizjet e figurave gjeometrike, por edhe proceset mund të bëhen të “animuara”. Pa ndihmën e teknologjive është më e vështirë të eksplorohej, për shembull, gjeometria fraktale, *wavelet* dhe të tjera fusha edhe zbatuese. Ndërthurja e disiplinave favorizohet, të paktën për njohuritë teknologjike dhe gjuhësore.

Nxënësi

Me nxënës, përveç nxënësve të shkollave, studentëve në kohën e sotme kuptojmë edhe punëtorë, profesionistë, të rritur të përfshirë në një formim të përhershëm (informal). Për të mos hequr përgjegjësinë e nxënësit, këto platforma (ambiente nxëniesje) duhet të strukturohen në mënyrë të tillë që autori të mos jetë i vetmi përgjegjës në zgjedhjen e njohurive domethënësve për nxënësin. Platforma duhet të strukturohet në mënyrë të tillë që nxënësi mund të bëjë zgjedhjet e veta në bazë të preferencave, interesave, motivimeve. Është e rëndësishme t’i lihet nxënësit mundësia e thellimit duke shkuar përtej programeve standarde, duke i dhënë lidhje me fusha të ndryshme të dijes [6, 10].

Mentori

Mentori është figura e “privilegjuar” e kësaj strukturë të re. Është figura që ka kontaktin real me studentët. Duke folur për “mentorin” nuk i referohemi detyrimisht një personi të vetëm, por shpesh, një grup individësh me të njëjtat kompetenca, çdonjëri prej të cilëve merret me një numër të caktuar studentësh.

Roli i mentorit përfshin fusha të ndryshme [10]:

- *fusha e administrimit dhe organizimit* - mentori duhet të drejtojë rrugën e vetë studentit dhe të grupit, duke autorizuar persona të aftë për problemet e mundshme teknike që kanë studentët.
- *fusha sociale* - mentori ka për detyrë të stimulojë relacionet mes nxënësve dhe duhet të jetë një lloj moderator, duke krijuar një klimë të komunitetit të nxënies², duke inkurajuar bashkëpunimin dhe duke bërë të ndjehet prania dhe disponueshmëria e tij.
- *fusha e didaktikës* - mentori ka për detyrë të mbështesë studentët në përcaktimin e drejtimeve të tyre të nxënies, t’i udhëheqë në përzgjedhjen e materialeve, t’u sigurojë atyre kuptimin e lëndës, t’i mbështesë në zhvillimin e një mendimi kritik dhe në ndërtimin e njohurisë, të korrigjojë konceptet e gabuara. Në këtë kuptim, mentori duhet të jetë një ekspert i didaktikës së disiplinës. Pra, mentori shpesh nuk është ai që vlerëson studentët, por është për ta vetëm një “udhëzues”.

3.2 Lidhjet në katërkëndëshin didaktik

Pa dyshim, edhe lidhjet mes kulmeve në Figurën 2 modifikohen nga ndikimi i përdorimit të platformave *e-learning* [2].

Autori-njohuritë - veprimtaria që karakterizon këtë relacion është kalimi nga “grumbulli” i njohurive tek njohuritë që duhet të jenë mësuar edhe nëpërmjet projektimit të situatave “a-didaktike”³ përgjatë së cilës nxënësi ndërton njohuritë e tij. Në mësimdhënie në përgjithësi, pra edhe në përdorimin e platformave *e-learning* i duhet dhënë më rëndësi proceseve sesa produkteve, ndryshe, nxënësi rrezikon të mësojë çfarë duhet bërë, por pa kuptuar domethënien, me qëllimin e vetëm të mbajmë rezultatin korrekt. E gjithë kjo kalon nga përmbajtja e lëndës për nga mënyrat sesi strukturohen, nga metodologjitë për t’i përshtatur apo për t’i paraqitur etj. Është thelbësore faza e projektimit. Platformat mbështesin zhvillimin e aftësive të studentëve në proceset e “trajtimeve”⁴ dhe “shndërrimeve”⁵. Si përfundim, autori duhet të përpunojë, organizojë dhe ndajë pjesët didaktike në mënyrë që të jenë të ndërlidhura me qëllimet e vëna për të arritur tek studenti qëllimet e nxënies së parashikuar.

Autori – nxënësi - midis këtyre dy kulmeve nuk ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë (për këtë vija që bashkon këto dy kulme është e ndërprerë), marrëdhënia është ndërmjetësuar nga njohuria, edhe në qoftë se, padyshim, veprimtaria e autorit, edhe pse jo drejtpërdrejtë, ka përfunduar te nxënësi.

Nxënësi – njohuria - përdorimi i teknologjive ka pasur një ndikim të madh mbi hyrjen tek njohuritë, duke eliminuar kufijtë hapësinorë-kohorë. Duhet të theksohet se ka një ndryshim mes përdorimit të internetit dhe platformave, ku te këto të fundit gjenden njohuritë e strukturuara, kontrolluara dhe të modeluara për qëllime didaktike. Në një platformë ka kontroll të vlefshmërisë dhe cilësisë, ndryshe nga ajo që ndodh në rrjet, ku shpeshherë është e vështirë të arrish të dallos informacionet e vlefshme nga ato të pavlefshme.

Autor – mentor, kjo lidhje karakterizohet nga folja “bashkëpunoj”. Bashkëpunimi është i një rëndësie thelbësore për të ndaluar vështirësitë e ardhura nga koncepte të ndryshme dhe nga mosshpërndarja e mundësive, si mundësitë metodologjike në bazë të platformës. Jo gjithmonë janë kushtet që kjo lidhje të ekzistojë (për këtë shkak vija që bashkon këto dy kulme është e ndërprerë).

Mentor – nxënës, mund të thuhet që foljet që karakterizojnë këtë lidhje janë “lehtësoj”, “këshilloj”, “udhëheq”. Në rastin e *e-learning* kjo marrëdhënie është me dy drejtime më shumë sesa në didaktikën tradicionale: jo vetëm mentori kërkon një ndërveprim nga studentët, por shpesh studentët rastësisht i drejtohen mentorit. Edhe pse mentori nuk është përgjegjës i zgjedhjes së materialeve të lëndës për platformën, është një person referimi (ndihmës) për zgjedhjet që duhet të bëjnë nxënësit, një zgjidhës i koncepteve të gabuara që mund të lindin, një organizator i vlefshmërisë së njohurive, nga fazat e socializimit dhe të institucionalizimit, etj. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është që mentori duhet të kuptojë faktorët emocionalë të sjelljes së nxënësve. Mentori nuk është ai që vlerëson, kështu që krijohet një “kontratë didaktike” e ndryshme me lidhjen tjetër nxënës – mësues.

Mentori – njohuritë, kjo lidhje është e filtruar nga lidhja mentor – nxënës, përderisa zgjedhjet që bën mentori për njohuritë janë gjithmonë të drejtuara tek nxënësit (vija e ndërprerë). Mentori administron kurset, mund të përcaktojë programin e punës, përparësitë, detyrat, të vendosë cilat metodologji dhe materiale të përdoren (tekste, dokumente, video, simulime, audio, tekste multimediale etj.).

Nxënës – nxënës, kjo lidhje karakterizohet nga folja “socializoj”, e cila merr një rëndësi të madhe në ambientet e *e-learning*. Në didaktikën tradicionale kjo lidhje është natyrale, falë bashkëpunimit fizik të nxënësve dhe mësuesit. Por nuk mund të përjashtojmë në proceset e nxënies ndërveprimin

social, teknologjitë e reja munden dhe duhet të mbështesin një nxënie bashkëpunuese nëpërmjet sistemeve të komunikimit, shpërndarjen e materialeve didaktike, sisteme që mbështesin procese të grupeve sinkrone dhe josinkrone. Nevoja për t'i dhënë rëndësi faktorëve “socialë” ka bërë të lindin ato që quhen komunitete të nxënies² dhe komunitete të praktikës⁶.

4. Përfundime

Sot *e-learning* është gjithmonë e më i pranishëm në procesin e mësimdhënies/nxënies dhe kërkimi shkencor duhet të shkojë drejt rakordimit të fuqive të *e-learning* me karakteristikat e veçanta të disiplinave. Rasti i matematikës është pak specifik dhe kjo kërkon një sforcim të madh të kërkimit shkencor, madje edhe ndërdisiplinor. Në këtë kuadër mes të tjerave, merr rëndësi të veçantë edhe ndryshimi i roleve të komunikimit, ku padyshim ndihmon në koordinimin e sistemeve semiotike që dërgojnë drejt një nxënie vërtetë domethënëse.

Katërkëndëshi didaktik përfshin dy figura të ndara, autorin dhe mentorin, të cilët kontribuojnë në rritjen dhe pasurimin e njohurive të nxënësit, përmes ekspertizës së tyre, orientimit, udhëzimit dhe mbështetjes së studentëve.

Nga ana tjetër, studentëve përmes përdorimit të instrumenteve të TIK, i jepet mundësia e thellimit duke shkuar përtej metodave klasike, duke krijuar tek ai të menduarin kritik.

Platformat *e-learning* eliminojnë kufizimet në hapësirë dhe kohë të shkollave klasike, duke u dhënë mundësinë e studimit të një discipline të veçantë edhe punëtorëve, profesionistëve dhe të rriturve. Përmes këtyre platformave, studentët ndërveprojnë me njëri-tjetrin duke forcuar kështu punën në grup, duke ballafaquar dhe duke ndarë idetë.

5. Referenca

- [1] Ferrari, P. L. Le potenzialità dell'e-learning in educazione matematica e il ruolo della ricerca. TD Tecnologie Didattiche, 19 (3), (2011), 136-141.
- [2] Albano, G. E-learning e matematica: stato dell'arte tra ricerca in tecnologia e didattica. L'Educazione Matematica, Serie X, Vol. 3, n. 1, (2013). pp. 1-8.
- [3] Hasan, R. Semiotic mediation, language and society: three exotripic theories - Vygotsky, Halliday and Bernstein, 2002, 96-99. <http://www.uct.ac.za/depts/pgc/sochasan.html>.
- [4] Pepkolaj, L; Rexha, G. Zhvillimi i e-learning: Kërkimi shkencor në teknologji dhe didaktikë, Optime, ISSN: 2220 – 461X, 2017, 151 – 158.
- [5] Pepkolaj, L. “Difficoltà in matematica: percorsi di autoformazione in e-learning”, teza e doktoraturës mbajtur pranë Universitetit të Studimeve në Salerno, Itali, 2015, 78-79.
- [6] Coppola, C.; Pacelli, T.; Pepkolaj, L. E-learning e matematica: stato dell'arte tra ricerca in tecnologia e didattica. L'Educazione Matematica, Serie X, Vol. 3, n. 1, 2013, pp. 9-44.
- [7] Deschamps X. S., Bass H., Bolaños Evia G., Seiler R., Seppälä M. e-Learning Mathematics. A Panel Discussion at International Congress of Mathematicians, Madrid, 2006, 156-167.
- [8] Trentin, G. Apprendimento cooperativo in rete: un possibile approccio metodologico alla conduzione dei corsi online. TD Tecnologie Didattiche, 2005, 36, 3, 47 – 61.
- [9] D'Amore B. Elementi di Didattica della Matematica. Bologna: Pitagora. 1999, 34-37.
- [10] Albano, G., Balderas Puga, A., Sbaragli, S. Mathematics education in e-learning environment: hoè the triangle “pupil-teacher-knowledge” changes. Rapporto di Ricerca – Centro di Eccellenza “Metodi e Sistemi per l'Apprendimento e la Conoscenza”. 2004, 123-125.

Fjalori

(Endnotes)

- 1 *self-efficacy* – mund të përcaktohet si një aftësi krijuese në të cilën qëllimi është të drejtojë nënaftësitë e veçanta konjitive, sociale, emocionuese dhe sjelljes në mënyrë të efektshme për zgjidhjen e qëllimeve specifike.
- 2 *komunitete të nxënies* – në këtë komunitet klasa mendohet të jetë një komunitet i efektshëm, ku çdo njëri mund të luajë një rol, mund të ndërrohen detyrat dhe përgjegjësitë. Çdo anëtar i komunitetit është i konsideruar si një burim që mund të konsultohet për të pasur informacione, përgjigje, stimuj dhe për të ndarë njohuritë.
- 3 *a-didaktika* – mësuesi sugjeron veprimtari pa dhënë me hollësi qëllimin, nxënësi është i vetëdijshëm që të gjitha veprimtaritë në klasë kanë për qëllim ndërtimin e njohurive të reja, por në këtë rast nuk di saktësisht nga fillimi çfarë do të mësojë.
- 4 *trajtime* – kuptojmë ato transformime të paraqitjeve brenda të njëjtit sistem semiotik (për shembull tek sistemi i gjuhës verbale, në folur e të shkruar).
- 5 *shndërrime* – kuptojmë kalimin nga një paraqitje e një sistemi semiotik në një tjetër, pa ndërruar objektin në fjalë (për shembull, kalimi nga një shprehje algjebrike e një funksioni tek grafiku i tij, kalimi nga një tabelë te një histogramë, etj.).
- 6 *komunitete të praktikës* – këto komunitete ndërtohen kur një grup personash që ndajnë interesa për të njëjtat veprimtari vendos të ndërveprojë në tentativë informale (joformale). Çdo njeri ka njohuritë dhe eksperiencat e tij që mund të shpërndahen në zgjidhjen e të njëjtave veprimtari.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

MIGRIMI DHE VARFËRIA NË VENDET E EVROPËS QËNDRORE DHE LINDORE: NJË ZBATIM I MODELIT TË GRAVITETIT (2007-2016)

Emi Malaj*, Visar Malaj**

*Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Vlorës, “Ismail Qemali”

**Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, lektor i jashtëm pranë Albanian University

Adresë kontakti: visar86@yahoo.it

Përmbledhje

Vendimi për të migruar është një funksion i disa variablave, të cilat ndihmojnë ose pengojnë migrimin dhe mund të shënohen me shenja pozitive ose negative. Faktorët negativë përfshijnë problemet sociale dhe ekonomike në vendet e origjinës, siç janë varfëria, shkelja e të drejtave, konfliktet politike dhe të armatosura etj. Nga ana tjetër, faktorët pozitivë lidhen me kushtet e vendeve pritëse si të ardhurat e larta, gjuha e përbashkët, niveli i sigurisë së lartë etj. Ky dokument përqendrohet në fenomenin e emigrimit në disa vende të Europës Qendrore dhe Lindore dhe mbi faktorët përcaktues përkatës. Ne vlerësojmë një model origjinal të gravitetit duke përfshirë disa variabla të pavarur që lidhen me çështjet tipike për vendet në zhvillim, siç janë varfëria, papunësia dhe korrupsioni. Sipas testeve diagnostifikuese, ekuacioni i vlerësuar përshtatet mirë me mostrën tonë. Autoritetet e vendeve të EQL duhet të orientojnë politikën e tyre drejt krijimit të vendeve të reja të punës dhe zbutjes së pabarazisë. Kjo do të çojë në një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe në zvogëlimin e daljeve të ardhshme të migracionit.

Fjalë kyçe: *vendet e EQL, migrimi, varfëria, teoria e gravitetit.*

MIGRATION AND POVERTY IN CEE COUNTRIES: A GRAVITY MODEL APPROACH (2007 – 2016)

Abstract

The decision to migrate is a function of several variables, which help or obstruct migration and can be marked with positive and negative signs. Negative factors include social and economic problems in home countries, such as poverty, rights violation, political and armed conflicts etc. On the other hand, positive factors are related with host countries conditions, such as high income, common language, high security level etc. This paper is focused on the emigration phenomenon in some CEE (Central and Eastern European) countries and on the corresponding determinants. We estimate an original gravity model including some independent variables that are related with typical concerns for developing countries, such as poverty, unemployment and corruption. According to the diagnostic tests, the estimated equation fits well our sample. Authorities of CEE countries should orient their policies

toward the creation of new jobs, the elimination of corruption and of the culture of impunity, and the mitigation of inequality. This will lead to a sustainable economic growth and to the reduction of future migration outflow.

Keywords: *CEE countries, migration, poverty, gravity theory.*

Hyrje

Një emigrant ndërkombëtar është një person i cili jeton përkohësisht ose përgjithmonë në një vend tek i cili ai/ajo nuk është rezident. Fluksi i emigrantëve në një destinacion specifik lidhet pozitivisht me nivelin e diversitetit përkatës të zonave dhe njerëzve. Kushtet e këqija ekonomike në vendet e origjinës çojnë në rritjen e flukseve të migracionit. Si rezultat, ne gjejmë një numër të madh të emigrantëve në vendet më të pasura dhe një nivel të konsiderueshëm mobiliteti në vendet më pak të zhvilluara. Çdo fluks provokon një kundërpërgjigje: një pjesë e rëndësishme e emigrantëve kthehen në vendin e tyre për shkak të recesioneve ekonomike.

Pasojat e migracionit mund të ndikohen nga variablat të shtytjes dhe tërheqjes. Variablat e shtytjes janë të lidhura me vendin e origjinës dhe përfshijnë disa probleme sociale dhe ekonomike. Emigrantët i tërheqin faktorë të ndryshëm në vendet pritëse, siç janë nivelet e larta të të ardhurave dhe sigurisë. Emigrantët kontribuojnë në zhvillimin e vendit të tyre; ata mund të nxisin tregtinë, investimet e huaja dhe turizmin. Remitancat botërore në vendet në zhvillim arritën në rreth 442 miliardë dollarë në vitin 2016, ndërsa numri i punëtorëve emigrantë për të njëjtin vit arriti në 250 milionë (1). Për më tepër, vendet e origjinës vuajnë nga “largimi i trurit” në vendet e zhvilluara: largimi i njerëzve të kualifikuar dhe të arsimuar për paga më të mira, kushte jetese më të mira dhe pasuri. Emigrantët gjithashtu kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në rritjen ekonomike të shumë vendeve pritëse. Ata luajnë një rol të rëndësishëm në konsolidimin e fuqisë punëtore, kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe taksave. Nga ana tjetër, një menaxhim i keq i fluksit të emigrantëve ose një konflikti i mundshëm në vendin e origjinës mund të çojë në rritje të papunësisë dhe konflikteve sociale në vendin pritës.

Fokusi kryesor i këtij punimi është vlerësimi i lidhjeve ndërmjet emigrimit nga disa vende të EQL dhe një grupi faktorësh, me qëllim rekomandimin e reformave dhe politikave të duhura. Në seksionin 2 ne raportojmë fakte të rëndësishme dhe shifra mbi migracionin ndërkombëtar dhe përcaktuesit përkatës në disa vende të EQL. Në Seksionin 3 japim një pasqyrë të teorive të migracionit dhe të zbatimeve përkatëse të kaluara. Në Seksionin 4 ne përcaktojmë dhe vlerësojmë ekuacionin e gravitetit duke përdorur një grup të dhënash që përfshijnë stokun e emigrimit nga CEE drejt disa destinacioneve evropiane dhe një sërë faktorësh të rëndësishëm. Në pjesën e fundit të punimit raportohen përfundimet.

Fakte dhe shifra

Numri i shtetasve të EQL të cilët migrojnë në vendet e zhvilluara evropiane është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Kjo është rezultat i rritjes së varfërisë, papunësisë dhe pabarazisë sociale. Figura e mëposhtme tregon PBB-në për frymë në vitin 2016 për shumicën e vendeve të EQL, të cilat nuk janë vërtet pjesë e Bashkimit Evropian dhe ndajnë shumë karakteristika të tjera të përbashkëta shoqërore dhe ekonomike (2). PBB për frymë në vitin 2016 për Malin e Zi ishte rreth 6,700 dollarë amerikanë, ndërsa vlera përkatëse për Moldavinë ishte 1,900 US \$. GDP mesatare për frymë në të njëjtin vit për vendet e BE ishte rreth 32,000 US \$. Figura 2 tregon përqindjen e popullsisë që jeton nën vijën kombëtare të varfërisë për vendet e EQL (3). Rreth 32% e popullsisë

në Armeni jetojnë nën nivelin e varfërisë, ndërsa Bjellorusia ka përqindjen më të ulët (rreth 5.7%). Përkufizimi i vijës kombëtare të varfërisë ndryshon midis vendeve, prandaj duhet të krahasojmë me kujdes të dhënat.

Figura 1. PBB për frymë (US \$ aktuale) në vitin 2016 për vendet e EQL

Burimi: Përpunimi i autorëve në të dhënat e Bankës Botërore





Figura 2. Popullsia nën vijën e varfërisë (%) në 2012-2016 për vendet e EQL

Burimi: Përpunimi i autorëve në të dhënat e Agjencisë Qendrore të Inteligjencës (CIA)



Armenia, Bjellorusia, Gjeorgjia, Moldavia dhe vende të tjera jo anëtare të BE janë pjesë e Politikës Evropiane të Fqinjësisë, e cila ka si qëllim nxitjen e integritit dhe marrëdhëniet pozitive midis vendeve. Një nivel i lartë i varfërisë dhe ndikimi i Rusisë janë pengesat kryesore për pranimin në BE për shumicën e këtyre vendeve. Armenia dhe BE nënshkruan në vitin 1996 Marrëveshjen e Partneritetit dhe Bashkëpunimit, e cila hyri në fuqi në vitin 1999 dhe shërben si kornizë ligjore për marrëdhëniet dypalëshe BE – Armeni. Në shkurt 2017, Armenia dhe BE nënshkruan një marrëveshje që do të forcojë marrëdhëniet ekonomike dhe politike. Franca, Gjermania dhe Spanja

janë destinacionet kryesore për emigrantët armenë. Numri i armenëve në Gjermani në vitin 2016 ishte rreth 12.000, ndërsa numri i armenëve që jetojnë në Francë në të njëjtin vit ishte 13.000 (4). Qytetarët moldavë mund të udhëtojnë pa vizë në Eurozonë që nga prilli i vitit 2014. Destinacionet kryesore të BE për moldavët janë Italia dhe Spanja me përkatësisht rreth 150.000 dhe 18.000 qytetarë në 2016 (4). Në 2014, Gjeorgjia dhe BE ratifikuan Marrëveshjen e Asociimit, e cila hyri në fuqi në korrik 2016. Qytetarët gjeorgjianë mund të udhëtojnë pa vizë në Eurozonë që nga marsi i vitit 2017. Greqia dhe Franca janë destinacionet kryesore për emigrantët gjeorgjianë. Numri i gjeorgjianëve që jetojnë në Greqi në 2016 ishte rreth 30.000, ndërsa numri i gjeorgjianëve që jetonin në Francë në të njëjtin vit ishte 12.000 (4). Në vitin 1995, Bjellorusia dhe BE nënshkruan një Marrëveshje Partneriteti dhe Bashkëpunimi, por ajo nuk u ratifikua nga BE. Bjellorusia nuk ka aplikuar për pranimin në BE. Destinacionet kryesore të BE për emigrantët Bjellorus janë Italia dhe Franca me përkatësisht rreth 10.000 dhe 9.000 qytetarë në 2016 (4).

Në qershor të vitit 2006 Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit (BE) me BE, e cila hyri në fuqi në prill të vitit 2009. Shqiptarët mund të udhëtojnë pa vizë në Eurozonë që nga dhjetori 2010. Vendet e BE-së i dhanë Shqipërisë statusin e kandidatit në qershor 2016. Destinacionet më të rëndësishme evropiane për shqiptarët janë Greqia, Italia dhe Gjermania. Numri i shtetasve shqiptarë që banonin në Gjermani në vitin 2016 ishte rreth 31.000, ndërsa numri i banorëve shqiptarë në Itali ishte 475.000 (4). Sipas burimeve joformale, numri i përgjithshëm i shtetasve shqiptarë që banojnë në Greqi është më shumë se 600.000. Në nëntor 2007 qeveria serbe nënshkroi SAA me BE, e cila hyri në fuqi në shtator 2013. Qytetarët serbë mund të udhëtojnë pa nevojën e vizave në Eurozonë që nga dhjetori 2009. Në mars të vitit 2012, Serbia mori statusin e kandidatit dhe në janar 2014, Këshilli i Europës filloi negociatat zyrtare të pranimit. Njohja e pavarësisë së Kosovës është një problem i pazgjidhur për Serbinë dhe një pengesë e rëndësishme për anëtarësimin në BE. Gjermania dhe Austria janë vendet me numrin më të madh të serbëve në Evropë. Banorët gjermanë me prejardhje serbe ishin rreth 310.000 në vitin 2016, ndërsa numri i shtetasve serbë që banonin në Austri ishte rreth 120.000 (4). Në vitin 2004 SAA midis BE dhe Maqedonisë hyri në fuqi. Në vitin 2005, Komisioni Evropian akordoi statusin e kandidatit për Maqedoninë, katërmbëdhjetë vjet pas shpalljes së pavarësisë nga ish-Jugosllavia. Në vitin 2009 maqedonasit morën të drejtën për të udhëtuar pa pasur nevojë për viza në Eurozonë. Në vitin 2012, Komisioni Evropian filloi një dialog të pranimit të nivelit të lartë me autoritetet maqedonase, një kontribut për përshpejtimin e reformave në administratën publike dhe reformat zgjedhore, mbrojtjen e të drejtave të pakicave, nxitjen e konkurrencës së tregut dhe rritjen ekonomike. Mosmarrëveshja me Greqinë është një pengesë e rëndësishme për pranimin e Maqedonisë në BE. Autoritetet greke e konsiderojnë 'Maqedoninë' një term grek, që lidhet me një rajon të lashtë grek. Greqia do të ushtrojë të drejtën e vetos për të penguar anëtarësimin e Maqedonisë në BE nëse ky problem mbetet i pazgjidhur. Rruga maqedonase në BE është gjithashtu e kushtëzuar nga marrëdhëniet e tensionuara me autoritetet bullgare, të cilët kanë shprehur indinjatën e tyre ndaj shtrembërimit të historisë midis dy vendeve. Mbrojtja e të drejtave të pakicave shqiptare është një problem tjetër, i ndërlidhur me pranimin e Maqedonisë në BE. Shqiptarët duhet të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta si maqedonasit. Komunitetet më të mëdha të maqedonasve jetojnë në Gjermani, Itali dhe Zvicër. Në vitin 2016 në Itali jetonin 73.000 shtetas maqedonas (4). Numri i maqedonasve në Gjermani për të njëjtin vit ishte 85,000, ndërsa numri i maqedonasve që jetonin në Zvicër ishte 65,000 (4). Qytetarët boshnjakë mund të udhëtojnë në zonën e euros pa viza që nga dhjetori 2010. BE dhe Bosnja dhe Hercegovina filluan dialogun e nivelit të lartë për procesin e pranimit në vitin 2012. Marrëveshja ndërmjet Bosnjës dhe Hercegovinës dhe BE hyri në fuqi

në vitin 2015. Gjermania dhe Austria janë dy nga destinacionet më të rëndësishme për emigrantët e Bosnjës dhe Hercegovinës. Ishin rreth 170.000 shtetas boshnjakë që banonin në Gjermani në vitin 2016, ndërsa numri i boshnjakëve që banonin në Austri ishte 94.000 (4). Mali i Zi është një shtet i pavarur që nga shpërbërja e Bashkimit të Serbisë dhe Malit të Zi pas referendumit të majit 2006. Mali i Zi rihapi negociatat e reja të pranimit me BE dhe nënshkroi SAA në vitin 2007, i cili hyri në fuqi në maj 2010. Malazezët mund të udhëtojnë pa vizë në Eurozonë që nga dhjetori 2009. Pas opinionit të favorshëm të Komisionit Evropian për aplikimin për anëtarësim në BE, Mali i Zi filloi negociatat për anëtarësim në vitin 2012. Gjermania dhe Zvicra janë destinacionet më të rëndësishme të Evropës Perëndimore për emigrantët malazezë. Në vitin 2016 kishte 2.800 malazezë që banonin në Zvicër. Numri i emigrantëve malazezë për këtë vit në Gjermani ishte 22.000 (4). Kosova është një kandidat potencial për pranimin në BE. Kuvendi i Kosovës shpalli pavarësinë në një seancë të jashtëzakonshme në vitin 2008. Numri i shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara që tashmë e kanë njohur pavarësinë e Kosovës ishte 115 në dhjetor 2017; nga këto, 23 vende janë anëtare të BE. SHBA dhe BE kanë ndihmuar vazhdimisht Kosovën dhe autoritetet e saj në rrugën drejt përparimit ekonomik dhe në konsolidimin e sundimit të ligjit. Shumica e vendeve të BE-së kanë zyrat diplomatike dhe ambasadat e tyre në Kosovë. Në vitin 2015 Kosova nënshkroi MSA (Marrëveshjen për Stabilizim Asociim) me BE, e cila është një nxitje e rëndësishme për zbatimin e reformave. Në Gjermani dhe Zvicër mund të gjejmë komunitetet më të mëdha të kosovarëve. Në vitin 2016 numri i qytetarëve kosovarë që banonin në Gjermani dhe Zvicër ishte përkatësisht 195.000 dhe 100.000 (4).

Rishikimi i literaturës

Vendimi për të migruar është një funksion i disa variablave, të cilat ndihmojnë ose pengojnë migrimin dhe mund të shënohen me shenja pozitive ose negative (5). Faktorët negativë përfshijnë problemet sociale dhe ekonomike në vendet e tyre, si: varfëria, shkeljet e të drejtave, konfliktet politike dhe të armatosura etj. Nga ana tjetër, faktorët pozitivë lidhen me kushtet e vendeve pritëse, siç janë të ardhurat e larta, klima më e mirë, gjuha e përbashkët, niveli i sigurisë etj. Si rezultat, ne gjejmë nivele të larta të emigrantëve në vendet më të pasura dhe një nivel të konsiderueshëm mobiliteti në vendet më pak të zhvilluara. Një pjesë e rëndësishme e emigrantëve kthehen në vendin e tyre të origjinës për shkak të recesioneve të mundshme ekonomike ose për të mësuar ose zhvilluar aftësi të veçanta. Emigrantët në një vend të caktuar nuk janë një kampion i mirë i popullsisë përkatëse, për shkak të mënyrave të ndryshme të përshtatjes ndaj disa faktorëve specifikë. Njerëzit e suksesshëm në vendet e origjinës kanë më shumë gjasa t'u përgjigjen pozitivisht faktorëve të vendit pritës dhe anasjelltas. Faktorë të tjerë relevantë si mosha, gjendja martesore, gjinia, arsimi, profesioni dhe madhësia e familjes mund të stimulojnë ose parandalojnë migrimin.

Modeli i sektorit të dyfishtë përfshin dy sektorë, një sektor urban, i cili mund të jetë publik ose privat dhe karakterizohet nga një produktivitet i lartë marxhinal i punës, dhe një sektor rural, me produktivitet marxhinal shumë të ulët të punës (6). Sektori rural, më pak i zhvilluar përfshin vendet e punës të cilat quhen të vetëpunësuar dhe joformale, ku pagat dhe produktiviteti janë të ulëta, ndërkohë që sektori urban është i qeverisur nga industrialistët që ofrojnë vende pune në fabrika dhe plantacione, duke siguruar paga të larta. Pagat, diferencat e të ardhurave dhe zgjerimi i sektorit industrial nxisin emigrimin nga sektori më pak i zhvilluar. Migrimi i punëtorëve vazhdon përderisa ndryshimi në kërkesën për punë zerohet, dhe si rezultat rritet produktiviteti i përgjithshëm i punës. Punësimi i emigrantëve do të stimulojë produktivitetin dhe investimet në sektorin urban (7). Hendeku i krijuar nga lëvizja e njerëzve mund të shfrytëzohet për të kontribuar në përparimin

e sektorit rural, kështu që si rezultat, politikat e ardhshme duhet të stimulojnë investimet dhe rritjen ekonomike në të dy sektorët ekonomikë. Ndryshimet në paga dhe në papunësinë urbane janë dy faktorë kyç të lëvizjes nga sektorët rurale në ato urbane (8). Njerëzit do të emigrojnë vetëm nëse të ardhurat urbane janë dukshëm më të mëdha se produkti rural. Variablat e punësimit dhe pagat në sektorin urban janë të lidhura pozitivisht me të ardhurat. Produktiviteti i punës në sektorin bujqësor dhe pagat dhe të ardhurat përkatëse janë gjithashtu në një lidhje të drejtpërdrejtë. Individët do të emigrojnë nga njëri sektor në tjetrin derisa të arrihet ekuilibri midis pagës reale të pritshme në sektorin e zhvilluar dhe pagës reale rurale. Rritja e të ardhurave rurale do të inkurajojë migrimin; kjo do të thotë se kostoja e mundësive për punë në sektorin urban është më e lartë se në sektorin rural. Migracioni ndërkombëtar i fuqisë punëtore në përgjithësi është i ndikuar nga variablat tërheqës (9). Vendet e zhvilluara karakterizohen nga një treg i dyfishtë i punës: një treg kryesor i përbërë nga vende pune stabël dhe fitimprurëse për punëtorët vendas dhe një treg më pak i zhvilluar i vendeve të pasigurta dhe të pakualifikuara që kryhen nga emigrantët. Të dy pagat e ulëta dhe ekzistenca e një numri të konsiderueshëm emigrantësh, çojnë në refuzimin e këtyre vendeve të punës nga punëtorët vendas. Ata tërhiqen nga një pagë më e mirë me të ardhura më të larta.

Emigrantët me kualifikim të lartë dhe të integruar mirë në tregun e punës kanë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike dhe kontribuojnë në reduktimin e diferencave të pagave midis punëtorëve të huaj dhe vendas (10). Migracioni konsiderohet si një institucion dhe lidhet me disa aspekte specifike të shoqërisë siç janë traditat, rregulloret, vlerat dhe parimet (11). Rrjetet janë infrastruktura që stimulojnë migracionin dhe ndihmojnë në përcaktimin e destinacioneve të mundshme dhe intervaleve të qëndrimit. Ato gjithashtu ulin kostot e transaksionit dhe kontribuojnë në integrimin në vendet pritëse. Tiparet endogjene të rrjeteve gjithashtu mund të pengojnë migrimin. Flukset e migracionit mund të shpjegohen nga variablat bazë të gravitetit, si dallimet e PBB-së, distanca (dypalëshe midis vendeve) dhe popullsia (12; 13).

Metodologjia

Shumë autorë kanë vlerësuar modele të ndryshme të gravitetit për migracionin duke u bazuar në hipoteza të lidhura me faktorët përkatës (14; 15; 16). Modelet e gravitetit bazohen në ligjin e gravitetit të Njutonit dhe janë përdorur gjerësisht për shkak të fuqisë së tyre të lartë shpjeguese. Sipas kësaj teorie, migrimi midis dy vendeve lidhet pozitivisht me madhësitë përkatëse dhe lidhet negativisht me distancën dypalëshe ndërmjet vendeve. Ekuacioni bazë i gravitetit përfshin popullatën si vlerësues të madhësisë së vendit dhe distancën përkatëse. Sipas rezultateve empirike, në një kampion prej 230 vendesh, në vendet me më shumë korrupsion inkurajohet emigrimi edhe për shkak të kushteve të paparashikueshme ekonomike, pasigurisë dhe një cilësie të ulët të jetës (17). Faktorë të tjerë shtytës përfshijnë popullatën, gjuhën e përbashkët dhe kufirin e përbashkët, ndërsa distanca dypalëshe zvogëlon migrimin. Rezultatet e një modeli graviteti për 200 vende për periudhën 1960-2010 treguan një rritje të presioneve migratore në të ardhmen e afërt (18).

Në këtë seksion ne vlerësojmë dy modele të ndryshme graviteti, “bazë” dhe “i zgjeruar”. Versioni i zgjeruar i modelit përfshin disa nga faktorët e migracionit të EQL, të cilët merren parasysh në teorinë mikro dhe makro të migracionit. Modeli bazë përfshin PBB-të e vendeve të origjinës dhe të vendit pritës dhe distancën përkatëse. Tabela në vijim tregon përkufizimet e variablave të marrë në konsideratë.

Tabela 1. Përkufizimet e variablave

Variablat	Përshkrimi
<i>Migrat_od</i>	<i>Stoku i migracionit nga origjina o në destinacionin d në vitin t</i>
<i>GDPcap_o</i>	<i>GDP për frymë në o në vitin t</i>
<i>GDPcap_d</i>	<i>GDP për frymë në d në vitin t</i>
<i>pop_o</i>	<i>Popullsia në o në vitin t</i>
<i>pop_d</i>	<i>Popullsia në d në vitin t</i>
<i>Distanca</i>	<i>Distanca bilaterale</i>
<i>unemp_diff</i>	<i>Diferenca midis normave të papunësisë o / d</i>
<i>corr_diff</i>	<i>Diferenca midis indekseve të perceptimit të korrupsionit d/o</i>

Ekuacionet janë vlerësuar për një kampion të veçantë që përfshin stokun e migracionit të EQL në destinacionet kryesore evropiane për periudhën 2007-2016. OECD (Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik) dhe Eurostat (Statistikat Evropiane) ishin burimet tona kryesore për të dhënat e migracionit. PBB-të dhe të dhënat përkatëse të popullsisë u morën nga baza e të dhënave të Bankës Botërore. Distancat bilaterale janë marrë nga baza e të dhënave GeoDist CEPII (19). Të dhënat e normave të papunësisë janë marrë nga Eurostat dhe Banka Botërore, ndërsa indekset e perceptimeve të korrupsionit janë llogaritur nga Transparency International.

“Pooled OLS” rezultoi metoda më e përshtatshme e vlerësimit. Në këtë rast, mesatarja e mostrës së gabimit idiosinkratik, duke pasur parasysh variablat shpjegues në të gjitha periudhat kohore dhe efektin e pavëzhguar, është zero. Çdo variabël i pavarur ndryshon me kalimin e kohës për të paktën disa njësi dhe nuk ekziston ndonjë lidhje e përsosur lineare midis variablave të pavarur. Tabela 2 tregon rezultatet e vlerësimit për ekuacionet e formuluar; në të dyja rastet, variablat shprehen në formë logaritmike. Shenjat e koeficientëve ndjekin pritjet teorike dhe parametrat janë statistikisht të rëndësishëm, prandaj mund të konfirmojmë rëndësinë e faktorëve të migracionit. R-squared është i lartë për ekuacionin e dytë, kështu që variablat shpjegues shpjegojnë një përqindje të lartë të ndryshueshmërisë së variablit të varur. Për më tepër, vlerat e koeficientit janë të krahasueshme me analiza të ngjashme të kaluara.

Tabela 2. Rezultatet e vlerësimit: koeficientët dhe vlerat përkatëse

Variablat e pavarur	Ekuacioni bazik	Ekuacioni i zgjeruar
<i>Intercept</i>	-6,5 (0,001)	-2,5(0,001)
<i>GDPcap_o</i>		-1,6(0)
<i>GDPcap_d</i>		1,7(0,02)
<i>pop_o</i>	1,41(0,005)	1,3(0)
<i>pop_d</i>	1,15(0)	1,1(0)
<i>Distance</i>	-2,9(0)	-2,7(0,0044)
<i>corr_diff</i>		0,63(0,031)
<i>unemp_diff</i>		0,77(0)
Adjusted R-square	0,5764	0,7473

Përfundime

Pagat, diferencat e të ardhurave dhe faktorë të tjerë nxisin emigrimin nga vendet më pak të zhvilluara. Procesi do të vazhdojë derisa ndryshimi në kërkesën për punë të jetë zero dhe si rezultat, rritet produktiviteti i përgjithshëm i punës. Punësimi i emigrantëve stimulon produktivitetin dhe investimet; ‘hendemku’ (i krijuar nga lëvizja e njerëzve) mund të kontribuojë në përparimin e vendeve të zhvilluara, kështu si rezultat, politikat e ardhshme duhet të stimulojnë investimet dhe rritjen ekonomike në të dy vendet, në atë të origjinës dhe të destinacionit. Emigrantët me kualifikim të lartë dhe të integruar mirë në tregun e punës kanë një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike dhe kontribuojnë në reduktimin e diferencave të pagave midis punëtorëve të huaj dhe vendas. Vendimi për të migruar ndikohet gjithashtu nga një rrjet i gjerë ndërmjetësish, që synon të maksimizojë fitimin e tyre individual. Ata gjithashtu veprojnë si agentë institucionalë që kontribuojnë në arritjen e ekuilibrave. Pavarësisht këtij kontributi, ndërmjetësit mund të ndikojnë në përzgjedhjen negative të emigrantëve.

Qëllimi kryesor i këtij artikulli ishte analiza e fenomenit të emigrimit nga disa vende të EQL dhe e përcaktuesve përkatës. Ne vlerësuar dy modele të gravitetit, duke përfshirë disa variabla të pavarur që lidhen me problemet tipike për vendet në zhvillim, siç janë varfëria, papunësia dhe korrupsioni. Sipas testeve diagnostikuese, ekuacioni i vlerësuar përshtatet mirë me mostrën tonë. Migrimi lidhet pozitivisht me PBB-në për frymë në vendet pritëse, popullsinë në vendet e origjinës dhe në vendin pritës, diferencën midis niveleve të papunësisë në vendet e origjinës dhe në vendet pritëse dhe dallimin midis indekseve të korrupsionit në vendet pritëse dhe në vendet e origjinës. Për më tepër, migrimi lidhet negativisht me GDP-në për frymë në vendet e origjinës dhe distancën dypalëshe. Autoritetet e vendeve të EQL duhet të orientojnë politikat e tyre drejt krijimit të vendeve të reja të punës, eliminimit të korrupsionit, si dhe zbutjes së pabarazisë. Kjo do të çojë në një rritje të qëndrueshme ekonomike dhe në minimizimin e fenomenit të migracionit.

Referenca

1. Personal remittances, received (current US\$) | Data [Internet]. Data.worldbank.org. 2018. Available from: <https://data.worldbank.org/indicator/bx.trf.pwkr.cd.dt>
2. GDP per capita (current US\$) | Data [Internet]. Data.worldbank.org. 2018. Available from: <https://data.worldbank.org/indicator/NY.GDP.PCAP.CD>
3. The World Factbook — Central Intelligence Agency [Internet]. Cia.gov. 2018. Available from: <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/fields/2046.html>
4. Migration and migrant population statistics-StatisticsExplained[Internet]. Ec.europa.eu. 2018. Available from: http://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Migration_and_migrant_population_statistics
5. Lee E. A theory of migration. Demography 1966; 3: 47-57.
6. Lewis W. Economic development with unlimited supplies of labor. Manchester School of Economic and Social Studies 1954; 22; 139-91.

7. Ranis G., Fei J. A theory of economic development. *American Economic Review* 1961; 51: 533-565.
8. Harris J., Todaro M. Migration, unemployment, and development: a two-sector analysis. *American Economic Review* 1970; 60: 126-142.
9. Piore M. *Birds of passage: migrant labour in industrial societies*. Cambridge; Cambridge University Press; 1979.
10. Borjas G. The economics of immigration. *Journal of Economic Literature* 1994; 32(4):1667-1717
11. Guilmoto C., Sandron F. The internal dynamics of migration networks in developing countries. *Population: An English Selection* 2001; 13(2): 135-164.
12. Beine M., Bertoli S., Moraga J. A practitioners' guide to gravity models of international migration. *The World Economy* 2016; 1-17.
13. Cuaresma J.C., Moser M., Raggl A. On the Determinants of Global Bilateral Migration Flows, *WWW for Europe Working Papers series* 2013; 5.
14. Grogger J., Hanson G. Income maximization and the selection and sorting of international migrants. *Journal of Development Economics* 2011; 95(1); 42-57.
15. Kim K., Cohen J. Determinants of international migration flows to and from industrialized countries: a panel data approach beyond gravity. *International Migration Review* 2010; 44(4); 899-932.
16. Ortega F., Peri G. The effect of income and immigration policies on international migration. *Migration Studies* 2013; 1(1); 47-74.
17. Poprawe M. On the relationship between corruption and migration: empirical evidence from a gravity model of migration. *Public Choice* 2015; 163 (3-4).
18. Ramos R., Suriñach J. A Gravity Model of Migration Between the ENC and the EU. *Tijdschrift voor economische en sociale gjeografie* 2017; 108(1); 21-35.
19. Mayer T., Zignago. S. Notes on CEPII's distances measures: The GeoDist Database. *CEPII Working Paper* 2011; 25.



Viti i IX-të i Botimit, Nr. 1,
Qershor 2018

ANALIZË MBI PROBLEMATIKAT E TIK NË ARSIM

Besjana Tosuni

Departamenti i Inxhinierive, Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, Albanian University

Adresë kontakti: b.tosuni@hotmail.com

Përmbledhje

Rritja e përdorimit dhe efektivitetit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në arsim është një prioritet i qartë i qeverisë shqiptare. Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar (SZHAPU) 2014-2020, ka si qëllim rritjen e fondeve për fuqizimin dhe përmirësimin e digjitalizimit në procesin e të nxënës. Pavarësisht nga strategjitë e rëndësishme të politikave për TIK në arsim, ka akoma shumë sfida. Politika dhe veprimi duhet të gjejnë balancën e duhur midis zbatimit të qëllimeve kryesore arsimore dhe përshtatjes së tyre sipas nevojave të veçanta të shkollave dhe të rajoneve.

Pajisja me lidhje interneti në shkollat fillore dhe të mesme në Shqipëri mbetet një sfidë, megjithatë përdorimi në rritje i TIK në arsim shihet si prioritet për të rritur cilësinë dhe rëndësinë e arsimimit, mësimdhënien efektive dhe për të ofruar më shumë informacion dhe shërbime për komunitetet dhe grupet e marginalizuara.

Ky punim hedh dritë mbi problematikat aktuale të përdorimit të TIK në arsim, duke u ndalur në fakte dhe diskutime. Pasi jepet një vështrim i përgjithshëm i gjendjes aktuale, nxirren konkluzione dhe jepen rekomandimet përkatëse. Bazuar në faktet e prezantuara, dalin katër çështje të përgjithshme të politikës arsimore, të cilat kërkojnë përpunim të mëtejshëm dhe vëmendje politike.

Fjalë çelës: dixhitalizim, politika arsimore, reformë, rekomandime, TIK.

ANALYSIS OF ICT ISSUES IN EDUCATION

Abstract

Increasing the use and effectiveness of ICT in education is a clear priority of the Albanian government. The Strategy for the Development of Pre-University Education (SZHAPU) 2014-2020 aims to increase funds for strengthening and improving digitalization in the learning process. Despite important ICT policy strategies in education, there are still many challenges. Policies and action must find the right balance between the implementation of the main educational goals and their adaptation to the needs of schools and regions.

Internet access in primary and secondary schools in Albania remains a challenge, however, the growing use of ICT in education is recognized as a priority to enhance the quality and importance of education, effective teaching, and to provide more information and services to communities and marginalized groups.

This paper sheds light on current issues of ICT use in education, focusing on facts and

discussions. Once an overview of the current situation is given, conclusions are drawn, and proper recommendations are given. Based on the facts presented, four general issues of educational policy arise, which require further elaboration and political attention.

Keywords: digitalization, education policy, reform, recommendations, ICT.

I. Hyrje

Rritja e përdorimit dhe efektivitetit të TIK-ut në arsim është një prioritet i qartë i qeverisë shqiptare. Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar (SZHAPU) 2014- 2020, ka si qëllim rritjen e fondeve për fuqizimin dhe përmirësimin e digjitalizimit në procesin e të nxënës. Qëllimi i mëtejshëm i Shqipërisë për të kapërcyer hendekun digjital dhe për të fuqizuar rininë nëpërmjet investimeve në rritje, në kapacitete dhe në përdorimin e TIK-ut në arsim, është i qartë. Kompetenca digjitale është një nga kompetencat kyçe, pjesë përbërëse e kornizës kurrikulare të Shqipërisë. Politikat e kohëve të fundit kanë treguar prioritetet e qeverisë në fushën e TIK-ut në arsim. Në fushën e rritjes së numrit të të rinjve, të rriturve, përfshi mësuesit që njohin dhe përdorin teknologjitë e komunikimit dhe informacionit (TIK), politikat shqiptare të kohëve të fundit janë në koherencë me qëllimet e SDG4.

Pavarësisht nga strategjitë e rëndësishme të politikave për TIK-un në arsim, ka akoma shumë sfida. Politika dhe veprimi duhet të gjejnë balancën e duhur midis zbatimit të qëllimeve kryesore arsimore dhe përshtatjes së tyre sipas nevojave të veçanta të shkollave dhe të rajoneve. Është e rëndësishme të arrihet një konsensus midis të gjitha palëve të interesuara, përfshirë drejtuesit e shkollave, pasi ata janë më të gatshëm të pranojnë ndryshimin, nëse e kuptojnë arsyen dhe domosdoshmërinë e reformave.

Pajisja me lidhje interneti në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta në Shqipëri mbetet një sfidë, megjithatë përdorimi në rritje i TIK-ut në arsim njihet si prioritet për të rritur cilësinë dhe rëndësinë e arsimimit, mësimdhënien efektive dhe për të ofruar më shumë informacion dhe shërbime për komunitetet dhe grupet e marginalizuara.

Sipas CBR prioritetet në fushën e TIK-ut në arsim në SZHAPU janë:

- Pajisja e shkollave me infrastrukturën për përdorimin e informacionit (kompjuter, laptop, smart table, tabletë).
- Internet me shpejtësi të lartë dhe mundësi hyrjeje në internet në ambiente të tjera të shkollës, jo vetëm në laboratorë.
- Mbështetje teknike që të sigurojë përdorimin efikas të infrastrukturës. [2]

Përdorimi i pajisjeve të TIK-ut dhe i lidhjeve me internet janë të kufizuara vetëm për laboratorët e kompjuterëve. (IZHA, 2015), Statistikat e ministrisë, venë në dukje se ka 1496 laboratorë kompjuterësh në shkolla në të gjithë Shqipërinë.

Në varësi të madhësisë së shkollave, laboratorët e kompjuterëve janë pajisur me 5 deri në 15 kompjuter për nxënësit dhe një për mësuesin. Sipas të dhënave të raportuara në Agjendën Digjitale 2015-2020, si edhe informacionit të përditësuar nga palët e interesuara, shumë nga 15731 kompjuterët dhe 1631 laptopët në shkollat e Shqipërisë nuk janë funksionalë [8]. Kompjuterët në laborator, përveç se janë të lidhur me internetin, nuk janë të pajisur me programe ose aplikacione për lëndët mësimore (MSHIAP). Kjo mund të ndryshojë me zbatimin e kurrikulës së re. Për

shembull, disa tekste shkollore të reja për shkollat e arsimit të mesëm të lartë kanë përmbajtje digjitale të hartuar nga botuesit për arsimin.

Sipas palëve të interesuara, projekti pilot me tableta, i zbatuar në 2015, rriti modernizimin dhe digjitalizimin e sistemit arsimor duke krijuar 120 klasa ndërvepruese me disa tabela smart, në 60 shkolla të mesme në gjithë Shqipërinë. Klasat ndërvepruese menaxhohen në nivel qendror. Gjatë intervistave nga grupi i punës së UNESCO-s për këtë dokument, u vu në dukje se shërbimet e internetit në shkolla nuk janë pjesë e shërbimeve publike kombëtare, por menaxhohen nga kompani private. Për më tepër, cilësia e shërbimit të rrjetit dhe infrastruktura nuk garantohen ose maten nga standarde kombëtare. Së fundi, u konstatua se nuk ka një periudhë të përcaktuar qartë për rinovimin e infrastrukturave të shkollave për TIK-un. Duke u bazuar në ato që deklarojnë drejtuesit, mësuesit dhe nxënësit, pengesa kryesore për përdorimin e TIK-ut ishte pamjaftueshmëria e pajisjeve.

II. Problematikat e përdorimit të TIK në arsim

Duke u bazuar tek faktet e paraqitura në fushën e TIK-ut në arsim, janë identifikuar katër problematikat kryesore.

- *1. Mungesa e një infrastrukture të qëndrueshme dhe e burimeve digjitale, pengojnë përdorimin e TIK-ut në shkolla.[1]*

Një nivel i caktuar për infrastrukturën teknologjike është kusht i domosdoshëm për të përdorur në mënyrë efektive teknologjitë në procesin mësimor. Për një zgjidhje të qëndrueshme, infrastruktura e TIK-ut duhet të përfshijë aspekte pedagogjike, si zhvillimi i kompetencës digjitale të mësuesve dhe ofrimi sa më shumë i përmbajtjes digjitale për mësimdhënie. Për më shumë, hartimi i një plani të qëndrueshëm që nga fillimi i një politike është një pikë e mirë fillimi për një zhvillim më efektiv të TIK-ut në arsim.

- *2. Mësuesve u nevojiten aftësi bazë pedagogjike më të forta për përdorimin e TIK-ut.*

Mësuesit luajnë një rol të rëndësishëm në përdorimin efektiv të TIK-ut për qëllime mësimore. Arsimi fillestar i mësuesve, trajnimet paraprake të mësuesve dhe të atyre në sistem, si edhe zhvillimi i vazhdueshëm profesional (ZHVP) kontribuojnë në forcimin e kompetencës digjitale të mësuesve. Këto përfshijnë zhvillimin e aftësive në TIK-ut për kodim, aftësitë për zhvillimin e TIK-ut si lëndë mësimore dhe aftësitë për të përdorur TIK-un në lëndët e tjera mësimore.

Përdorimi i kompjuterëve dhe/ose tabletave është i domosdoshëm, por jo kusht i mjaftueshëm për përdorimin e TIK-ut në mësimdhënie dhe nxënie. Të pasurit e mbështetjes pedagogjike dhe teknike në nivel shkolle është i rëndësishëm, pasi siguron që mësuesit të përdorin TIK-un në mësimdhënie. Drejtuesit në nivel shkolle duhet që sigurimin e një mbështetjeje të tillë ta bëjnë prioritet të qëllimeve të procesit mësimor në shkollë. Sipas CBR, mësuesit në Shqipëri nuk janë të përgatitur për përdorimin e teknologjisë së re në mësimdhënie. Aftësitë që mësuesit duhet të zhvillojnë gjatë trajnimit të tyre fillestar për përdorimin e teknologjisë në klasë, për qëllime pedagogjike përfshijnë njohuritë bazë kompjuterike, lundrimin në internet, përdorimin e tabelave elektronike, krijimin e materialeve mësimore digjitale, komunikimin me postë elektronike dhe njohuri bazë për krijimin e faqeve në ueb. Për përmirësimin e aftësive të mësuesve në TIK, në reformën e arsimit të lartë që është duke u zhvilluar, thuhet se mësuesit duhet të kenë aftësi të TIK-

ut gjatë trajnimit të tyre fillestar.[5]

- 3. *Përmirësimi i sigurisë në internet për fëmijët dhe të rinjtë duhet të jetë një prioritet shumë i rëndësishëm.*

Në botën e sotme të internetit, siguria është një shqetësim kryesor. Mundësitë e mëdha të hyrjes në internet bëjnë që nxënësit, të rinjtë dhe njerëz nga shtresat në nevojë të përballen me kërcënime serioze, si cyberbulling, përmbajtje informacioni të papërshtatshme dhe veprime të ndaluara ligjërisht. Pajisja me informacion mbi rreziqet në internet, masat mbrojtëse dhe praktikatat e sigurta në internet duhet të jenë një prioritet i rëndësishëm në Shqipëri.

Një studim i kohëve të fundit i bërë nga World Vision International (2016) me 821 të anketuar të moshës 13-18 vjeç, tregoi se përmirësimi i sigurisë në internet duhet të jetë një prioritet. Rreth 44% e të anketuarve raportuan se e përdornin internetin për të parë çdo ditë materiale pornografike, ndërsa 62% konfirmuan se kanë shokë që vizitojnë faqe të ngjashme.[12] Të gjithë bien dakord që politika për mbrojtjen e fëmijëve në internet mbështetet tek angazhimi dhe përgjegjësitë e përbashkëta të të gjithë palëve të interesuara. Për të vepruar në mënyrë efektive, qeveritë dhe mësuesit duhet të ngrenë shkallën e ndërgjegjësimit të prindërve mbi rrezikun e mundshëm të internetit dhe t'i pajisin ata me mjetet e duhura për të rritur shkallën e sigurisë së fëmijëve të tyre. Kështu që mësuesit kanë përgjegjësinë të forcojnë njohuritë e fëmijëve dhe të prindërve mbi internetin. Në mënyrë që të përballen me sfidat e përdorimit të internetit, mësuesit, koordinatorët e TIK-ut dhe drejtuesit e shkollave duhet të marrin trajnim të rregullt mbi problemet e sigurisë në internet. Shqipëria duhet të promovojë politika të sigurisë elektronike që përfshijnë gjithë shkollën, duke siguruar që fëmijët dhe të rinjtë e përdorin TIK-un në mënyrë të përshtatshme dhe të sigurt. Për të qenë efektive, këto politika duhet të zbatohen nga i gjithë komuniteti i shkollës, përfshi stafin e mësuesve dhe nxënësit, të cilët e përdorin internetin në shkollë dhe jashtë saj.

- 4. *Shqipëria do të përfitonte nga një sistem qendror vlerësimi dhe nga udhëzuesit kombëtarë mbi përdorimin e TIK-ut në arsim.*

Deri në vitin 2017, palët e interesuara që u intervistuan nga grupi i punës së UNESCO-s raportuan se Shqipëria nuk ka asnjë sistem qendror monitorimi dhe vlerësimi, asnjë udhëzues kombëtar që ka të bëjë me përdorimin e TIK-ut për qëllime vlerësimi, si dhe asnjë plan të qartë kërkimor mbi TIK-un. [4]

Të dhënat mbi disponueshmërinë dhe cilësinë e burimeve të TIK-ut, si edhe të trajnimit të mësuesve të TIK-ut janë shumë të rralla në Shqipëri. Është e vështirë të sigurohet informacion i saktë përsa i përket përdorimit të TIK-ut në shkolla. Për shembull, palët e interesuara nuk e dinin me saktësi gjerësinë e bandës së internetit në shkolla, nëse kompjuterët dhe programet kompjuterike janë të vjetruara apo moderne, numrin e personelit që trajnohet për TIK-un, aftësitë kompjuterike të mësuesve, praninë e mbështetjes pedagogjike e teknike në shkolla dhe se si teknologjitë përdoren për qëllime arsimore dhe administrative. Politika aktuale dhe institucionet që kanë të bëjnë me TIK-un në arsim, janë shumë të fragmentuara për të përmbushur aspiratat kombëtare në rritje dhe kërkesat globale. [6] Shqipëria do të përfitonte nga zhvillimi i një infrastrukture të qëndrueshme dhe gjerësisht të disponueshme, si edhe nga burime digjitale për mësimin, përmirësimi i aftësive bazë dhe pedagogjike të mësuesve në TIK, rritja e ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe nxënësve mbi rreziqet e internetit; zbatimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi dhe zhvillimi i udhëzuesve

kombëtarë në përdorimin e TIK-ut për qëllime vlerësimi. Politikat kombëtare të TIK-ut në arsim do të kenë ndikim më të madh nëse ato janë në përputhje me politikat e tjera strategjike dhe operacionale, veçanërisht atyre që rrisin cilësinë, barazinë dhe gjithëpërfshirjen në arsim.

III. Rekomandimet për problematikat e hasura

REKOMANDIME PËR ÇËSHTJEN 1

Rritja e investimeve në shërbime dhe materiale që mbështesin përdorimin efektiv të TIK-ut në shkolla.

- 1.1 Plotësimi i nevojave për një infrastrukturë TIK-u të qëndrueshme dhe gjerësisht të përdorshme, duke vendosur qëllime të qarta afatmesme dhe afatgjata për të zgjeruar pajisjet dhe lidhjet me internet.
- 1.2 Rritja e investimeve në infrastrukturën e TIK-ut dhe lidhjen e internetit në zonat e largëta.
- 1.3 Rritja e investimeve për burimet e të nxënësve digjital.
- 1.4 Përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit për sistemin parauniversitar, si dhe bazën elektronike të të dhënave për arsimin e lartë.
- 1.5 Rritja e investimeve në burimet njerëzore që janë të domosdoshme për përdorimin e këtyre mjeteve. [9]

REKOMANDIME PËR ÇËSHTJEN 2

Investimi tek mësuesit për të ndërtuar kapacitete për një përdorim efektiv të TIK-ut në shkolla.

- 2.1 Zbatimi i reformës së arsimit të lartë, me fokus të veçantë për arsimimin e mësuesve kandidatë dhe zhvillimi i një sistemi kombëtar për të monitoruar zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive të TIK-ut të mësuesve në sistem dhe atyre që do hyjnë në sistem. [11]
- 2.2 Bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë për të hartuar dhe zbatuar iniciativa për zhvillimin profesional, me synim trajnimin e mësuesve në sistem dhe mësuesve të TIK-ut në veçanti, për përdorimin e TIK-ut për arsye mësimore.
- 2.3 Inkurajimi i bashkëpunimit midis mësuesve dhe drejtuesve të shkollës me ekspertë të niveleve të ndryshme në përdorimin e TIK-ut për qëllime mësimdhënieje dhe nxënieje.

REKOMANDIME PËR ÇËSHTJEN 3

Mbrojtja e rinisë dhe shtresave të pambrojtura të shoqërisë nga veprimtaria e rrezikshme në internet.

- 3.1 Duke bashkëpunuar me institucionet arsimore, të rrisim ndërgjegjësimin e fëmijëve, adoleshentëve, të rinjve dhe familjeve të tyre mbi situatat problematike në internet. [3]

REKOMANDIME PËR ÇËSHTJEN 4

Zhvilloni mjete dhe sisteme që do ta zgjerojnë përdorimin dhe funksionalitetin e TIK –ut në arsim .

- 4.1 Zhvillimi i një sistemi qendror për mbledhjen periodike (vjetore dhe dyvjetore) dhe publikimin e statistikave që përmbajnë të dhëna për infrastrukturën, pajisjet, trajnimet, burimet mësimore, burimet vlerësuese dhe përdorimin e TIK-ut. [10]
- 4.2 Hartimi i një platforme për zbatimin e TIK-ut në arsim dhe udhëzues kombëtarë për përdorimin e TIK-ut në arsim.

IV. Rekomandime mbi politikat sipas nivelit të vlerësuar të përparësisë, vështirësisë, kostove dhe afateve kohore

Tabela 1. Aspekti vendimmarrës dhe kuadri kohor i rekomandimeve mbi çështjen e parë

Çështja 1	Aspekti vendimmarrës (I Lartë/ I Mesëm/ I Ulët)			Kuadri kohor		
Rekomandime	Përparësia	Vështirësia	Kostot	Afat shkurtër	Afat mesëm	Afat gjatë
1.1 Plotësimi i nevojave për një infrastrukturë TIK-u të qëndrueshme dhe gjerësisht të përdorshme duke vendosur qëllime të qarta afatmesme dhe afatgjata për të zgjeruar pajisjet dhe lidhjet me internet.	L	M	L			
1.2 Rritja e investimeve në infrastrukturën e TIK-ut dhe lidhjen e internetit në zonat e largëta.	L	L	L			
1.3 Rritja e investimeve për burimet e të nxënit digjital.	L	M	L			
1.4 Përmirësimi dhe mirëmbajtja e sistemit të informacionit për sistemin parauniversitar, si dhe bazën elektronike të të dhënave për arsimin e lartë.	L	M	L			
1.5 Rritja e investimeve në burimet njerëzore që janë të domosdoshme për përdorimin e këtyre mjeteve.	L	M	M			

Tabela 2. Aspekti vendimmarrës dhe kuadri kohor i rekomandimeve mbi çështjen e dytë

Çështja 2	Aspekti vendimmarrës (I Lartë/ I Mesëm/ I Ulët)			Kuadri kohor		
Rekomandime	Përparësia	Vështirësia	Kostot	Afat shkurtër	Afat mesëm	Afat gjatë
2.1 Zbatimi i reformës së arsimit të lartë, me fokus të veçantë për arsimimin e mësuesve kandidatë dhe zhvillimi i një sistemi kombëtar për të monitoruar zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive të TIK-ut të mësuesve në sistem dhe atyre që do hyjnë në sistem.	L	M	M			
2.2 Bashkëpunimi me donatorë ndërkombëtarë për të hartuar dhe zbatuar iniciativa për zhvillimin profesional, me synim trajnimin e mësuesve në sistem dhe mësuesve të TIK-ut në veçanti, për përdorimin e TIK-ut për arsye mësimore.	L	M	U			
2.3 Inkurajimi i bashkëpunimit midis mësuesve dhe drejtuesve të shkollës me ekspertë të niveleve të ndryshme në përdorimin e TIK-ut për qëllime mësimdhënieje dhe nxënieje.	M	U	M			

Tabela 3. Aspekti vendimmarrës dhe kuadri kohor i rekomandimeve mbi çështjen e tretë

Çështja 3	Aspekti vendimmarrës (I Lartë/ I Mesëm/ I Ulët)			Kuadri kohor		
Rekomandime	Përparësia	Vështirësia	Kostot	Afat shkurtër	Afat mesëm	Afat gjatë
3.1 Duke bashkëpunuar me institucionet arsimore, të rrisim ndërgjegjësimin e fëmijëve, adoleshentëve, të rinjve dhe familjeve të tyre mbi situatat problematike në internet.	L	M	M			

Tabela 4. Aspekti vendimmarrës dhe kuadri kohor i rekomandimeve mbi çështjen e katërt

Çështja 4	Aspekti vendimmarrës (I Lartë/ I Mesëm/ I Ulët)			Kuadri kohor		
Rekomandime	Përparësia	Vështirësia	Kostot	Afat shkurtër	Afat mesëm	Afat gjatë
4.1 Zhvillimi i një sistemi qendror për mbledhjen periodike (vjetore dhe dyvjetore) dhe publikimin e statistikave që përmbajnë të dhëna për infrastrukturën, pajisjet, trajnimet, burimet mësimore, burimet vlerësuese dhe përdorimin e TIK-ut.	M	M	M			
4.2 Hartimi i një platforme për zbatimin e TIK-ut në arsim dhe udhëzues kombëtarë për përdorimin e TIK-ut në arsim.	L	L	L			

Referenca

1. Abdurrahmani, T. The Teacher Qualification Scheme: A Case of Albania. *Problems of Education in the 21st Century*, Vol. 55. 2013. <http://oaji.net/articles/2014/457-1420054869.pdf> (Accessed 3 September 2015.)
2. Blink, D. and Ciko, I. *SDG National Action Plan and Baseline Report Assignment Briefing Presentation* 2017, 156-158.
3. BIRN (Balkan Investigative Reporting Network). *Albania Illegally Axed Headmasters, Report Says*. www.balkaninsight.com/en/article/albania-illegally-axed-headmasters-report-says. 2014., 45-48. (Accessed 5 November 2015.)
4. European Commission. (European Commission/EACEA/Eurydice). *The Teaching Profession in Europe: Practices, Perceptions and Policies*. Eurydice Report. Luxembourg, Publications Office of the European Union 2015, 129-132.
5. <http://www.anefore.lu/wp-content/uploads/2015/09/EURYDICE-THE-TEACHING-PROFESSION.pdf> (Accessed 1 November 2015.)
6. Gardinier, M. *Chapter 6: Albania: An overview*, in *Education in Non-EU Countries in Western and Southern Europe*, edited by Terra Sprague. Bloomsbury, London, 2016, 167-173.
7. Harizaj, A.. *A case study of Albania's participation in PISA 2009*. CEPS Journal 1: 3, 2011, pp. 97-118.
8. Ministria e Arsimit dhe Sporteve. *Reforma E Sistemit Arsimor Parauniversitar: Raporti Paraprak* [Pre-University Education System Reform: Preliminary Report]. Tirana. (In Albanian.) http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/parauniversitar/RAPORTI_Korrik.pdf (Accessed 29 February 2016.)
9. MSHIAP (Ministry of State for Innovation and Public Administration), (no date). *Cross-cutting strategy "Digital agenda of Albania 2015-2020"*. Available at http://www.inovacioni.gov.al/files/pages_files/Digital_Agenda_Strategy_2015_-_2020.pdf (Accessed on January 29, 2016.)
10. *Strong Performers and Successful Reformers in Education: Lessons from PISA for the United States*. Paris, OECD Publishing. 2011b., 121-123. <http://dx.doi.org/10.1787/9789264096660-en>. (Accessed 22 October 2015.)
11. *Albania - Education Excellence and Equity Project*. Washington, DC, World Bank Group. 2014a. <http://documents.worldbank.org/curated/en/2014/03/19368623/albania-education-excellence-equity-project> (Accessed 12 October 2015.)
12. World Vision International. *A Study on Child Online Safety in Albania* 2016, 98-99. <http://www.wvi.org/albania/publication/study-child-online-safety-albania> (Accessed 31 January 2016.)

Shtojca A

Lista e shkurttimeve

CBR Country Background Report/Raporti mbi Informacionin Paraprak të Vendit.

CPD/ZHPV Continuing Professional Development/Zhvillimi i Vazhduar Profesional.

ICT/TIK Information and Communication Technology/Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit.

IED/IZHA Institute of Educational Development/Instituti i Zhvillimit të Arsimit.

MSHIAP/MSHIAP Ministry of State for Innovation and Public Administration/Ministria e Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike.

PUEDS/SZHAPU Pre-University Education Development Strategy/Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar.

SIE/ISHA State Inspectorate of Education/Inspektoriati Shtetëror i Arsimit.

UNESCO United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization/Organizata për Kulturë, Shkencë dhe Arsim e Kombeve të Bashkuara.



Viti i IX-të i Botimit, Nr.1,
Qershor 2018

UDHËZIME PËR AUTORËT

Materialet (artikujt) i adresohen revistës *OPTIME*. Ato i nënshtrohen vlerësimit të redaksisë, e cila miraton për botim, pasi ka bërë modifikimet eventuale.

Materiali i dërgohet sekretariatit të redaksisë së *Albanian University* në adresën *Bulevardi Zogu I, Tiranë, znj. Eglantina Dervishi, email: egladervishi@yahoo.com dhe Erda Qorri, email: erdaqorri@gmail.com*

Materiali dorëzohet në 3 kopje (një origjinal dhe 2 fotokopje), si dhe në formën elektronike (me disketë). Ai duhet të shoqërohet me adresën e email-it të autorit me të cilin do të lidhet redaksia në vazhdim. Po ashtu, dorëzohet një formular, i cili duhet të firmoset nga autorët e tjerë që i delegojnë autorit kryesor kompetencat. Autorësia nënkupton që secili autor të këtë marrë pjesë në mënyrë të mjaftueshme në punim, aq sa të marrë përgjegjësi publike për përmbajtjen e tij. Renditja e autorëve përcaktohet nga vendimi i përbashkët i bashkautorëve.

Pasi kthehet materiali për rregullime nga autori/autorët, ai ridërgohet në formën përfundimtare.

Drejtshkrimi i gjuhës shqipe është i detyrueshëm. Nuk pranohet zëvendësimi i shkronjës **ë** dhe **ç**, përkatësisht me shkronjat **e** dhe **c**.

Materiali duhet të renditet sipas kësaj mënyre:

Faqja e titullit përmban:

Titullin

Emrin /emrat e autorëve (pa titujt shkencorë)

Adresat e të gjithë autorëve. Kur autorët janë në qendra të ndryshme pune, djathtas tyre bëhet një shenjë (që specifikohet më poshtë), p.sh.:

Emër Mbiemër *, Emër Mbiemër **, Emër Mbiemër ***

* Albanin University

** Fakulteti i Mjekësisë i UT

*** Ministria e Shëndetësisë

Adresa e plotë (përfshirë telefonin dhe email-in) e autorit që do të mbajë lidhje me revistën.

Abstrakti

Paraqitet në shqip dhe në versionin anglisht dhe përmban jo më shumë se 250 fjalë. Abstraktit në anglisht i vihet edhe titulli. Në abstrakt paraqitet qëllimi, metodat, rezultatet dhe përfundimet.

Poshtë abstraktit shkruhen fjalët kyçe. P.sh.:

Fjalë Kyçe: revistë, artikull, psikologji.

Materiali

Gjatë shtjellimit të materialit çdo referencë, figurë dhe tabelë numërohet në shifra arabe me numër rendor sipas rendit që citohen në tekst. Kur janë më shumë se 2 referenca, ato ndahen me presje).

Nuk përdoren shkurtime të tjera përveç atyre që janë përdorur në abstrakt.

Falënderimet, nëse ka, shtypen në mbarim të tekstit, pas referencave.

Referencat

Referencat shënohen në tekst me numërorë arabe sipas rendit që citohen.

Referencat shtypen në fletë të veçanta nga teksti me hapësirë dyfishe sipas stilit *Vancouver* (International Committee of Medical Journal Editors Uniform requirements for manuscripts submitted to biomedical journals). Kur lista e autorëve përbëhet nga 1 deri në 7 vetë, citohen që të gjithë. Kur ajo përmban më shumë se 7 vetë, citohen vetëm 3 të parët dhe pas të tretit, shënohet fjala et al. (ose me shkurtimin shqip *e bp.*).

Referencat përshkruhen si më poshtë:

1. Referenca e artikujve periodikë

Autorët ,Titulli, Revista, viti, volumi, faqe, p.sh. :

(1) Quilici J., Gallo R. Physiopatologie des syndromes coronariens aigus. Ann Cardiol. Angeiol 2009;148;611-23.

2. Referenca e një libri

Autori. Titulli, Vendi i botimit, Shtëpia botuese, Viti i botimit.

P.sh.:

(2) Cohen J. Return extrasystoles. New York; Grune and Stratton; 1996.

3. Referenca e një kapitulli libri

Autori kapitullit. Emri kapitullit. Emri i autorit të librit Emri i librit. Vendi i botimit. Shtëpia botuese. Viti botimit; faqet e kapitullit.

P.sh.:

(3) Baillet J. L'apport de la scintigraphie dans le diagnostic de l'embolie pulmonaire. Në: Chiche P La maladie thrombo-embolique pulmonaire Paris; L'Expansion scientifique française; 1969, f. 107-34.

Shkrimet që nuk u përmbahen këtyre udhëzimeve do t'u rikthehen autorëve për rishikim pa u marrë në shqyrtim.

Redaksia

